

NË GJYKATËN THEMELORE NË FERIZAJ

P. nr. 250/13

6 tetor 2016

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jetë i formës së prere dhe mund të jetë objekt i ankesës në bazë të ligjit të aplikueshëm.

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Piotr Bojarczuk, si kryetar i trupit gjykues, gjyqtarja e EULEX-it Marie Tuma dhe Gjyqtari Kosovar Musa Konxheli si anëtarë të panelit, me procesmbajtës Hysni Recica, në rastin penal kundër:

1. M. S.

Pseudonimi	X
Emri i babait	X
Data e lindjes	X
Vendi i lindjes	X
Gjinia	Mashkull
Adresa	X
Kombësia	Shqiptar
Shtetësia	Kosovar
Profesioni	X
Numri personal i identifikimit	X
I arrestuar	X

2. V. T.

Nofka	-
--------------	----------

Emri i babait	X
Data e lindjes	X
Vendlindja	X
Gjinia	Mashkull
Adresa	X
Kombësia	Albanian
Nënshtetësia	Kosovar
Profesioni	X
Numri personal i identifikimit	1X
Gjendja financiare	X
Gjendja familjare	X
Shkollimi	X
Masat kufizuese	X

Akuzuar me aktakuzën e Prokurorit Special PPS.nr. 5/12 me datë 27 dhjetor 2013 dhe parashtruar me Regjistrin e Gjykatës Themelore në Ferizaj/Uroševac me 27 dhjetor 2013,

Akuzuar me veprat penale të:

MS (dhe BSH):

Pika 1: SHPËRDORIM I POZITËS ZYRTARE në bashkëkryerje, në kundërshtim me Nenin 339 (1) dhe (2) në lidhshmëri me Nenin 23 të ish Kodit Penal të Kosovës (“KPK”), aktualisht penalizuar nën Nenin 422 në lidhshmëri me Nenin 31 të KPK-së 2013.

Pika 2: MARRJA E RRYSHFETIT në bashkëkryerje, në kundërshtim me Nenin 343 (1) në lidhshmëri me Nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht penalizuar nën Nenin 428 në lidhshmëri me Nenin 31 të KPK-së 2013.

Pika 3: USHTRIMI I NDIKIMIT në bashkëkryerje, në kundërshtim me Nenin 345 (1) në lidhshmëri me Nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht penalizuar nën Nenin 431 (1) dhe Nenin 31 të KPK-së 2013.

MS dhe VT

Pika 4: SHMANGJA NGA PAGESA E TAKSAVE TË DETYRUESHME DOGANORE në bashkëkryerje, në kundërshtim me Nenin 318, paragrafët 1 dhe 4, në lidhshmëri me Nenin 31 të KPK-së 2013.

MS:

Pika 5: DHËNIA E NDIHMËS KRYESVE PAS KRYERJES SË VEPRËS PENALE, në kundërshtim me Nenin 388 (1) të KPK-së 2013.

Pika 6: DHËNIA E NDIHMËS KRYESVE PAS KRYERJES SË VEPRËS PENALE, në kundërshtim me Nenin 388 (1) dhe (2) të KPK-së 2013.

Pika 7: MOSLAJMËRIMI I VEPRAVE PENALE APO KRYESVE TË TYRE, në kundërshtim me Nenin 386 (1) (nën-paragrafi 1.9) i KPK-së 2013.

Pika 8: MBAJTJA NË PRONËSI, NË KONTROLL OSE POSEDIM TË PAAUTORIZUAR TË ARMËVE, në kundërshtim me Nenin 374 paragrafi 1, në lidhshmëri me Nenin 120, pika 38, e KPK-së 2013.

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit kryesor në Gjykatën Themelore në Ferizaj/Uroševac (mbajtur në Kacanik/Kacanik dhe në Pallatin e Drejtësisë në, Veternik, Prishtinë) me 19 dhe 30 maj, 2 dhe 12 qershor, 10 dhe 11 korrik, 4 dhe 25 gusht, 8, 16, 19 dhe 30 shtator, 13 dhe 28 tetor, 13, 14 dhe 27 nëntor, 5, 8 dhe 15 dhjetor 2014 dhe 16, 26 dhe 30 janar dhe 10, 23, 24, 25, 26 shkurt 2015, 3 dhe 31 mars 2015 dhe 2 dhe 21, 23 dhe 27, 28 dhe 29 prill dhe 13, 15 dhe 27 maj 2015 dhe 22 dhe 29 qershor 2015 dhe 1, 2, 3, 9, 10, 11, 13, 22, 23 dhe 24 korrik 2015 dhe 2,

28 dhe 29 shtator 2015 dhe 6,13, 19 dhe 27 tetor, 16 dhe 20, 23 dhe 24 nëntor, 7 dhe 8 dhjetor 2015, 15 shkurt, 17 dhe 18 mars, 21 dhe 24 mars, 22, 25 dhe 26 prill, 21 korrik, 2 gusht, 5, 9 dhe 26 shtator dhe 4 dhe 6 tetor 2016 dhe në prani të Prokurorit të PSRK-së Z. Drew G. Engel, të pandehurit, M.S. dhe V.T. dhe avokatët e tyre mbrojtës, A.R. (më parë A.I.) dhe A.S. dhe në të cilat palët e dëmtuara kanë qenë ose prezent ose të ftuar që të gjithë;

Trupi gjykues, pas diskutimit dhe votimit sipas Nenit 357 paragrafi 2 dhe Neni 359 i Kodit të Procedurës Penale¹ (“KPP”) në seancë të hapur për publikun dhe në prani të palëve, gjykata lëshon dhe shpall si në vijim:

AKTGJYKIM

I pandehuri, M.S. me të dhëna personale si më lartë, është **FAJTOR** për;

M.S. (dhe B.SH.):

PIKA 1: SHPËRDORIM I POZITËS ZYRTARE në bashkëkryerje, në kundërshtim me Nenin 339, paragrafi 2, në lidhshmëri me paragrafin 1, në lidhshmëri me Nenin 23 të ish Kodit Penal të Kosovës (“KPK”), aktualisht penalizuar nën Nenin 422 në lidhshmëri me Nenin 31 të KPK-së 2013.

Sepse në qershor të vitit 2012, në Ferizaj, Kosovë dhe/ose diku tjetër në Kosovë, të pandehurit **M.S.**, si një person zyrtar, domethënë një toger në Policinë e Kosovës dhe Shef i njësisë së anti-trafikimit në Ferizaj (dhe **B.SH.**, si një person zyrtar, domethënë si një zyrtar policor), në bashkëkryerje dhe me qëllimin për të përfituar të mira materiale të paligjshme për veten e tyre, e kanë keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare, do të thotë kanë kërkuar para nga XH.B. dhe A.S., dhe duke u zgjeruar në anëtarët e tjerë të familjes së B

¹ Ligji Penal Nr.04/L-123

S (përkatësisht, 4750 Euro), duke u shkaktuar dëme financiare këtyre personave, në shkëmbim të premtimit për ta siguruar lirimin e B.S. nga paraburgimi, ose duke premtuar që ai nuk do të dënohet dhe/ose duke premtuar që do të siguroheshin që ai nuk do e vuaj dënimin e tij. Këto veprime të të pandehurve kanë përfshirë, në mes të gjerave tjera, propozime ndaj familjes S, se të pandehurit do ti kontaktonin dëshmitarët në mënyrë që ata ti ndërronin deklaratat e tyre kundër B.S., tu epnin dhurata Prokurorëve të caktuar në rastin e B.t, dhe të mbajnë dëshmi të caktuara kundër B.S. nga dosja e rastit që i është dhënë zyrës së Prokurorisë.

PIKA 2: MARRJA E RRYSHFETIT në bashkëkryerje, në kundërshtim me Nenin 343, paragrafi 1, në lidhshmëri me Nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht penalizuar nën Nenin 428 në lidhshmëri me Nenin 31 të KPK-së 2013.

Sepse në qershor të vitit 2012, në Ferizaj, Kosovë dhe/ose diku tjetër në Kosovë, të pandehurit **M.S.**, si një person zyrtar, domethënë një toger në Policinë e Kosovës dhe Shef i njësisë së anti-trafikimit në Ferizaj (dhe **B.SH.**, si një person zyrtar, domethënë si një zyrtar policor), në bashkëkryerje kanë kërkuar dhe pranuar një dhurtaë apo një përfitim tjetër për veten e tyre (do të thotë një pagesë monetare që arin shumën totale përafërsisht në vlerën e 4750 Euro) për të kryer në kuadër të autoritetit të tyre një akt zyrtar apo tjetër të cilin ai ose ajo nuk duhet ta kryejë apo që kanë mundur ta kryej ose të dështojnë për ta kryer një akt zyrtar apo tjetër të cilën ata është dashur apo kanë mundur që ta kryejnë, në mënyrë që ose ta sigurojnë lirimin e B.S. nga paraburgimi, ose që të siguronin që ai të mos dënohej dhe/ose të siguroheshin që ai të mos e vuajë dënimin e tij. Këto veprime të të pandehurve kanë përfshirë, mes tjerash, propozimet në familjen S.se të pandehurit do ti kontaktonin dëshmitarët në mënyrë që ata ti ndryshojnë deklaratat e tyre kundër B.S., tu japin dhurata prokurorëve të caktuar në rastin e tij, dhe të mbanin prova të caktuara kundër B.S. nga dosja e rastit që i është dhënë zyrës së prokurorisë.

PIKA 3: USHTRIMI I NDIKIMIT në bashkëkryerje, në kundërshtim me Nenin 345 paragrafi 1, në lidhshmëri me Nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht penalizuar nën Nenin 431 paragrafi 1, në lidhshmëri me Nenin 31 të KPK-së 2013.

Sepse në qershor të vitit 2012, në Ferizaj, Kosovë dhe/ose diku tjetër në Kosovë, të pandehurit M.S. (dhe B.SH.), në bashkëkryerje, kanë kërkuar dhe e kanë pranuar një ofertë (do të thotë pagesë monetare që arrin shumën në përafërsisht 4750 Euro) të një përfitimi të paligjshëm për veten e tyre shkëmbim të ushtrimit të një ndikimi të pa vend nga ana e kryesit të veprës ndaj procesit të vendim marrjes së një personi zyrtar në mënyrë që ose ta siguronin lirim e B.S. nga paraburgimi, ose të siguroheshin që ai të mos dënohet dhe/ose të siguronin që ai të mos e vuajë dënimin e tij, pa marrë parasysh nëse ndikimi është ushtruar ose nëse po ose jo ndikimi i supozuar shpie në rezultatin e synuar.

M.S. (dhe V.T.):

PIKA 4: SHMANGJA NGA PAGESA E TAKSAVE TË DETYRUESHME DOGANORE në bashkëkryerje, në shkelje të Nenit 318, paragrafët 1 dhe 4, në lidhshmëri me Nenin 31 të KPK-së 2013.

Sepse V.T. qëllimisht ka bërë shmangjen e pagesës së tarifës së tatimit doganor apo tarifave të tjera apo obligimet doganore për pagesën e importimit të mallrave, përkatësisht, një makinë e tipit Renault Clio, me tabela të regjistrimit Franceze me numër XX-XXX-XX, duke përfshirë edhe intervenimin e të pandehurit M.S. kur V.T. është ndaluar nga policia me datë 28 maj 2013, për ta shmangur pagesën e tarifave doganore apo obligimeve përndryshe të pagueshme, apo me konfiskimin e makinës së lartpërmendur. M.S. pastaj ka intervenuar në mënyrë të sigurojë që V.T. ta marri një “gjobë simbolike”, dhe në këtë mënyrë me qëllim ia kanë mundësuar V.T.t që ti shmangi pagesat e tarifave doganore, tarifat tjera apo obligimet doganore të pagueshme për makinën e sipërpërmendur. Duke vepruar në këtë mënyrë, M.S. po ashtu ia ka mundësuar V.T.t që ta shmangi konfiskimin e mallrave, do të thotë të makinës së sipërpërmendur, të cilat nuk janë deklaruar saktë apo vlera e pagesës.

M.S. :

PIKA 5: DHËNIA E NDIHMËS KRYESVE PAS KRYERJES SË VEPRËS PENALE, në kundërshtim me Nenin 388, paragrafi 1 i KPK-së 2013.

Sepse me 28 maj 2013, në Ferizaj, Kosovë, apo diku tjetër në Kosovë, i pandehuri **M.S.** është lajmëruar me telefon nga një person i quajtur **V.T.** se ky i fundit ishte ndaluar në rrugë nga policia për shkak se voziste një automjet të paregjistruar si deh nuk i kishte paguar tarifat doganore për këtë automjet, më specifikisht një Renault Clio, me tabela të regjistrimit Franceze XX-XXX-XX. Sipas kërkesës së V T, **M.S.** ka folur me zyrtarin policor i cili e kishte ndaluar V.T. dhe e ka bindur këtë zyrtar policor për të ia lëshuar vetëm një dënim për kundërvajtje. Duke vepruar në këtë mënyrë, M.S. e ka ndihmuar V.T. si kryes i një krimi (do të thotë që ti shmanget pagesës së detyrueshme të tarifave doganore në kundërshtim me Nenin 318 paragrafi 1 i KPK-së) që ti shmanget zbulimit ose arrestit.

PIKA 6: DHËNIA E NDIHMËS KRYESVE PAS KRYERJES SË VEPRËS PENALE, në kundërshtim me Nenin 388 paragrafët 1 dhe 2 të KPK-së 2013.

Sepse me 29 maj 2013, në Ferizaj, Kosovë ose diku tjetër në Kosovë, i pandehuri **M.S.** është informuar se **R.A.** kishte shtënë në një makinë afër një restorani të quajtur, “International” dhe jo vetëm që M.S. nuk e kishte raportuar këtë incident, ai në mënyrë aktive kishte intervenuar tek viktimat, për të mos e raportuar këtë incident në polici. Duke vepruar në këtë mënyrë M.S. e ka ndihmuar R.A.N si kryes i një krimi (do të thotë shkelje e nenit 365(1) “Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm” dhe neni 375(2) “Përdorimi i armës ose i një instrumenti të rrezikshëm” të KPK-së 2013, të cilat janë vepra penale nën kapitullin XXX –Veprat penale me armë të KPK-së 2013) për ta shmangur zbulimin ose arrestimin dhe ka ndërmarrë hapa në drejtim të pengimit të arrestimit, ekzekutimit apo dënimit të R.A.T duke siguruar që R A të mos raportohet për veprën penale që e ka kryer.

PIKA 7: MOSLAJMËRIMI I VEPRAVE PENALE APO KRYESVE TË TYRE, në kundërshtim me Nenin 386 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.9 i KPK-së 2013.

Sepse me 29 maj 2013, në Ferizaj, Kosovë ose diku tjetër në Kosovë, i pandehuri **M.S.** ishte informuar se **R.A.** kishte shtënë në një makinë afër një restorani të quajtur “International” dhe M.S. më pas nuk e kishte raportuar këtë incident, e cila përbën veprë penale (do të thotë shkelje të Nenit 365(1) “Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm” dhe Neni 375(2) “Përdorimi armës ose i një instrumenti të rrezikshëm” të KPK-së 2013, të cilat që të dyja janë vepra penale nën Kapitullin XXX – Veprat penale me armë të KPK-së 2013).

PIKA 8: MBAJTJA NË PRONËSI, NË KONTROLL OSE POSEDIM TË PAAUTORIZUAR TË ARMËVE, në kundërshtim të nenit 374 paragrafi 1, në lidhshmëri me nenin 120, pika 38, e KPK-së 2013.

Sepse me 11 shtator 2013, **M.S.** ka pasur në pronësi, në kontroll apo ka poseduar një sasi prej 48 plumbash ose të municionit, pa pasur në posedim një leje të duhur siq kërkohet nga ligji; dhe ka pasur në pronësi, në kontroll apo ka poseduar një sasi prej 50 plumbash “gazi” të cilat janë të ndaluara me ligjin për Armët në Nenin 4, paragrafi 1.1.10, dhe kështu duke e shkelur ligjin në fuqi (Ligjin mbi Armët).

ARSYETIMI

A. KOMPETENCAT E TRUPIT GJYKUES

1. Në bazë të Nenit 11 (1) të Ligjit mbi Gjykatat, Ligji Nr. 03/L-199, Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar të gjitha rastet në shkallë të parë, përpos përndryshe parashikuar me ligj. Neni 8 i Ligjit mbi Gjykatat thekson se Gjykata Themelore e Ferizajit është themeluar për territorin inter alia të Komunës së Ferizajit. I pandehuri, M.S. ka qenë i bashkë-akuzuar në po të njëjtën aktakuzë me (6) të pandehur të akuzuar me veprat penale që hyjnë në sferën e Nenit 15 (1.19) të po të njëjtit Ligj. Aktakuza në këtë rast është parashtruar me 27 dhjetor 2013.

B. HISTORIKU PROCEDURAL

2. Me 23 mars 2013, Prokurori ka lëshuar një Vendim mbi Fillimin e Hetimeve, e cila qe zgjeruar me 28 mars 2013 me rastin e lëshimit të Vendimit të Prokurorit mbi Zgjerimin e Hetimeve.
3. Me 11 shtator 2013, i pandehuri M.S. është arrestuar me 12 shtator 2013 gjyqtari i procedurës paraprake ka urdhëruar paraburgim kundër të gjithë të pandehurve në këtë rast, duke e përfshirë edhe të pandehurin M.S. , për një periudhë prej një (1) muaji. Me rastin e skadimit të kësaj periudhe prokurori ka aplikuar që kjo periudhë të vazhdohet. Gjyqtari i procedurës paraprake e ka aprovuar këtë kërkesë. Periudha e paraburgimit është vazhduar sipas statutit kohë pas kohe.
4. Me 27 dhjetor 2013, Prokurori e ka parashtruar aktakuzën PPS Nr. 05/2012, duke i akuzuar zyrtarisht të pandehurit M.S. , B.SH., B.V., S.M., dhe R.A.. Të gjitha kërkesat për ta refuzuar ose hedhur poshtë aktakuzën dhe/ose provat, qenë refuzuar në shkallë të parë dhe në bazë të ankesës.
5. Seanca e parë e seancës fillestare është mbajtur me datë 10 janar 2014. Seanca e dytë është mbajtur me 10 shkurt 2014. I pandehuri, A.M. nuk ka marrë pjesë në asnjë seancë edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt. Me 12 shkurt 2014 kryetari i trupit gjykues ka lëshuar një Urdhër Arresti vendor dhe ka aplikuar për një Urdhër Arresti Ndërkombëtar e cila qe lëshuar më pas. Rasti qe ndarë zyrtarisht dhe i ishte caktuar numri i ri i referencës PKR. Nr. 193/15. I pandehuri, A.M. mbetet në arrati. Avokatët për të pandehurit e tjerë kanë parashtruar kundërshtime ndaj provave dhe kërkesave për ta hedhur poshtë aktakuzën por Kryetari i trupit gjykues dhe Gjykata e Apelit i kanë refuzuar këto.
6. Shqyrtimi kryesor ka vazhduar me datë 19 maj 2014 në Gjykatën Themelore në Ferizaj (duke u mbajtur në Kacanik). Seancat më pas ishin mbajtur në datat e dhëna si më sipër.

7. Në seancën e shqyrtimit kryesor me datë 2 shkurt 2015 i pandehuri, R.A. hyri në një marrëveshje mbi fajësinë me Prokurorin e PSRK-së. Me datë 23 shkurt 2015 kryetari i trupit gjykues e ka ndarë rastin kundër të pandehurit R.A. dhe me datë 25 shkurt 2015 trupi gjykues ka lëshuar aktgjykimin duke e caktuar dënimin.
8. Në seancën e shqyrtimit kryesor me datë 8 dhjetor 2014 avokatët për të pandehurit, B.V. dhe S.M., avokatët, I H dhe A A , kanë theksuar se klientët e tyre kanë kërkuar që të lidhin një marrëveshje mbi fajësinë në lidhje me akuzat. Me 15 dhjetor 2014 kryetari i trupit gjykues e ka lëshuar një aktvendim duke i liruar që të dy të pandehurit nga paraburgimi në arrest shtëpiak. Ai ka theksuar se ai ka propozuar që të ia përkujtoj që të dyve dënimin kur shqyrtimi kryesor të përfundoj në lidhje me të pandehurit tjerë M.S. dhe V.T.. Sidoqftë, dikur kah korriku i vitit 2015 pandehuri B.V. u arratis. Me 17 gusht 2015 kryetari i trupit gjykues ka lëshuar një Urdhër Arresti dhe një kërkesë për lëshimin e një letërreshtimi e cila edhe qe lëshuar më pas. Në shkurt 2016 i pandehuri B.V. ishte arrestuar në gjermani dhe ekstraduar në Kosovë duke arritur me 1 prill 2016. Gjyqtari kujdestar i Eulex-it e ka vendosur atë në paraburgim. Me 4 gusht 2016 paneli i shqyrtimit kryesor e ka lëshuar një aktgjykim duke e caktuar dënimin.
9. Në tetor 2015 i pandehuri S.M. po ashtu është arratisur. Kryetari i trupit gjykues po ashtu ka lëshuar një Urdhër Arresti dhe ka aplikuar për një Urdhër Arresti Ndërkombëtar e cila qe lëshuar më pas dhe mbetet ekzistuese. Me 8 nëntor 2016 kryetari i trupit gjykues e ka lëshuar një Urdhër duke e ndarë rastin kundër S.M.t. Rasti po ashtu i është ri-dërguar gjyqësorit të Kosovës për çdo procedim të mëtejshëm.

C. PROVAT E PRANUESHME

10. Pala e dëmtuar **B.S.** i ka dhënë deklarata Inspektoratit Policor të Kosovës (“IPK”) me 11 prill², 19 gusht³ dhe 20 nëntor 2013⁴. Ai po ashtu ka dhënë një deklaratë në zyrën e

² Dosja e Prokurorisë 2A faqe 460-485

³ Dosja e Prokurorisë 2A faqe 486-491

⁴ Dosja e Prokurorisë 2A faqe 492-498

prokurorisë me datë 26 shtator 2013⁵ . Më pas ka dëshmuar në seancat e shqyrtimit kryesor.

11. Pala e dëmtuar B.S. e ka filluar deklaratën e tij me 11 shtator 2013 në IPK duke i konfirmuar të dhënat e tija personale dhe duke e konfirmuar prejardhjen e tij. Ai ka theksuar se profesioni i tij i tanishëm është Drejtor i kompanisë “Luboteni” në komunën e Shtërpcës/Štrpce. Sidoqftë, ai ka theksuar se ai nuk ka vepruar në cilësinë e tij meqë qe arrestuar nga Policia e Kosovës me 30 maj 2012 në Ferizaj, ku ai tha se ka qëndruar për rreth 6 (gjashtë) muaj në paraburgim. Ai ka theksuar se ai është liruar me datë 27 nëntor 2012 para se të arrestohej sërish me datë 4 janar 2013 por është liruar sërish me datë 5 janar 2013.
12. B.S. ka theksuar se ai është arrestuar me 30 maj 2012 nga zyrtarët policorë E A , B.SH. dhe një zyrtar tjetër policor të cilit nuk ia di mbiemrin. Ai ka theksuar se ai ishte arrestuar nën dyshimin për trafikim të qenieve njerëzore.
13. B.S. theksoi se në mëngjesin e datës 30 maj 2012 ai ka shkuar në Gjilan për ti kryer ca punë. Atje ai e takoi një person të quajtur V. e cila ka punuar për kompaninë e sigurimeve “Kosova e Re”. Ai e takoi atë në një restorant të quajtur “Planet” e shoqëruar nga burri i saj. Një person me emrin S ka qenë me palën e dëmtuar B.S..
14. B.S. ka theksuar se gjersa ata kanë qenë duke ngrënë drekë, ai e ka marrë një telefonatë nga një numër i panjohur, por ai nuk iu është përgjigjur. Më vonë, shoku i tij R B ka thirrur dhe e ka pyetur atë “pse nuk përgjigjeni meqë është numër i policisë?” B.S. ka theksuar se ai do i thirri ata menjëherë dhe veptoi ashtu. Ai tha se një zyrtar policor i quajtur Menderes u përgjigj dhe i tha atij që të vij menjëherë në stacionin policor. B.S. u përgjigj se ai do të vonohej pak dhe tha që M. e pyeti nëse ata mund të niseshin në të njëjtën kohë , (M. nga Ferizaji dhe B.S. nga Gjilani) në mënyrë që të takohen në mes të rrugës. Sidoqftë, B.S. theksoi se ai ishte ende i nxënë kështu që M. erdhi në Gjilan.

⁵ Dosja e Prokurorisë 2A faqe 433-459

15. B.S. theksoi se më të arritur në Gjilan, M. e ka thirrë atë dhe ai shkoi vetë të takohet me M.n i cili i ka thënë atij “ata” ishin në pompën e benzinës në Gjilan. Sidoqftë, B.S. tha se kur shkoi atje M. nuk ishte atje. Në vend të kësaj, ishte E.A. një zyrtar policor nga fshati Brod, “*komshiu i tij i parë*”, B.SH., nga fshati Firaj (po ashtu një zyrtar policor) dhe zyrtari policor N.
16. B.S. ka theksuar se që të tre nga ata i janë afruar makinës së tij dhe N. e ka pyetur atë “*a mos keni armë në makinë?*” B.S. theksoi se ai ishte befasuar nga kjo pyetje por E.A. i kishte thënë N.t “*ai nuk është duke u marr me armë*” dhe pastaj B.SH. ka thënë, “*Ju duhet të vini në stacionin policor në Ferizaj*”. B.S. tha që ai është përgjigjur, “*nuk ka problem le të shkojmë menjëherë*”.
17. B.S. ka theksuar se B.SH. i ka thënë atij se ai nuk mund ta vozis makinën e tij dhe se ai mund ta marrë gjersa B.S. udhëton me N dhe E.A. B.S. ka theksuar në makinën e policisë se N. i ka thënë atij disa herë, “*burrat ndonjë herë gabojnë në jetën e tyre*”. Ai ka thënë se ai nuk e di se kujt i referohej ai.
18. B.S. ka theksuar se kur ata kanë arritur në rreth rrotullimin afër stacionit policor në Ferizaj, N. i ka thënë atij “*ne duhet të ua vëmë ju prangat meqë e kemi një urdhër që ti vëmë ato nga momenti kur ne takohemi por ne ju kemi lënë të lirë gjer më tani*”. B.S. ka theksuar se ai ishte i befasuar nga kjo gjë.
19. B.S. ka theksuar se rreth orës 17:30, ata kanë hyrë në një zyre në stacionin policor ku ai e ka parë një burrë që nuk e njeh. Ai person i ka thënë në mënyrë kërcënuese, “*përse nuk keni ardhur menjëherë?*” B.S. tha që ai ishte përgjigjur, “*Unë erdha në bashkëpunim me ju dhe unë nuk jam fshehur apo nuk kam ikur fare*”. Ai tha që personi I panjohur kishte thënë “*a më njeh mua?*” në çka B.S. ishte përgjigjur që jo. Ai ka theksuar se personi kishte pyetur “*a ke shkuar ndonjëherë nëpër lokale me muzikë?*” B.S. është përgjigjur që ai rrallë ka vepruar ashtu. Ai tha që ky person pastaj kishte thënë, “*Unë jam M. që e kam kontaktuar që nga fillimi*” para se të pyeste “*a e keni vrarë dikë?*” B.S. theksoi që ai ishte shumë i shokuar me këtë gjë.

20. B.S. theksoi se M. pastaj kishte pyetur “*a e kam martuar unë ndonjë Serb me ndonjë femër nga Shqipëria?*” B.S. ka theksuar se kjo nuk ishte e vërtetë dhe se ai nuk kishte kohë të merrej me gjëra të tilla. Sidoqftë, ai ka theksuar se ai ishte ftuar nga P J në një drekë në të cilën ka pasur mysafirë nga Shqipëria kështu që ai kishte shkuar atje për të përkthyer. Ai theksoi që ai e ka kuptuar që palët kanë arritur në një marrëveshje mes tyre për një martesë dhe se ai nuk ka pasur asnjë rol në këtë punë.
21. B.S. ka theksuar se M. doli dhe shkoi në një zyre tjetër dhe se e solli një fotografi të një gruaje dhe se e ka pyetur B.S. nëse ai e njohte atë në të cilën gjë ai u përgjigj “*unë nuk e njoh atë*”. B.S. ka theksuar se në atë moment ai e ka kuptuar se ai nuk e kishte vrarë askënd por se ishte akuzuar për trafikim të femrave. Ai theksoi se ai e ka kuptuar këtë sepse M. kishte pyetur nëse ai e kuptonte fjalën trafikim dhe ai është përgjigjur se ai dinte pak në lidhje me këtë në lidhje me të cilën M. kishte thënë “*vepra penale e trafikimit është më serioze se sa vrasja*”.
22. B.S. ka theksuar se pastaj M. e ka pyetur atë “*a ke organizuar ndonjëherë në jetë ndonjë festë?*” dhe nëse ai e njeh “*L. dhe X.*” B.S. është përgjigjur se ai i ka njohur në vitin 2010. B.S. tha se M. pastaj e ka lënë atë me E.A. dhe B.SH. B.SH. e ka pyetur nëse ai e kishte një Avokat dhe kur ai ka thënë jo B.SH. i ka thënë se do të ia gjej një. B.S. ka theksuar se B.SH. dhe E.A. i kanë thënë atij “*ne jemi ndalur meqë je fqinji ynë dhe ne jemi ndalur për të të ndihmuar meqë dikush tjetër është intervistuar dhe ju nuk mund të ikni aq lehtë*”.
23. B.S. ka theksuar se një avokat, R SH pastaj ka ardhur. B.SH. I ka thënë M., “*a duhet që ti ndihmoj kushëririn tim në kompjuter, që ti rregulloj fjalitë që të jetë më lehtë pastaj në procedurat e mëtejme?*” B.S. ka theksuar se ata kanë vazhduar që ta marrin atë në pyetje dhe ai është përgjigjur dhe se ata e kanë shënuar përgjigjen e tij dhe e kanë pyetur avokatin nëse ishin duke e përpiluar si duhet.

24. B.S. theksoi se ai ka qëndruar edhe për 3-4 orë tjera. Ai ka theksuar se B.SH. i ka thënë atij që të shkojë në zyrën e M. ku ai e ka mbyllur derën dhe ka thënë “*ju jeni daja im andaj si mund të ju ndihmoj?*” B.S. ka thënë se ai është përgjegjës “*a keni fëmijë?*” në të cilën M. ka thënë “*po*”. B.S. ka theksuar se ai ka thënë, “*për hir të fëmijëve të tu, unë nuk kam të bëj asgjë me këtë çështje aspak*”. B.S. ka theksuar se M. i ka thënë atij “*unë do ju ndihmoj aq sa mundem*”. B.S. ka theksuar se ai është kthyer në zyre ku ka qenë më herët ku B.SH. ia ka dhënë atij telefonin e tij dhe ka thënë, “*ne do të ju njoftojmë në shtëpi meqë unë do rri në stacionin policor*”.
25. B.S. ka theksuar se qëllimi i paraburgimit të tij për një kohë aq te gjatë në stacionin policor ka qenë “*për të marrë para nga unë, sidoqoftë, në atë moment unë nuk e kam kuptuar fare që qëllimi ka qenë paratë*”. Ai ka theksuar “*ata më kanë dërguar në burg në stacionin policor në Ferizaj ku B. dhe N. më kanë shoqëruar. Atje unë i kam kaluar 2 netë dhe një ditë, pastaj në ora 8:00 në mëngjes E dhe N. kanë ardhur, me kanë marrë dhe më kanë thënë se po shkojmë në gjykatë në Prishtinë*”.
26. B.S. ka theksuar se kur kanë ardhur deri tek restorant “*Lamborghini*” në dalje të Ferizajit, M. ka shkuar duke thënë “*ndihmojini atij sepse ai është i yni*”. B.S. ka theksuar se ata kanë vazhduar për në Prishtinë, dhe se gjatë kësaj kohe N. Dhe E ishin “*disi u vinte keq*” dhe e kanë këshilluar atë që të flasë, “*sikur ne e kemi rregulluar për ju*”. Ai tha që ai e ka kuptuar që shoku i tij i ngushtë, R B ishte dëshmitar dhe E.A. tha, “*ai e ka bërë një deklaratë të mirë në favor tëndin dhe ai është një shok i mirë*” dhe ata e kanë këshilluar atë, “*ato gra kanë folur keq për ju por nuk ka rrezik për ju*”. Ai po ashtu ka thënë se “*nëse mund ti kontaktoni këto gra në mënyrë që të ndikoni tek to që ti ndërrojnë deklaratat e tyre dhe do ishte mirë, por është me shumë rrezik për të ndikuar në dëshmitarë*”.
27. B.S. ka theksuar se para se ta dërgonin atë në gjykatë ata e kanë prangosur atë dhe e kanë pyetur, “*a ka ardhur avokati?*” B.S. ka thënë se ai nuk e ka ditur dhe ata ia kanë dhënë atij telefonin e tij dhe ai e ka thirrë një shok të quajtur M A për të pyetur nëse avokati kishte ardhur dhe ai ka thënë “*ai do vijë tani*”. B.S. tha që më vonë një burrë të cilin ai e

njohu ka ardhur dhe e ka prezantuar veten e tij si as T G dhe ka thënë se ai ishte një avokat. B.S. ka thënë T.G. ia ka bërë disa pyetje të cilave ai iu është përgjigjur.

28. B.S. ka theksuar se në gjykatë, Gjyqtari e ka dënua atë me paraburgim për një muaj dhe e ka pyetur atë nëse ai pajtohej me këtë masë për të cilën ai kishte thënë “po”, para se avokati i tij të intervenonte dhe të thoshte se, *“klienti im nuk është në gjendje të mirë shëndetësore dhe nuk ka të bëjë asgjë me këtë çështje”*. B.S. ka theksuar se ata e kanë dërguar atë në burg në Lipjan. Pas 2-3 ditësh avokati T G ka ardhur dhe i ka thënë atij se rasti kërkon shumë punë dhe ka kërkuar 25.000 euro. B.S. ka theksuar se ai është konsultuar me vëllezërit e tij Arben dhe S.n dhe ata i kanë thënë atij, *“ne e kemi rregulluar këtë; është duke shkuar mirë dhe ne jemi në kontakt me M. dhe B gjatë tërë kohës”* Më pas ata i kanë thënë atij, *“ne ia kemi rregulluar punën dhe me datë 27 nëntor ju do të lirohemi nga paraburgimi vetëm se 25000 euro duhet të ipen”*. B.S. ka theksuar se 27 nëntori 2012 erdhi dhe ai e ka parë avokatin e tij R G i cili i ka thënë atij, *“ne e kemi bërë një marrëveshje me gjyqtaren H H që ju të deklaroheni fajtor”*. B.S. ka thënë se ai ka pyetur pastaj, *“si ta pranoj diçka që nuk e kam bërë?”*, por avokati ka thënë, *“është më mirë të deklarohesh fajtor e të jesh në liri, dhe pastaj do jesh në liri, nëse e njeh dikë ti mund ta fshehësh dosjen e rastit për 2-3 vjet dhe pastaj vjetrohët dhe ka shumë metoda për të mos shkuar në burg”*.

29. B.S. ka theksuar se avokati i tij i ka thënë atij, *“ju do të dënoheni me burgim prej 2 vjet e gjysmë”*. B.S. theksoi se ai nuk e pranon këtë gjë dhe ka kërkuar që ti shohë vëllezërit e tij, K, A dhe S. Ai tha që ai e ka pyetur K, *“a kështu unë duhet të dal nga burgu – duke e pranuar diçka që nuk e kam bërë”* në të cilën gjë K nuk tha asgjë, ndërsa A ka thënë *“vëlla prano ose përndryshe nuk do të të lirojnë edhe pse na e dimë që ti nuk je fajtor meqë këtu nuk ka drejtësi”*.

30. B.S. ka theksuar *“në atë moment unë kam menduar që ta pranoj fajin e të jem i lirë dhe të shoh drejtësinë time, kështu që me dhunë dhe me zhvatje unë jam detyruar që të hyj në një marrëveshje të tillë mbi fajësinë dhe procedurat kanë përfunduar dhe unë jam dënua në një procedurë që ka zgjatur jo më shumë se 5 minuta dhe unë jam dënua me 2 ose 3*

muaj burgim meqë Gjyqtare H H mi ka falur 2 muaj bazuar në atë se çfarë me tha avokati im”.

31. B.S. ka theksuar më pas se ai ka shkuar në paraburgim dhe se në ora 13:00 ai ka kërkuar që të dali dhe ta bëj një telefonatë në familjen e tij që të ju thotë se ai po kthehej në shtëpi dhe ai u ka thënë atyre që të mos i japin para askujt gjersa ai të vij në shtëpi. Ai ka theksuar se në ora 16:00 ai është liruar dhe (vëllai i tij) A dhe (dhëndri) XH.B. ishin duke e pritur atë.
32. B.S. ka theksuar se pas 2-3 ditësh, M.S. e ka thirrur atë dhe ata janë takuar në një restorant në fshatin Jezercë. Të pranishëm kanë qenë M., B.SH. dhe XH.B.. B S ka theksuar se ata ishin duke ngrënë drekë dhe M dhe B.SH. ishin duke thënë *“ne të kemi ndihmuar shumë”* dhe B.SH. gjatë tërë kohës thoshte *“ti duhesh ti falënderohesh dajës (M.) meqë ka ndihmuar shumë”* por M. po thoshte *“ti nuk ke pasur fat”* meqë B K, Prokurorja ishte e sëmurë dhe se procedurat po përparonin ngadalë dhe *“ unë kam pasur vështirësi gjersa e kam gjetur një Prokuror tjetër në mënyrë që ta zëvendësojë prokuroren e (mëparshme)”*.
33. B S ka theksuar përgjatë bisedës se nuk u ka treguar atyre se ai ishte dënuar me burgim prej 2 vitesh dhe 3 muajsh. Ai ka theksuar se ai nuk mund të besonte se sa shumë para ata kishin marrë nga vëllai i tij dhe se ata kanë shpërndarë para duke blerë telefona dhe Laptop për prokurorë dhe gjyqtarë në mënyrë që ta shpejtonin rastin e tij dhe që ta lironin atë nga paraburgimi dhe Akuzat në përgjithësi. B.S. ka theksuar se ai nuk mund të duronte më dhe se ua ka thënë në fytyrë *“ju më keni gënjyer mua mjaft meqë jam dënuar me burgim prej 2 vitesh dhe 3 muajsh”*. Ai tha se ata e kanë ndërruar stilin e bisedës dhe se i kanë thënë atij *“ne do të të ndihmojmë ty sërish meqë ne do e kthejmë rastin në ri-gjykim meqë nuk ka mundësi tjetër; mos u mërzit ti je i lirë dhe puno”*.
34. B S theksoi se pas përfundimit të drekës ata kanë dalur jashtë dhe M. i ka thënë atij *“unë të kam bërë shumë të këqija ty por unë nuk të kam njohur ty si dhe lidhjen time me ty dhe mua më vjen turp që ta takoj dajën B. (babai i B.)”*. Ai ka thënë, *“mua më duhet që të vi*

në shtëpinë tuaj dhe ti kërkoj falje babait tënd (dhe ti them atij) djali yt është i pafajshëm por nuk ka pasur fat". B S ka theksuar se ai i ka thënë atij që të vij por qëllimi i tij ka qenë që të zbulojë dhe të mbledhi sa më shumë informacione që është e mundur.

35. B S ka theksuar se 2-3 ditë para Vitit të Ri ata e kanë informuar atë se po vinin. Ai ka theksuar se M. ka ardhur në shtëpinë e tij me B.SH. dhe dhëndrin e tij, XH. Ata kanë shkuar dhe i kanë kërkuar falje babait të tij për rastin e djalit të tij. B S theksoi se pas mesnate ai ka shkuar që ti shoqërojë mysafirët në shtëpi, B.SH. ka shkuar me makinën e XH. ndërsa M. shkoi me të me makinë. B S theksoi se ai e ka pyetur atë për B.D., drejtorin e kompanisë B. nga Kaçaniku/Kaçanik sepse vëllezërit e tij i kanë thënë atij se ishte pas tërë kësaj pune të orkestruar por M. ishte i paqartë dhe e ka ndërruar temën. B S ka theksuar se ata kanë ndaluar tek restorani "Evropa" në ora 02:30 dhe gjatë tërë kohës B.SH. po thoshte, *"ti ia ke borgj aq shumë dajës (M.t) meqë ai të ka ndihmuar ty shumë"*.
36. B.S. ka theksuar katër ditë me vonë se ai ka qenë me një shok tek restorant "Lamburgjini" kur ka ardhur M. dhe ai e ka ftuar atë që të ulet me ta dhe ai është ulur. Shoku ka shkuar dhe B.S. e ka ftuar M. në drekë dhe ata kanë shkuar në një restorant në Jezercë. B.S. ka theksuar në vazhdim se M. e ka thirrur B.SH. dhe kur ata kanë arritur në restorant B.SH. ka filluar që të thotë sërish, *"ti i detyrohesh aq shumë M."*
37. B.S. ka theksuar se ai nuk e ka njohur M. para arrestimit të tij, sidoqoftë kur ai është arrestuar M. i ka thënë atij *"ti je daja im"* që do të thoshte se ai ishte nipi i tij. Ai ka theksuar se ai e ka njohur B.SH. meqë ai ishte nga Fshati Firajë, një fshat afër fshatit të tij, dhe ai ka shkuar në shkollën e mesme në Ferizaj së bashku me vëllain e B, A. Ai ka theksuar se E.A. ka qenë një komshi në fshatin ku ai jeton dhe se nuk ka pasur problem me të ose me familjen e tij.
38. B.S. ka theksuar se B D, është nga Fshati Doganaj, Komuna e Kaçanikut dhe ai është pronari i kompanisë "Burimi" Company dhe derisa ai është arrestuar, ai ka pasur marrëdhënie të mira.

39. B.S. pastaj ka përshkruar se si ai ka blerë një makinë të tipit Mercedes për veten e tij në Gjermani dhe një tjetër, një Mercedes ML të llojit xhip, po ashtu për veten e tij, por ai ia ka dhënë makinën B. (D, "B") meqë bashkëpunonin në biznes me njëri tjetrin. Sidoqoftë, B.S. ka theksuar se gjatë kohës që ai ka qenë në burg, vëllezërit e tij i kanë thënë *"Mercedesi që e ke blerë ti është tani duke u vozitur nga M., i cili të ka arrestuar"* dhe gjatë tërë kohës ata kanë dyshuar që "Beqa" është personi që ka qenë prapa komplotit për të më dërguar mua në burg.
40. B.S. ka theksuar se pasi që ai është liruar nga burgu ai po ashtu është takuar me M. dhe B në restorantin "Freskia" në Nerodime, Ferizaj; dhëndri i tij XH. (B.) ka qenë po ashtu prezent. Ai ka theksuar se pas takimit B. dhe M. kanë ardhur në shtëpinë e tij ku ata kanë ngrënë darkë së bashku dhe ai po ashtu u takua me M. edhe një herë tek restoranti "Lamburgjini" dhe prej aty ata kanë shkuar në restorantin "Freskia" dhe B.SH. ka ardhur më vonë.
41. B.S. ka theksuar në këto dy takime që ata i kanë pasur me ta tek restorant "Freskia", M. dhe B.SH. e kanë kërkuar aktvendimin përmes së cilit ai ishte dënuar dhe liruar nga paraburgimi *"në mënyrë që të përpiqet të më ndihmojë"*. Ai po ashtu ka theksuar se si M. i ka thënë atij se kishte ardhur në posedim të një makine të llojit Mercedes sepse *"B. ishte në telashe"* dhe se si ai e ka blerë atë duke thënë, *"unë ia dhashë atij një Audi dhe pak para"*.
42. B.S. ka theksuar se pas lirimit nga burgu B D ka ardhur 2 ose 3 herë në shtëpinë e tij. Ai ka thënë se ata kanë folur për një makinë të tipit Mercedes dhe B i ka thënë atij. *"Para se ju të burgoseshit, unë kam dërguar ca beton në objektin e M.t por nuk e kam ditur se objekti i kujt ishte por qëkur je arrestuar unë e kam kuptuar se unë po dërgoja beton në objektin e M.t dhe se ai e kishte rastin tënd"*. Ai po ashtu ka theksuar se një partner i tij dhe i B, i quajtur N ZH, nga Kaçaniku, i ka thënë atij se B. e ka pasur një problem dhe se është dashur që ta fali një Mercedes dhe ai nuk din asgjë më shumë.

43. B.S. ka theksuar me 4 janar 2013, ai po drekonte kur e ka pranuar një telefonatë në ora 13:00 nga M.S. i cili kërkonte nga ai që të shkojë në shtëpinë e tij. Ai po ashtu e mori një telefonatë nga një person Serb nga Shtërpce dhe shkoi në një bar të quajtur “Made” në Brezovicë që të ia shesë atij një VW “Tuareg” të llojit xhip për €18,000. Ai thekson se blerësit kanë shkuar për ti tërhequr paratë nga Banka dhe ai ishte duke pritur dhe se ishte vonë që të takohej me M. Ai ka theksuar se gjatë kohës gjersa ai po diskutonte për ta shitur xhipin disa miq ishin duke e pritur atë në Shtërpce ku ata kanë pritur për 2 orë dhe kur ai e pa që ishte vonë, ai i ka thirrur ata që të vijnë në Brezovicë sepse ai nuk mund të shkonte në Shtërpce. Ai ka theksuar gjatë bisedës me ta se S., pronari i kompanisë Bageri, po ashtu e ka thirrur atë. Ai ka theksuar se ai po ashtu e ka pasur një telefonatë nga një numër i panjohur. Telefonuesi e ka prezantuar veten e tij si Zyrtar policor me Departamentin e Krimeve të Rënda në Prishtinë dhe ka kërkuar që të takohen diku në Ferizaj. B.S. ka theksuar se ai ishte shumë i befasuar dhe shumë i shokuar dhe ai e ka ftuar M. në telefon dhe e ka pyetur nëse ai e njeh këtë burrë. Ai ka theksuar se M. ka thënë “B., nëse nuk ndihesh fajtor, shko dhe takohu me të, meqë unë e njoh shumë mirë sepse është kolegu im”.
44. B. ka thënë se ai e ka ftuar vëllain e tij K. që të vijë sa më parë që është e mundur në Brezovicë, në restorantin “Made” dhe ai ka arritur shpejt. B.S. i ka thënë atij që ta thërrasë XH, shko tek M. dhe merre djalin dhe ta fshehësh diku meqë situata nuk është e mirë dhe kjo e ka alarmuar XH. Ai ka theksuar se babai i tij po ashtu ka thirrur dhe se ai e ka ditur që diçka nuk është në rregull.
45. B.S. ka theksuar se ai më pas ka folur në telefon me XH dhe K të cilit ishin duke u takuar me M. Ai ka theksuar se ai nuk e ka ditur nëse të shkojë dhe ta takojë personin nga Prishtina sepse nëse ai nuk do shkojë ata do mendojnë që ai është fajtor, nëse do vepronte në këtë mënyrë ai e dinte që ishte e orkestruar kjo gjë dhe me siguri do të përfundonte në burg. Ai ka theksuar se ai ka shkuar me pronarin e kompanisë “Bageri” (S) në drejtim të Shtërpçës dhe se ata kanë ndaluar në një kafene në Shtërpçë ku kanë qëndruar deri në ora 19:15 kur K. e ka thirrur atë dhe ka thënë, “*eja në Ferizaj meqë ne jemi duke folur me M.n, ata nuk do ju dërgojnë ju në burg, ju vetëm duhet që ta ipni një deklaratë*”.

46. B.S. ka deklaruar se në ora 20:00, ai ka shkuar me XH dhe K në zyrën e M. "në stacionin policor në Ferizaj. Me të arritur M. ka pyetur, "A e njihni Sanellën?" në të cilën gjë ai u përgjigj, "Po e njoh atë". M. ka thënë, "situatë nuk është e mirë meqë ky është një rast serioz". Ai ka theksuar në më pak se dy minuta një zyrtar policor dhe një zyrtar tjetër policor në rroba civile kanë ardhur dhe e kanë pyetur M., "a është ky personi i përfshirë në rastin e Gjilanit?" për të cilën M. tha "Po". Ai theksoi që M. u ngrit, iu afrua dy zyrtarëve policorë nga Prishtina, gjersa ai e kishte shpinën e tij të kthyer dhe ka thënë "ai është kushëriri im" por ai e ka bërë një gjest me kokën e tij kah zyrtari policor nga Prishtina që ta marrë B.S.n dhe të veprojë sipas planit të rregulluar më parë nga ata. B.S. deklaroi se ai u nis menjëherë për Prishtinë me këta zyrtarë policor në një makinë private. Ora ka qenë 21:00. Ai deklaroi se ai nuk ka marrë asnjë dokument zyrtar në lidhje me paraburgimin e tij e as avokati i tij nuk është lajmëruar.
47. B.S. ka deklaruar se kur ata kanë ardhur në Prishtinë ai është dërguar në një stacion policor të cilin nuk e di dhe atje kanë qenë 3-4 zyrtarë policorë të cilët kanë qenë që të gjithë pa uniforma. Ai deklaroi se menjëherë njëri nga zyrtarët policorë i ka thënë njërit nga kolegëve të tij që menjëherë ta kompletojnë një dosje për paraburgim. Ai ka deklaruar se ata kanë hyrë në një zyre ku ata i kanë thënë atij që të ulet dhe pas një kohe avokati i tij R G ka ardhur dhe ka thënë, "B., si ndodhi që je sërish këtu me të njëjtin problem?" Ai u përgjigj, "unë nuk kam të bëj asgjë me gjëra të tilla, çdo gjë është e orkestruar". Ai tha që Policia e ka pyetur atë më tej dhe pastaj e ka vendosur në qeli ku u kanë thënë rojeve, "ky person e ka bërë një krim mjaft të rëndë, ne nuk mund të bëjmë asgjë por ne na duhet që ta gjejmë për të një dyshek të lagur që të flejë gjithë natën në ujë". Atij nuk iu është lejuar për të pirë duhan.
48. B.S. ka theksuar se të nesërmen ai është dërguar në Gjykatë. Prokurori e ka lexuar aktakuzën dhe ka përmendur drogë dhe trafikim e cila gjë e ka shokuar atë. Ai theksoi fillimisht që gjykata ka propozuar paraburgimin por avokati i tij ka argumentuar kundër kësaj dhe është ndryshuar në paraburgim në vend të kësaj.

49. B.S. ka theksuar se gjersa në paraburgim, XH dhe K, janë takuar me M. disa herë meqë ka qenë një rast serioz. Ai ka theksuar se me 27 janar ai ka dalur para Gjykatës ku viktimo ka bërë deklaratë para Gjyqtarit dhe ku në asnjë fazë nuk e ka implikuar atë në asnjë vepër penale kundër saj. Ajo madje tha, “*B nuk më ka bërë mua asgjë të keqe, ai vetëm më ka ndihmuar*”.
50. B.S. ka theksuar se pasi që ai është liruar nga paraburgimi me 5 janar 2013 ai nuk është takuar me M. ose B.SH.
51. Në deklaratën e tij të dhënë në IPK me datë 19 gusht 2013 pala e dëmtuar B.S. ka theksuar se ai është liruar nga paraburgimi me 2 gusht 2013. Ai ka theksuar se në mëngjesin e datës 14 gusht 2013 ai po pinte kafe me dhëndrin e tij XH.B. në kafenenë “*Lamborghini*” në pompën e benzinës HIB në Ferizaj. Ai ka theksuar se togeri M.S. nga Policia e Ferizajit iu është afruar atyre dhe se u ka thënë që ishte i frikësuar për B.S.n dhe për atë se çfarë kishte bërë ai. Ata i kanë ndërruar numrat e telefonit mes vete dhe janë dakorduar që të takohen më vonë. B.S. më pas ia ka dërguar një SMS M.S. t dhe ai është përgjigjur me “*OK*” po rata nuk janë takuar. B.S. ka shtuar se XH.B. është takuar me M.S. dhe B.SH.n tek Hani i Elezit disa ditë para takimit me datë 14 gusht 2013.
52. Pala e dëmtuar, B.S. ka theksuar se ai e takoi M.S. n edhe njëherë në kafenenë “*Lamborghini*” tek pompa e benzinës. Ai theksoi se kjo ka qenë një muaj pas lirimt të tij në vitin 2012. Ata janë marrur vesh që të shkojnë sërisht tek një kafene në Jezerc dhe B.SH. iu është bashkuar atyre. B.S. ka theksuar se B.SH. ka filluar që të flasë në lidhje me dikë i cili i kishte para borgj atij dhe B.S. e kishte kuptuar këtë si shenjë se ai duhej që ti ipte para B.SH.t.
53. Pala e dëmtuar, B.S. pastaj e ka përsëritur dëshminë e tij më të hershme me 4 janar 2014 me djalin e tij Mërgimin në Shtërpce. Ai e ka përsëritur se si e ka lutur vëllain e tij Kemajlin që ta marrë djalin e tij meqë ishte shumë i shqetësuar dhe po qante. Ai ka theksuar se ai ka dështuar që ta përmendi më parë se kur ai e ka marrë një telefonatë nga policia e Prishtinës, ata kanë kërkuar nga ai që të takohen në shitoren “*Ben-af*” në Ferizaj.

Ai e ka përsëritur pretendimin e tij të mëparshëm, qëllimet e kontaktit dhe takimi i mëvonshëm ishte për të nxjerrë para nga ai.

54. Pala e dëmtuar B.S. ka theksuar se pasi që ishte dërguar në arrest shtëpiak ai është takuar me M.S. n rastësisht dhe se atij i vinte keq për atë se çfarë i kishte ndodhur dhe se ai shqetësohej që B.S. ishte mbajtur në arrest shtëpiak për 7 muaj. Ai theksoi se ai ia dha M.S. numrin e tij të ri të telefonit.

56.

55. Pala e dëmtuar, B.S. e filloi dëshminë e tij para trupit gjykues me datë 2 qershor 2014. Ai ka konfirmuar lidhjet e tija familjare me palët e tjera të dëmtuara dhe dëshmitarët në këtë rast dhe ai i dha numrat e tyre të telefonit dhe të tijën aq sa mbante në mend. Ai ka theksuar se ai e kishte themeluar kompaninë ndërtimore “Luboteni” në vitin 2002. Ai ka theksuar se në kulmin e suksesit të saj kompania ka punësuar më shumë se shtatëdhjetë (70) persona por kjo u zvogëlua që nga arrestimi i tij në vitin 2012. Ai ka theksuar se kompania kishte një reputacion të mirë kudo. Ai ka deklaruar se ai nuk mund të caktojë një shifër për qarkullimin e tij por atij i shkonte mirë dhe ka udhëtuar rregullisht në vendet e tjera Evropiane që të blinte mallra . Ai theksoi se ai e kishte marrë një kredi përmes vëllait të të pandehurit M.S. , që ishte drejtor banke, për këtë qëllim. Ai tha që ai nuk e njihnte të pandehurin M.S. në atë kohë. Ai theksoi se ai i ka përfshirë të gjitha asetet e kompanisë së tij në kërkesën për kredi. Ai theksoi se ai e ka një shtëpi të madhe familjare të cilën e ndan me vëllezërit e tij dhe e cila ka vlerë përafërsisht €200,000 si dhe shtëpinë e tij. Ai po ashtu ka theksuar se ai ka në pronësi dy (2) parcela të tokës. Ai ka theksuar se kompania “Luboteni” i takonte gjithë familjes. Ai ka theksuar se i kishte shumë llogari bankare dhe se kishte aksione në kompaninë “Burim”, që është kompania e B D. Ai ka theksuar se mes viteve 2010 dhe 2012 ka pasur përafërsisht tre deri në katër milion euro në llogaritë e tija dhe në kulmin e suksesit të saj kompania “Luboteni” kishte vlerë rreth dy milion euro.

56. Ai ka theksuar se në vitin 2012 ai ka shkuar në Gjermani me B D dhe e ka blerë një makinë Mercedes të cilën më pas ia ka dhënë B.t dhe ka udhëtuar në një makinë tjetër. Ai ka theksuar se makina ka qenë model i vitit 2012 dhe ka kushtuar €12,500.
57. Pala e dëmtuar B.S. pastaj e ka përshkruar arrestimin e tij të parë në maj 2012. Detajet kanë qenë në thelb të njëjta sikurse ato të përshkruara në intervistat e mëparshme. Ai ka shtuar se M.S. i ka thënë se ai ishte daja i babait të tij. Ai ka theksuar se kur është pyetur nëse e dëshiron një avokat të cilën ai edhe e pohoi, Z. R SH në fund mbërriti.
58. Ai ka theksuar se para se avokati i tij të arrinte B.SH. dhe N O vazhdoi që ti thoshte atij se ky rast ka mundur që të merrej nga dikush tjetër por ata e kishin marrë për ta bërë më të lehtë për të. Ai ka theksuar se B.SH. ka folur me të privatisht dhe se i ka thënë atij që të flasë me M.S. n privatisht meqë ai do i ndihmojë atij. B.S. ka theksuar se ai e ka bërë këtë gjë dhe M.S. ka thënë që ai do mundohet shumë që ta ndihmojë.
59. Pala e dëmtuar B.S. pastaj ka përshkruar se si është dërguar ai në Prishtinë ku ai e ka takuar avokatin e tij T G. Ai ka theksuar se ai nuk e ka informuar prokurorin më herët se në atë kohë M.S. dhe B.SH. ishin tek Restorani Ballkan Petrol dhe M S i kishte thënë dhëndrit të tij XH.B. se ai do ishte në arrest shtëpiak por nuk do e dërgojnë sepse ai e kishte pranuar paraburgimin. Ai ka theksuar se pas seancës gjyqësore ai ka takuar dy nga vëllezërit e tij të cilët i kanë thënë se nuk kishte nevojë për ta punësuar T G sepse ata ishin në kontakt me M.S. n dhe B.n gjatë gjithë kohës dhe se rasti ishte një “ *punë e kryer*”.
60. Pala e dëmtuar B.S. pastaj e ka identifikuar M.S. n dhe B.SH. në Gjykatë. Ai ka theksuar se ai i njeh që të dy nga vendbanimi dhe se nuk ka pasur probleme me asnjërin.
61. Pala e dëmtuar B.S. ka rrëfyer se si pastaj ai ishte udhëzuar që të deklarohej fajtor dhe ai ka folur me vëllezërit e tij dhe se ka vendosur për ta pranuar marrëveshjen. Ai ka theksuar se ai ishte në tërësi i vetëdijshëm kur unë e kam marrë këtë vendim. Ai ka theksuar se ai e ka ditur se nuk ka pasur prova kundër tij. Ai ka theksuar se avokatët e tij

vetëm i kanë thënë atij se çfarë ishin akuzat por nuk i kanë treguar asnjëherë asnjë provë ose nuk kanë pyetur se çfarë ishte mbrojtja e tij.

62. Kur ai e rifilloi dëshminë e tij më 12 qershor 2014, pala e dëmtuar, B.S. ka konfirmuar se pas arrestimit të tij në stacionin policor të Ferizajt M.S. dhe B.SH. ishin të pranishëm dhe ai është marrë në pyetje para se të vinte avokati i tij dhe në një moment të caktuar ai shkoi dhe i foli M.S. t në zyrën e tij të veçantë, ku ai i tha *"unë nuk e dija se ne jemi të lidhur me këtë, unë nuk e di se kush jeni ju"* dhe: *"unë do të bëj çmos për t'ju ndihmuar."* B.S. ka deklaruar se ai ishte i tronditur me këtë. B.S. deklaroi se B.SH. e ka quajtur atë kushëri i tij dhe M.S. i tha atij se ai ishte daja i babait të tij para se të ketë përsëritur se ai do të e bëjë me të mirën për të e ndihmuar.
63. B.S. ka theksuar se kur ai është dërguar në stacionin policor dhe është mbajtur atje për dy netë dhe një ditë dhe pastaj është dërguar në qendrën e paraburgimit nga B.SH. i cili ia ka dhënë edhe një telefon që ta thërrasë familjen e tij të cilën edhe e thirri. Ai theksoi se ai e ka telefonuar vëllain e tij A S dhe i ka thënë atij se ai ishte në paraburgim në polici dhe se nuk e dinte në të vërtetë arsyen.
64. B.S. ka theksuar se të nesërmen ai është dërguar në Prishtinë nga M.S. , B.SH. dhe një zyrtar tjetër. Atij i është dhënë një telefon për ta thirrur avokatin. Avokati, T G ka ardhur më pas. B.S. ka theksuar se ai ka bërë disa pyetje para se ai të dërgohej në gjykatë ku ai e ka pranuar caktimin prej një muaji në paraburgim edhe pse akuzat nuk kanë nënkuptuar asgjë për të dhe ai ka qenë i shokuar me to.
65. B S theksoi se ai është dërguar në burg në Lipjan kur pas tre ose katër ditësh avokati i tij T G sërish ka ardhur dhe ka kërkuar 25,000€. B.S. ka theksuar se ai do flasë me familjen e tij për këtë dikur më vonë gjatë ditës por ata e kanë këshilluar që të mos veprojë ashtu dhe kanë theksuar se çështja veq ishte *"pune e kryer"*.
66. B.S. ka theksuar se ai ka qenë i shokuar me atë se çfarë po ndodhte gjatë kësaj kohe. Ai ka theksuar me një rast se ai e ka humbur vetëdijen. Ai ka theksuar se zyrtarët përgjegjës

për të gjitha këto ishin nga policia e Ferizajit dhe ai e ka identifikuar M.S. n dhe B.SH. në gjykatë. Ai ka theksuar se ai e ka njohur B.SH. nga vendbanimi i tij. Ai ka qenë në shkollë me vëllain e tij A SH. Ai ka theksuar se gjer në arrestimin e tij ai nuk e ka parë kurrë M.S. n në jetë e lërë më të ketë probleme me të.

67. B.S. ka theksuar se para arrestimit të tij ai e ka përdorur një numër telefoni mobil që përfundonte me 904 dhe kjo ka qenë një telefon publik në emër të kompanisë “Luboteni”.

68. B.S. ka theksuar se ai ka mbetur në paraburgim gjer ka fundi i vitit 2012. Ai ka deklaruar se për afërsisht para një muaji vëllezërit e tij kishin ardhur që ta vizitonin atë dhe kanë theksuar se ata do e paguajnë shumën prej 25,000€ dhe se ai do lirohej me 27 nëntor si një person i pafajshëm. Ai ka theksuar se në atë ditë ai është dërguar në Prishtinë dhe se është paraqitur para trupit gjykues. Avokati i tij i ri R G i ka thënë atij se një marrëveshje ishte arritur me prokuroren B K dhe nëse B.S. do të vetë deklarohet ai do të dënohet me dy vjet e gjysmë burg. B.S. ka theksuar se ai nuk do e pranojë asnjë fajësi meqë nuk kishte bërë asgjë. Ai theksoi se ai ka folur me vëllezërit e tij të cilët kanë qenë në gjykatë dhe se vëllai i tij A.S. e ka këshilluar atë që ta pranojë marrëveshjen meqë nuk kishte drejtësi dhe se ky ishte rasti i vetëm për të dalur jashtë. B.S. theksoi se ai vendosi që ta pranojë marrëveshjen. Ai theksoi se avokati i tij nuk ka ditur asgjë në lidhje me paratë që janë paguar meqë kjo gjë nuk ishte përmendur para tij. Ai theksoi se ai nuk i besonte avokatit të tij. Ai theksoi se atij nuk iu është treguar asnjë provë kundër tij dhe konsultimet e tyre kanë zgjatur vetëm 15 minuta. Ai ka theksuar se ai vetëm e ka ditur që rasti kundër tij është në lidhje me trafikim të qenieve njerëzore. Dhe asnjëri nga avokatët e tij nuk e ka pyetur atë nëse ka ndonjë mbrojtje për këtë.

69. Pala e dëmtuar B.S. i ka vazhduar provat para trupit gjykues kryesor me 10 korrik 2014.

70. B.S. ka theksuar se posa ai ka vendosur që të pranonte fajësinë seanca ka zgjatur vetëm rreth pesë minuta. Ai ka theksuar se ai e ka marrë një dënim prej dy vite e gjysmë burgim

port re muaj nga këto do suspendoheshin që do të thotë se ai duhej që ta vuante një dënim përfundimtar prej dy vite e tre muaj.

71. B.S. ka theksuar se 2-3 ditë pasi që ishte liruar M.S. e ka ftuar atë që të takohen përmes XH.B. Ata janë takuar në fshatin Jezerca në restorantin “Freskia”. Të pranishëm kanë qenë B.S., M.S., B.SH. dhe XH.B.. B. i kishte shumë borgj M.S. t sepse ai ka bërë shumë për të dhe i ka ndihmuar shumë. Ai ka theksuar se M.S. i ka thënë atij se ai nuk kishte fat, procesi i tij po shkonte ngadalë dhe se ai nuk e ka ditur që ai ishte daja i tij. Ai po ashtu theksoi se prokurorja, B K ishte e sëmurë e cila po ashtu e ka vonuar procesin. Së fundi, ai ka theksuar se ai kishte pranuar ca para nga vëllai i B që të blejë iPhone dhe kompjuterë Laptop për gjyqtarët dhe prokurorët.
72. B.S. ka theksuar se M.S. dhe B.SH. nuk e kanë ditur që ai ishte dënuar dhe kur ai ua tha ata menjëherë e kanë ndërruar temën dhe kanë thënë, “*Ne ende jemi në gjendje për të të ndihmuar ty sepse ne mund ta dërgojmë rastin tënd për ri-gjykim sepse nuk ka mundësi tjetër.*” Ai ka theksuar se ai ka besuar që ata veqse e kanë ditur që ai ishte dënuar dhe se befasia e tyre ishte e trilluar. Ai ka thënë që ata e kanë udhëzuar që të vazhdojë që të punojë dhe se ata do vazhdojnë që ta ndihmojnë atë.
73. B.S. ka theksuar se kur grupi po shpartallohej M.S. i ka thënë atij, “*unë të kam borgj shumë sepse unë nuk e kam ditur që kemi lidhje familjare dhe se unë kam turp që ta ballafaqoj babain tënd Bedri Sulejmani.*” Ai theksoi që M.S. po ashtu ofroi që të vijë në shtëpinë e tij dhe që ti kërkonte të falur babait të tij.
74. B.S. theksoi se ai e ka informuar M.S. n se dyert e tija ishin të hapura për të. B.S. theksoi që M.S. dhe B.SH. më pas kanë ardhur në shtëpinë e tij për darkë dhe i kanë kërkuar falje babait të tij, i kanë thënë që djali i tyre ka qenë i pafat dhe se problemi mund të rregullohej dhe se ata kanë ndenjur duke biseduar gjer në ora 2 pas mesnate.
75. B.S. ka theksuar se kur grupi po shpartallohej ai e ka pyetur M.S. n për B D sepse kur ai ka qenë në paraburgim vëllezërit e tij kanë menduar se ai ishte i përfshirë në ndonjë

mënyrë në këtë kurth. Ai ka theksuar se M.S. vetëm do thoshte B D po ashtu ishte në telashe por ai nuk tregonte se përse. Kur është pyetur si ndodhi që ai ta vozisë një makinë Mercedes që B dhe B D e kishin blerë në Gjermani dhe ia kishin dhënë B D, Menders S ka theksuar se B ia kishte dhënë një makinë Audi B D dhe një shumë parash. Ai nuk tha se çfarë ishte shuma dhe ndërroi temë.

76. B.S. më pas ka theksuar se ka pasur një takim më vonë me M.S. n dhe B.SH. tek kafeneja “Lamburgjini”. B.S. ka theksuar se ai ka qenë atje me një shok kur M.S. ka arritur dhe ai e ka ftuar atë që të ulet dhe ta pijë një kafe. Shoku i tij ka shkuar dhe ai dhe M. kanë sugjeruar që të kthehen në restorantin “Freskia” në Jezerc. Kur ata kanë arritur tek “Freskia” B.SH. po ashtu ka arritur dhe ka deklaruar se ai ka një problem dhe kishte nevojë për ca para për një biletë aeroplani. Shuma prej €600 ishte përmendur. Në këtë moment B.S. sërish e ka identifikuar M.S. n dhe B.SH.n në gjykatë.

77. B.S. ka vazhduar me dëshminë e tij para trupit gjykues në seancën e datës 11 korrik 2014.

78. B.S. ka deklaruar se M.S. më pas e ka kërkuar një kopje të aktvendimit të Gjykatës që e kishte liruar atë. B.S. pastaj dha dëshmi për arrestimin e tij të dytë që ka ndodhur me 4 janar 2013 në restorantin “Montana”. Atë mëngjes ai kishte shkuar në Shtërpce me djalin e tij M* për të pirë kafe. Atje ata kanë takuar disa miq, përkatësisht pronarin e restorantit “Europa”, një person të quajtur Kani dhe një shok tjetër të quajtur R, që punon në Afganistan dhe që ishte në pushim në atë kohë. Ai e ka ftuar B dhe M S që të shkojnë dhe të hanë drekë në restorantin “Luboteni” në Brezovicë. Sidoqftë, përafërsisht në ora 13:00 ai e ka marrë një telefonatë nga M.S. . Ai ka thënë, “unë kam dëgjuar që e keni një grup të personave që merren me pjesën e jashtme të ndërtesës” dhe “a mund të vini dhe të shikoni se çfarë punë duhet që të kryhet”. B.S. ka theksuar se ai është përgjigjur se ai ka do gjëra tjera për ti kryer së pari por se do vijë.

79. B.S. ka theksuar se ai është vonuar dhe nuk mund të shkoj dhe se në vend të kësaj ka shkuar afër tek një kafene ku ai e ka përfunduar një marrëveshje për ta shitur një makinë Volkswagen “Touareg” për 18,000€. Sidoqftë, rreth orës 16:00, ai e ka pranuar një

telefonatë tjetër dhe personi ka theksuar se ishte nga Policia nga Departamenti i Krimeve të Rënda në Prishtinë dhe zyrtari donte që të takohej në ora 18:00 në rrugën Prishtinë-Kacanik. B.S. ka theksuar se ai ishte i shokuar kur e ka pranuar këtë telefonatë dhe ai menjëherë e ka telefonuar M. dhe ai e ka udhëzuar Menderes *“nëse ti nuk ke bërë asgjë të keqe, ti mund të shkosh dhe ti takosh ata”*.

80. B.S. theksoi se në këtë kohë ai ishte shumë i shokuar dhe e ka ndalur telefonin e tij. Ai ka theksuar se edhe djali i tij ishte i shokuar. Ai ka theksuar se ai e ka thirrur vëllain e tij K S dhe ka kërkuar që ta marrë djalin e tij dhe ta strehojë tek shtëpia e XH.B. Ai pastaj ka kërkuar që XH dhe K të takohen me M.S. dhe. B.S. ka theksuar se ai ka vendosur që të largohet diku që ta shmangi të arrestuarit e sërishëm.

81. B.S. theksoi se ai doli nga Brezovica dhe ka shkuar në Shtërpce. Ai ka deklaruar se K dhe XH e kanë telefonuar në telefonin e djalit të tij Mërgimit dhe XH. i ka thënë atij *“B, nëse nuk ke bërë asgjë gabim, eja këtu”*. B.S. theksoi që ai u takua me S SH në Shtërpce dhe ai e ka këshilluar atë që të mos takohet me askë meqë ishte shumë vonë. Sidoqftë, B.S. ka theksuar se ai ka vendosur që të shkoj dhe kur ka arritur në Ferizaj ai e ka telefonuar vëllain e tij K i cili ka qenë në kafeteri afër stacionit policor me XH. Ata kanë shkuar në stacionin policor. M.S. ishte atje.

82. B.S. theksoi se M.S. e ka pyetur atë nëse e njeh një femër të quajtur S dhe ai tha që po, në të cilën gjë M.S. tha që ishte një rast serioz. B.S. ka theksuar se ai i ka thënë M.S. t që ai nuk kishte të bënte asgjë me këtë çështje, serioze apo jo, por M.S. tha që edhe ai nuk kishte *“të bënte asgjë me këtë rastin”*. Ai tha që Policia do vinte nga Prishtina dhe B.S. mund të fliste me ata.

83. B.S. theksoi se pas 5 minutash dy zyrtarë policorë në rroba civile kanë ardhur. Ai theksoi se M.S. u tha atyre që B.S. ishte përfshirë në rastin Sanella, dhe ua bëri me kokë atyre që ta marrin atë dhe ai është dërguar në Prishtinë.

84. B.S. theksoi se gjatë rrugës zyrtarët policorë e kanë ofenduar atë. Ai ka theksuar se ata kanë arritur rreth orës 21:00 në stacionin policor në Prishtinë dhe ai i ka parë tre ose katër persona/zyrtarë policorë që i kanë pyetur ata të dy që e kanë shoqëruar atë *“a e keni sjellë ju atë këtu?”* dhe kur ata e kanë konfirmuar ata kanë thënë *“ju duhet të filloni menjëherë që ti bëni përgatitjet për arrestim.”* Ai theksoi se ai ishte vendosur në një dhomë për ta pritur avokatin e tij R. G.
85. Kur R G ka arritur ai ka thënë *“B, a është ende me problem të njëjta dhe me krimet e njëjta.”* Ai theksoi se zyrtari policor pastaj ka vazhduar që ta intervistojë atë. Ai ka theksuar se shumë gjëra të ndryshme ishin duke u përmendur duke përfshirë edhe drogën dhe ai e ka përsëritur që ai nuk ka pasur asgjë të bëj me diçka të tillë. Sidoqftë, ai ka theksuar se ata i kanë rregulluar të gjitha dokumentet dhe e kanë dërguar në paraburgim në një ndërtesë tjetër në Prishtinë ku një zyrtar policor u ka thënë rojeve, *“nëse ky person është i vetëdijshëm se çfarë ka bërë, ne nuk kemi të drejtë që ti bëjmë atij asgjë”*.
86. Të nesërmen në ora 09:00 ose 10:00, B.S. ka theksuar se ai është dërguar në gjykatë nga katër persona. Kur ata kanë arritur në gjykatë prokurori ka filluar që ta lexojë aktakuzën dhe B.S. ka theksuar se ai është *“shumë i tmerruar për ta dëgjuar”*. Ai theksoi se ai nuk e njihje të bashkakuzuarin. Ai ka theksuar se rasti ka pasur të bëj me diçka që pretendohet se ka ndodhur rreth para 2 vite e gjysmë 2 diku në Gjilan. Ai ka theksuar se Gjyqtari ka urdhëruar një muaj paraburgim për që të dy por se avokati i tij R G është ngritur dhe ka thënë, *“ju nuk keni argumente, nuk ka prova kundër tij”* dhe po ashtu ka thënë se ka masa tjera që mund të përdoren përpos paraburgimit siq janë arresti shtëpiak apo paraqitja në stacionin policor. B.S. ka theksuar se ata janë nxjerrë jashtë sallës por menjëherë pastaj ata janë ftuar sërish dhe një urdhër për arrest shtëpiak ishte lëshuar. Ai ka theksuar se kur ai është kthyer në shtëpi, ka qenë një situatë tmerruese në familjen S. Ai tha se ishte një përzierje e lumturisë dhe frikës dhe për të shtatë ka qenë tmerruese.
87. B.S. ka theksuar se ai beson që ai ishte vënë në shënjestër nga M.S. meqë ai po tentonte të ndërtonte shtëpi me rrogë të zyrtarit policor dhe si rezultat në nevojë të madhe për të holla. Ai ka theksuar se më pas ai e ka raportuar rastin në IPK.

88. B.S. ka vazhduar me prova para trupit gjykues në seancën e datës 4 gusht 2014. Ai ka theksuar se Sokol Shabani ka qenë me të gjatë tërë kohës kur Policia e Prishtinës e ka ftuar atë dhe e ka këshilluar atë që të mos shkoj me ta atë mbrëmje. Ai ka theksuar se paraqitja e tij në gjyq ishte me datë 5 janar 2013, të shtunën. Ka qenë ai, një i bashkë-akuzuar të cilin nuk e ka njohur, dy zyrtarë policor në rroba civile dhe një panel gjyqtarësh. Edhe avokati i tij mbrojtës R G ishte po ashtu prezent.
89. B.S. ka theksuar se rasti i tij qe dhënë sërish në gjykatë me datë 27 janar 2013 dhe para kësaj R G e ka ftuar ose K ose A.S. (ai nuk mund ta mbaj në mend se kënd) dhe pala e dëmtuar do ishte e pranishme me 27 janar 2013 dhe ai, *“mezi ia ka arritur që ta bindi gjykatën që ta dëgjojë B.S.n”* sepse ata nuk kanë dashur që ta dëgjojnë atë.
90. B.S. ka theksuar se me 27 janar 2013 policia e ka dërguar atë në Prishtinë. Ai ka theksuar se pala e dëmtuar e pretenduar ka qenë e pranishme dhe ka dhënë një deklaratë e cila nuk e ka implikuar atë aspak. Ajo ka treguar se si ishte marrë nga P për në Shtërpce dhe se si ajo njihje shumë persona atje por ajo tha se B.S. nuk i kishte bërë asaj asgjë.
91. B.S. ka theksuar se ai eventualisht qe liruar nga arresti shtëpiak me datë 2 gusht 2013. Ai theksoi se me 14 gusht 2013 ai ka shkuar në Ferizaj dhe se pinte kafe në kafenenë *“Lamburgjini”* në pompën e benzinës në HIB kur M.S. ishte shfaqur. B.S. ka theksuar se M.S. ka thënë se ai ishte shumë i brengosur që ai ishte mbajtur në burg për një kohë aq të gjatë dhe se ishte shumë i lumtur që ishte liruar dhe ka thënë se *“unë ju dua ju dhe familjen tuaj”*. Ai theksoi se ai ishte në nguti por se ata duhet të takohen sërish dhe se ai ia dha B.S. numrin e tij të telefonit.
92. B.S. ka theksuar se ai, familja e tij dhe biznesi i tij ishin në humbje të madhe financiare si rezultat i të gjitha ngjarjeve.
93. Gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të tërthortë nga ish avokati i të pandehurit, M.S. avokati A I në seancën e shqyrtimit kryesor me datë 25 gusht 2014, B.S. ka theksuar se ai

ishite drejtor i kompanisë “Luboten”, ai ka qenë jashtë vendit dhe se është përfaqësuar nga vëllai i tij A.S. i cili ka qenë i “pronari i dytë i ndërmarrjes”. Ai po ashtu ka pasur qasje në llogaritë e shumta bankare të kompanisë. Ai ka theksuar se në vitin 2012 nuk ka pasur shumë para të gatshme në këto llogari.

94. Ai ka konfirmuar se me 30 maj 2012 ai ka qenë në restorantin “Planet” në Gjiilan në një grup që e ka përfshirë edhe Sanellën, viktimën e pretenduar në rastin e dytë kundër tij që ishte me 4 janar 2013.

95. B.S. ka theksuar se ai po ashtu i ka njohur edhe L P dhe N P që nga viti 2010 dhe se ai ka pasur marrëdhënie të mira me ta. Ai e mbante në mend një festë në vitin 2012 ku ata kanë qenë aty prezent. B.S. ka theksuar se të gjitha deklaratat që e kanë implikuar atë në trafikimin me qenie njerëzore ishin marrë me dhunë dhe ishin të rrejshme. Sidoqftë, ai ka theksuar se besonte se ai nuk ishte më “ne duart e bandës” por se tani ishte në, “Duart e drejtësisë”. Kur është pyetur për të elaboruar ai ka thënë se këto “banda” ishin të pandehurit e pranishëm në gjykatë.

96. B.S. ka theksuar se gjatë arrestimit të tij të parë, B.SH. e kishte drejtuar atë për në zyrën e M.S. për të kërkuar ndihmë. Sidoqftë, ai ka theksuar se M.S. nuk i ka kërkuar atij para në mënyrë të drejtpërdrejtë.

97. B.S. ka theksuar se ai është takuar me M.S. sërish pas lirit të tij nga periudha e paraburgimit dhe se kjo ishte aranzhuar nga XH.B.. Ai ka theksuar se B.SH. ka qenë po ashtu prezent. Ai ka theksuar se në atë takim M.S. nuk ka kërkuar për para ose përfitime tjera. Ai konfirmoi se ata u takuan përsëri në shtëpinë e tij me urdhër të M.S. meqë ai dëshironte që të fliste me babain e B.S. Sërish, ai theksoi se në këtë takim, as nuk janë kërkuar e as nuk janë dhënë para.

98. B.S. ka theksuar se ai e njeh R B dhe se ai ka qenë një dëshmitar në procedurat në të cilat ai është deklaruar fajtor. Ai ka theksuar se ai ka punuar në Kuvendin Komunal si Shef i

Planifikimit. Ai ka theksuar se ai e ka njohur atë nga ditët shkollore dhe se ata ende gëzojnë marrëdhënie të mira.

99. B.S. përsëriti se rasti kundër tij ishte një fabrikim dhe se personat e akuzuar para trupit gjykues ishin përgjegjës për këtë. Ai po ashtu ka theksuar edhe vëllai i tij besonte se B D ishte i përfshirë. Ai theksoi se ai e kishte takuar atë pas lirimit të tij nga paraburgimi me datë 27 nëntor 2012.

100. B.S. konfirmoi se M.S. nuk ka kërkuar para në asnjërin nga takimet e tyre. Ai theksoi se përfundimisht ai e raportoi rastin në polici me datë 14 prill 2013 kur ai dha deklaratë në IPK. Ai theksoi se ai ra dakord që të takohet me të pandehurit pas kësaj në mënyrë që të mbledhi prova kundër tyre.

101. 101. B.S. ka theksuar se G I (“Mishi”) është nipi i tij dhe se në prill 2013 ai ka ardhur tek ai dhe ka pyetur, “*çfarë i keni bërë dajës tim?*” ai ka theksuar “*çdo gjë është bërë përmes kompanisë Salihu Salihu*” dhe pronar ka qenë kushëriri i E.A.t dhe “*kinse ai e ka shtyrë atë që ta bëjë këtë komplot*”.

102. 102. B.S. ka Konfirmuar se A D dhe ai është nipi i B D ka qenë i lidhur me kompaninë “*Burimi*”. Ai theksoi se ai ia ka dhënë makinën e tipit Mercedes të cilën e ka importuar në vitin 2012 B (dhe jo A) D.

103. 103. Në përgjigje të pyetjeve nga avokati i të pandehurit, B.SH., B.S. theksoi se ai fillimisht ishte në mbajtjes nga Policia për dy netë dhe një ditë. Ai ka theksuar se B.SH. e ka incizuar intervistën e tij dhe procesverbalet i ishin lexuar atij. Ai konfirmoi se ai e ka njohur B.SH. përmes vëllait të tij nga një fshat i afërt dhe ka gëzuar marrëdhënie të mira me ta. Ai ka theksuar se pas arrestimit të B.SH. nuk ka pasur “*përpyetje apo ushtrim të ndikimit*” mes tij dhe familjes së tij. Ai ka theksuar se ai nuk ka pasur dijeni në lidhje me ndonjë kërcënim nga familja e B.SH.t kundër anëtarëve të familjes së tij apo kundër ndonjërit nga dëshmitarët.

104. 104. B.S. ka theksuar se ai i është nënshtruar terapisë në lidhje me traumat që i ka pësuar. Ai ka theksuar se ai e ka vazhduar terapisë pas datës 2 gusht 2013. B.S. deklaroi se ai e ka udhëhequr një biznes të mirë i cili në kulmin e suksesit ka pasur të punësuar 70 persona por tani ishte në një gjendje shumë të keqe dhe kishte vetëm 6 punëtorë. Ai theksoi se për këtë ai e fajëson arrestimin e tij. Sidoqftë, ai ka theksuar se qëllimi i tij ka qenë që ta ri-ndërtojë biznesin. Ai ka theksuar se familja e tij kishte vuajtur si rezultat i arrestimit të tij dhe se vazhdonte që të vuante meqë ata kurrë nuk kanë pasur ndonjë përfshirje negative me policinë.
105. Dëshmitari i rradhës për të dëshmuar ka qenë pala e dëmtuar **K.S.** Në deklaratën paraprake ai i ka dhënë deklarata IPK-së se me datë 24 mars 2013⁶ dhe prokurorit me datë 27 shtator 2013⁷. Ai është shfaqur për të dëshmuar para trupit gjykues me datë 8 shtator 2014. Sidoqftë, atë ditë ai është sëmure në sallën e gjyqit dhe nuk ishte në gjendje që të dëshmojë gjer me datë 16 shtator 2014.
106. Me 16 shtator 2014 K S ka theksuar se ai ka punuar për kompaninë “Luboteni” që nga viti 2001 dhe ka qenë në maje që nga viti 2013. Ai konfirmoi një zbritje në të hyrat e kompanisë që nga viti 2012. Ai theksoi që në kulmin e suksesit të saj kompania vlente rreth 2 milion euro. Ai ka theksuar se kompania dhe në të vërtetë familja S.kanë pasur marrëdhënie të mira me komunitetin në Kacanik dhe ata nuk kanë pasur asnjëherë problem me policinë.
107. K.S. ka theksuar se B.S. i ka marrë përsipër çështjet e aranzhimeve financiare me banka por ai ka qenë i përfshirë në këto procese. Ai ka emëruar persona të ndryshëm në banka me të cilët ka bashkëpunuar por ai nuk e ka ditur emrin e A.S.
108. K.S. ka theksuar se në vitin 2012-13 ai po përdorte një telefon mobil që ishte i regjistruar ne emër të kompanisë dhe andaj numri ishte në dispozicion për publikun duke përfshirë edhe policinë.

⁶ Dosja e Prokurorisë 2A në fq 602-609

⁷ Dosja e Prokurorisë 2A në fq 566-601

109. K.S. ka theksuar se vëllai i tij, B. ishte arrestuar në fund të muajit maj 2012. Ai ishte informuar nga vëllai i tij A. Ai theksoi se ai ka shkuar në stacionin policor në Ferizaj ku është takuar me avokatin e tij K, por nuk mund ta mbaj në mend mbiemrin e tij. Ai ka theksuar se ai nuk mund të japi asnjë arsye për arrestimin e B.t dhe më pas është tërhequr nga rasti por jo para se të thoshte M.S. , B.SH. dhe E.A. e kishin informuar atë se B *“ishte akuzuar me akuza të rënda”* në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore ashtu siq edhe ishte. Ai theksoi se para vitit 2012 ai as që e kishte dëgjuar emrin e M.S. t. Ai e dinte që B.SH. një herë kishte punuar tek pompa e benzinës por ai nuk ka pasur problem me të dhe ai e njihte E.A. meqë ishte fqinji i tij.
110. K.S. ka theksuar se menjëherë pas arrestimit të B, vëllai i tij A dhe dhëndri i tij XH.B. ishin më së shumti të involvuar në rastin. Ai tha që kishte njohur M.S. dhe B.SH.n dhe ata po ndihmonin me rastin.
111. K.S. ka theksuar se 3 muaj pas arrestimit të B.t, ai e ka takuar shokun e tij F H tek restorani “Firaja”. Ai pyeti për familjen dhe ka folur në lidhje me avokatë. K ka theksuar se qëkur A.S. dhe XH.B. ishin përfshirë me M.S. dhe B.SH.n në rastin që ai mendoi se do ti vinte në fund. Sidoqftë ai e ka mbajtur në mend F H duke thënë “M” (d.m.th M.S. duhet *“ti përfundojë gjërat shumë mirë”*).
112. K.S. ka deklaruar se në kohën kur A.S. dhe XH.B. e kanë takuar M.S. n dhe B.SH.n pothuajse çdo ditë ata kanë pritur lirimin e B në çdo moment. Ai ka deklaruar se çdo herë që ata kanë pasur takim me M.S. n dhe B.SH.n ata do e takonin edhe atë. Ai ka theksuar se ata e kanë informuar atë, M.S. n dhe B.SH.n se ata do të i ndihmojnë B duke ndikuar tek L P dhe N H të cilat që të dyja kanë qenë viktime në atë kohë. Ai theksoi se M.S. dhe B.SH. kanë kërkuar para në mënyrë që të blinin kompjuterë ose telefona iPhone për prokurorët.
113. K.S. ka theksuar se ai ka besuar që F H ka pasur kushërinjë në forcat policore dhe ai e ka njohur me siguri M.S. Ai ka theksuar se në një kohë të caktuar XH.B. dhe A.S. e kanë këshilluar atë se kishin nevojë për para. Ai theksoi se ai ua ka dhënë 300 ose 400

euro por nuk mund ta mbajë në mend cilën. Ai theksoi se rregullisht ai u ka dhënë atyre para pa e konfirmuar çdo herë domosdoshmërisht gjatë secilat rast se për çka ishin. Ai ka theksuar se ai beson që shuma e përgjithshme që e ka dhënë është diku 4,500€. Ai ka theksuar se ai ka qenë i informuar se paratë në të shumtën e rasteve qenë dorëzuar në supermarketin “Viva Fresh” në Ferizaj dhe pjesa tjetër në pompën e benzinës “Euro-Miti”. Ai ka theksuar se ca para ishin marrë hua edhe nga B H dhe R I si deh nga banka. Ai ka theksuar se ai e ka parë A.S. dhe XH.B.n duke u ulur me M.S. n dhe B.SH. tek Ballkan-Petrol duke darkuar së bashku me B H dhe kjo ishte hera e parë që ai e ka parë M.S. Ai ka theksuar se ky takim ka ndodhur pas arrestimit të parë të B. por ai nuk e di saktësisht se kur.

114. Pala e dëmtuar K.S. ka vazhduar me dëshminë e tij me datë 19 shtator 2014. Ai ka theksuar se ai e ka vizituar rregullisht vëllain e tij në burgun e Lipjanit dhe e ka informuar atë se ai kishte intervenuar dhe se rasti do të zgjidhej nga data 27 nëntor 2012. Në ditën që ai ka theksuar se ai ka shkuar me vëllain e tij dhe dhëndrin e tij XH.B. në Prishtinë ku avokati i B., R. G. i ka propozuar B. që të deklarohet fajtor, të cilën gjë ai edhe e bëri dhe më pas qe dënuar me 2 vite e 3 muaj burgim. Ai ka theksuar se kjo seancë gjyqësore nuk ishte në fakt e caktuar për këtë datë. Ai ka deklaruar se ai besonte që B.V. dhe S.M. e kishin rregulluar këtë gjë.

115. K.S. ka deklaruar se pasi që B. ishte liruar ai e kishte telefonuar atë duke e përdorur telefonin e A.S.t dhe i kishte thënë që të mos ipte para sepse ishte deklaruar fajtor dhe Kemajli kishte thënë e do të vepronte ashtu.

116. K.S. tregoi se si në mes të dhjetorit 2012 M.S. dhe B.SH. kishin ardhur në shtëpinë e tij familjare në fshatin X për darkë dhe për të pirë dhe se kishin ndenjur deri në mesnatë dhe se ata i kishin kërkuar falje babait të tij për rastin dhe se i kishin thënë që B. nuk kishte pasur fat. Ai ka theksuar se kjo ka qenë hera e parë që ka qenë në shoqëri të M.S. dhe B.SH.t edhe pse i kishte parë më parë në pompën e benzinës X. Ai i ka identifikuar që të dy në gjykatë.

117. K.S. pastaj tregoi që një pasdite, në fillim të vitit 2013 ai ka shkuar në Brezovicë sepse B. e kishte shitur një banesë atje. Ai theksoi se posa ai ka arritur atje B ka qenë në nxitim që të shkojë sepse ai kishte folur me M.S. n i cili kërkonte që disa punë në shtëpinë e tij të kryheshin. Ai ka theksuar se diku në mbrëmje, B e ka marrë një telefonatë nga departamenti i policisë i krimeve të rënda në Prishtinë dhe se ai e ka thirrur Kemajlin që ta informojë atë në lidhje me këtë. Ai ka theksuar se B e kishte thirrur M.S. n i cili e kishte këshilluar atë *“nëse ndihesh fajtor më mirë shmangje që tu biesh atyre në duar, nëse je i pafajshëm, shko atje se ata nuk do të bëjnë asgjë”*. Ai tha që atë mbrëmje ai dhe XH.B. shkuan në kafenenë “Cosmo” afër ambulancës. Ai theksoi se ai e ka pyetur M.S. se ku qëndronte problem dhe se a mund ti takonte personat që po e kërkonin B e tij. Ai theksoi se M.S. është përgjigjur, *“ti nuk mund të luash me shtetin kështu”* dhe, *“vëllai yt ka bërë aq shumë gjëra të këqija sa që do e mbushi një kamion dhe unë e kam marrë vetëm një çantë të vogël dhe se i kam fshehur të tjerat. Unë nuk dua që ti fshehi gjërat pasi që drejtësia është e barabartë”*. Ai theksoi se M.S. nuk ka qenë në punë atë ditë por se ka shkuar që ta presë B, të cilin, K.S. ka theksuar se e ka thirrur dhe pastaj ai e kishte dorëzuar veten e tij tek M.S. në stacionin policor në Ferizaj.
118. Pala e dëmtuar K.S. e ka vazhduar dëshminë e tij me datë 30 shtator 2014.
119. Ai theksoi se M.S. ka thënë që B duhet që të shkojë në stacionin policor në Ferizaj dhe se ai do ta intervistojë atë personalisht. K.S. ka theksuar se ai besonte që kjo ishte një lojë për të siguruar dorëzimin e B.S.. Në fund ai ka thënë që B.SH. ka shkuar në shtëpinë e tij dhe më vonë B.S. dhe XH.B. kanë shkuar në stacionin policor.
120. K.S. ka theksuar se ai e ka kuptuar se në stacionin policor në, zyrtarët policorë nga Prishtina kanë arritur dhe kanë pyetur se kush ishte B.S. dhe në bazë të B.S. dhe XH.B., M.S. u ka thënë atyre *“Merreni atë. Ai është i imi. Ndhimojini një qikë”*.
121. K.S. ka theksuar se B qe arrestuar dhe të nesërmen rreth orës 17:00 M.S. e ka kontaktuar atë në mënyrë të drejtpërdrejtë në kafenenë *“Lamborghini”* ku ai ka thënë se ai do i ndihmojë B.S. *“deri në maksimum”* por pas kësaj dhe deri me datën 21 mars 2013

situata ishte relativisht e qetë. Ai ka thënë se edhe djali i M.S. t ka qenë i pranishëm në takim.

122. K.S. ka theksuar se me 27 mars 2013 së bashku me XH.B. ai e ka takuar B.SH.n para shtëpisë së B.SH.t në makinën e tij. Ata kanë folur në lidhje me rastin e B.S.. Ai ka theksuar se kjo bisedë ishte po ashtu e incizuar tërësisht në IPK të cilët po ashtu ishin duke e monitoruar takimin. Ai ka theksuar se B.SH. ka theksuar se ai dëshironte që rasti të ridërgohej në Ferizaj meqë ai mund të ushtronte ca ndikim atje ndërsa vetëm M.S. kishte ndikim në Prishtinë. Ai ka thënë se B.SH. kishte thënë se ai do të fliste me M.S. n të nesërmen në mënyrë që të përcaktonte se çfarë po ndodhte me B.S.n.

123. K.S. e ka theksuar se ai beson që M.S. mund të bëj ndonjë gjë në lidhje me rastin e parë duke e përfshirë B.S.n edhe pse B.S. veq ishte deklaruar fajtor. Ai ka thënë që B. ia kishte dhënë M. një dokument për ta ndihmuar. Ai ka thënë që B.SH. kishte treguar që M.S. po fliste me dikë në Prishtinë në lidhje me rastin e B.. Ai ka theksuar se mund të kishte një ri-gjykim në Ferizaj ku ai kishte ndikim. Ai nuk mund ta mbaj në mend nëse i ishte bërë një referencë një prokurori të quajtur A. Ai ka thënë se B.SH. i ka thënë atij se ai duhet që ta grumbullojë një shumë të caktuar parash por ai nuk e mban në mend shumën.

124. Në përgjigje të pyetjes nga avokati A I, Avokat mbrojtës i të pandehurit M.S. , pala e dëmtuar K.S. ka theksuar se në fund të vitit 2011 dhe në fillim të vitit 2012 xhironlogaria e kompanisë “Luboteni” ishte e zbrazët. Ai ka theksuar që B.S. ishte drejtor i kompanisë dhe se A.S. ishte zëvendës i tij. Ai ka theksuar se pas arrestimit të B.S. në vitin 2013 ai e mori përsipër të udhëhequrit e saj. Sidoqftë, ai ka theksuar se pas arrestimit të B.S. në maj 2012 kompania filloi të përjetojë problem financiarë.

125. K.S. nuk mund të thoshte se sa herë pas arrestimit të vëllait të tij ai e ka kontaktuar A dhe XH por ai tha se ka qenë rregullisht dhe sa herë që kishte takime me M.S. n dhe B.SH., ai është informuar nga vëllezërit e mi A dhe XH se ata kishin diskutime të caktuara.

126. K.S. ka theksuar se ai e dinte që një numër avokatësh ishin angazhuar që ta përfaqësojnë vëllain e tij, por i vetmi të cilin ai e takoi ishte R G. K.S. ka theksuar se ai e dinte që vëllai i tij ishte liruar me 27 nëntor 2012. Ai tha që ai e kishte pasur një bisedë me avokatin R G po atë ditë. Ai ka theksuar se avokati e kishte këshilluar vëllain e tij që të deklarohej fajtor sepse në ri-gjykim ai do të lirohej. Ai ka theksuar se avokati veq i kishte thënë XH.B. se rasti ishte një orkestrim dhe se ai ishte vënë në kurth nga Policia.
127. K.S. ka theksuar se ai e njihnte B D dhe se ai ishte pronari i kompanisë “X”. Ai ka theksuar se ai po ashtu e dinte edhe kompaninë “X”. Ai ka theksuar se rasti eventualisht ishte raportuar në polici në mars 2013 por ai nuk mund të thoshte si. Ai ka theksuar se deri në këtë kohë familja e tij ia kishte dhënë më shumë se 4,500€ M.S. t.
128. Avokati mbrojtës pastaj e ka ngritur çështjen e marrëveshjes së huasë të cilën pretendohet ta ketë dëshmuar në mes të disa nga palët e këtij rasti. Pas parashtresave nga të gjitha palët, avokati mbrojtës eventualisht u tërhoq nga rasti dhe ishte zëvendësuar përkundër faktit që mund ti kërkohej atij që të dëshmojë si dëshmitar në ndonjë kohë.
129. Pala e dëmtuar K.S. e ka vazhduar dëshminë e tij me datë 13 tetor 2014. Në përgjigje të pyetjeve nga avokati R A, Avokat mbrojtës i të pandehurit, B.SH., ka theksuar se pas takimit të tij me avokatin, K në kohën e arrestimit të parë të vëllait të tij, XH.B. dhe A.S. janë marrë me rastin. Sidoqftë, ai e ka përsëritur deklaratën e tij të mëparshme se ata e kishin informuar atë në lidhje me zhvillimet e rastit dhe në lidhje me secilin takim me B.SH.
130. K.S. konfirmoi se ai personalisht asnjëherë nuk i kishte dhënë para M.S. t ose B.SH. por ai konfirmoi se ai ia kishte dhënë përafërsisht 300 ose 400 euro A.S.t të cilat ai ka mundur që të shpenzojë duke dalur me M.S. n ose B.SH.
131. K.S. ka theksuar se ai ka dëgjuar nga A.S. dhe XH.B. të cilët kanë qenë të pranishëm atje se B.SH. i ishte afruar prokurorit për ta ndihmuar B.S.

132. K.S. ka theksuar se në një rast të caktuar ai ka marrë këshillë nga IPK-ja para se të fliste në telefon në lidhje me këtë rastin. Sidoqftë, ai ka theksuar se IPK-ja nuk e ka këshilluar atë se çfarë të thoshte në bisedimet e incizuara.
133. K.S. ka theksuar se familja e tij kishin vendosur njëzëri që të raportojnë se çfarë po ndodhte me policinë në shkurt të vitit 2013. Ai u arsyetua për vonesën duke thënë që ai dëshironte për të grumbulluar informata para se ta informonte policinë. Ai e ka përsëritur deklaratën e tij të mëparshme se policia nuk e kishte udhëzuar atë çfarë të thoshte por se thjesht ishin të interesuar për ta incizuar bisedën.
134. Në përgjigje të pyetjeve nga avokati, A S avokat i të pandehurit V.T., pala e dëmtuar K.S. ka theksuar se ai e ka diskutuar çështjen e vëllait të tij me shumë avokatë duke përfshirë edhe R A të cilin e ka këshilluar kur vëllai i tij ishte në arrest shtëpiak. Ai ka theksuar se Z. A e kishte udhëzuar atë se nuk kishte asnjë rast kundër klientit të tij.
135. Në përgjigje të pyetjeve nga i pandehuri M.S. në seancën e datës 13 nëntor 2014 pala e dëmtuar K.S. ka theksuar se ai nuk dinte asgjë në lidhje me promovimin e tij brenda Policisë së Kosovës dhe se nuk ishte i interesuar në këtë.
136. Në përgjigje të pyetjeve gjatë ri-marrjes në pyetje nga prokurori, pala e dëmtuar K.S. ka theksuar se ai beson që vëllai i tij ishte tërësisht i pafajshëm ndaj të gjitha akuzave kundër tij. Motivimi i atyre të cilët i kanë fabrikuar akuzat kundër tij kishte të bënte me përfitime financiare dhe ai është deklaruar fajtor sepse avokati i tij e kishte këshilluar që të veprojë në atë mënyrë.
137. Pala e dëmtuar **A.S.** ka dhënë dy deklarata paraprake në IPK⁸ dhe një tek prokurori⁹. Ai ka filluar që të japi dëshmi para trupit gjykues në seancën e datës 14 nëntor 2014.

⁸ Dosja e Prokurorisë 2A faqe 815-835

⁹ Dosja e Prokurorisë 2A faqe 758-814

138. Në deklaratën e tij në IPK ai tregon datën kur policia e ka arrestuar vëllain e tij B (28 ose 30 maj 2012), vëllai i tij A. i kishte thënë atij që të shkojë dhe ta marrë makinën e B nga Stacioni Policor në Ferizaj, meqë B kishte “*disa probleme*”. Ai theksoi se ai e ka telefonuar dhëndrin e tij XH B dhe së bashku me të atë natë ata kanë shkuar në stacionin policor në Ferizaj. Ai ka theksuar kur kanë hyrë se atyre nuk u është thënë se çfarë ka ndodhur, atyre vetëm u ishin dhënë çelësat e makinës së B dhe ata kanë shkuar në shtëpi. Ai ka theksuar se zyrtari policor që po qëndronte në kabinë nuk u ka thënë atyre asgjë.
139. Ai theksoi se të nesërmen ai kishte shkuar me XH.B. ta takonte K S në stacionin policor dhe ai u ka thënë atyre se ai e kishte marrë një avokat dhe theksoi se nuk dinte më shumë në lidhje me rastin e B.
140. Ai theksoi më pas se ai, XH.B. dhe djali i xhaxhait të tij S S, kanë shkuar në një kafene tjetër ku janë takuar me B dhe B D i cili ka propozuar që ta takojë M D, vëllain e B D, për të kuptuar më shumë për rastin. Ai ka theksuar se ata e kanë takuar atë në kafenenë “Evropa” në Kacanik. Atje M D i ka informuar ata (në lidhje me B), “*ata e kanë marrë atë për shkak të disa femrave, sepse edhe më parë unë kam dëgjuar disa fjalë për të*”, dhe ai po ashtu ka thënë “*është mjaft keq*”. Ai ka theksuar se atëherë ata kishin dëgjuar se rasti ishte në lidhje me dy (2) femra të quajtura L P dhe N H. Ai ka theksuar se ai po ashtu ka dëgjuar kur B D i ka thënë XH.B. “*rri me Dajku'n*”, *sepse ai është personi për ta kryer punën*”.
141. Ai theksoi se në një takim më pas, në një restorant të quajtur “Adriatiku” një person i quajtur A K ose “L.” e ka përmendur një person të quajtur R, i cili “*ka qenë më shumë në kontakt me M*”. Ai ka theksuar se më vonë atë mbrëmje ata e kanë takuar R në një kafene në anën e majtë të rrugës Ferizaj-Prishtinë. Ai u ka thënë atyre që “*M*” ka qenë këtu para disa minutash, por ai u ka thënë atyre se ata mund ta takojnë atë të nesërmen.
142. Ai ka theksuar se të nesërmen ata kanë shkuar në kafenenë “*Lamburgjini*” në

Ferizaj dhe kanë pirë kafe atje dhe se “*Burimi*” e ka telefonuar “M” i cili ka arritur më vonë dhe ka pirë kafe me “L.n”. A.S. ka theksuar se pas një kohe të shkurtë M është larguar gjersa L ka ardhur në tavolinën e tyre dhe u ka thënë që, “*gjërat janë mirë, se B. është dërguar në Prishtinë*”. Ai ka theksuar se ata kanë shkuar në Prishtinë, së bashku me L dhe ai i ka thënë atij (A) se do të ishte mirë që ti epej M. një shumë diku rreth pesë mijë (5.000) euro, sepse vetëm ai mundet “*që ta rregullojë këtë gjë*”. Ai ka theksuar se ata kanë ardhur në Prishtinë ku është mbajtur seanca gjyqësore dhe para seancës, në gjykatë ai është takuar po ashtu me M, shokun e B i cili e ka informuar atë se ai e kishte gjetur një avokat, T G, të cilit familja duhet që të ia japi dy mijë e gjashtëqind (2,600) euro, vetëm për këtë seancë.

143. Ai theksoi se Gjykata ka caktuar tridhjetë (30) ditë paraburgim dhe ata kanë shkuar në Ferizaj. Gjatë rrugës ai e ka telefonuar dhëndrin e tij, XH.B. dhe ata janë dakorduar që të takohen në restorantin “*Ballkan*” në Kacanik. Ai ka theksuar se kur ai ka shkuar atje ai i ka parë “*M, B (zyrtarin policor)*”, dhe kanë ngrënë drekë me XH.B.. Ai ka theksuar, “*që nga kjo ditë, pothuajse çdo ditë zyrtari policor B e ka telefonuar vazhdimisht dhëndrin tim Xh në telefon*”. Ai ka theksuar se dy ditë më vonë XH.B. e ka informuar atë se B.SH. dëshironte që ti takojë në Ferizaj. Ai ka theksuar se të nesërmen në mëngjes, ai dhe XH kanë shkuar në Ferizaj dhe janë takuar me B.SH.n i cili i ka dërguar në zyrën e tij dhe ka filluar që tu tregoj atyre në lidhje me të bëmat e B dhe u ka thënë “*ne po ashtu i kemi edhe 100 faqe tjera për ti dërguar, por nuk do ti dërgojmë, meqë tani ne do tu ndihmojmë ju*”. Ai ka theksuar se pastaj ka ardhur “M”. Ai ka theksuar se B.SH. ka dalur nga zyra e tij dhe ka diskutuar diçka me të dhe pastaj i ka dërguar në zyrën e M.S. t ku ata kanë folur me M.n.

144. Ai ka deklaruar se M.S. ka filluar që tu thotë atyre se është e mundur që B të dënohet deri në dymbëdhjetë (12) vjet dhe se, “*ata kanë edhe 100 faqe tjera që ti dërgojnë në lidhje me B, por se ne nuk do ti dërgojmë ato, ne edhe do i shqyejmë ato (grisim) dhe nuk do i dërgojmë, meqë siq duket ai është daja im dhe nuk e kam ditur këtë gjë*”.

145. A.S. ka theksuar se ata më pas kanë shkuar në shtëpi dhe pas disa ditësh ai dhe XH.B. kanë shkuar tek parkingu i marketit “Viva” e vjetër. Ai ka theksuar se B.SH. ka ardhur dhe u ka thënë që ai e kishte dëmtuar makinën e M. (një Audi), dhe se kishte nevojë për 1000€ që ta riparojë atë, plus, 50€ për drekë meqë ai po u ndihmonte atyre. Ai ka theksuar se ai ka shkuar në aparatën ATM tek Banka Pro-Credit në qytetin e Ferizajit ku ai i ka tërhequr 300€ dhe se ai veq i kishte ca para të gatshme dhe ka shkuar në vend parking tek XH.B. dhe B.SH. dhe u ka thënë atyre që aparati ATM nuk po i nxirrte më para. Ai ka theksuar se ai e ka telefonuar djalin e xhaxhait të tij S D dhe ka kërkuar nga ai nëse mund të ia huazonte 500€ por ai i ka thënë atij se ai nuk i kishte por se do të shihte nëse do mund ti gjente ndokë, nga disa fqinjë që jetonin në Ferizaj. Ai ka theksuar se ai ka thirrur më vonë që të thotë se kishte gjetur ca para nga një i njohur i tij “R”. Ai ka theksuar se ai dhe XH.B. më pas janë takuar me B.SH. dy orë më vonë, sërish në vend parkingun e marketit “Viva” e vjetër në Ferizaj. Ai ka theksuar se B.SH. sërish ka hyrë prapa në makinën e tyre dhe se sërish u ka thënë atyre që i duheshin para për ta riparuar makinën e M.. Ai ka theksuar se XH.B. ia ka dhënë B.SH.t shumën prej 1050 eurosh.

146. A.S. ka theksuar se të nesërmen B.SH. e ka telefonuar XH.B.n dhe ka thënë që ata duhej të shkonin në Prishtinë *“në mënyrë që të na e dëshmojë ne që ai është i angazhuar që ta ndihmojë B”*. Ai ka theksuar në po të njëjtën ditë, si ai dhe XH.B. kanë shkuar në pompën e benzinës në *“Euro Miti”* që ta takojnë B.SH.n dhe kanë vozitur në Prishtinë. Ai ka theksuar se ata kanë shkuar në zyrën e Prokurorit në Prishtinë dhe B.SH. ka shkuar tek Prokurorja B.K. dhe pas 15 minutash B.SH. është kthyer dhe u ka thënë që ai kishte folur me Prokurorin dhe se rasti i B.t ishte mirë. A.S. ka theksuar pastaj se B.SH. kishte thënë, *“le të shkojmë në fakultetin “AAB” në Fushë Kosovë”*. Ai ka theksuar se ata kanë shkuar atje dhe para se të futeshin në fakultetin “AAB” B.SH. ka thënë, *“mua më duhen 300 euro sepse do e paguaj semestrin, andaj a i keni”*. Ai ka theksuar se XH.B. i ka kontrolluar xhepat e tij por ai nuk kishte para andaj B.SH. e ka pyetur atë nëse ai kishte 300€, dhe ai ka theksuar se ai ia ka dhënë 300€ por se ai e ka ditur që atij i duheshin vetëm 280€.

147. Ai ka theksuar se pasi që B.SH. i kishte paguar tarifën në kolegjin “AAB” B.SH. ka thënë *“ne do të shkojmë tani që ta takojmë shefin, ai e kishte fjalën për Mendën, sepse ai gjithmonë e ka quajtur M. shef”*. Ai tha që ata kanë shkuar në një restorant (nuk i kujtohej emri) por kur kanë arritur, *“M. na ka parë ne dhe ka dalur jashtë restoranti”* dhe atje menjëherë ka bërë titull B, duke i thënë atij *“pse i ke sjellë këta persona këtu”*, ai më referohej mua dhe XH.”.
148. A.S. ka theksuar se pas tre deri në pesë ditë, B.SH. ka telefonuar sërish dhe e ka caktuar një takim me XH. dhe A. sërish në vend parkingun e marketit “Viva” e vjetër në Ferizaj, ku u ka thënë atyre, *“ne kemi nevojë për 1.400€, prej të cilave 400€ për H. meqë ai i ka ato femra në dorë, dhe 500€ për Mendën”*. Ai ka theksuar se ata janë marrë vesh për ti sjellë paratë brenda një ore. Ai ka theksuar se ai i ka pasur 1000€ të tijat ndërsa i ka marrë 400€ nga XH.B. dhe sërish në vend parkingun e marketit “Viva” e vjetër, B.SH. është futur në makinën e tyre dhe XH. ia ka dhënë 1.400€ B.SH.t në praninë e tij dhe duke i marrë paratë ai i është drejtuar XH.B.t duke i thënë *“ nëse ndodh diçka ti do të konsiderohesh si borxhli gjaku ndaj meje”* dhe ai po ashtu ka thënë, *“nëse ne do ia arrijmë që ta kryejmë tërë këtë punë, ti duhet që të paguash 15,000€”*.
149. A.S. ka theksuar se ai po ashtu ishte i vetëdijshëm se B.SH. e ka telefonuar XH.B.n sërish të nesërmen dhe ka kërkuar që të takohen tek lagjia *“Fusha e Pajtimit”* në Kacanik por XH.B. ka shkuar vetëm. Ai ka theksuar se pas disa ditësh B. po ashtu e kishte telefonuar Xh. sërish duke kërkuar që të takoheshin në restorantin përgjatë rrugës së Nerodimes, *“tek mulliri”*. Ai theksoi se këtë herë ai ka shkuar me XH.B.n dhe M. dhe B kanë qenë atje por posa kanë arritur në parking, B.SH. ka dalur dhe i është drejtuar duke i thënë, *“ju nuk duhet që të vini meqë M. nuk dëshiron që ju të jeni këtu”* andaj ai ka shkuar në shtëpi. Ai ka theksuar se XH.B. më pas i ka thënë atij se ai i ka dhënë 500€ por se ai nuk ka qenë prezent.
150. A.S. ka theksuar se kur B.S. e ka pasur seancën e tij të rradhës në gjykatë, *“ata”* e kanë telefonuar XH.B. sërish dhe i kanë thënë që, *“1,500€ duhet që të sigurohen të*

cilat do ti ipen Prokurorit, një Laptop dhe 2 telefona iPhone". Ai ka theksuar se ai menjëherë e ka telefonuar A S që mundësisht ti sigurojë atij ca para dhe ai i ka thënë që të vij në Shtërpce. Ai theksoi se ai ka shkuar atje, por A nuk ka qenë në gjendje që ti sigurojë paratë, andaj ai e ka thirrur "Musën" që e ka një pompë benzine në rrugën e fshatit Greme dhe një auto-shkollë dhe ai ka kërkuar nga ai që të ia huazojë 1500€ për 2 deri në 3 ditë, por ai nuk i ka pasur ato. A.S. ka theksuar se XH.B. ka vendosur që ta thërrasë "B" që është pronari i pompës së benzinës "Ballkan Petrol" dhe ata kanë shkuar drejt atje dhe XH. i ka marrë paratë nga ai dhe nga aty ata kanë shkuar në Ferizaj ku e kanë takuar B.SH. dhe janë marrë vesh që të takohen por ai nuk ka qenë në gjendje që të shkoj në takim sepse ai nuk është ndier mirë por ai ka theksuar se XH.B. ka shkuar dhe "ua ka dërguar paratë atyre".

151. A.S. ka theksuar se në ditën e gjykimit të B, ai dhe XH.B., K. dhe S. S. kanë shkuar në Prishtinë. Ai ka theksuar se ata janë futur në ndërtesën e gjykatës dhe avokati R.G. e ka ftuar atë dhe K. dhe ata kanë dalur jashtë dhe ai i ka dërguara ata tek B. dhe u ka thënë "B. duhet që të deklarohet fajtor, përndryshe do të zgjatet edhe për 7 ose 8 muaj dhe nuk do të ketë seanca gjyqësore dhe sërish ai do të dënohet". Ai ka theksuar se K. nuk është pajtuar me këtë por ai (A.) i ka thënë B. që të deklarohet fajtor vetëm që të lirohet por B. nuk është pajtuar po ashtu duke thënë "si mund ta pranoj unë atë kur nuk e kam bërë". Ai ka deklaruar se seanca gjyqësore është mbajtur dhe B. është dënuar me 2 vite dhe 3 muaj burgim dhe është liruar në po të njëjtën ditë.
152. Në dëshminë e tij të mëvonshme në prokurori, A.S. i ka përsëritur pretendimet e njëjta në lidhje me dorëzimin e parave tek të pandehurit M.S. dhe B.SH. dhe se çka ai besonte të ishte qëllimi i tyre.
153. Në dëshminë e tij para trupit gjykues A.S. ka deklaruar se ai është vëllai i A, B. dhe i K.S. dhe se babai i tyre është B.S. Ai ka theksuar se XH.B. është dhëndri i tij dhe se ata janë mjaft të afërt. Ai ka deklaruar se ai është një Operator makine me profesion. Ai jeton me familjen e tij në Brod.

154. A.S. ka deklaruar se S.S. është kushëri i tij. Ai ka theksuar se ai e njeh B. H. sepse ai ishte pronar i restorantit në “Ballkan Petrol” dhe se ka lidhje me XH.B.. Ai ka theksuar se kompania “Luboteni” i ka blerë të gjitha furnizimet me karburant aty.
155. A.S. ka theksuar se ai e njeh R.A. (jo I.) dhe H.B. Ai ka theksuar se M. S ka qenë një inxhinier që ka punuar me kompaninë “Luboteni”. Ai ka theksuar se D.D. po ashtu ka punuar për kompaninë duke transportuar rërë ashtu si dhe R.V.
156. A.S. ka theksuar se ai nuk e ka njohur A.B, A.I. ose R.S.. Megjithatë, ai e ka njohur B.D., i cili ka qenë pronar i një kompaninë për ndërtimin e rrugëve dhe më të cilin kompania “Luboteni” ka punuar rregullisht dhe ka gëzuar marrëdhënie të mira. Ai ka deklaruar se ai e ka njohur R.B. i cili ka punuar në administratën komunale në Shtërpce. Ai ka deklaruar se ai e ka njohur F.H. nga vendlindja e tij fshati Brod. Ai ka theksuar se ai e ka njohur S.SH. si person i cili po ashtu ka qenë pronar i kompanisë ndërtimore dhe me të cilin kompania “Luboteni” ka punuar rregullisht.
157. A.S. ka deklaruar se në vitin 2012 dhe 2013 ai e ka pasur një telefon mobil të regjistruar në emër të kompanisë. Ai ka theksuar se gjatë kësaj kohe ai ka qenë zëvendësues i B.S. gjersa ende ka punuar si makinist. Ai ka deklaruar se kompania ka qenë shumë e nxënë dhe e ai ka pasur shumë kontrata për tu marrë me to si dhe me “problemin” e B.
158. A.S. ka theksuar se kompania “Luboteni” është themeluar në vitin 2000, ka qenë profitabile që nga viti 2004 dhe ishte e njohur edhe në komunitetin lokal pasi që ishte e angazhuar në shumë projekte për entitete publike dhe private. Ajo bazën e kishte në komunën e Shtërpces. Ai ka theksuar se në kulmin e suksesit të saj kompania punësonte përafërsisht 70 punëtorë. Sidoqftë, ai ka theksuar se ai nuk mund të komentojë me saktësi në lidhje me pozitën financiare të kompanisë kur B.S. është arrestuar së pari në vitin 2012.

159. Duke iu kthyer çështjes së vëllait të tij, arrestimit të B., A.S. ka deklaruar me 30 maj 2012 se ai ishte thirrur nga A.S. i cili e ka informuar atë se B.S. është arrestuar dhe se ata kanë pasur nevojë që ta marrin makinën e tij nga stacioni policor në Ferizaj. Ai ka theksuar se ai e ka ftuar XH.B. dhe se ata kanë shkuar së bashku në stacionin policor në Ferizaj.
160. A.S. ka theksuar se kur ata kanë arritur në stacionin policor atyre nuk u është dhënë asnjë informacion në lidhje me B. por thjesht i është thënë që të vijë të nesërmen dhe që ti ipen çelësat e makinës së tij që ti marri me vete. Ai ka thënë e para kësaj ngjarjeje, familja nuk ka pasur probleme me autoritetet.
161. A.S. ka deklaruar se të nesërmen, M., një mik i B.S. e ka thirrur atë dhe së bashku me XH.B. ata e kanë rregulluar që të takohen në tregun e bagëtive në Ferizaj. Ai ka deklaruar se Musa e kishte marrë një avokat të quajtur K. Ata të gjithë janë takuar në kafene. Ai ka deklaruar se Musa ka folur veçmas me Kemajlin dhe pastaj e ka informuar atë dhe XH. se B. është arrestuar për veprat penale që përfshinin femra dhe se ata duhej që të shkonin në shtëpi dhe të presin për udhëzimet e tija, gjë që edhe e bënë ata. Më vonë, po atë ditë, ata e kanë pranuar një telefonatë nga një person i quajtur B. (mbiemrin e të cilit ai nuk mund ta mbante ndërmend) por i cili ishte nga Komuna e Shtërpçës dhe ishte pronar i kompanisë “*Iliria*”. B. ka deklaruar se ai dëshironte që të shkonte në shtëpinë e A. me B.D. pronarin e kompanisë “*B.*”. A.S. ka theksuar se ai e ka refuzuar këtë propozim sepse ai nuk ka dashur që pjesa tjetër e familjes ta zbulonin që B. ishte arrestuar. Ata janë marrë vesh që të takohen në një kafene në Shtërpçe. Atje, ai, XH.B. dhe S.S. janë takuar me B.D. dhe B. i cili ka ardhur.
162. A.S. ka deklaruar se ata kanë bërë disa pyetje në lidhje me B. dhe kanë thënë që ata do bëjnë çmos që ta ndihmojnë atë. Ai ka thënë që B. e ka thirrur një person të quajtur M.D. (i cili ka qenë pronari i një kompanie për asfaltimin e rrugëve e quajtur “*Euro-Trans*”), vëllai i B.D. dhe ka propozuar një takim. A.S. ka deklaruar se ai e ka njohur M.n nga bizneset e mëhershme në lidhje me punët ndërtimore. Ai ka deklaruar se takimi është mbajtur në kafenenë “*Europa*” afër pompës së benzinës Ballkan, në rrugën për në

Prishtinë. Ai ka theksuar se XH., S., ai vetë, B. dhe B. të gjithë kanë marrë pjesë. M.D. ka ardhur më vonë. Ai ka theksuar se ai e dinte për rastin dhe se L.P. dhe N. H. ishin duke e akuzuar B.S.

163. A.S. ka deklaruar se M.D. ka sugjeruar që të thërritet A.D. sepse “*ai merret me ato vajza*”. Ai ka deklaruar se B.D. ka thënë, “*të lutem mos rri me dajën sepse ai punon atje*” dhe ai e ka kuptuar që kjo të jetë një referim për B.SH. të cilin pastaj A.S. e tregoi në gjykatë. Ai po ashtu ka deklaruar se B. dhe Bashkim u ka thënë atyre se M. e ka njohur M. nga më parë, ai ishte një toger në Policinë e Kosovës dhe ai ishte në krye të rastit të B.

164. A.S. ka theksuar se B.SH. dhe familja e B.D. janë në farefisni por ai nuk e dinte në çfarë mënyre. Ai deklaroi se XH.B. e kishte thirre A.D. dhe kishte shkuar bashkë me të në Ferizaj ku e kishin takuar atë në një restorant të quajtur “*Adriatik*”. Ai kishte theksuar se A.D. kishte ardhur dhe kishte dashur të kontaktonte një shoqe të L.P. dhe N.H. por ai nuk kishte mundur ta bënte këtë. Ai theksoi se nuk e kishte njohur A.D. më herët. Ai deklaroi se një person me emrin L. ishte ulur te ata dhe kishte theksuar se M.S. (të cilit ai i referohej si “*M.*” ishte në krye të rastit). Ai theksoi se L. ishte shok i A.D.t. Ai theksoi se L. kishte thënë se e ka një shok me emrin R., i cili është shok i M.S. dhe se ata duhet të flasin me atë. Ai theksoi se menjëherë më pas se kjo i referohej R.A. dhe ai kishte treguar me gisht kah ai në sallën e gjykimit. Ditën e nesërme ishte caktuar një takim me R.. Ai theksoi se e njihte atë që nga fëmijëria dhe se ata kishin luajtur së bashku por ai nuk e kishte njohur L. më parë.

165. A.S. kishte deklaruar se ai besonte se M.S. dhe R.A. ishin miq të ngushtë dhe kishte konfirmuar në një deklaratë të mëhershme ku e kishte shprehur mendimin e tij se ata po bashkëpunonin.

166. Kur pala e dëmtuar A.S. e kishte përmbledhur deklaratën e tij më 5 dhjetor 2014, ai kishte deklaruar vet ditën e nesërme se S. dhe XH. ishin takuar me R.A. në një kafene me muzikë dhe L. i kishte folur atij por ai kishte thënë se M. kishte qenë aty para 15

minutave por veçse kishte shkuar, kështu që L. e kishte rregulluar punën me u takuar me RamaD.n përsëri ditën e nesërme në pompën e benzinës “Lamborghini” afër Shtimes. Ai kishte theksuar ditën e nesërme se L. nuk ka mundur të kontaktonte R. kështu që ai e kishte thirrë M.S. drejt për drejt.

167. A.S. kishte theksuar se kur ai ishte kthyer, kjo kishte qenë hera e parë kur ai e kishte parë M.S. Ai kishte treguar me gisht kah ai në gjykatë. A.S. theksoi se M.S. kishte thënë se ai do të mund të sjellte B.S.n aty për të pirë kafe. A.S. kishte deklaruar se L. ju kishte thënë atyre se punët ecnin mirë por ata kishin thënë se duhej t’i jepnin M. 5,000 euro dhe se ai do t’i ndihmonte atyre pasi që ai “*kryente punë*”. Ai theksoi se kurrë nuk ishte takuar apo bërë biznes me L. më herët dhe se nuk kishte pasur raporte të këqija në mes të familjes së tij dhe M.S. , R.A. apo L. para kësaj. Ai deklaroi se L. dhe M.S. ishin miqësor ndaj njëri tjetrit.

168. A.S. kishte theksuar se pas këtij takimi ai, S. dhe L. kishin shkuar në Prishtinë ku ishin takuar me Musën, shokun e B.S.. Ai e kishte informuar atë se ai ishte udhëzuar nga avokati T.G., i cili duhej të paguhej 2600 euro për dëgjimin për caktimin e paraburgimit. A.S. kishte theksuar se ai e kishte bërë pagesën, këtë pagesë.

169. A.S. deklaroi se kur ata kishin arrite në Prishtinë, ata kishin shkuar në gjykatë dhe e kishin paguar avokatin, T.G.. Megjithatë, ai theksoi se B.S. ishte duke u mbajtur në paraburgim për një muaj. Më vonë gjatë asaj dite ai deklaroi se XH.B. kishte një takim me M.S., B.SH.n dhe B.H. në “*Balkan Petrol*”. Ai nuk ishte prezent por XH.B. i kishte treguar atij në lidhje me këtë. Ai theksoi se i kishte thënë se M.S. kishte thënë se puna ishte kryer dhe se B.S. do të lirohej.

170. A.S. deklaroi se aty ishte edhe një drekë dy ditë më pas (gjithashtu në “*Balkan Petrol*” në të cilin M.S. , B.SH. edhe një polic tjetër, emri i të cilit ai mendonte se është N. (nuk mund t’ia mbante në mend mbiemrin e tij) gjithashtu ishin prezent. A.S. ka deklaruar se ai ka mare pjesë me XH.B.. Ai as nuk e kishte takuar e as nuk kishte pasur asnjë komunikim (të mirë, keq apo indiferent) me B.SH.n apo familjen e tij më herët. Ai kishte treguar me gisht kah ai në gjykatë.

171. A.S. deklaroi se M.S. kishte folur më së shumti por ai nuk kishte folur shumë për rastin e B.S.. A.S. deklaroi se menjëherë pas këtyre drekave, B.SH. e kishte thirrë XH.B. pothuajse çdo ditë. Ai deklaroi se takimi i ardhshëm ishte te stacioni i policisë. Ai tha se B.SH. e kishte thirrë XH.n menjëherë më pas pak a shumë. Ai theksoi se thirrjet ishin bërë zakonisht për të caktuar takimet dhe përmes telefonit nuk është diskutuar kurrë asgjë. Ai tha se as ai e as XH.B. asnjëherë nuk kanë pranuar thirrje nga M.S. apo B.SH. para rastit të B.t. Ai theksoi se B.SH. e kishte thirrë XH.B. pasi që ai i besonte atij sepse ishin të afërt familjarisht.
172. A.S. theksoi se tre ditë pas takimit në *“Balkan Petrol”*, B.SH. e kishte thirrë XH.n dhe i kishte thënë atij me ardhur në stacion të policisë në Ferizaj. Ai kishte shkuar së bashku me B.SH.n dhe ai ishte takuar me ata aty dhe i kishte dërguar te zyra e tij. Ai theksoi se B.SH. iu kishte ofruar atyre lëng dhe kishte thënë *“ne”* do të heqim 100 faqe nga shkresat e lëndës së B.t dhe se nuk do t’ia dorëzojmë prokurorit”. Pas një kohe erdhi M.S. . B.SH. deklaroi se ai do t’i ndihmonte B. por *“vetëm M. mund ta kryen punën”*. A.S. tregoi bindjen e tij se me fjalën *“ne”* B.SH. kishte nënkuptuar ai vet dhe M.S. . Ai e deklaroi bindjen e tij se ata të dytë do të siguroheshin që vëllai i tij të lirohej.
173. A.S. deklaroi se B.SH. më pas i kishte thënë atyre që të shkojnë te zyra e M.S. e cila ishte në zyrën afër. A.S. theksoi se posa filluan të bisedonin ai dhe XH. në lidhje me rastin e B. duke thënë se është i vështirë rasti i tij dhe se ai mund të dënohet me burgim prej 10 deri në 12 vjet. Ai po ashtu tha se po qe se do e kishte ditur më herët se B. është daja i tij, tani ai do të mundohet me i ndihmuar. Ai e përsëriti pohimin e tij se ai nuk do t’ia dërgon 100 faqe prokurorit. Ai theksoi se ai dhe XH. pastaj u larguan nga zyra e M.S. dhe u takuan me B.SH.n i cili e përsëriti pohimin e tij të mëhershëm se vetëm M.S. mund ta ndihmon B. me dal nga burgu. Ai tha se mendon kësisoji sepse M.S. është zyrtar i policisë dhe se ai është duke e udhëhequr rastin.
174. A.S. theksoi se përafërsisht tri ditë më pas B.SH. e kishte thirrë XH.B. dhe e kishte rregulluar një takim në supermarketin e vjetër *“Viva”* në Ferizaj. Ai tha se kur shkuan atje B.SH. kishte theksuar se ai e kishte pas një aksident me veturën e M. dhe ai

tha se do të ishte mirë me i ndihmuar atij pasi që ai është duke punuar në rastin e B.t dhe i kishte kërkuar 1,000€ në mënyrë që me e riparuar veturën. Ai theksoi se kjo bisedë ishte mbajtur në parking ose në veturën e tij ose në veturë të XH.t. Ai theksoi se B.SH. gjithashtu i kishte kërkuar 50 € pasi që ai kishte paguar për drekën e M.S. më herët. Ai kishte thënë se XH.B. e kishte pa veturën e dëmtuar më vonë dhe i kishte thënë atij.

175. A.S. theksoi se kur B.SH. i kishte kërkuar këto para, ai kishte shkuar në bankomat por nuk kishte mundur me i tërheqë me shumë se 300€, kështu që ai ishte kthyer dhe i kishte treguar për këtë B.t dhe XH. dhe B. i kishte thënë atij me shkuar dhe me provuar përsëri. Ai tha se kishte provuar me tërheqë para përsëri por pa sukses, kështu që së bashku me XH.B. ata shkuan te njëri prej dajëve të A. por ai nuk kishte pasur para me vete kështu që A.i kishte kërkuar këto nga kushëriri i tij S., i cili kishte biseduar me disa fqinj dhe eventualisht i kishte marrë 500€. A.S. tregoi se ai pastaj ishte takuar me S., i kishte marrë paratë nga ai dhe ia kishte dhënë ato B.SH.t. Ai kishte thënë se paratë ishin marrë nga R.A. Ai kishte pasur disa para me veti dhe theksoi se e kishte dhënë një total prej 1,050€ B.SH.t në supermarketin “Viva” i cili kishte thënë përsëri se ato nevojiteshin për të riparuar veturën e M.S. . A.S. deklaroi se ai dhe XH.B. ia kishin dhënë këto para B.SH. pasi që ata besonin se ai dhe M.S. ishin duke i ndihmuar atyre për të liruar nga burgu B.S.n, megjithatë ai kishte thënë se ata kishin kuptuar se ishin duke e bërë të kundërtën dhe duke i vështirësuar punët edhe më shumë.

176. A.S. theksoi se XH. dhe B.SH. kishin folur me telefon atë natë dhe ishin pajtuar me shkuar në zyrën e prokurorisë në Prishtinë ditën e nesërme. Ai kishte theksuar ditën e nesërme se ai dhe XH. ishin takuar me B.SH. dhe B.D. në “Euromiti”. Ai pohoi se kishin shkuar në Prishtinë dhe përgjatë rrugës B.SH. e kishte bezdisur atë disa herë duke thënë se çdo gjë në lidhje me B. do të jetë në rregull dhe pastaj kishte pohuar duke thënë se punët ishin duke shkuar për së keqi, se ai mund ti marr gjashtë deri në dhjetë vjet burgim por ai dhe M.S. do të mundohen që ta bëjnë më të mirën për atë. Ai e tregoi bindjen e tij se qëllimi i këtij udhëtimi ishte për të dëshmuar se ai është duke punuar në rastin e B.S.

177. A.S. kishte deklaruar se kur ata kishin arrite në zyrën e prokurorisë B.SH. i kishte thënë atyre që të shkojnë për kafe dhe se ai do të takohet me prokuroren B.K.. Ata kurrë nuk ishin takuar më herët. A.S. deklaroi se kur B. ishte kthyer, ai kishte thënë se gjërat po shkonin në rregull dhe se ai nuk mund të besonte se ato punë ishin aq mirë por se nuk kishte treguar se përse mendonte kështu.
178. A.S. deklaroi se grupi kishte shkuar pastaj në Fushe Kosovë sepse B.SH. është dashur të paguante disa shuma të shkollimit aty. A.S. kishte deklaruar se njëherësh pasi kishin arrite aty, B.SH. kishte kërkuar 280€ për të paguar shkollimin e tij në Universitetin AAB. A.S. kishte deklaruar se ai i kishte dhënë atij 300€. Ai theksoi se ndihej i obliguar për me i paguar paratë pasi që B.SH. ishte duke ndihmuar në lidhje me rastin e B.t.
179. A.S. theksoi se pasi që i ishin paguar paratë e shkollimit, B.SH. kishte propozuar me e takuar M.S. n pasi që ai ishte në Prishtinë.
180. Kur A.S. i kishte përmbledhur provat e tij para trupit gjykues më 8 dhjetor 2014 ai kishte theksuar se ky takim ishte mbajtur në restorant (emrin e të cilit ai nuk mund ta kujtonte) por rrugës ai i kishte tërhequr 100€. Ai theksoi se posa iu kishin afruar derës së restorantit, M.S. i kishte parë ata, ai ishte zbehur, kishte ardhur dhe e kishte bllokuar hyrjen dhe i kishte bërtite B.SH. me fjalët *‘Përse i ke sjellë këtu?’* Ai theksoi se B.SH. ishte përgjigje se ishte takuar me B.K. dhe se punët ishin duke shkuar mirë, kur M. kishte thënë më pas, *‘ne do t’i sqarojmë këto çështje më vonë’*. Pastaj ai, XH. dhe B.SH. kishin dalë prej restorantit dhe ishin kthyer në Ferizaj.
181. A.S. kishte theksuar se pas katër ditësh B.SH. e kishte thirrë XH. dhe e kishte rregulluar edhe një takim në restorantin *“Old Mill(Mulliri i Vjetër)”*. A.S. kishte theksuar se kur ata kishin shkuar në restorant B.SH. kishte dalë dhe kishte thënë se M.S. nuk dëshiron të takohet me ata dhe ai i kishte thënë XH.t, *‘do të kishte qenë mirë me i pas me vete 500 Euro’*. Ai theksoi se pas këtij takimi, kishte qenë edhe një takim tjetër në supermarketin e vjetër *“Viva”* në Ferizaj. Ai kishte theksuar se më herët kur B.SH. i

kishte thënë atyre se M.S. nuk ka dashur të takohet me ata dhe se XH. duhet me i pas me vete 500€ , ai ia kishte dhënë 500€ XH.t. Ai kishte theksuar se ai nuk e bënte këtë vullnetarisht. XH. e kishte informuar menjëherë atë se ia kishte dhënë këto 500€ M.S. t dhe B.SH. atë ditë. Ai po ashtu tregoi se XH. i kishte thënë se M.S. i ka thënë atij me shkuar te shtëpia e R.B. dhe me i thënë atij me ndryshuar deklaratën e tij.

182. A.S. tha se ai ishte takuar me XH., ata shkuan te R.B. dhe i kishin thënë atij këtë. Ai tha se R.B. ishte përgjigjur, *“mos u brengos, kur unë dal para prokurorit do ta them të vërtetën”*.

183. Në lidhje me supermarketin e vjetër *“Viva”* në Ferizaj, A.S. tha se B.SH. e kishte thirrë XH.n me u takuar aty dhe XH. i kishte thënë atij dhe ata kishin shkuar atje. Ai theksoi se kur ata kishin arrite B.SH. kishte hyrë në veturën e tyre dhe i kishte pyetur ata me ia dhenë 1,400 €. Ai tregoi se 500€ ishin për M.S. n, 500€ për atë vet dhe 400 për H.B., polic i cili punonte në njësi speciale në policinë e Kosovës në komunën e Kaçanikut. Ai tha se B.SH. kishte deklaruar se Hasani e kishte nën kontroll gruan e cila e kishte akuzuar B.n dhe se ata do të bënin çfarëdo që të thotë ai. A.S. kishte thënë se këto gra ishin L.P. dhe N.H.. A.S. deklaroi se ai e kishte përshtypjen se nuk do të mund ta refuzonte kërkesën e B.SH. për para.

184. A.S. deklaroi se ai kishte pasur vetëm 1,000€ me vete atë ditë, kështu që ata shkuan në shtëpi të XH.B. dhe i morën edhe 400€. Ai deklaroi se B.SH. nuk kishte shkuar me ata por ai e kishte telefonuar XH.n përsëri dhe ata ishin takuar në dyqanin *“Viva”*, përsëri dhe ia kishin dhënë paratë B.SH. Ai theksoi se XH. i kishte thënë B.SH. mos me i thirre ata çdo ditë me i kërkuar paratë. Ai deklaroi se B.SH. në përgjigjen e tij tha se nëse diçka ndodh, atëherë ata ia kanë borxh atij jetën. Ai tha se B.SH. po ashtu shtoi se, *“kur të përfundon e tërë kjo, ti duhesh me i dhënë edhe 15,000 Euro”*.

185. Kur i është treguar edhe një deklaratë tjetër, deklarata e A.S. thoshte se kishte qenë ai i cili ia kishte dhënë paratë B.SH. Ai deklaroi se B.SH. i kishte marrë paratë dhe ai i kishte thënë XH. se nëse diçka do të ndodhte, ai do ta konsideronte XH. si borxhli të

gjakut. Ai e shpjegoi këtë me “*diçka*” ai e kishte kuptuar se ka menduar se po qe se do të flas dikush në lidhje me këtë dhe se kjo ishte një gjë e keqe.

186. A.S. deklaroi se ishte i bindur se B.SH. dhe M.S. kishin nën kontroll provat në rastin e B. dhe prandaj do të mund të ndikonin në rezultat.

187. A.S. deklaroi se pasi që e kishte bërë këtë pagesën prej 1,400€, ditën e nesërme B. e kishte thirrë XH. përsëri dhe ata ishin pajtuar me u takuar te “*Fusha e Pajtimit*” afër Kaçaniut. H.B. do të ishte prezent po ashtu pasi që qëllimi i takimit ishte me e bërë pagesën prej 400 € atij, të cilat do të përdreshin për të blerë një pompë për veturë. A.S. tha se ai nuk kishte marrë pjesë në këtë takim por më pas i kishte treguar XH. atij se paratë ishin dorëzuar.

188. A.S. deklaroi se po ashtu aty kishte takime të menjëhershme me B.SH.n duke përfshirë një në rrugën Nerodime te restoranti “*Old Mill*”(mulliri i vjetër). Ai theksoi se ai kishte marrë pjesë në këtë takim me XH. dhe të dytë B.SH. dhe M.S. ihsin aty. Ai theksoi se ai e kishte të qartë se ata preferonin me u takuar me XH.B. dhe A.S. kishte thënë se ai besonte për këtë, pasi që ishte i lidhur familjarisht B.SH..

189. A.S. deklaroi në takimin e parë në restorantin “*Old Mill*” se ai nuk kishte hyrë brenda por XH. menjëherë i kishte thënë atij se i kishte dhënë B.SH.t dhe M.S. 500€ atë ditë dhe se ai ia kishte dhënë paratë atij në prezencë të B.SH.t më herët në parkingun e restorantit “*Old Mill*” - në vend parkim. A.S. tha se XH. i kishte thënë atij se ai ia kishte dhënë paratë M.S. t dhe se kjo ishte për “*shpenzimet*” që ata gjoja i kishin bërë duke punuar për rastin e B.t dhe se ai do të lirohej deri në fund të muajit. Megjithatë , ai tha se gjatë kësaj kohe nuk ka pasur ndonjë zhvillim në rastin e B.t në atë muaj.

190. A.S. deklaroi se në të njëjtën ditë ata i kishin dhënë afër 500€ R.B.t. Ai deklaroi se ata e kishin thirrë atë së pari dhe ishin pajtuar me u takuar në shtëpinë e tij në fshatin Bibaj. Ai deklaroi se XH. i kishte thënë atij me e ndryshuar deklaratën e tij. Ai kishte

thënë se M. do t'i kishte thënë atyre se nëse R.B. nuk do të pajtohej në lidhje me këtë, ai dhe B. do të bisedonin me atë.

191. A.S. tha se R.B. ndihej shumë keq me ia dhënë deklaratën policisë pasi që ai frikësohej nga ata. Ai e tregoi bindjen e tij se M.S. dhe B.SH. kishin treguar se do të bisedonin me ato gra. A.S. deklaroi se R.B. i kishte thënë atyre, *“mos u brengos, pasi që kur flas me prokurorin do ta them të vërtetën”* dhe se kjo do t'i ndihmon B.S.. Ai i kishte informuar ata në lidhje me atë që e kishte thënë më herët në polici se nuk ishte e vërtetë dhe se ai e kishte thënë këtë vetëm sepse kishte frikë nga policia regjionale në Ferizaj.
192. Sa i përket takimit të dytë në restorantin *“Old Mill”*, A.S. deklaroi përsëri se B.SH. e kishte thirrë XH.B. me e organizuar atë takim dhe kur ata kishin arrite, M.S. dhe B.SH. veç kishin qenë aty. Ai tha se ata të gjithë kishin ngrënë drekë, por nuk është diskutuar për punë.
193. Sa i përket takimit në restorantin *“Old Mill”* A.S. deklaroi përsëri se kjo ishte rregulluar nga B.SH.. Ai nuk kishte marrë pjesë. Ai tha se XH.B. i kishte thënë atij se B.SH. i kishte kërkuar 1,500€ me blerë laptop dhe dy telefona mobil iPhone për prokurorin. Ai e deklaroi se besonte se kërkesa i ishte bërë XH.t në emër të dyve, B.SH.t dhe M.S. Ai tha se ishte munduar me i siguruar paratë prej vëllait të tij A. dhe nga një burrë i quajtur Musa por ata nuk i kishin pasur këto para. Pastaj ata iu drejtuan B.H.t, i cili ishte pronar i *“Balkan Petrol”* dhe ai ia kishte dhënë paratë atyre. Ai deklaroi se nga ai vend XH. e kishte thirrë B.SH. dhe ata e kishin rregulluar me u takuar në *“Euro Miti”* i cili është një restorant dhe pompë e benzinës rrugës në Prishtinë prej Ferizajit. Ai tha se nuk ndihej mirë, kështu që ai nuk ka marr pjesë.
194. A.S. deklaroi se XH. i kishte thënë atij në këtë takim se B.SH. i kishte thënë atij që të shkonte në supermarket dhe të blinte parfum dhe me i vendos aty në kuti 1,500€. Ai deklaroi se XH. po ashtu i kishte thënë atij se ai e kishte bërë këtë dhe se ata dëshironin me u takuar me M.n. Ai deklaroi se XH. po ashtu i kishte thënë atij se kur ia kishte

dhënë parfumin me para brenda M.S. ai kishte thënë, *'A dëshiron me më korruptuar mua tani?'* Ai deklaroi se XH. ia kishte thënë këtë më vonë në të njëjtën ditë.

195. A.S. deklaroi se rasti i B.t ishte kthyer në gjykatë më 27 nëntor 2012. Ai tha se kishte marrë pjesë në gjykatë së bashku me S.S., XH.B. dhe K.S.. Ai theksoi se aty ishte prezent avokati R.G. dhe se kishte biseduar me atë dhe K.S.. Ai theksoi se avokati, R.G. e kishte këshilluar B.S.n se ai duhet të kërkon për marrëveshje për pranimin e fajësisë ose do të duheshin edhe shtatë muaj shtesë dhe se B. përsëri do të dënohej.
196. A.S. deklaroi se K.S. dhe B.S. nuk ishin pajtuar me qëndrimin e avokatit mbrojtës pasi që B. nuk kishte kryer vepër. Megjithatë, ai e kishte thënë pikëpamjen e tij se B. duhej të deklarohet se ishte fajtor, thjesht për të dal nga qendra e paraburgimit sa më shpejt që është e mundshme.
197. A.S. tha se B.S. dhe avokati mbrojtës, R.G. është pajtuar të bën marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe se ai do të dënohej me burgim prej 2 vjet dhe gjashtë muaj. Ai thotë se B. është dërguar prapa në paraburgim por është liruar në të njëjtën ditë. Ai kishte thënë se ai vet dhe XH.B. e kishin marrë atë në të njëjtën ditë dhe e kanë dërguar në shtëpi.
198. A.S. tha se M.S. dhe B.SH. po ashtu kishin ardhur në shtëpi të tij pasi që ishte liruar B.S.. Ai deklaroi se ishte prezent në atë kohë por ai nuk kishte qëndruar me ata pasi që ishte lodhur nga ata duke i kërkuar para. Ai tha se e kishte dëgjuar nga babai i tij dhe nga XH.B. se M.S. kishte shkuar te babi i tij dhe kishin kërkuar falje për burgimin e djalit të tij. Ai kishte thënë se besonte se nuk ishin ftuar.
199. A.S. deklaroi se B.S. ishte arrestuar përsëri në janar 2013, gjatë natës por kësaj radhe të nesërmen është dërguar në arrest shtëpiak. Ai theksoi se menjëherë më pas B. ishte takuar me B.SH. dhe M.S. n në kafenenë *"Lamburgini"*. Ai kishte qenë prezent po ashtu së bashku me XH.B..

200. A.S. tha se M.S. kishte folur rreth rastit në lidhje me arrestimin e vëllait të tij të fundi dhe se ai kishte thënë se ky nuk paraqet ndonjë problem pasi që do të dërgohet për ri-gjykim dhe arrestimi i tij aktual shtëpiak do të vazhdohej për dy muaj. Megjithatë, ai po ashtu kishte thënë se rasti i dytë ishte “*shumë më serioz*”. A.S. e kishte theksuar se ai ishte i bindur se e kishte kuptuar se ai vet dhe B.SH. do të siguroheshin që rasti të dërgohet për rigjykim dhe se ata i njihnin prokurorët dhe gjyqtarët. B.SH. nuk kishte folur gjatë këtij takimi.
201. A.S. tha se avokati i B. në kohën kur është bërë arrestimi i tij i parë kishte qenë T.G. por ai ishte angazhuar vetëm muajin e parë pasi që M.S. i kishte thënë XH.B. se nuk ka nevojë për me angazhuar një avokat të shtrenjtë. Megjithatë, ai kishte theksuar se familja pas kësaj kishin shpenzuar në total afro €10,000 për shpenzime ligjore. Ai tha se i tërë rasti kishte ndikuar keq në atë. Ai kishte deklaruar se nuk mund të punonte. Ai tha se i kishte dhënë IPK-së gjendjen e bankës në lidhje me tërheqjen e parave që e ka bërë ai në atë kohë.
202. Kur pala e dëmtuar, A.S. është kthyer në bankën e dëshmitarit më 16 janar 2015 ai është marrë në pyetje tërthorazi mbi aspektet e dëshmisë së tij nga avokati për të pandehurin, M.S. , avokati A.R.
203. A.S. deklaroi se e ka kryer shkollën fillore dhe menjëherë ka punuar me makina por ai nuk ka arsim financiar as për biznes. Ai deklaroi se kompania “*Luboteni*” ishte me bazë në Shtërpce. Ai tha se nuk dinte asgjë në lidhje me kompaninë “*Sallahu*”. Megjithatë, ai deklaroi se nuk ka ditë se edhe kjo kompani ka bërë ofertë për tenderin për të cilin ka bërë ofertë edhe “*Luboteni*”. Ai tha se nuk ishte i vetëdijshëm mbi tensionet në mes tyre. Ai tha se e njihnte policin e Kosovës të quajtur E.A. dhe se ai ishte i lidhur me kompaninë “*Sallahu*” por nuk e dinte se në çfarë mënyre.
204. A.S. tha se kur B.S. nuk ishte në Kosovë, ai ishte *de facto* drejtor dhe se ka bërë çfarë është nevojitur me e udhëheqë një kompani duke përfshirë menaxhimin financiar të saj. A.S. deklaroi se kompania i ka festuar dhjetë vjet të ekzistimit të saj me një ndejë në

një restorant në Shtërpce. Aty kishte pasur këngëtare femra por ai nuk i njihte se cilat ishin ato.

205. A.S. e kishte përsëritë dëshminë e tij të dhënë më herët mbi takimin me M. dhe avokatin K. në një kafe, një ditë pasi ishte arrestuar B. për herën të parë dhe se si avokati K. e kishte informuar atë se arrestimi i B. ishte *“lidhur me femra”*.
206. A.S. e kishte përsëritë dëshminë e tij në lidhje me takimin e ardhshëm në Café Bar *“Europa”* në Kaçanik, ku ishte takuar me M.D., S., ZH., B. dhe B. dhe se si M. kishte thënë se do të ishte vështirë me e siguruar lirin e B. Ai i pajtua me atë që kishte thënë M. se ata duhet t’i gjenin këto femra dhe me i pyetur se përse e akuzonin B.n.
207. A.S. deklaroi se M. kishte thënë *“qëndro me dajën”* dhe ai e kishte kuptuar këtë si referim për B.D., vëllai i nënës, pasi që ai do të ndihmonte B. Ai u pajtua në atë takim se askush nuk e kishte përmend M.S. apo me këshilluar që me u larguar nga ai. Ai tha se L. e kishte thirrë M.S. gjatë takimit në kafën *“Lamborghini”*. Ai e kishte përsëritë dëshminë e tij të mëhershme se L. kishte thënë se M.S. se ai do të mund të sjellte B.n me pirë kafe.
208. A.S. e kishte konfirmuar atë ditë se B.S. ishte vendos në paraburgim për një muaj pas arrestimit të tij të parë, aty ishte mbajtur një takim në *“Balkan Petrol”* me XH.B., B.SH., M.S. dhe B.H.. Ai tha se kishte qenë në Prishtinë por XH. e kishte thirrë atë dhe i kishte thënë se çështja kishte përfunduar. A.S. deklaroi se XH. i kishte thënë atij se dreka po shërbehet për nder të B.S., pasi që ai do të lirohej atë ditë.
209. A.S. e kishte përsëritë dëshminë e tij të mëhershme se nuk ka pasur kontakt direkt me M.S. por XH.B. ka pasur. A.S. e kishte përsëritë dëshminë e tij se pas takimit në *“Ballkan Petrol”* ai kishte shkuar me XH.B. në stacion të policisë në Ferizaj, pasi që B.SH. i kishte thirrë ata përmes XH. Ai theksoi se nuk ka kërkuar me parë asgjë prej dokumenteve në shkresat e lëndës, të cilave iu referohej. Ai deklaroi se gjithsej, ai kishte shkuar në stacion të policisë dy herë.

210. A.S. deklaroi se nuk ishte i vetëdijshëm se R.A. ka punuar ndonjëherë në diçka por se ai vetëm sorollatej rrugëve. Ai e dinte se ky ishte shok i ngushtë i M.S. por nuk e dinte nëse këta kishin bashkëpunuar. A.S. deklaroi se dita kur ishte takuar me M.S. ishte dita kur B.SH. e kishte marrë atë dhe XH. në një restorant në Prishtinë por posa i kishte parë M.S. ata, ai iu kishte afruar se ishte nervozuar duke e pyetur B.SH. se përse i kishte sjellë ai aty. Ai nuk ia kishte shtrënguar dorën M.S. e as nuk e pranoi se i ka dhënë ndonjëherë para të gatshme M.S. personalisht e as se i ka premtuar përfitim material. Megjithatë, ai deklaroi se gjithmonë ishte ndjerë keq pasi që ishte takuar me M.S. n dhe B.SH.n.
211. A.S. deklaroi se ai personalisht ishte konsultuar me avokatin E.SH. në lidhje me rastin B. vetëm një herë. Ai deklaroi se nuk kishte thënë se ai i jepte para policisë në lidhje me rastin e B.S..
212. Në përgjigje në pyetjen nga avokati, A.D. avokati mbrojtës i të pandehurit, B.SH. në seancën e datës 26 Janar 2015, pala e dëmtuar A.S. e kishte konfirmuar se ai ishte zëvendës drejtor i kompanisë “Luboteni” dhe e ka menaxhuar kompaninë në mungesë të B.S. edhe ndonëse ai nuk e kishte kryer shkollën e lartë. Ai deklaroi se ishte takuar me dhe kishte biseduar me vëllezërit e tij rregullisht në lidhje me çështjet e kompanisë. Ai theksoi se nuk kishte pasur qasje në llogaritë e kompanisë .
213. A.S. deklaroi se në 2010 kompania e kishte organizuar një ndejë në Shtërpce për të festuar dhjetë vite në biznes. Atij nuk i kujtohej nëse L.P. dhe N.H. kishin qenë prezent. Atij nuk iu kujtohej edhe një ndejë tjetër në “Planet” në vitin 2012 në të cilin një zonjë me emrin S. apo R.B. ishin prezent. Megjithatë ai e konfirmoi se e njihnte R.B.n ndonëse B. ishte më i afërt me të. Ai deklaroi se e dinte se R.B. ka punuar në komunë të Shtërpçës por jo edhe se ai kishte punuar atje në zyrën e prokurimit. Ai e konfirmoi se me rastin e arrestimit të parë të B.t, ai kishte kërkuar nga R.B. me dëshmuar vetëm të vërtetën.

214. A.S. pastaj i konfirmoi aspektet e dëshmisë së tij të mëhershme, kryesisht pohimi se në takimin në restorantin “Europa” M. kishte deklaruar se B. është arrestuar për shkak të disa femrave, ai duhet të kontakton Dajkën dhe se ai menjëherë kishte shkuar në stacion të policisë në Ferizaj me XH.B. dy herë. Ai deklaroi në rastin kur B.SH. ia kishte treguar atij dokumentet të cilat pohonte se i takojnë shkresave të lëndës së B. të cilat ai nuk kishte pasur rastin me i lexuar e as me i prekur.
215. A.S. pastaj konfirmoi aspektet e ndryshme të dëshmisë së tij të mëhershme duke përfshirë një takim i cili u mbajt në supermarketin “Viva” në Ferizaj, se si i kishte mbledhur paratë por se si ia kishte dhënë në fakt XH. ato B.SH. Ai konfirmoi se nuk ishte prezent në takimin i cili ishte mbajt në restorantin “Mulliri i Ri” në rrugën Nerodime por XH.B. i kishte thënë atij se ia kishte dhënë M.S. t dhe B.SH.t 500€. Ai konfirmoi se ai personalisht kurrë nuk e kishte kontaktuar B.SH. me telefon.
216. Në përgjigje të pyetjes nga i pandehuri, B.SH. pala e dëmtuar, A.S. kishte thënë se e njihnte atë përmes XH.B. dhe e dinte se ata kishin lidhje familjare por nuk e dinte se çfarë lidhje.
217. A.S. pastaj i konfirmoi aspektet e ndryshme të dëshmisë së tij të mëhershme duke i përfshirë hollësitë e takimit në supermarketin “Viva” në Ferizaj, në shtëpinë e tij në fshatin Brod dhe në shtëpinë e B.SH. ku ata kishin qëndruar jashtë në veturën e tyre.
218. Në ri-marrjen në pyetje për të sqaruar çështjet të cilat janë ngritë në marrjen në pyetje tërthorazi, pala e dëmtuar A.S. deklaroi se me “Dajku” i referoheshin B.SH. dhe “me qëndruar pas tij” nënkuptonte me u mbështetë në atë se ai mund të kryente punë. Ai po ashtu e sqaroi se as M.S. apo B.SH. nuk ia kanë treguar dokumentet atij në fakt të shkresave të lëndës së B.t por ai tha se ishte ndier keq kur kishte dëgjuar se aty kishte shumë dokumente në shkresat e lëndës kundër B.t.
219. A.S. deklaroi se aty ka shumë kontakte të telefonit nga B.SH. te XH.B.. Në veçanti ai theksoi se B.SH. kishte thirre me organizuar takim në “Viva”. Në fakt ai

deklaroi se çdo takim ishte organizuar nga B.SH. dhe se ai pa dyshim e kishte ngritë çështjen e parave.

220. Në përgjigje ndaj pyetjes së kryetarit të trupit gjykues, palës së dëmtuar, A.S. kishte theksuar se ngjarjet e dyshuara në lidhje me vëllain e tij, ai tregoi me hollësi se ka pasur ndikim të pafavorshëm në pozitën financiare të kompanisë “Luboteni”. Ai tha se atij i kishte rastisur puna me u marrë jo vetëm me udhëheqjen e kompanisë por po ashtu edhe me M.S. n dhe B.SH.n, të cilët e thërrisnin çdo ditë.

221. Dëshmitari **XH.B.** kishte filluar me dhënë dëshmi para trupit gjykues në shqyrtim gjyqësor më 30 janar 2015. Më herët, ai i kishte dhënë deklaratat në IPK¹⁰ dhe para prokurorit¹¹.

222. Në fillim të dëshmisë së tij para trupit gjykues më 30 janar 2015, XH.B. deklaroi se motra e babait të tij (halla) dhe babai i B.SH. janë të lidhur me martesë. Ai deklaroi se kishte punuar si mekanik për 25 vjet, që nga koha kur e kishte braktisë shkollën. Ai tha se din shkrim dhe lexim. Ai deklaroi se shpeshherë i referohen me nofkën “XH.”. Ai tha se ishte martuar me motrën e B.S. në 1996. Ai tha se Arben dhe K.S. janë vëllezërit e motrës së tij.

223. XH.B. tha se ka punuar për shumë kompani për vite të tëra. Nga viti 2012 deri 2014 ai ka punuar për “Obria” në Ferizaj dhe për kompaninë “Luboteni” gjithashtu. Ai deklaroi se kur kishte punuar për kompaninë “Luboteni”, ai kishte pasur një marrëveshje verbale me B.S. se ai nuk do ta pranonte një pagë të rregullt. Ai deklaroi se ata kishin pasur për qëllim me e zgjeruar kompaninë dhe ata u pajtuan se ai do të jetë në krye të departamentit mekanik.

224. XH.B. deklaroi se ai e njihte familjen e afërt të B.S. dhe shumicën prej familjes së gjerë të tij. Ai tha se i kishte pasur numrat e tyre të telefonave dhe kishte kaluar shumë

¹⁰ Lënda e Prokurorisë 2A në pp 542-565

¹¹ Lënda e Prokurorisë 2A në pp 499-541

kohë në kompaninë e tyre nga viti 2012 deri 2014. Ai deklaroi se ai po ashtu e njihte B.H. pasi që ata ishin rritë së bashku dhe se ai gjithmonë e kishte pasur numrin e tij të telefonit.

225. XH.B. deklaroi se ai e njihte R.I. vetëm si figurë. Ai tha se e njihte H.B. që ishte polic nga Biqevci por vetëm e kishte kontaktuar atë njëherë në lidhje me rastin e B. Ai kishte deklaruar se e njihte M.S. sepse ai vjen nga i njëjti fshat dhe se ata janë të lidhur familjarisht. Ai deklaroi se e njihte D.D. sepse ai ishte nga fshati afër tij dhe se ai ishte ngasës i kamionit i cili transportonte zall. Ai deklaroi se nuk e njihte R. V, A. B. apo Sh.B.. Ai tha se e njihte B.D. dhe ata e kishin kryer ushtrinë në ish Jugosllavi. Ai tha se e njihte R.B. dhe kishte kontakte me atë në vitin 2012-2013.

226. XH.B. deklaroi se ai dhe B.SH. ishin shumë të afërt kur ishin të rinj. Ai deklaroi se me kalimin e viteve ata ishin larguar por kjo nuk kishte ndodhur për shkak të problemeve të tyre në mes veti. Ai deklaroi se kontakti ishte rifilluar kur e kishte kontaktuar atë në lidhje me rastin e B.S. pasi që ishte arrestuar.

227. XH.B. ka deklaruar se B.S. ishte drejtori i kompanisë “Luboteni” dhe se ai ishte përgjegjës për çdo gjë. Ai tha se brenda dy muajve të arrestimit të tij, biznesi kishte dal jashtë kontrollit pais që ishte e pamundur me udhëheqë kompaninë pa atë. Ai deklaroi se kompania ishte e vendosur me zyre kryesore në Shtërpce. Ishte themeluar në 2001 dhe fillimisht i kishin punësuar vetëm anëtarët e familjes S. dhe ishte udhëhequr nga shtëpia e tyre. Megjithatë, ai theksoi se deri më 2012 kishin pasur në pronësi gjysmë hektari tokë ku janë mbajtur të gjitha makineritë dhe veturat e tyre. Kompania po ashtu ka marrë me qira zyre të vogla në Shtërpce. Deri më 2012 ai ka konsideruar se kompania ka pasur vlerë prej një milion eurove. Ai ka theksuar se para arrestimit të B. vlera e kompanisë ishte rritë por më pas kishte pësuar një rënie.

228. XH.B. ka deklaruar se ka jetuar me gruan e tij dhe fëmijët në shtëpinë tij e cila ishte 7 km larg prej familjes S. Megjithatë, ai ka deklaruar se situata e tij financiare është përkeqësuar që nga arrestimi i B pasi që kjo kishte shkaktuar probleme në lidhje me kontratat në të cilat ai është dashur me punuar.

229. XH.B. ka deklaruar se ai aktualisht ka vozitur Mercedes por në vitin 2012-2013 ai e ka vozitur një Opel të kuq “Astra” apo ndonjëherë VW “Golf” dhe/apo “Touareg” i cili i takon A. apo respektivisht B.S.
230. XH.B. ka thënë se përfshirja e tij në rastin e arrestimit të B.t ka filluar kur ai e ka pranuar një thirrje telefonike nga A.S. një natë rreth orës 21:00 apo 22:00. A. e kishte informuar atë se B. ishte arrestuar dhe të shkonte në stacion të policisë me marrë veturën e tij. Ai deklaroi se A.S. nuk i kishte dhënë atij asnjë detaj tjetër në lidhje me arrestin e tij.
231. XH.B. deklaroi se ai dhe A. kishin shkuar në stacion të policisë në Ferizaj dhe e kishin marrë veturën e B. dhe e kishin pyetur policinë se përse ishte arrestuar B. por ata nuk kishin dhënë asnjë të dhënë. Ai deklaroi se ata kishin shkuar për kafe dhe pastaj ishin kthyer në shtëpi. Ai deklaroi se familja e B. ishte traumatizuar pasi që ata kurrë nuk kishin pasur probleme ma herët me policinë.
232. XH.B. kishte deklaruar se ditën e nesërme kishte shkuar me A. në Ferizaj ku një person i quajtur Musa nga Prishtina e kishte thirrë A. dhe ata ishin takuar në restorantin e quajtur, “Kafja e Drurit”. Ai theksoi se Musa ishte shok i B. dhe se ata ishin takuar dy apo tre herë më herët. Ai deklaroi se Musa i kishte thënë vet atij dhe A. i kishte angazhuar disa avokatë mbrojtës për B. Ai deklaroi se disa avokatë kishin ardhur aty dhe i kishin diskutuar disa çështje me M.. Megjithatë, ai deklaroi se ata nuk ishin në gjendje me ia sqaruar atij se përse ishte arrestuar B.. Ai ishte pajtuar në deklaratën e tij të mëhershme të dhënë në IPK në mars 2013, ai kishte thënë se Musa e kishte informuar atë rreth arrestimit të B., se ai ishte arrestuar për shkak të “disa femrave”. Ai pohoi se deklarata ishte e vërtetë. Ai tha se M. po ashtu e kishte informuar atë se ai do të merrej me rastin së bashku me avokatët.
233. XH.B. kishte theksuar se atë natë B.D. e kishte thirrë A.S. Ata ishin pajtuar me u takuar në Shtërpce së bashku me një burrë të quajtur B. nga Bitija. Ai kishte dëshmuar që

B. i kishte këshilluar ata për me gjete një person me iu shpjeguar se përse ishte arrestuar B. dhe ai e kishte përmendur M.D.. Ai kishte thënë se në këtë pikë B.D. kishte rekomanduar me e kontaktuar "Dajën". Ai e kishte kuptuar se me këtë nofkë i referoheshin B.H.. Ai pohoi se emri i B.SH. nuk ishte përmend.

234. Megjithatë, XH.B. pranoi se në deklaratën e tij të dhënë para prokurorit në shtator 2013 ai kishte thënë se ishte përmendur emri i B.SH.t dhe se ai do të mund të kontaktohej përmes B.H. Ai kishte theksuar se ata janë "të dytë dajë i njëri tjetrit". Ai theksoi se e kishte kuptuar referimin e B.D. se "Dajku" ishte në fakt referimi i bërë për B.H. e jo për B.SH.n por ai e kishte pranuar se këtë nuk e kishte thënë ai në deklaratën e tij para prokurorisë në shtator 2013 apo para IPK-së në maj 2013. Ai pohoi se e kishte thirrë B.H. menjëherë. Ai deklaroi se ata ishin takuar ditën e nesërme në pompën e benzinës në "Balkan Petrol" pastaj aty ishte informuar se B.SH. punonte në hetim.

235. Kur ai e kishte përmbledhur dëshminë e tij më 10 shkurt 2015, pala e dëmtuar XH.B. kishte deklaruar se ai kurrë nuk kishte thënë se do të ishte problem me u takuar me B.SH. por ma shumë me B.H. Megjithatë, ai e pranoi se e kishte nënshkruar deklaratën e cila e pohonte të kundërtën. Ai deklaroi se iste takuar me B.SH. për të parën herë në "Balkan Petrol" dhe më pas kishte pasur shumë biseda telefonike me atë. Ai tha se e kishte marrë numrin e mobilit të B.SH. në një takim në "Balkan Petrol". Ai tha se e kishte takuar M.D. në "Europa" gjithashtu me B.D. B., A.S. dhe S.S., kushëriri i A.. Ai deklaroi se kishte qenë M. ai i cili e kishte informuar atë se përse ishte arrestuar B. dhe ai tha se i dukej e çuditshme se si e dinte ai këtë. Ai deklaroi se M. i referohej këtyre njerëzve në mënyrë nënçmuese. Ai pohoi se e njihnte B. prej më herët përmes punës së tij si mekanik. Kur i kishin thënë atij se në deklaratat e tij të mëhershme , ai kishte thënë se nuk e njihnte atë, pala e dëmtuar XH.B. kishte thënë se ai ishte i sëmurë kur e kishte dhënë deklaratën e tij dhe se atij nuk i kujtohej se e njihnte atë në atë kohë. Megjithatë, ai e pranoi se e kishte nënshkruar deklaratën.

236. XH.B. deklaroi se familja S. ishin traumatizuar me arrestimin e B. dhe kjo nuk i kishte ndodhur asnjëherë atyre. Ai deklaroi se familja e tij e ngushtë dhe e gjerë, mbështeteshin te ai shumë. Ai deklaroi se edhe ai po ashtu ishte i traumatizuar.
237. XH.B. e kishte konfirmuar përmbajtjen e një deklaratë të mëhershme nën përshtypjen se ai e kishte kuptuar më vonë se M. ishte shok i M.S. dhe se ai i kishte thënë se kush janë femrat e përfshira në këtë rast. Megjithatë, ai deklaroi se ai në fakt kishte thënë se ai kishte dyshime se M.S. e kishte informuar M.D. se kush ishin këto femra por fjalët *“Dyshoj në këtë”* nuk janë regjistruar. Ai e konfirmoi se kujtesa e tij ishte më e mirë e në të tashmen se kur e kishte dhënë deklaratën. Në përgjigje në pyetjen e parashtruar nga kryetari i trupit gjykues, ai kishte deklaruar se ai nuk ishte kërcënuar me e mohuar deklaratën e tij të mëhershme. Ai vetëm tha se ishte më i qetë tani dhe se kishte qenë keq në kohën kur i kishte dhënë deklaratat e tij të mëhershme.
238. XH.B. deklaroi se e kishte zbuluar nga bisedat vijuese me shokët dhe përfundimisht se M. dhe M.S. ishin shokë. XH.B. e kishte paraqitë bindjen e tij se M.S. dhe B.D. i kanë shkëmbyer veturat e tyre, një Audi për një Mercedes. Ai deklaroi se Mercedesi ishte blerë nga B.
239. Kur ai e kishte përmbledhur dëshminë e tij para trupit gjykues më 23 shkurt 2015, pala e dëmtuar XH.B. e kishte përsëritur pohimin e tij të mëhershëm se ai nuk ishte mirë kur e kishte dhënë deklaratën e tij të mëhershme por deklarata e tij e dhënë para policisë ishte më e saktë se ajo që e kishte dhënë para prokurorit.
240. XH.B. deklaroi se ai kishte shkuar në takime pas arrestimit të B. me A.S. Ai e kishte përsëritur dëshminë e tij të mëhershme se ishte takuar me B. dhe M. ditën pas arrestimit të B., A. dhe S. ishin po ashtu prezent. Ai tha se në këtë takim M. e kishte përmendur emrin A.D. dhe e kishte këshilluar familjen S. me e takuar atë pasi që ai do të mund të rregullonte për palët e dëmtuara të njohura me i tërheqë deklaratat e tyre.

241. XH.B. deklaroi se ai menjëherë e kishte thirre z. D. dhe së bashku me A. dhe S.S., ai ishte takuar me atë në Ferizaj. Ai kishte qenë prezent në një restorant me një person të quajtur L. , të cilin XH.B. nuk e kishte takuar më herët. Ai tha se z. D. nuk ishte i vetëdijshëm për situatën e cila e përfshinte B.S.n dhe ata është dashur me e informuar atë. Ai deklaroi se A.D. e kishte informuar atë se palët e dëmtuara nuk mund të kontaktoheshin pasi që i kishin ndryshuar numrat e telefonave dhe pastaj L. i kishte thënë se M.S. ishte duke u marrë me rastin. Ai pohoi se besonte se L. kishte lidhje familjare me M.S. n.
242. XH.B. deklaroi se L.i kishte thënë atyre se M.S. ishte një toger me gradë të lartë në Policinë e Kosovës dhe se ai do të mund t’ia kryente një nder L.t. Megjithatë, atij i kujtohet se A.D. përfundimisht kishte thënë se ai nuk mund të ndihmonte.
243. XH.B. deklaroi se L. kishte thënë se është ide e mirë me shkuar dhe me u takuar me M.S. n. Ai tha se së bashku me A. dhe S.S., ai dhe L. e takuan atë në një vend me muzikë të gjallë në Prelez në rrugën kryesore nga Ferizaji në Prishtinë.
244. XH.B. deklaroi se në këtë vend ai e kishte takuar një mik të përbashkët të L. dhe M., i cili iu kishte thënë atyre se M. ishte larguar pak para pesë minutave. Ai tha se ata e kishin rregulluar një takim për mëngjes në ditën e nesërme ku do të takoheshin A.me S. dhe me M.S. XH.B. pohoi se ai tashmë ishte pajtuar me u takuar me B. në *“Balkan Petrol”*. Ai tha se ai e njihte L. si shok të M. e asgjë më shumë . Ai tha se më vonë ishte takuar me M.S. n dhe si e kishte treguar me gisht në gjykatë. Ai tha se L. nuk kishte treguar saktësisht se çfarë mund të bënte M. me e ndihmuar B.S.n.
245. XH.B. deklaroi se ditën e nesërme ai kishte shkuar në *“Balkan Petrol”* dhe ishte takuar me B.H. Ai tha se i kishte treguar atij për rastin e B. dhe kjo ishte kur B. i kishte thënë atij se B.SH. ishte polic. XH.B. deklaroi se B.H. i kishte propozuar atyre që ta pyesin B.SH.n se çfarë kishte ndodhur me rastin e B.t dhe ai ishte pajtuar me e bërë këtë. Ai deklaroi se B.H. më pas e kishte thirre B.SH. Ai kishte treguar me gisht kah B.SH. në gjykatë.

246. XH.B. deklaroi se B.SH. i kishte ftuar të dytë në Ferizaj. Ai tha se B. kishte shkuar aty dhe pastaj e kishte thirre atë dhe i kishte kërkuar atij me shkuar përsëri në *“Balkan Petrol”* dhe kur ai kishte arrite aty, B.SH. dhe M.S., kishin qenë të dytë prezent, por ai nuk e dinte në atë kohë se kush ishte M.S.
247. XH.B. deklaroi se B.SH. i ishte afruar atij dhe i kishte thënë atij se B. kishte probleme dhe se ai do të mund të dënohej me burgim prej 6 deri në 10 vjet. Ai pohoi se po ashtu M. kishte qenë duke biseduar në telefon me prokuroren B.K. duke u mundura me i ndihmuar B. me u liruar nga burgu. Ai tha se i kujtohej se B.SH. i drejtohej M.S. si shok.
248. XH.B. deklaroi se grupi ishin ulur dhe kishin filluar me biseduar. Ai kishte thënë se M.S. i kishte thënë fjalët deri në atë fazë ku B. është bërë *“më shumë se serb”*. Megjithatë, ai po ashtu pohoi se do t’i ndihmonte pasi që B. kishte lidhje familjare me B. i cili ishte prezent.
249. XH.B. deklaroi se grupi kishin drekuar dhe gjatë drekës ai kishte pasur një bisedë me B.SH. i cili i kishte thënë atij se M.S. ishte i shkathët dhe i aftë. Kur ishte përkujtuar nga prokurori për një deklaratë të dhënë në IPK në mars 2013, në të cilën kishte deklaruar se B.SH. e kishte tërhequr anash dhe i kishte thënë se M.S. është një ujk i vjetër, se ai do ti ndihmonte B.S. por ndoshta ai do te kërkon diçka në kthim, XH.B. tha se atij nuk i kujtoheshin këto fjale specifike. XH.B. deklaroi se i kishte thënë B.SH. se nuk kishte probleme në lidhje me këtë.
250. XH.B. deklaroi se ai nuk i kishte paguar asgjë askujt atë ditë. Kur ishte shtyre me treguar të vërteten , ai as nuk ishte i sigurte nëse B.SH. i referohej pagesës legjitime apo jo legjitime por më vonë e kishte kuptuar se kishte qenë *“një mashtrim”*. Atij nuk iu kujtohej nëse shuma ishte përmendur nga ndokush. Ai ishte konfuz ne lidhje me atë se a i referohej prokurori pagesave qe i ishin bërë B.SH. dhe M.S. apo T.G. Megjithatë, ai e pranoi se kurrë nuk kashtë pranuar asnjë vërtetim për pagesë të cilat dyshohet se ai iu

kishte bërë atyre. Kur kryetari i trupit gjykues i kishte bërë presion, pala e dëmtuar XH.B. deklaroi se ai i kishte bërë disa pagesa policëve në mes të majit 2012 dhe marsit 2013.

251. Kur ai e paraqiti dëshminë e tij para trupit gjykues më 24 shkurt 2015, pala e dëmtuar, XH.B. deklaroi se ai ishte befasuar kur personat të cilët e kishin arrestuar B.S.n ia kishin ofruar ndihmën e tyre atij. Megjithatë, ai deklaroi se ishte befasuar kur shkoi në shtëpi dhe u informua se B. nuk ishte liruar nga burgu. Ai tha se dreka zgjati shumë dhe se atij nuk iu kujtohej çdo gjë që i kishte thënë M.S. atij. Megjithatë, ai besonte se ishte B.SH. i cili e kishte thirrë atë menjëherë me i treguar se paraburgimi i B. ishte vazhduar. XH.B. deklaroi se para takimit të tij në *"Balkan Petrol"* ai nuk ishte i përfshirë me B.SH.n dhe/apo me M.S. n as mirë, as keq apo indiferent.
252. XH.B. tha se A.S. i kishte thënë atij se L. ishte takuar me M.S. gjatë kohës kur B.S. ishte arrestuar në Prishtinë. Ai tha se para takimit në *"Balkan Petrol"* ai nuk kishte pasur kontakt me M.S. n asnjëherë.
253. XH.B. tha se ditën e nesërme ai vet, A.S., B.SH., M.S. dhe njëri prej kolegëve të tyre (emrin e të cilit ai nuk e kujtonte) ishin takuar përsëri në *"Balkan Petrol"*. Atij nuk iu kujtohej se kush e kishte caktuar takimin por kur iu kishte parashtruar pyetja ai kishte deklaruar më herët se B.SH. e kishte caktuar se kjo është e vërtetë. Ai kishte shkuar në takim me A.S.n. Ata u takuan në *"Balkan Petrol"* përsëri. XH.B. tha se M.S. , B.SH. dhe njëri prej kolegëve të tyre, të gjithë kishin qenë prezent. Ai tha se grupi kishin diskutuar rastin e B.t.
254. XH.B. tha se njëra prej temave që është diskutuar ishte në lidhje me atë që me i ndihmuar B., nëse do të kërkoheshin para për këtë, kush do të garanton për këtë pagesë. Ai tha se B.SH. dhe M.S. e kishin kërkuar këtë prej tij. Ai tha se asnjë zyrtarisht asgjë nuk ishte treguar në lidhje me këtë por ishte përmendur shuma rreth €4,000. Ai tha se as B.SH. e as M.S. nuk e kishin diskutuar procedurën me të cilës B. do të pranonte ndihmë për këto para.

255. XH.B. tha se ai dhe A.S. po ashtu e kishte pranuar një thirrje telefonike nga B.SH. duke i ftuar ata me u takuar në stacionin e policisë në Ferizaj ditën e nesërme. Ai tha se ata kishin shkuar dhe kur kishin arritur B.SH. i kishte shërbyer me pije dhe i kishte thënë atyre me ia shkruar një kërkesë “*shefit*”, pasi që ai do t’i ndihmonte atyre. Ai tha se M.S. nuk ishte atje atëherë por pastaj kishte ardhur më vonë.
256. XH.B. tha se aty kishin pasur një diskutim me B.SH.n në lidhje me rastin e B.. Atij iu kujtua se B.SH. ia ishte treguar një CD atij dhe kishte deklaruar se kjo do të ishte keq për B. nëse përmbajtja e saj do të ishte zbuluar. Megjithatë, atij iu kujtua se ai kishte thënë, “*se B. ndodhet në një situatë të vështirë se ne nuk i kemi dërguar gjysmën e gjësendeve; shefi është duke ndihmuar mjaft, për shkak meje kur ai kishte thënë se ai ku kurrë nuk do t’i paraqiste ato gjëra që ndodhen në CD dhe se ata do t’i djegin ato*”
257. XH.B. tha se B.SH. po ashtu kishte thënë, “*tani që e di se ai është miku yt dhe tani shefi (M.S.) është duke e kuptuar se ai është daja i babait të*”. Ai tha se B. ndodhet në një situatë të vështirë por shefi do ta ndihmon atë dhe do ta shpejton rastin. XH.B. tha se ai besonte se kjo i referohej M.S. XH.B. tha se B.SH. i kishte thënë se B. mund ta merr një dënim prej 6 deri 12 vjet burgim.
258. XH.B. tha se kur M.S. kishte shkuar në zyrën e tij ai tha se M. pastaj iu kishte referuar lidhjes së tyre familjare po ashtu dhe kishte theksuar se ata nuk do t’ia dërgonin prokurorisë CD-në me prova , të cilën e kishte përmendur më herët B.SH.. XH.B. tha se as B.SH. e as M.S. nuk kishin pyetur për asgjë në kthim për këtë në atë çast.
259. XH.B. tha se nga koha kur ata kishin ardhur në stacion të policisë deri në fund të vizitës së tyre, B.SH. tha për nevojën që duhet me çmuar M.S. n pasi që ai mund të kryen punë të shumta. Ai tha se ai ishte aty për të ndihmuar dhe se ishte shumë i fuqishëm. Ai tha se M.S. dhe B.SH., të dytë kishin premtuar se do të ndihmonin. Ai tha se M.S. kishte thënë se ata do të bënin “*çfarëdo që është e nevojshme*”. Ai tha se ai ishte nën presion por kishte një “*besim të caktuar*” në ata pasi që ata ishin policë.

260. XH.B. tha se një burrë i quajtur N. e kishte hyrë në zyrën e M.S. në kohën kur ata po dilnin. Ai tha se ishte polic. Ai tha se pas këtij takimi ai dhe A.S. ishin kthyer në shtëpi. Ai tha se kishin biseduar dhe ishin shumë optimist se M.S. dhe B.SH. do t'i ndihmonin atyre.
261. XH.B. pastaj kishte deklaruar se pas 3-4 ditësh pas këtij takimi, ai e kishte pranuar një thirrje nga B.SH. me propozimin se ata duhet të shkonin në prokurori në Prishtinë. Megjithatë, kur iu ishte paraqitur një kopje e një deklaratë të mëhershme, ai u pajtua se ai në fakt kishte thirre me organizuar një takim në supermarketin e vjetër "Viva" në Ferizaj. A.S. kishte shkuar me atë. Ai tha se B.SH. i kishte thënë atyre se kishte pasur një aksident me veturën e M., Audi A4. Ai i kishte kërkuar €1,000 me e rregulluar atë. Ai u pajtua se në deklaratën e mëhershme ai kishte thënë se ai i kërkonte paratë pasi që ishte duke iu ndihmuar me rastin e B. Ai tha se nuk e kishte parë as dëmin e as faturën e riparimit të veturës. Ai tha se po ashtu A.i kishte dhënë B.SH.it €50 për drekë. XH.B. tha se ata nuk i kishin pasur me vete €1,000 kështu që A.i kishte tërhequr €300 apo €400 nga bankomati por ai nuk e dinte se kush i kishte marrë edhe €600 shtesë. Ai tha se ata i kishin dhënë €1,050 B.SH.t në veturën e A. në një takim të mëpasshëm në supermarketin e vjetër "Viva". Ai u pajtua se ai kishte qenë i saktë në deklaratën e tij të mëhershme kur kishte thënë se B. i kishte marrë paratë dhe tha se ata nuk duhet të brengosen për këtë çështjen pasi që kjo do të rregullohet dhe ai e thoshte këtë vërtetë. Ai po ashtu tha se ai kishte thënë saktë në deklaratën e mëhershme të tij kur kishte deklaruar se paratë nuk do të humbnin dhe se ai i ndihmonte B.t. Ai tha se nuk konsideronte se ai duhej t'i paguante këto para. Ai tha se nuk kishte pranuar ndonjë vërtetim për këto fare.
262. XH.B. tha se ishte takuar me B.SH. përsëri disa ditë më pas "Euro Miti". Ai tha se takimi ishte rregulluar nga B.SH. dhe se ai dhe A.e kishin marrë atë me veturë dhe kishin shkuar në Prishtinë. Ai tha se Musa Mani dhe B.D. ishin po ashtu në "Euro Miti". Ai kishte arrite me A. në veturën e tij VW Golf 5. A. kishte vozitur.

263. XH.B. tha se B.SH. i kishte informuar ata se ai do të shkonte me pyetur Prokurorin që me punuar në rastin e Bidajit. Ai tha se kur kishin shkuar atje, me udhëzime të B.t, ai dhe A.kishin qëndruar në kafene në ndërtesën e prokurorisë kur kishte shkuar ai me biseduar me prokuroren, B.K.. Ai tha se i vetmi rast kur e kishte dëgjuar këtë emër kishte qenë kur M.S. kishte biseduar me atë në telefon në takimin e tyre të parë në "Balkan Petrol". Ai tha se nuk e kishte parë B.SH.n duke biseduar me prokurorin.
264. XH.B. tha se B.SH. ishte kthyer te ata në fund të vizitës së tyre dhe kishte thënë *"punët nuk po shkojnë keq, është në rregull"*. XH.B. tha se ai, A.S. dhe B.SH. pastaj kishin shkuar në Universitetin AAB. Ai tha se pasi kishin arrite atje ata kishin hyrë në ndërtesë , B.SH. kishte shkuar te zyra e referentit por pastaj ishte kthyer shkurtimisht te ata më pas dhe ju kishte kërkuar €300 për me e paguar semestrin. Ai tha se A.ia kishte dhënë paratë atij. Ai e theksoi faktin se B.SH. ishte duke ndihmuar në rastin e B.t, *"kishte qenë gjithmonë një faktor konstant por kryesisht paratë i ishin dhënë referentit për pagesë të semestrit"*. Atij nuk iu kujtohej asnjë marrëveshje se paratë do të paguheshin përsëri.
265. XH.B. tha se kur ata e kishin përfunduar punën në Universitetin AAB, B.SH. ia kishte dhënë propozimin e grupit për të shkuar në restorant në Prishtinë ku ishin takuar me M.S. n. Ai tha se kur kishin arrite në restorant, kishte hyrë B., ai dhe A.S. i ishin afruar derës por M. menjëherë kishte dalë jashtë dhe i kishte bërtite B.SH.t duke e pyetur atë se përse i ke sjellë këta në restorant ? Ai tha se B.SH. ishte zbehur dhe nuk ndihej rehat. Ai deklaroi se me këto fjale, grupi u kthye në veturë dhe shkuan në Ferizaj.
266. XH.B. pastaj e konfirmoi përmbajtjen e deklaratës së tij më 24 mars 2013 në të cilën kishte deklaruar, *"Po, pas disa ditësh B. më thirri në telefon dhe më tha të takohem me M. afër "Old Mill"*. Ai tha se ky ishte një restorant në Ferizaj. Ai tha se kishte shkuar në një takim me A.S. por kur ata kishin shkuar atje, *"me kërkesë të M.; A. i kishin kërkuar mos me marr pjesë në takim"*. Ai tha se B.SH. i kishte informuar ata në lidhje

me këtë. Ai tha se B.SH. po ashtu ia kishte rikujtuar atij se do të duhej të kishte ca para me vete, së paku €500. Ai tha se A.S. ia kishte dhënë paratë atij dhe pastaj kishte shkuar.

267. XH.B. tha se ai pastaj kishte hyrë në restorant dhe M.S. ishte aty. Ai tha se atij i kishin thënë se nevojiteshin €500 për *“shpenzime”*. Ai tha se të dytë B.SH. dhe M.S. e kishin informuar atë në lidhje me këtë dhe kishin thënë se paratë ishin për të paguar për dreka, me i paguar njerëzit e ndryshëm dhe shpenzimet tjera. Përsëri, ai kishte thënë se nuk e kishte marrë vërtetimin e pagesës për këto para.

268. XH.B. ishte pajtuar me përmbajtjen e deklaratës së tij më 24 mars 2013 deri në pjesën kur B. kishte thënë *“A. është B. dhe B. është A.”*. Ai kishte thënë se A.SH. ishte vëllai i B.SH. Ai po ashtu u pajtua se R.B. ishte dëshmitar në rastin e B. Ai theksoi se, *“ai është shok i B. që nga shkolla fillore edhe para se me u arrestuar B.; R. ishte kapur, M. dhe B.; dhe ai e kishte dhënë një deklaratë në lidhje me B.”*.

269. XH.B. tha se M.S. i kishte thënë atij, *“po që se R. do ta ndryshonte pak deklaratën e tij, kjo do t’i ndihmonte shumë B.”*. XH.B. tha se ai ishte përgjigjur, *“Nuk ka problem, unë do të shkoj dhe të bisedoj me Raifin”*.

270. XH.B. ishte pajtuar me përmbajtjen e deklaratave të tij të mëhershme siç vijon, *“M. i kishte thënë B. se juve ju është dhënë detyra me i gjetur ato femra dhe me kërkuar nga ato me i ndryshuar deklaratat”*. Ai tha se M.S. tha se do të merrej me Prokurorin, gjykatën dhe çështjet tjera nga Prishtina.

271. XH.B. deklaroi se ai ishte ndjerë keq dhe i fyer në këtë takim. Ai e urrente mënyrën se si B. ishte i lidhur me vëllain e B.SH. që ishte në mënyrë false dhe ai ishte ndjerë *“si një njeri që nuk e di se si funksionon bota”*. Ai tha se ai e kishte të qartë se B.SH. dhe M.S. e kishin shpikë dhe montuar tërë incidentin por ai tha se nuk mund të kundërshtonte edhe pse dëshironte me iu treguar atyre se nuk ishte i dobët. Ai u pajtua se ishte ndjerë i turpëruar. XH.B. tha se natyra e shpikur e këtij takimi i kishte ngrite

dyshimet e tij se dikush po mundohej me e shfrytëzuar atë. Ai u pajtua se kishte dhënë para disa herë dhe B.S. ishte ende në burg.

272. XH.B. deklaroi se pas takimit në restorantin *“Old Mill”* ai kishte pas takim me avokatin T.G.. XH.B. po ashtu ishte pajtuar me përmbajtjen e deklaratës së tij të datës 26 shtator 2013 deri në momentin kur M.S. e kishte këshilluar atë, *“që me i thënë Raifit me thirre atë, M.n direkt; nëse R. kishte frikë”*. XH.B. kishte deklaruar se ai besonte se kjo ishte në lidhje me deklaratën e tij që e kishte dhënë në lidhje me rastin e B. Ai tha se R.B. jetonte në fshatin Bibaj dhe ai dhe A.S. e kishin vizituar atë atje.

273. XH.B. tha se R.B. ishte shumë i stresuar dhe ai kishte thënë se *–“deklarata të cilën ai e kishte dhënë, ishte nën kontrollin e tij”*; dhe kur ishin shtruar pyetjet nga policia, ai kishte thënë se *“ata më kanë bërëtitur mua”*, dhe siç kishte deklaruar ai, *“Unë e humba disi kontrollin; dhe atë që e ka deklaruar policia unë e kam pranuar. Mirëpo, kur të shkoj në prokurori, unë nuk do të frikësohem nga askush dhe unë do ta pranoj deklaratën si të timen , por jo edhe pyetjet dhe përgjigjet”*. XH.B. kishte deklaruar se R.B. kishte deklaruar se ai nuk do t’i pranon pyetjet dhe përgjigjet të cilat janë shkruar në deklaratë.

274. Kur ai i përmbloodhi dëshmitë e tij në trupin gjykues më 25 shkurt 2015, pala e dëmtuar XH.B. ishte pajtuar me përmbajtjen e deklaratës së tij pranë IPK-së më 26 shtator 2013 se R.B. kishte gënjyer në deklaratën e tij të mëhershme para policisë në lidhje me B. Ai kishte thënë se R.B. i kishte thënë atij se policët hetues nga Ferizaji kishin ushtruar presion në atë dhe se ai ishte frikësuar. XH.B. kishte thënë se R.B. i kishte thënë atij dhe A. se ai ishte kontaktuar nga policia dhe pastaj kishte shkuar te ata me dhënë deklaratë në të njëjtën ditë kur ishte arrestuar B..

275. XH.B. ka deklaruar një apo dy ditë pas kësaj bisede me Raifin, ai e kishte pranuar një thirrje telefonike në lidhje me takimin me B.SH. Ai ka deklaruar menjëherë më pas se ata ishin takuar në supermarketin e vjetër *“Viva”* në Ferizaj. Ai tha se ai ishte vozitur

aty me A. Ai ka deklaruar se janë takuar me B.SH.n në parking të veturave me propozimin e tij.

276. XH.B. ka deklaruar se kur ai është takuar me B.SH., ai i kishte thënë atij se M.S. *“ndodhet në anën tjetër të objektit, 500 euro nevojiteshin për M.n, edhe 500 për B., edhe 400 për H.” dhe kjo kishte qenë me e zgjidhur problemin e B.t.*

277. XH.B. tha se B. e kishte informuar atë se H. ishte një zyrtar i policisë speciale , i cili kishte qenë shok i tij. XH.B. tha se H. nuk ishte aty por M.S. ishte prezent në një objekt tjetër, në anën tjetër të parkingut. Ai tha se e njihnte H. prej më herët. Ai u pajtua se më herët kishte deklaruar se i njihnte dy ankuesit dhe se mund t’i afrohej atyre për me i thënë me i ndryshuar deklaratat.

278. XH.B. tha se kjo kërkesa e fundit për para i kishte dhënë atij një ndjenjë të optimizmit se diçka do të bëhej për B. nga M.S. dhe B.SH.. Ai tha se as ai e as A. nuk i kishin pasur me vete paratë. Ai tha se ishin detyruar me marr para hua por nuk iu kujtohej se nga kush. Ai tha se donatorët nuk ishin informuar për arsyen se për çka nevojiteshin paratë. Ai tha se S.S. po ashtu kishte qenë i përfshirë në mbledhjen e parave.

279. XH.B. tha se ishin marrë vesh me B.SH.n që paratë me iu dorëzuar në parking të supermarketit të vjetër *“Viva”* në Ferizaj dy orë më vonë. Ai deklaroi se ai nuk mund t’i rezistonte kërkesës për para pasi që këto ishin për t’i ndihmuar B. megjithëse nuk e dinte se si do t’i ndihmonin M.S. dhe B.SH. atij. Ai deklaroi se me i dhënë para në këtë mënyrë ishte realiteti i jetës në Kosovë. Ai e ka theksuar bindjen e tij se po qe se nuk do t’i kishte dhënë këto para nuk do të kishin pranuar ndihmë fare. Megjithatë, ai deklaroi se në atë kohë ai nuk e konsideronte këtë si ryshfet. Edhe tani, ai deklaroi se besonte se këto ishin për të mbuluar shpenzimet e policëve. Në mënyrë më specifike ai deklaroi se familja e tij dhe e B.SH. ishin të lidhur për pesëdhjete vite dhe në këtë kontekst ai i kishte paguar paratë për shkollimin e tij.

280. XH.B. tha se para arrestimi të B., ai nuk kishte pasur marrëdhënie armiqësore me polici e aq më pak me i paguar atyre para për çfarëdo. Ai u pajtua me Kryetarin e trupit gjykues se ai besonte se po qe se do t'i paguante këto para B.SH., çdo gjë do të rregullohej. Ai tha se A.S. ia kishte dhënë €1,400 B.SH.t me këtë rast. XH.B. tha se ata ishin takuar me B.SH. përsëri ditën e nesërme dhe kishin shkuar në restorantin “Beni” në Kaçanik. Ai tha se H. kishte qenë po ashtu aty .
281. Kur ai e kishte paraqitë dëshminë e tij më 26 shkurt 2015, pala e dëmtuar XH.B. tha se B.SH. e kishte thirre atë me e organizuar këtë takim. Ai tha se B.SH. kishte biseduar në lidhje me një pompë e cila po punonte mirë dhe për atë kjo ishte një referencë për €400 të cilat ai ia kishte dhënë atij për H. më herët. Ai tha se as B.SH. e as H. nuk i kishin dhënë atij vërtetimin për pagesën prej €400 për pompën Bosch.
282. XH.B. tha se atij nuk iu kujtohej se kishte pasur një bisedë me H. në lidhje me atë se si po shkon rasti i B. Megjithatë, ai u pajtua se ai kishte përshtypjen se ai ishte aty në lidhje me ndihmën për B. që ishte përmendur më herët. Ai ishte pajtuar me përmbajtjen e një deklaratë të mëhershme ku B.SH. i kishte thënë vazhdimisht atij se B.H. nuk dinte asgjë në lidhje me faktin se ai dhe A.i kishin dhënë atij para. Ai tha se nuk ia kishin shpjeguar atij se përse kjo ishte kështu por ai tha se ishin pajtuar që me i mbajtur pagesat në fshehtësi.
283. XH.B. tha se disa ditë pasi ishte takuar te “Beni”, ai e kishte pranuar edhe një telefonatë nga B.SH.. Ai kishte thënë se kjo ishte një thirrje për të caktuar një takim në restorantin “Mulliri i vjetër” apo “Old Mill”. Ai tha se aty kishin qenë disa takime me M.S. dhe B.SH. por A.S. nuk kishte qenë prezent gjithmonë. Ai tha se M.S. dhe B.SH. kishin qenë prezent kur i kanë kërkuar €500. Ai ishte pajtuar me përmbajtjen e deklaratës së mëhershme se i kishte dhënë B.SH. €500 në të gatshme para M.t.
284. XH.B. tha se janë mbajtur katër apo pesë takime të ngjashme në restorantin “Old Mill” dhe M.S. dhe B.SH. kishin qenë gjithmonë së bashku. Aty kurrë nuk kishte pasur njerëz të huaj. Ai tha se ata do të diskutonin rastin e B. dhe thanë se ata besonin se në

fund të muajit B. do të lirohej por M. do të thoshte po ashtu , *“Unë kurrë nuk mund të ju garantoj 100 përqind”*. Ai pranoi se në deklaratën e kaluar ai kishte thënë se, *“është puna e jonë dhe ne e kemi Prokurorin dhe se kjo është çfarë ne bëjmë”*. Ai tha se prokurori ishte B.K..

285. XH.B. tha se pas T.G., familja e kishte marrë avokatin E.SH. me u marr me çështjen. Ai tha se kjo ndodhi për shkak se T.G. për një seancë gjyqësore kishte kërkuar €25,000. Ai deklaroi se M.S. kishte thënë se nuk ka nevojë që të paguajmë aq shumë para. XH.B. tha se E.SH. kishte qenë i vetmi avokat të cilin ai e njihte. Ai tha se M.S. e kishte aprovuar përzgjedhjen e tij. Ai tha se kishte biseduar me M.S. në lidhje me këtë çështje pasi që besonte se ai ishte duke e ndihmuar atë.

286. XH.B. tha se gjatë kësaj kohe R.B. ishte thirre me dëshmuar në zyrën e Prokurorit. Ai deklaroi se kishte shkuar në Prishtinë së bashku me A. dhe R. Ai deklaroi se Raifi kishte shkuar në zyre të prokurorisë dhe kishte dhënë deklaratën e tij dhe më pas iu kishte bashkangjitur atyre për kafe. Ai iu kishte thënë atyre se çdo gjë ishte në rregull dhe ai e kishte thënë të vërtetën në lidhje me rastin e B.

287. XH.B. tha se A.S. ia kishte paguar E.SH. €2,000 dhe se ai e kishte pranuar një vërtetim për këtë. Ai tha se nuk ishte i kënaqur me performancën e tij. Ai tha se E. SH. e kishte informuar atë se Prokurori i kishte telefonuar viktimat e dyshuara disa herë por ato nuk ishin përgjigje.

288. XH.B. tha se në këtë pikë ai e kishte telefonuar B.SH. dhe i kishte thënë atij që të takoheshin në restorantin *“Nukodime”* rrugës për Ferizaj. Ai tha se M.S. dhe B.SH. ishin aty. Ai tha se ata iu kishin referuar dy ankimuesve dhe kishin thënë, *“Duket se kemi një problem, por kjo do të rregullohet pasi që ne do t'i gjejmë ato disi”*. Megjithatë, ai ka theksuar se ata i kishin thënë atij po ashtu të qëndronte i qetë dhe se ata do të merreshin me probleme.

289. XH.B. tregoi se kishte biseduar në telefon me B.SH. ditën e nesërme. Ai tha se ai e kishte informuar atë se viktimat ishin gjete dhe me shkuar në shtëpi të B. me biseduar në lidhje me këtë. M.S. po ashtu do të ishte aty. Ai tha se A.S. e kishte dërguar aty dhe pastaj ishte larguar.
290. XH.B. tha se në takim M. kishte thënë se ata i kanë gjetur viktimat dhe “ *pasi që puna pothuajse ka përfunduar, mos ta prishim edhe për pak*”. Ai tha se me këtë ai nënkuptonte se viktimat e dyshuara do të jepnin deklaratat dhe B. do të lirohej. Ai tha se ishte informuar se B.K. ishte sëmurë dhe se do të zëvendësohej në këtë intervistë. Ai tha se B.SH. kishte thënë se prokurorët e ri kishin nevojë për dy iPhone dhe një laptop si “*shpërblim*”. Ai e ka përmendur shifrën prej €1,500. Ai tha se ai do ti kishte treguar se kur me i dorëzuar ato. Ai e tha këtë se kjo kishte qenë vetëm disa ditë pak para se me skaduar paraburgimi i B.t. Ai tha se ishte larguar me A. me i marrë këto para. Ai deklaroi se ndihej i obliguar me i marrë ato me frikën se çfarë mund ti ndodhte B. Ai tha se ishte i stresuar dhe i frikësuar.
291. XH.B. tha se ai dhe A.S. i kishin bërë disa telefonata shokëve të cilët nuk mund ti gjenin paratë. Ai tha se ata përfundimisht shkuan në “*Balkan Petrol*” dhe i kishin marrë paratë nga B.H. Ata nuk ia kishin shpjeguar atij se përse ju nevojiteshin paratë.
292. XH.B. tha se gjatë kësaj kohe A.S. ishte sëmurë. Ai tha se ai ishte kthyer në shtëpi të B.SH. dhe kishte shkuar me u takuar me M.S. n te “*Euro Miti*”. Ai tha se gjatë rrugës për aty ata ishin ndalur në një dyqan, ku ai e kishte blerë një pako cigare dhe B.SH. kishte blerë një parfum. XH.B. tha se B.SH. e kishte këshilluar atë që me i vendos €1,500 në shishe të parfumit dhe pastaj me ia dhënë këto para kur ia jepnin shenjën M.t. Ai tha se ata kishin shkuar në “*Euro Miti*” dhe ishin takuar me M. i cili kishte thënë “*punët janë rregulluar në Prishtinë*”. Ai tha se B.SH. pastaj i kishte thënë atij që me ia dorëzuar kutinë , të cilën gjë e bëri duke e vendosur në tavolinë, ku e mori M., e hapi atë dhe tha, “*tani dëshironi të më korruptoni edhe mua*”. Ai tha se në atë çast M.S. n e kishte thirre njëra prej viktimave dhe kishte thënë “*mos e shkyç këtë telefon nesër pasi që unë do ta dërgoj njërin prej punëtorëve të mi me iu dërguar në Prishtinë në*

mënyrë që ju me dhënë deklaratën para Prokurorit". Ai e miratoi përmbajtjen e deklaratës së mëhershme të dhënë ku e kishte pyetur B.SH.n se përse paratë duhej të ishin në kuti dhe ai u përgjigj *"kjo duhet të bëhet "*.

293. XH.B. tha se mënyra e fshehtë se si ishin dhënë paratë dhe fjalët e M.S. e kishin ngritë dyshimin se diçka e pafavorshme ishte duke ndodhur. Ai deklaroi se A.S. nuk kishte qenë prezent kësaj radhe. XH.B. e kishte miratuar deklaratën e tij të mëhershme kur kishte thënë se ka biseduar me avokatin E.SH. i cili kishte thënë *"punët janë në rregull tani"*.

294. XH.B. kishte thënë ditën e nesërme se E.SH. kishte shkuar te zyra e Prokurorit me i dëgjuar deklaratat e dhëna nga viktimat. Ai e kishte informuar atë se kishte biseduar me M.S. dhe se ai është duke e ndihmuar mjaft me çështjen e B.

295. XH.B. tha se M.S. i kishte thënë atij se ai do të ishte në Prishtinë me parë se çfarë po ndodhte sa i përket dhënies së dëshmimeve. Ai tha më vonë se avokati E.SH. e kishte thirrë atë me i thënë se punët kishin shkuar shumë keq në Prishtinë në lidhje me deklaratat. Ai deklaroi se kishte qenë në veturë me A.S. kur e kishte marrë këtë lajm. Ai tha se nuk i kishte treguar A. pasi që ai veç ishte mjaft i stresuar. Ai tha se kishte shkuar menjëherë te shtëpia e B.SH. ku ai dhe M. luanin shah. Ai tha se i kishte thënë atyre në lidhje me thirrjen nga avokati. Ai kishte thënë se M. kishte thënë se nuk ka koment tani, B. ishte nevrikosur dhe kishte thënë se H. i kishte tradhtuar. XH.B. tha se kishte qëndruar aty edhe për 10 minuta por ai pastaj ishte i stresuar dhe ishte larguar nga aty.

296. XH.B. tha se çështja e €1,500 ishte përmendur dhe M.S. kishte thënë se këto para ishin shpenzuar dhe për momentin nuk i kishte. Ai e miratoi përmbajtjen e një deklarate të mëhershme ku M.S. kishte thënë se paratë janë shpenzuar për *"rregullimin e gjërave por një tradhti i kishte prishur të gjitha"*. Ai tha se M.S. kishte thënë se diçka ka ndodhur me H. dhe E. (një oficer me një grade më të ulët në njësinë e M.).

297. XH.B. e tregoi bindjen e tij se ai e kishte përshtypjen se viktimat e dyshuara do të ndryshonin deklaratat e tyre deri në atë masë sa që B. do të lirohej 100% dhe H. është dashur me u siguruar që kjo të ndodh. XH.B. tha se pas kësaj bisede ai kishte shkuar në shtëpi dhe ai e dinte se paraburgimi i caktuar për B. do të vazhdohej. XH.B. tha se A.S. menjëherë e kishte larguar avokatin E.SH. nga pozita e tij dhe e kishte angazhuar R.G.
298. XH.B. tha se gjatë kësaj periudhe të burgosjes së B., pasuria e kompanisë “Luboteni” kishte filluar me rënë dukshëm. Ai tha se B.D. i kishte thënë atij se ai as që e njihje M.S. n, ndërsa M.S. dhe B.D. i kishin shkëmbyer veturat e tyre brenda katër apo pesë ditësh pasi që ishte vazhduar paraburgimi i B. edhe për dy muaj shtesë. XH.B. e deklaroi bindjen e tij se B.S. nuk kishte kryer asnjë vepër penale dhe arrestimi i tij dhe burgimi ishte bërë për të marrë para nga ai dhe me ndikuar në mënyrë të pafavorshme në pasurinë e kompanisë “Luboteni”. Ai tha se pagesat e tij vetëm për një muaj ishin afro €4,700 duke mos i përfshirë shpenzimet shtesë për benzinë dhe gjëra tjera.
299. XH.B. tha se pas një kohe të caktuar pasi që ishin dhënë paratë në formë të pagesave dhe shpenzimet tjera, ai kishte filluar me biseduar me shokët e tij dhe e kishte kuptuar se *“është duke u luajtur një lojë e madhe”*. Ai i kishte treguar dyshimet tij se pas kësaj qëndron miqësia në mes të M.S. dhe B.D.. Ai tha se e dinte se ata ishin miq me B.D. i cili ia kishte dhënë veturën M.S. Ai tha se nuk ishte i vetëdijshëm mbi rregullimet e kompanisë me bankat vendore por ai menjëherë e kishte kuptuar nga B. se vëllai i M.S. t punonte në bankë. Ai e tha bindjen e tij se B. ishte synuar për shkak të pasurisë së kompanisë. Ai tha se pas arrestimit të B. kompania kishte probleme me kompaninë e B.D.. Më herët ata kishin bashkëpunuar pro pas arrestimit të B.t, disa prej makinerive të “Luboteni” kishin mbetur me ata dhe B.D. nuk i kishte kthyer ato dhe ishte duke i përdorë këto pajisje. Ai tha se B.D. *“ishte kthyer kundër nesh dhe na ka përdorë neve”*.
300. XH.B. tha se pasi që ishte vazhduar paraburgimi i B.t, ai e kishte parë se nuk ka pasur përparim për pesë muaj dhe ai ishte ndjerë i mashtruar nga B.SH. dhe në veçanti nga M.S. . Ai kishte thënë bindjen e tij se njerëzit në Ferizaj i frikësoheshin M.S. dhe iknin sa herë që përmendej emri i tij.

301. XH.B. tha se në mes të muajt maj dhe nëntor 2012 kishte pasur kontakte të mëtejshme me K.S. me e zgjidhur këtë rast. Ai tha se kishte pranuar po ashtu thirrje tjera nga B.SH. Ai tha se kurrë nuk i kishte refuzuar ftesat e tij për me u takuar pasi që ata ishin në lidhje familjare.
302. XH.B. e kishte paraqitë dëshminë e tij më 31 mars 2015. Ai kishte deklaruar në gjykatë se vetëm Kemajli dhe A.kishin biseduar me avokatin R.G. përjashta dhe ata kishin biseduar me B.n dhe seanca nuk ishte zhvilluar fare dhe se B. ishte liruar. Ai tha se N. i kishte thënë atij se as B. e as ajo nuk ishin fajtor. Ai tha se ajo nuk e dinte se kush ishin policët të cilët e kishin arrestuar atë.
303. XH.B. tha se B. i kishte thënë atij për këshillën nga avokati i tij e cila ishte se ai do të lirohej po qe se deklarohej fajtor. XH.B. kishte thënë gjatë së njëjtës periudhë se ai kishte pasur një bisedë me një fqinj të quajtur M.S.i cili e kishte informuar atë se i kishte parë Nazifen, M.S. n dhe B.SH.n të ulur në një tavolinë *“Balkan Petrol”* para se me u liruar B.. XH.B. deklaroi se ai nuk e kishte njoftuar B.SH.n dhe M.S. n mbi lirimin e B.t pasi që pas përpjekjeve të tyre fillestare lirimi i B. kishte dështuar, ai nuk kishte pasur më kontakte me ata.
304. XH.B. deklaroi më vonë atë ditë se B.S. i kishte thënë atij se e kishte thirre M.S. atë me e parë shtëpinë të cilën ishte duke e lyer, *“dhe me e bërë një marrëveshje”*. Atij nuk iu kujtohej se kompania *“Luboteni ”* ka kryer ndonjë punë të lyerjes apo të ndërtimitarisë për M.S. n para asaj telefonate që i ishte bërë B. XH.B. tha se ai e kuptonte se ata ishin pajtuar me u takuar se me parë shtëpinë por B. ishte vonuar për shkak të dikujt i cili dëshironte me blerë veturë dhe më vonë ai e kishte pranuar një telefonatë nga policia e Prishtinës. Ai po ashtu deklaroi se B. e kishte thirre M.S. n dhe e kishte pyetur se përse po e kërkon atë policia dhe M. i kishte thënë atij se nuk dinte asgjë rreth kësaj pune por nëse ai nuk kishte bërë asgjë të keqe , ai do të duhej me i thirre ata përsëri.

305. XH.B. tha se kur B. e kishte telefonuar atë dhe i kishte thënë atij se K. ishte duke ardhur rrugës dhe se ata ishin rrugës duke u takuar me M.S. n në Ferizaj. Ata ishin takuar në një kafene në Ferizaj. B.SH. kishte qenë prezent po ashtu. XH.B. tha se në këtë takim M.S. përsëri kishte thënë se nëse B. nuk ka bërë asgjë të keqe, ai duhet të shkon në polici, por po qe se frikësohet ai duhet të shkon në zyre të tij dhe se ai do t'i bënte disa thirrje telefonike pasi që nëse nuk ka bërë asgjë keq atëherë askush nuk mund ta merr atë.
306. XH.B. tha se pastaj e kishte thirre B., i cili e kishte takuar atë dhe ata kishin shkuar në zyre të M.S. Ai tha se dy persona të cilët erdhën nga Prishtina, një burrë dhe një grua dhe ata e kishin pyetur B. disa pyetje se nëse njihje një grua serbe në Gjilan. Ai tha se M.S. përsëri i kishte thënë B.S. se nuk duhet të frikësohet nëse nuk bërë asgjë të keqe. Ai ka deklaruar se B. kishte thënë se nuk e njihje këtë grua. Menjëherë më pas B. ishte arrestuar. Avokati i tij, R.G. ishte thirre. Policia e kishte marrë B.S.n në Prishtinë.
307. XH.B. tha se kur B. kishte thënë se e njihje këtë grua, M.S. e kishte pyetur *“çfarë mund të bëjmë ne, pasi që ai ishte daja i babait të tij?”* Ai tha se ai, A., K. dhe S. kishin shkuar në Prishtinë. Ai tha se B. ishte dërguar në paraburgim dhe pas disa ditëve avokati kishte ardhur dhe i kishte thënë atyre se B. do të mbahej në paraburgim atë natë dhe se do të ketë seancë dëgjimore të nesërmen.
308. XH.B. tha se kur seanca ishte mbajtur, u pa se B. nuk ishte akuzuar për asgjë nga askush. Përveç kësaj, kjo grua serbe vetëm e njihje B.n si emër dhe ajo nuk dinte asgjë më shumë në lidhje me atë. Megjithatë, ai deklaroi se B. ishte vendos në paraburgim.
309. XH.B. tha se tre apo katër ditë më pas, K.S., M.S. dhe ai ishin takuar dhe kishin pirë kafe në barin *"Lamborghini"* në Ferizaj. Ai tha se M.S. i kishte thënë atij se nuk kishte pasur nevojë me thënë asgjë dhe se ai do të mundohet me i ndihmuar B.t .
310. XH.B. tha se brenda disa ditësh apo ashtu ngjashëm, ishte edhe një takim në *"Lamborghini"* në mes të atij, A.S. M.S. dhe B.SH. Ata kishin pirë kafe dhe përsëri M.S. kishte thënë se ai kujdesej për rastin. Ai nuk kishte thënë se çfarë bënte ai

veçanërisht por ai kishte thënë se dëshironte me ndihmuar për shkak të lidhjes familjare. Atij nuk iu kujtohej asgjë në lidhje me atë se çfarë ka thënë B.SH..

311. XH.B. tha se ai po ashtu ishte takuar me M.S. dhe B.SH. në një vend të quajtur "Freskia". Ai e kishte përsëritë pohimin e tij se dëshironin me ndihmuar dhe se rasti do të transferohej në Ferizaj. Ai tregoi se përpjekjet e tij në Prishtinë duket se kishin dështuar. XH.B. tha se as M.S. e as B.SH. nuk kanë kërkuar para në asnjërin prej këtyre takimeve në "Lamborghini" apo "Freskia".
312. XH.B. tha se aty kishte qenë një takim i rastësishëm në "Lamborghini" në gusht 2013 ku ai kishte qenë prezent me B.n dhe M.S. ju kishte afruar atyre dhe i kishte përshëndetë ata. Ai tha se M.S. kishte thënë se çdo gjë është në rregull se B. do të lirohet pasi që ai ishte i frikësuar se çfarë do të ndodh me atë.
313. XH.B. tha se M.S. kishte thënë se ai ishte munduar me i ndihmuar B. Ata i shkëmbyen numrat e telefonave. Ai tha se akuzat e B. ishin ende pezull dhe te pazgjidhura në atë kohë. Ai tha se ai ishte takuar me ata të dy rastësisht në gusht në "Balkan Petrol". Ai tha se ata kishin pasur një bisedë të zakonshme me M.S. n i cili pyeti nëse B. punonte.
314. XH.B. tha se ai nuk kishte pasur asnjë presion apo kërcënim, të cilat i ka konsideruar si të papërshtatshme në atë kohë. XH.B. tha se ai ndihej "pak jo rehat me u ballafaquar me B.n në këtë rast". Ai tha se policia i ka ofruar atij masa mbrojtëse por ai i kishte refuzuar. Ai e ka mohuar që e ka konsideruar B.SH.n si një rrezik për veten dhe familjen e tij. Ai e ka mohuar këtë pasi që B.SH., M.S. , B.V. dhe S.M. janë arrestuar në shtator 2013, ai ka pranuar mjaft telefonata të pakëndshme në kontekst të këtij rasti.
315. Pala e dëmtuar XH.B. është marrë në pyetje tërthorazi nga avokatët mbrojtës në shqyrtimin gjyqësor më 21 prill 2015.

316. Në përgjigje të pyetjes nga avokati mbrojtës i të pandehurit M.S. , avokati mbrojtës A.R., pala e dëmtuar XH.B. deklaroi se për arsye shëndetësore ai ishte vozitur për intervistë te prokurori nga B.S.. Ai tha se prokurori e ka pyetur atë në lidhje me gjendjen e tij shëndetësore dhe ai u përgjigj se nuk ishte mirë me bërë deklaratë. Ai tha se e pranonte ofertën e prokurorit të pushimeve të vazhdueshme, por ai nuk e kishte informuar atë se ai mund të jetë i pasaktë dhe kjo mund të shkaktonte probleme në shqyrtim gjyqësor. Ai tha po ashtu se ai e ka informuar prokurorin se do të jetë vështirë për atë *“me u paraqitë me njerëzit e mi para gjykatës”*. Ai tha se ai po ashtu se e ka informuar prokurorin se ai kishte qenë i sëmurë dhe kishte marrë medikamente.
317. A.R. i kishte thënë palës së dëmtuar XH.B. në seancën e shqyrtimit gjyqësor më 10 shkurt 2015 , ai tha se deklarata që ai e ka dhënë para prokurorit ishte 20 përqind e pasaktë. XH.B. nuk e ka konfirmuar këtë përqindje por e ka pranuar se ai mund ti ketë harruar disa gjëra në atë kohë për shkak të gjendjes së tij mjekësore. Ai tha se përmbajtja e deklaratës së tij ishte e vërtetë por mund t’i mungojnë disa gjëra.
318. A.R. i kishte thënë XH.B. se ai ka deklaruar se kur B.D. i kishte thënë atij me thirrë Dajkun, ai menjëherë e kishte thirrë B.H. dhe vetëm më vonë B.D. ia kishte shpjeguar se Dajku ishte B.SH.. Ai kishte pyetur nëse kjo pasaktësi ishte si rezultat i sëmundjes së tij apo atij thjesht nuk iu kujtohej. Ai tha se ishte B. i tij personal pasi që ai zakonisht iu drejtohej B.H. si D.
319. XH.B. konfirmoi se ai kishte pasur një marrëveshje me B.S. në lidhje me udhëheqjen e kompanisë *“Luboteni”* që nga viti 2001 por kjo kurrë nuk është zyrtarizuar. Ai tha se kurrë nuk e kishte paraqitur vetën si bashke-pronar të kompanisë *“Luboteni”* por më shumë si një dhëndër i familjes S. Ai tha se ka qenë një mik i ngushtë i B.S. edhe para se me u martuar me motrën e tij. Ai e gëzonte një marrëdhënie të qëndrueshme me atë.
320. XH.B. e kishte konfirmuar se e njihte SH.S.n dhe familjen e saj. Ai e njihte vëllain e saj G.F.. Ai tha se e dinte se ai e kishte vlarë një person dhe ishte arrestuar dhe

akuzuar nga M.S. . XH.B. tha se sa i përket kësaj ai ishte i vetëdijshëm se ai është kategorizuar si palë e dëmtuar që nga fillimi i procedurës penale.

321. XH.B. tha se kompania “*Luboteni*” i kishte zyrat kryesore në Shtërpce prej kohës kur ishin themeluar , por ai nuk e dinte se kur i ka lëshuar këto. Ai tha se përgjegjësia e tij ishte më shumë për makineri se sa për administratë. Ai tha se shumica e makinerive të kompanisë ishin të dorë së dytë. Ai tha se në veçanti ishte blerë një gërryese e asfaltit e dorës së dytë në Gjermani.
322. XH.B. tha se M.S. kishte ardhur tek posedimi i një veture Mercedes e cila më herët kishte qenë pronë e B.S. përmes një marrëveshjeje të këmbimit dhe po ashtu janë dhënë edhe ca para.
323. XH.B. konfirmoi se ai kishte marrë pjesë në ndejën për hir të dhjetë vjetorit të kompanisë “*Luboteni*” në Shtërpce. Ai tha se aty kishte pasur muzikë dhe vallëzim por se ai nuk i njihte valltaret. Në lidhje me takimin me Musën në “*Fitorja*” pas arrestimit të B., XH.B. tha se M. thjesht i kishte thënë atij dhe A. me shkuar në shtëpi dhe me pritë. Ai tha se ishte e mundshme që ai po ashtu i kishte thënë atyre që mos me fole me askënd për këtë punë.
324. XH.B. tha se qëllimi i takimit në mes të tij, A.S. dhe M.D. në “*Evropa 92*” në Kaçanik ishte për të pyetur nëse ai ishte i vetëdijshëm në lidhje me rastin e B.t, nëse ai do të mund të bënte diçka rreth kësaj. XH.B. Tha se ai ishte i mendimit se kjo ishte “*në lidhje me femrat*”. Ai tha se M.D. kishte propozuar një takim me A., në të cilën ai dhe A.edhe morën pjesë.
325. XH.B. e konfirmoi se ai e kishte kuptuar se M.D. ishte shok me M.S. n nga koha kur ishte bërë një marrëveshje në mes të tij dhe B.D. në lidhje me veturën e cila i takonte B.S.. XH.B. tha se nga momenti kur M.S. i kishte thënë atij se e njihte M., ai dyshonte se M.S. i kishte M.t për rastin e B.

326. XH.B. tha se ai nuk e kishte pyetur avokatin mbrojtës se përse ishte arrestuar B. në fillim pasi që familja kishin vizita të kufizuara me atë. Ai tha se ai dhe A.S. kishin shkuar në polici me marrë veturën e B. por ata nuk ishin takuar me B.SH. dhe M.S.
327. XH.B. tha se në vizitën e tij të dytë në stacion të policisë (tri ditë më vonë) M.S. dhe B.SH. ishin sjellë normal, madje edhe mirë. XH.B. tha se A.D. nuk është polic. Ai tha se M.D. i tha atyre se A.D. i njëhte femrat të cilat kishin paditë B.n, dhe ata shkuan me pyetur atë për arsyet e arrestit të B. Ai u pajtua se ai tashmë e dinte se përse B. ishte arrestuar por ai besonte se Afeti do t'i dinte pohimet specifike. Megjithatë, ai tha se Afeti i tha atyre se ato femra i kishin ndërruar numrat e tyre të telefonave shumë shpesh dhe ai nuk ishte në gjendje me biseduar me ato.
328. XH.B. tha se në atë kohë ai nuk ishte i vetëdijshëm për deklaratat e këtyre dyjave. Ai tha se nuk kishte biseduar me avokatin mbrojtës në lidhje me atë dhe nuk ishte i vetëdijshëm nëse ato po tregonin të vërtetën. Ai vetëm i dinte emrat e tyre dhe nuk kishte pasur asnjë informatë tjetër.
329. XH.B. tha se ai kishte pasur kryesisht komunikime me B.SH.n në 2012 dhe M.S. kurrë nuk e kishte thirrë atë. Megjithatë atij nuk iu kujtohej nëse e kishte thirrë M.S. n në qershor 2012.
330. Kur ishte pyetur nëse M.S. i kishte kërkuar personalisht paratë për të riparuar veturën e tij, pala e dëmtuar XH.B. deklaroi se ai nuk i kishte kërkuar vet, por pasi ishin dhënë paratë M.S. dhe B.SH. i kishin treguar atij se vetura ishte riparuar. Ai e konfirmoi se M.S. nuk ishte prezent kur €1,050 i ishin dhënë B.SH.t. Ai e kishte përsëritë pohimin e tij të mëhershëm se shuma prej €1,500 i ishte dhënë direkt M. në kuti të parfumit.
331. XH.B. tha se ai dhe A.S. është dashur me huazuar shumë para të cilat ia kishin dhënë B.SH. dhe M.S. t pasi që shumica e parave të tyre ishin të investuara dhe nuk kishin para të gatshme.

332. Në lidhje me rastet kur është informuar se M.S. kishte biseduar me B.K.n, ai tha se nuk ia kishte marrë telefonin me e konfirmuar këtë. Ai pohoi se nuk ishte pyetur më herët dhe se atij kurrë nuk iu kishte kujtuar me e thënë këtë gjatë një takimi kur M. i kishte treguar atij se në lidhje me këtë bisedën me B.K.
333. XH.B. e kishte përsëritë dëshminë e tij të mëhershme pasi që e kishte paguar shkollimin e B.SH.t në Universitetin AAB, ata ishin takuar me M.S. n në restorant kur M.S. e pa B.SH.n, ai ishte nevrkosur dhe kishte thënë *“ju nuk është dashur të vinit këtu”*.
334. XH.B. tha kur B.SH. i kishte kërkuar menjëherë €1,400 ai e kishte bërë këtë në bashkëpunim me M.S. n siç ishin pajtuar në takimin e kaluar. Ai tha kur paratë ishin dhënë, M.S. ishte në një ndërtesë aty afër 2-3 metra larg. Ai tha se nuk e kishte parë deri ditën e nesërme .
335. XH.B. e kishte përsëritë dëshminë e tij të mëhershme se në fund të qershorit 2012 kur paraburgimi i B.S. ishte vazhduar, ai e kuptoi se familja ishte mashtruar dhe ata kishin vendos mos me dhënë më para. Ai tha se nuk i kishte treguar avokatit mbrojtës se ai po i jepte para policisë.
336. XH.B. e tha B. e tij se B.SH. është kushëri dhe se nuk ishte puna e tij me ndihmuar me rastin e B., ndërsa kjo ishte puna e M. me ndihmuar. Në lidhje me njërin prej takimeve në restorantin *“Old Mill”* ai tha se ishte rregulluar duke biseduar me B.SH. por qëllimi takimit ishte me u takuar me atë dhe me M.S. n.
337. XH.B. tha se i kishte dhënë €500 M.S. pasi që transaksioni ishte bërë në një vend publik, kryesisht *“Euromiti”* dhe se ishte e nevojshme me i fshehur paratë. Ai pohoi se menjëherë më pas kishte biseduar me anëtarë të IPK-së dhe i kishte informuar ata për arrestimin e B. dhe arsyet e supozuara për këto arrestime.

338. Kur pala e dëmtuar, XH.B. ishte marrë në pyetje tërthorazi më 23 prill 2015, ai tha se nuk e kishte mbajtur një shënim se sa herë i kishte dhënë para M.S. apo B.SH.t.
339. XH.B. tha se ishte prezent në sallën e gjykimit kur B.S. ishte deklaruar se ishte fajtor. XH.B. tha se ai nuk e mbante në mend saktësisht se kush i kishte thënë familjes se përse B.S. ishte arrestuar por ai theksoi se familja e kishin kuptuar më vonë . Ai tha se nuk e dinte vet se përse ishte arrestuar ai dhe më vonë familja e kishin kuptuar përmes të tjerëve . Ai tha se sa i kujtohet atij, policia nuk e kishin kontrolluar shtëpinë e B. e aq më pak me e provokuar apo maltretuar familjen e tij gjatë cילו prej arrestimeve të tij.
340. XH.B. dëshmitari z. R.B. kishte shkuar vet në zyrën e prokurorit. Ai vet kishte shkuar por me një veturë veçmas. Ai tha se kur ata kishin arrite, R.B. kishte hyrë në zyrën e prokurorisë dhe pasi që e kishte përfunduar ai kishte dalë jashtë dhe ata kishin pirë kafe gjatë së cilës kohë E.SH. kishte dalë jashtë se ata ishin takuar me atë. Ai iu kishte thënë atyre se gjoja sikur viktimat ishin thirre nga Prokurori por ata nuk ishin paraqitë. R.B. i tha atij se ai nuk i pranonte pyetjet dhe përgjigjet por thjeshtë “*e kishte pranuar deklaratën time të lirë*”. Ai tha se nuk e dinte se atij nuk iu lejohet me i diskutuar këto çështje me një dëshmitar të rastit.
341. Në përgjigje të pyetjes nga kryetari i trupit gjykues , pala e dëmtuar XH.B. tha se kur ai kishte dhënë deklaratën para prokurorit ai kishte qenë keq dhe ka pasur zbrastësira në kujtesën e tij por ai u pajtua se këto lidheshin me disa hollësi dhe jo me faktet kryesore të rastit. Ai tha se ato nuk lidheshin me diçka “*diçka të rëndësisë së madhe*. Ai kishte deklaruar se atij nuk iu nevojitej kujdesi psikiatri apo psikologjik.
342. Dëshmitari A. S.e kishte filluar dëshminë e tij në shqyrtimin gjyqësor po ashtu në seancën e 23 prillit 2015.
343. Ai deklaroi se ishte marangoz me profesion dhe se kishte punuar për kompaninë “*Luboteni*”. Ai tregoi se ishte i martuar dhe i kishte katër fëmijë. Ai tha se e kishte

përfunduar shkollën e mesme më 1990. Kishte filluar të punonte për B.S. në 2009-2010. A. S.deklaroi se kishte dhënë deklarata të vërteta para policisë dhe prokurorisë.

344. Ali S.tha se ai nuk kishte pas asnjë të ardhur pasi që kompania nuk ishte më funksionale. Ai tha se para vitit 2012 kur ishte arrestuar B. kompania kishte qenë mjaft e suksesshme. Ai tha se kishte fituar €500 në muaj. Ai ishte punësuar si mbikëqyrës i punëtorëve në kompani për ndërtimin e rrugëve, kanalizim, asfaltim dhe biznes publik dhe privat të ndërtimtarisë.

345. A. S.tha se nuk e njohte B.H. Ai tha se njohte R.I. pasi që kishin jetuar në të njëjtin fshat dhe se ata kishin marrëdhënie të mira shoqërore. Ai tha se nuk e njohte H. B. apo M.S.. Ai tha se e njohte D.D. dhe B.D.. Ai tha se e njohte R.V.. Nuk e njohte A. I. por atij nuk iu kujtohej nëse e njohte R.S..

346. A. S. tha se ai e njohte R.B. pasi që ai ishte nga Brodi. Megjithatë, në lidhje me rastin e B. ai tha se nuk e njohte një person me emrin M.. Megjithatë në të njëjtin kontekst ai tha se nuk e njohte një person se si quhej dhe kishte raporte të mira me të. Ai tha se nuk e njohte L. apo A.D. A. S.tha se para majit 2013 ai nuk kishte dëgjuar për M.S., B.SH., V.T. dhe R.A.

347. A. S.tha se atij iu kujtohej koha kur ishte arrestuar B. në fund të vitit 2012. Ai besonte se arrestimi i tij i parë kishte qenë më 30 maj 2012, ai ishte liruar më 12 nëntor 2012 dhe arrestimi i dytë ishte bërë më 4 janar 2013. Ali S.tha se në fillim familja nuk e dinin arsyen se përse ishte arrestuar për herë të parë por e kishte kuptuar më vonë. Gjatë kohës kur e kishte deklaruar ai kishte qenë më shumë i brengosur në lidhje me punët e kompanisë.

348. A. S.e konfirmoi se ai edha një deklaratë para Policisë së Kosovës më 17 maj 2013. Ai e konfirmoi se aty kishte deklaruar se atij i kishte thënë vëllai i tij se “E. dhe M. e kanë arrestuar atë “. Ai tha se e njohte E. por jo edhe M.S.

349. A. S. tha se deri kur ishte arrestuar B., familja asnjëherë nuk kishin pasur raporte negative me policinë, prokurorinë apo gjykatën. Ai tha se arrestimi i B. e kishte një ndikim të keq në familje. Ai deklaroi se e ishte marrë përsipër punën e B. Tha se A.kishte pasur një rol por ai kryesisht ishte marrë me rastin e B. pas arrestimit të tij. Ai tha se K.S. dhe XH.B. po ashtu ishin “*duke vrapuar rreth rastit të B.*”.
350. A. S.u pajtua me përmbajtjen e deklaratës së tij më 17 maj 2013 kur K., XH. dhe A.ishin në kontakt me avokatët e tyre të rastit. Ai tha se kurdo që i kishte pyetur ata në lidhje me hollësitë e rastit, ata gjithmonë i kishin thënë B. do të lirohet sot ose nesër.
351. A.S.i kujtohet se në qershor 2012 ai e kishte pasur një telefonatë nga A.S. në lidhje me disa para. Ai tha se i nevojiteshin €1,500 po nuk mund t’i merrte këto para kështu që XH. dhe A.i kishin siguruar paratë nga dikush tjetër dhe më vonë i kishin marre €1,500 nga axha i tij, B. S.dhe nëse i japin paratë ai do të ia jepte atyre dhe pastaj ia kishin kthyer ato para. Ai tha se i kishte treguar atyre se paratë ishin për rastin e B.t dhe nëse i japin paratë ai do të lirohej. Ai tha se nuk i kishin treguar se për kënd ishin ato e as se ishin për ryshfet.
352. Megjithatë, kur i ishte treguar një deklaratë e mëhershme ai u pajtua se A.S. i kishte treguar atij se paratë ishin si ryshfet për lirimin e B. Ai nuk ishte i vetëdijshëm nëse para arrestimit të B. se a janë shoqëruar ndonjëri prej anëtarëve të familjes me të pandehurit apo nëse i kishin pasur borxh para apo mallra atyre. Ai tha se nuk e dinte por se nuk besonte se aty kishte ndonjë ndjenjë të keqe në mes tyre.
353. A. S.tha se A.S. dhe XH.B. i kishin mbledhë paratë për pagesën e avokatit të B. Ai tha se atij nuk i kishin treguar hollësitë e sakta apo për pagesat që i ishin bërë B.SH. dhe/apo M.S. por sigurisht që A.S. dhe XH.B. do ta dinin ma mirë se kujt ia kishin dhënë paratë. Atij nuk iu kujtohej nëse i kishin thënë për ndonjë pagesë që ishte bërë për një aksident automobilistik.

354. Në përgjigje të pyetjeve nga avokati mbrojtës për të pandehurin, M.S. avokati, A.R., A. S.deklaroi se ai nuk e kishte regjistruar punësimin e tij në kompaninë “Luboteni” pasi që B.S. ishte marrë me të gjitha çështjet administrative . Ai nuk e dinte nëse ndonjëra prej kompanive të rajon kishte falimentuar në vitet 2012 dhe/apo 2013. Ali S.tha se besonte se B. ishte arrestuar me urdhër të M. dhe gjithashtu me Enverin dhe se ata ishin në detyrë pasi që ata nuk mund të kryenin asnjë arrestim privatisht.
355. Dëshmitari **M. S.**e kishte filluar dëshminë e tij para trupit gjykues më 27 prill 2015. Ai deklaroi se i kishte 17 vjet. Ai tha se e kuptonte dallimin në mes të vërtetës dhe gënjeshtërs.
356. M. S.deklaroi se B.S. ishte babai i tij, K.S. ishte axha i tij sikurse A.S., ndërsa XH.B. është dhëndri i babait të tij. B. S.është gjyshi i tij. Ai pohoi se S.S. është kushëri i tij.
357. M.S.tha se qëndronte pas deklaratës së tij të mëhershme të dhëna para policisë dhe prokurorisë. Ai tha se në vitet 2012-2013 ai nuk punonte dhe përkrahej financiarisht nga babai i tij i cili ka punuar në kompaninë “Luboteni” në Shtërpcë. Ai tha se kishte raporte të afërta me babanë e tij . Megjithatë, ai po ashtu pohoi se nga viti 2012 deri tani ai ka qenë në kontakte të shpeshta me gjyshin e tij dhe me axhët.
358. M. S.tha se ai nuk e njohte B.H., R.Y.apo H.B.. Megjithatë, ai e njohte M.S. pasi që kishte punuar në kompaninë “Luboteni”. Ai deklaroi se e njohte D.D. pasi që edhe ai kishte punuar në kompani. Ai pohoi se e njohte R.B. si shok të kushëririt të tij S. dhe ai e përshkroi atë. M. S.tha se nuk e njohte A.I. por ai e njohte R.I., B.D. dhe R.B.
359. M. S. deklaroi se e njohte M.S. dhe B.SH. Ai tha se e njohte R.A. dhe V.T. por vetëm emrat e tyre dhe nga salla e gjykimit. Ai tha se kurrë nuk ishte shoqëruar me asnjërin prej këtyre personave e as nuk kishte lidhje familjare me këta.
360. M. S.tha se atij iu kujtohej kur është arrestuar babai i tij më 2012. Ai pohoi se ishte 30 maji dhe ai i kishte 14 vjet në atë kohë. Ai tha se kjo e bënte atë që të ndihej

“shumë keq”. M. S. tha se në 2012 dhe 2013 ai e kishte pasur një iPhone 4. Ai e kishte ndryshuar numrin e tij më 2014. M. S. tha se kishte ndihmuar me punë në kompaninë “Luboteni” duke i përgatitur dokumentet për tender dhe i kishte kryer disa punë tjera të nëpunësit. Ai tha se para arrestimit të babait të tij, kompania kishte pasur punë dhe ishte e njohur në Ferizaj dhe në komunën e Shtërpçës.

361. M. S. deklaroi se “*problemet*” kishin filluar vetëm pas arrestimit të babait të tij. Ai pohoi se axhët e tij po bisedonin rreth kësaj. Ai tha se ata nuk ishin duke punuar në atë kohë. M. S. pohoi se ai kishte mësuar rreth arrestit të babait të tij nga axha A., por ai nuk e kishte gjete arsyen e këtij arresti vetëm pas tre apo katër ditësh. Ai tha se para atij arresti, askush në familjen e tij nuk e dinte apo nuk ishte i ndërlidhur me M.S. n apo B.SH., R.A. apo V.T. e as nuk i kishin borxh favore asnjërit prej tyre e as anasjelltas.
362. M. S. tha se ai nuk kishte bërë asgjë apo nuk kishte mbajtur asnjë takim apo nuk ishte munduar me u takuar me dikën i cili do ta ndihmonte babanë e tij. Ai tha se pas arrestimit të tij fillestar, babai i tij ishte liruar me 27 dhjetor 2012 por pasi që i ishte paraqitë deklarata e tij më 16 tetor 2013, ai u pajtua se kishte qenë në fakt në nëntor 2012. M. S. tha se aty kishte pasur një ndejë të madhe mirëseardhjeje në shtëpinë e tyre familjare në Brod. Ai pohoi se A. dhe K.S. dhe XH.B. kishin qenë aty prezent, po ashtu edhe familja e tij e ngushtë dhe gjyshi. A. dhe S.S. ishin po ashtu prezent.
363. M. S. tha se pasi që kishte kaluar një kohë pas lirimit të babait të tij, dy policë kishin ardhur në shtëpinë e tij. Ai tha se ata kishin ardhur “*gjoja sikur me kërkuar falje*” pasi që e kishin arrestuar babanë e tij. Ai tha se si ishte prezent. Ai e kishte identifikuar M.S. dhe B.SH. në gjykatë dhe dy policë. Ai tha se gjyshi i tij dhe Kemajli ishin po ashtu prezent. Ai tha se dy policët kishin ardhur me XH.B.. Ai tha se kishte shkuar në mesnatë por dy policët ishin ende aty.
364. Kur i ishte paraqitë deklarata e tij para IPK-së më 16 tetor 2013, dëshmitari M.S. u pajtua se B.SH. kishte biseduar më shumë se M.S. por M. i kishte kërkuar falje gjyshit të tij dhe kishte deklaruar se nuk ishte i vetëdijshëm se ai ishte daja i tij. Ai tha se aty

kishin qenë prezent edhe B.SH., M.S. , babai i tij , gjyshi i tij dhe XH.B.. Nëna e tij dhe motra A. e shërbenin ushqimin. Ai tregoi se e kishte përshtypjen se që nga ajo natë M.S. dhe B.SH. kishin pasur një lidhje me rastin e babait të tij. M.S.tha se në këtë takim B.SH. ia kishte dhënë €5 njërit prej fëmijëve në shtëpi. M.S.e përfundoi dhënien e dëshmisë së tij duke deklaruar se aty kishte pasur një ndjenjë të keqe në familjen S.në lidhje me arrestimin e babait të tij.

365. Në përgjigje të pyetjeve nga avokati mbrojtës për të pandehurin, M.S. avokati A.R., M.S.tha se XH.B. i ka sjellë M.S. n dhe B.SH.n në shtëpinë e tij. Ai tha se po ashtu edhe familja i kishte pritur mirë ata.

366. Dëshmitari S.S. filloi me e dhënë dëshminë e tij para trupit gjykues gjatë shqyrtimit gjyqësor në seancën e 28 prillit 2015 dhe kishte vazhduar me 29 prill 2015. Ai i kishte dhënë deklaratat para IPK-së dhe para prokurorit.

367. Ai pohoi se pala e dëmtuar B.S., K.S. dhe A.S. ishin kushërinjtë e tij. Ai tha se kishte punuar me kompaninë "Luboteni"si kryepunëtor nga vitit 2008 deri më 2012derisa puna ishte përkeqësuar.

368. Ai tha se e njihte B.H. si pronar të "Balkan Petrol". Ai pohoi se e njihte R.I. pasi që ai vjen nga fshati i tij nga Brodi dhe ai kishte raporte të mira me atë. Ai tha se tani nuk kishte raporte me B.H. dhe se tani ishte vetëm një njeri njohur. Ai e tregoi bindjen e tij se XH.B. ishte disi i lidhur me B.H. Ai tha se nuk e njihte H.B.apo M.S. por ai e njihte A.S. e cila ishte vajza e B.S.. Ai tha se e njihte D.D. pasi që ai kishte punuar shkurtimisht për kompaninë "Luboteni". Ai tha se e njihte R.V. pasi që ai kishte punuar me atë në Zvicër dhe i kishte raportet e mira me të.

369. S.S. pohoi se ai nuk e njihte A.B. por ai nuk e njihte R.S. që nga viti 1997. Ai tha se e njihte B.D. dhe se ai ishte pronari i kompanisë B. e cila ishte kompani rivale por edhe si një kompani me të cilën bashkëpunonte ndonjëherë Luboteni. S.S. tha se e njihte R.B. nga Brodi dhe se ai kishte punuar në zyrën komunale të Shtërpces. S.S. tha se ai

nuk e njihje asnjërin prej të pandehurve përveç V.T., të cilin e njihja prej 15 vitesh më herët, pasi që ai kishte qenë në shkollën fillore me atë. S.S. tha se ai i kishte dy numra të telefonit në 2012 dhe 2013. Ai tha se njëri ishte për punë e tjetri ishte numri i tij privat por të dy numrat ishin të njohur publikisht dhe të gjithë i dinin.

370. S.S. deklaroi se B.S. ka qenë pronari i kompanisë “Luboteni” dhe “*personi kryesor në kompani*”. S.S. deklaroi, para arrestimit të B.S., kompania “Luboteni” ka pasur një reputacion të lartë pa probleme, në veçanti në komunë të Shtërpcës dhe gjatë sezonës së verës , aty kanë qenë 65 deri në 70 punëtorë duke punuar në kompani. Ai deklaroi se e njihje B.S., se kishte marrë hua nga bankat private, banka ProCredit dhe ndoshta edhe Banka Ekonomike. Ai tha se në fillim të vitit 2012 kompania ka qenë në “*gjendje të mirë financiare*”. Ai ka deklaruar se ka qenë mjaft i afërt me dajën Sylejmanin në këtë kohë ishte i njoftuar me llogaritë e kompanisë . Ai u pajtua se pasuria e familjes ishte e njohur në atë pjesë.

371. S.S. deklaroi se që nga ajo kohë gjendja e tij financiare ishte përkeqësuar dhe kjo i kishte ndodhur duke u falënderuar “*personave zyrtarë, të cilët e kishin keq informuar dhe i kishin fabrikuar të dhënat e caktuara*” që po ashtu kanë ndikuar në familjen S. Ai deklaroi se njëri prej këtyre personave ishte i pandehuri, M.S. .

372. S.S. deklaroi se një ditë në maj të vitit 2013 ai ishte kthyer nga dorëzimi i një dokumenti të tenderit në Podujevë dhe kishte shkuar drejt e në punë, por kishte vërejtur se punëtorët nuk ishin në disponim të mirë. Ai deklaroi se ishte takuar me A., vëllain e B.t, dhe se ai i kishte treguar lajmin për arrestimin e B.t. Ai deklaroi se vëllezërit e B. A.dhe K. e kishin konfirmuar lajmin, por se nuk e dinin se për çfarë veprë(ash) bëhej fjalë. Ai u pajtua se arrestimi kishte ndodhur një ditë më parë.

373. S.S. deklaroi se ditën e nesërme në zyrat e kompanisë, K.S. i kishte thënë atij se avokati që e kishte shoqëruar B. në polici, kishte deklaruar se ai ishte arrestuar për shkak të deklaratës së dy dëshmitareve, por se ai nuk dinte të thoshte se kush ishin. Ai deklaroi

se më pastaj ishte takuar me A.S. XH. B. dhe K.S. në kafenenë “Popi”. Ai deklaroi se A.S. kishte marrë një thirrje nga Bashkim dhe B.D. që ishin në dijeni të arrestimit të B.t.

374. S.S. deklaroi se B. dhe B.D. kishte arritur në kafene dhe e kishin informuar grupin se dy dëshmitaret quheshin N.H. dhe L.P.. Ai deklaroi se B. dhe B. kishin sugjeruar që ata ta thërrisnin M.D. sepse ai i njihnte zyrtarët policorë në Ferizaj. Ai deklaroi se B. ose B.D. e kishin thirrur M. dhe e kishin aranzhuar një takim në restorant “Europa 92”. Ai deklaroi se ai kishte shkuar atje me A., K., B.n dhe B. kishte ardhur. Ai deklaroi se M.D. kishte ardhur më vonë. Megjithatë, ai deklaroi se nuk ishte e qartë nëse M.D. ishte në dijeni të arrestimit të B.S.. Ai deklaroi se M.D. e kishte parë personin me emrin A.D. që ishte ulur në tavolinën afër dhe kishte folur me të lidhur me rastin sepse ai kishte thënë se kishte marrëdhënie të mira me N.H., dhe ai e kishte pyetur atë nëse ai mund ta thërriste atë dhe ta pyeste se çfarë kishte thënë ajo në deklaratën e saj.

375. S.S. u pajtua me përmbajtjen e një deklarate të mëhershme në kuptimin që B.D. kishte deklaruar se M.D. i njihnte M.S. dhe B.SH.n dhe se kishte marrëdhënie miqësore, por M.D. kishte deklaruar se ky rast ishte “një rast i rrezikshëm” dhe se ai nuk mund të përfshihej.

376. S.S. deklaroi se ai, XH.B. dhe A.S. e kishin aranzhuar të takoheshin me A.D. në Ferizaj në një kazino, ku ai kishte bërë përpjekje t’i telefononte njëres nga vajzat, por se nuk kishte pasur sukses. Ai po ashtu ishte përpjekur të vihej në kontakt përmes një mikeshe të përbashkët, por edhe kjo kishte dështuar.

377. S.S. deklaroi se një person me emrin L. po ashtu ishte i pranishëm në kazino dhe A.D. i kishte thënë grupit të tij se ai ishte nga Kaçaniku i vjetër dhe ai tha se mund t’i njihnte zyrtarët policorë dhe se ai po ashtu mund t’i njihnte edhe dy ankueset femra. S.S. deklaroi se L. ishte ai, i cili e kishte përmendur shefin e Njësisë kundër Trafikimit me Njerëz në Policinë e Kosovës në Ferizaj se ai ishte M.S. dhe se ai kishte deklaruar se gëzonte marrëdhënie të mira me të dhe se do të përpiqej të kontaktonte me të për të parë se cili është problemi dhe se “si mund të ndihmojmë ne”.

378. S.S. deklaroi se ditën tjetër ai e kishte parë M.S. n në kafenenë “*Lamborghini*” shumë shkurt, por se ata nuk kishin folur pasi që ai ishte në një tavolinë tjetër. S.S. deklaroi se grupi i tij kishte folur me “*L.n*” prej mesnatës e deri në 2-3 të mëngjesit. Ai deklaroi se gjatë kësaj kohe, L. kishte folur me dikë me emrin D. të cilin ai e kishte pyetur për M.S. n. Ai deklaroi se ai nuk e dinte se si L. e njihte D. ose se si ai e njihte M.S.
379. S.S. e vazhdoi dëshminë e tij më 13 maj 2015. Ai deklaroi se ai nuk ndihej rehat në praninë e L.t, pasi që në të vërtetë nuk e njihte atë. Megjithatë, ai ishte i përgatitur të fliste me të nëse kjo do ta lehtësonte kontaktin me M.S. Ai deklaroi se me sa duket L. kishte aranzhuar një takim me M.S. n që do të zhvillohej të nesërmen e ditës kur B. ishte dërguar në Gjykatën e Qarkut.
380. S.S. deklaroi se të nesërmen, kur B.S. duhej të dërgohej në Gjykatën e Qarkut, ai dhe A.S. e kishin marrë L.n dhe kishin shkuar në Ferizaj. Ai deklaroi se L. kishte dashur ta merrte në këtë takim edhe një person me emrin D. Ai deklaroi se A.S. e kishte numrin e L.t. S.S. ceku se njëra nga arsyet pse grupi kishte ndenjur vonë në kafenenë “*International*” ishte se kishte gjasa që ankueset mund të ishin të pranishme atje për muzikë.
381. S.S. deklaroi se personi me emrin D. ishte i pranishëm kur grupi i tij kishte arritur në kafe. Ai nuk e njihte atë. Ai deklaroi se D. kishte thënë se M.S. nuk do të ishte atje atë natë, por se do të ishte e mundur që ai të takohej me të të nesërmen në orën tetë në Ferizaj, ku do të trajtohej gjendja e vështirë e B. Ai u pajtua se L. i kishte thënë se D. ishte mik i ngushtë i M.
382. S.S. deklaroi se familja donte ta dinte arsyen e arrestimit të B.S. dhe të siguronte qasje te M.S. (i cili e kishte arrestuar atë) se kjo ishte “*rruga e parë për të ardhur deri te informatat*”. Ai deklaroi se qëllimi i tyre ishte që po ashtu të “*të merrnin njëfarë lloj ndihme*”. Ai deklaronte se ai e njihte prokurorin dhe se gjykata do të mbështetej në

informatat nga policia. Ai e deklaronte B. e tij se M.S. dhe/ose B.SH. do të mund të ndihmonin në lirimin e B.S.. Ai deklaroi se avokati T.G. ia kishte treguar atij deklaratat e ankueses dhe se ato ishin shumë të dobëta. S.S. deklaroi se ai e dinte se çfarë gradash mbanin M.S. dhe B.SH., se ato ishin grada të larta dhe familja e konsideronte këtë të rëndësishme në lidhje me ndihmën ndaj B.t.

383. S.S. deklaroi se të nesërmen në mëngjes, ai, XH.B., A.S. dhe L. duhej të takoheshin me D.. Megjithatë, ata nuk mund ta gjenin D., ashtu që L. i kishte telefonuar M.S. drejtpërdrejt me telefon. Ata e kishin aranzhuar që të takoheshin në kafenenë "Lamborghini", që më parë ka qenë pompë e benzinës dhe piceri. Ai deklaroi se M.S. kishte arritur dhe kishte çuar L.n me veturë deri te stacioni i policisë. Kur ai ishte kthyer, ai kishte pasur një bisedë në një tavolinë të veçantë me L. Kur kjo përfundoi, L. e informoi grupin se situata ishte mjaft serioze, por se M.S. e kishte siguruar atë se ai do t'i ndihmonte B. dhe se ai kishte shumë prova të cilat nuk i kishte dërguar te prokurori. Ai kishte thënë "mos u brengos çdo gjë do të rregullohet". Ai deklaroi se L. e çoi M.n prapë te stacioni i policisë në veturën e tyre.

384. S.S., ishte ndjerë jo rehat në atë kohë. Ai deklaroi se në njërën anë M.S. ishte i përfshirë në konstruktimin e rasteve, e në anën tjetër ai po përpiqej të ofronte ndihmë. Ai deklaroi se nuk e njihte M.S. n në atë kohë, por më vonë kishte mësuar se ai ishte një person me ndikim në polici.

385. Ai tha se më pastaj grupi shkoi me veturë në Prishtinë për seancën mbi paraburgimin e B.S. në Gjykatën Themelore. Në veturë, L. kishte deklaruar se M. kishte thënë se ai i ka mbajtur disa prova nga prokurori dhe kjo ishte e rëndësishme sepse veprat e supozuara ishin të rënda. Ai deklaroi se ai ishte shokuar kur e kishte dëgjuar këtë.

386. S.S. deklaroi se ai mendonte se M. do t'i ndihmonte B.S. sepse e njihte atë përmes L.t dhe si shokun e një shoku. Ai deklaroi se B. nuk e njihte L.n, por se ai kishte thënë se "ne duhet t'ia japim ndonjë shpërblim ose dhuratë" dhe se, "M. do t'i ndihmojë B.t".

387. S.S. deklaroi se në Prishtinë avokat ishte T.G.. Ai deklaroi se gjyqtari nuk e kishte shpallur vendimin deri në orën 15:00. B. ishte dërguar në paraburgim për 30 ditë. Ai deklaroi se ai ishte informuar për vendimin nga një zyrtar policor i Policisë së Kosovës, E.A., të cilin ai e njohte si fqinj. Ai deklaroi se nuk i ishte afruar atij më parë për ndihmë sepse ai ishte vetëm me gradë të ulët. Megjithatë, ai po ashtu e deklaronte B.n e tij se ky zyrtar ishte *“pjesë e këtij krimi”*.
388. S.S. deklaroi se pas seancës gjyqësore në Prishtinë, ai, A. Dhe K.S., XH.B. dhe L. e kishin aranzhuar për t’u takuar te *“Balkan Petrol”*. Ai deklaroi se ai e dinte se emri i pronarit ishte B. dhe se po ta shihte do ta njohte. Kur ata arritën, L. tashmë ishte atje i ulur në një tavolinë së bashku me M.S. dhe B.SH.n dhe se ata ishin duke ngrënë drekë.
389. Ai deklaroi se ai dhe K.S. nuk i ishin bashkuar këtij grupi. Ai deklaroi se më pas ai kishte marrë një mesazh nga B.SH. përmes XH. ku i kërkohej atij *“që të rrinte larg nga ky rast, unë do të rri larg nga ky rast dhe nuk do të përfshihem se përndryshe do të jetë keq edhe për mua”*.
390. S.S. deklaroi se pasi e kryen drekën, këta zyrtare u ngritën dhe u larguan dhe i thanë kamarierit se ata nuk do të paguanin për këtë drekë sepse i kishin thënë A. dhe XH. se *“B. do të lirohet shumë shpejt dhe se ai do të paguajë për këtë”*. Ata nuk kishin paguar. Ai deklaroi se ai nuk e kuptonte këtë. Ai deklaroi se zyrtarët policorë i kishin thënë A.S.t dhe XH.B. se B.S. do të lirohej së shpejti. Ai deklaroi se pas kësaj edhe L. u largua dhe shkoi në shtëpi. Ai deklaroi se XH.B. i kishte thënë atij se që nga ajo kohë e më tutje, se çdo problem duhet ta trajtonte drejtpërdrejt me M.S. n dhe të mos përdorë më ndërmjetës. Ai e deklaroi B.n e tij se kjo ishte për shkak të faktit se XH.B. kishte marrëdhënie familjare me B.SH.n.
391. S.S. deklaronte se që nga fillimi, në rast se ndonjë shpërblim ose paratë bëheshin problem, ai ishte në favor të kësaj dhe donte ta dinte shifrën ose çfarë lloj shpërblimi. Ai deklaroi se A.S. nuk kishte problem as me atë çështje. Ai e deklaroi B. e tij se paratë do të jepeshin në këmbim të lirit të B.S..

392. S.S. deklaroi se kur po afrohej data e skadimit të masës së paraburgimit, atëherë filluan diskutimet në lidhje me paratë. Ai ka deklaruar në mënyrë specifike se, A.S. dhe XH.B. kishin kërkuar €1,500. Ai deklaroi se ata e informuan atë se M.S. dhe B.SH. po i kërkonin paratë për ndërrimin e prokurorit, ashtu që një prokuror tjetër nga Ferizaj do ta merrte përsipër rastin. Se gjoja ata e njihnin atë dhe se ai do ta hiqte masën e paraburgimit. Ai deklaroi se i kishte dhënë këto para. Ai i kishte disa prej tyre dhe se pjesën tjetër i kishte marrë hua. Ai deklaroi se mbase A.S. dhe XH.B. po takoheshin me M.S. dhe B.SH.n çdo ditë.
393. S.S. deklaroi se rreth kësaj kohe edhe ai kishte takime të rregullta me F. H. i cili ishte një mik dhe fqinj dhe i cili i kishte inkurajuar ata që të paguanin ryshfet për lirimin e B.t, pasi që, në bazë të përvojës së tij, kjo ishte gjëja e vetme që funksiononte në Kosovë. Ai e deklaroi B. e tij se F.H.i njihnte M.S. dhe B.SH., por se nuk kishte asnjë lidhje me ta.
394. S.S. deklaroi se, gjersa familja po prisnin para Gjykatës së Qarkut, ishte paraqitur dëshmitarja N.H., iu ishte afruar atyre dhe kishte thënë, *‘Unë do ta tregoj të vërtetën para gjykatës sepse mua personalisht më kanë përcjellë dhe kërcënuar që ta jap atë deklaratë para hetuesve policorë edhe pse e njoh B.n dhe më vjen shumë keq dhe se fjalët që ata kanë thënë nuk qëndrojnë aspak’*. Ai deklaroi se ajo kishte thënë *‘Jam e sigurt se do ta them vetëm të vërtetën’*.
395. Megjithatë, S.S. deklaroi se kur avokati i B. pastaj ishte përfshirë, kishte pasur, *“njëfarë lloj trazimi”* dhe se avokati kishte këmbëngulur që B. ta pranonte fajësinë sepse nga 1 janari 2013 do të hynte në fuqi ligji i ri dhe rasti do të transferohej në Ferizaj dhe B. do të mund të vuante në arrest shtëpiak për një kohë të gjatë. S.S. deklaroi se ai nuk do ta pranonte këtë pasi që B. nuk kishte kryer asnjë vepër penale. Ai tha se avokati shkoi me Arbenin dhe Kemajlin dhe folën me B. dhe e bindën B.n që ta pranonte fajësinë. Ai deklaroi se B. e kishte bërë këtë sepse nëse do të lirohej nga burgu, ai do të kishte mundësi ta raportonte këtë rast tek autoritetet. Ai deklaroi se trupi gjykues e kishte

pranuar deklarin e tij mbi pranimin e fajësisë pa dëgjuar asnjë dëshmitar dhe e kishte dënuar atë.

396. S.S. deklaroi se N.H. i kishte thënë Policisë së Kosovës, kryesisht M.S. B.SH. por edhe E.A. se e kishin marrë një deklaratë të rrejshme nga ajo dhe se gabimisht e kishin akuzuar B.S.n me qëllim që ta shkatërronin B.S. me të gjitha mjetet. Ai deklaroi se ata e kishin bërë këtë për shkak se ata e dinin se N.H. dhe L.P. mund të manipuloheshin lehtë. Policia i njihte ata nga baret që ato frekuentonin. Ai deklaroi se N.H. kishte deklaruar se B.S. ishte njeri i mirë dhe se ajo nuk kishte asgjë kundër tij.

397. S.S. deklaroi se gjykata e kishte dënuar B.S. me dy vjet e tre muaj burgim, ose dy vjet e gjashtë muaj, se edhe koha që ai e kishte kaluar në burg i ishte llogaritur si pjesë e dënimit dhe gjykata kishte vendosur ta lironte atë përkohësisht deri sa verdikti të merrte formë të prerë.

398. S.S. deklaroi se kur ai kishte vizituar B. të nesërmen në mëngjes, ai e kishte këshilluar atë që ta paraqiste rastin dhe të mos kontaktonte më me M.S. dhe B.SH.n. Megjithatë, ai deklaroi se B. nuk e kishte marrë këshillën e tij dhe në vend të kësaj dhe përmes XH.B., ai kishte organizuar një takim me M.S. dhe B.SH.n dhe ata kishin ngrënë darkë në një restorant në Ferizaj.

399. S.S. deklaroi se më pas B. i kishte thënë atij se ky takim kishte ndodhur dhe se M.S. dhe B.SH. kishin kërkuar falje dhe kishin thënë se nuk e njihnin B. shumë mirë, por të mos brengoseshin se ata do të punonin në këtë, do t'i bindnin dëshmitaret dhe rasti do të hiqej dhe B. do të lirohej pa kusht. Ai tha se ata donin të shkonin te shtëpia e familjes S.dhe t'i kërkonin falje babait të B. Ai deklaronte se ishte i befasuar me gjithë këtë dhe se ai e kishte paralajmëruar B. se nëse ai do të vazhdonte t'u shkonte atyre sipas qejfit, ai nuk do ta ndihmonte më atë dhe se ai nuk donte të përfshihej në këtë. Ai i kishte thënë, *“bëj çka të duash, por të garantoj se do të shkosh në burg prapë”*. Ai deklaroi se një javë ose dhjetë ditë pas lirimit të B., M. dhe B. shkuan te shtëpia e babait të B. për darkë dhe ai nuk e kishte fare idenë për këtë. Ai kishte mbërri te shtëpia e tyre dhe e kishte parë një

veturë të çuditshme për të cilën e kishte informuar vajza e B., se vetura u përkiste M. dhe B. dhe në atë moment ai ishte larguar. S.S. deklaroi se ai më pas kishte mësuar nga B. se ata kishin kërkuar falje dhe ai i kishte thënë B. se ai ishte sikurse një fëmijë që ishte mashtruar me një karamele.

400. S.S. ishte pajtuar me përmbajtjen e deklaratës së tij të mëparshme para prokurorit në kuptimin se B.SH. dhe M.S. ishin takuar me A. dhe XH. edhe një dhjetë herë më shumë, por jo sepse nuk i besonin atij.

401. S.S. deklaroi se ai nuk kishte marrëdhënie shumë të mira me XH.B.n dhe ai tha se ai është njëloj personi që nuk e di se ku e ka kryet. Ai e deklaroi B.n e tij se asnjëri prej anëtarëve të familjes S.nuk i besonte M.S. dhe B.SH, por XH.B. ishte më optimisti në këtë aspekt dhe ai e kishte bindur Arbenin. Ai e deklaroi B. e tij se të gjithë ata besonin se “rasti” kundër B.S. ishte një fabrikim. Ai e deklaroi B.e tij se A.dhe XH. kishin frikë nga M. dhe B., por se ai nuk kishte. Ai deklaroi se familja e B.t kishin frikë nga M.S. dhe B.SH.. Ai deklaroi se gruaja e B.t e kishte informuar se djali i saj për shkak të frikës e kishte ndërprerë vijimin e kursit të gjuhës angleze në Ferizaj.

402. Në përgjigje të pyetjeve nga avokati i të pandehurit M.S. , avokati A.R., S.S. deklaroi se para arrestimit të B.t kompania kishte qenë fitimprurëse dhe se të gjitha faturat ishin paguar. Ai deklaroi se nuk ishte kontabilisti i kompanisë, por ai ishte në kontakt të përditshëm me B. dhe ishte shumë në dijeni të gjendjes financiare.

403. S.S. rrëfeu për incidentin kur ai ishte në Ferizaj dhe ngiste një veturë VW Golf 5 të regjistruar në emër të kompanisë "Luboteni" dhe policia e kishte ndaluar atë. Ai i kishte kërkuar patentë shoferin dhe dokumentin e regjistrimit të veturës. Kur ata e panë se ishte e regjistruar në emër të kompanisë "Luboteni", një zyrtar tha, “Kjo i përket Shefit i cili ka shitur femra”. Ai deklaroi se kishte reaguar duke thënë “A jeni i sigurt z. Zyrtar policor se ai ka shitur femra?” atëherë zyrtari u përgjigj, “Krejt policia e di se ai ka shitur femra”. Ai e dinte se kjo nuk ishte e vërtetë, kështu që ai iu drejtua zyrtarit policor duke thënë “Shumë shpejt do të vijë koha kur pafajësia e B.t do të vërtetohet dhe njerëz të

tjerë do të shkojnë në burg". Ai deklaroi se kjo ia konfirmonte atij ndikimin e M.S. në radhët e policisë në Ferizaj. S.S. deklaroi se arsyeja se pse familja dëshironte të fliste me M.D., L. D. dhe B.D. ishte se ata donin të dinin se për çfarë ishte e tërë kjo, se pse po akuzohej B..

404. S.S. deklaroi se ai i kishte lexuar deklaratat e N.H. dhe L.P. dhe se ato ishin në kundërshtim me njëra-tjetrën. Ai deklaroi se ato kishin thënë se e njihnin B. përmes R.B. Atij i kujtohet se ato e kishin pranuar se kishin qenë në një ndejë për të festuar dhjetë vjetorin e kompanisë "*Luboteni*", ishin cekur marrëdhëniet seksuale "*normale*" me B.S. por asnjëra femër nuk kishte punuar ndonjëherë për kompaninë "*Luboteni*".

405. S.S. shpjegoi se në fillim të vitit 2012 kompania "*Luboteni*" kishte filluar me shumë sukses. Kishte bërë investime të mëdha. Kishte plan që të hapte një gurthyes tjetër për ta zgjeruar biznesin dhe "rasti" kundër B. ishte mënyra më e shkurtër për ta ndalur të ardhmen e suksesshme të kompanisë.

406. S.S. deklaroi se L. pretendonte se ai ishte mik me M.S. por ai nuk mund ta konfirmonte këtë. Ai deklaroi se L. kishte propozuar që t'i afroreshin M.S. përmes D., pasi që ai ishte më afër atij.

407. S.S. e kishte përsëritur dëshminë e tij të mëhershme që N.H. i kishte thënë atij personalisht më 27 nëntor 2012 duke thënë "*Ne kemi qenë të detyruara dhe kjo nuk është e vërtetë*" dhe se zyrtarë hetues ishin M.S. , E.A., N.O. dhe B.SH.. S.S. konfirmoi se ai nuk e njohte M.S. para këtij rasti. Ai konfirmoi se ai personalisht asnjëherë nuk i kishte dhënë atij ndonjë para, e as nuk i kishte kërkuar para, e as nuk ka qenë i pranishëm kur të tjerët i kishin dhënë atij para.

408. S.S. deklaroi se në kohën e arrestimit të B., shtëpia e tij nuk ishte kontrolluar. Ai tha se gruaja dhe vajzat e B. nuk e kishin takuar M.S. n në atë kohë ose që nga ajo kohë.

409. Ai tha në seancën kur B. e pranoi fajësinë ishte një gjyqtare femër, ndërsa prokurore ishte B.K.. Avokati mbrojtës kishte deklaruar se gjyqtare ishte H.H..

410. Në përgjigje të një pyetje nga mbrojtësja e të pandehurit V.T., E.H.V. (që e zëvendësonte A.S.), S.S. e deklaronte B.n e tij se kompania “Luboteni” ishte vënë në shënjestër nga policia për shkak se ata ishin në dijeni se kompania po planifikonte ta zgjeronte biznesin. Ai po ashtu e deklaroi B.n e tij se zyrtarët policorë nuk ishin të kënaqur që kompania po bashkëpunonte tepër shumë me komunitetin serb në Komunën e Shtërpcës.
411. Në përgjigje të pyetjeve nga i pandehuri M.S. , S.S. deklaroi se ai e kishte lexuar deklaratën e R.B. gjoja njërit nga miqtë më të mirë të B. dhe ndërsa R.B. konfirmonte se policia “*ushtroi dhunë kundër tij kur ai ishte marrë në pyetje*”. Ai deklaroi se atij i “*kishte rënë të fikët dhe se ata i kishin derdhur ujë atij*”. Shkurt, ai ishte detyruar të jepte deklaratë.
412. M.S. po ashtu e pyeti nëse ai po jepte pretendimin e avokatit të viktimës se ai kishte pësuar dhunë fizike dhe psikologjike me qëllim që të jepte deklaratat të rreme, e po ashtu që ishte torturuar? Në përgjigje, S.S. deklaroi se ai nuk kishte folur me avokatin e viktimës. Ai deklaroi se ai ishte përpjekur të bisedonte me prokuroren e rastit, B.K., por se ajo nuk e takonte atë.
413. Pastaj M.S. e pyeti S.S.n se çfarë nënkuptonte kur ai supozonte që ai (M.S.) i inskenonte veprat penale në njërën anë dhe në anën tjetër ndihmonte që ato të zgjidheshin? S.S. ishte përgjigjigjur se ai konsideronte se M.S. nuk i kishte ndihmuar B.t me asgjë dhe se ai ishte përpjekur t’i luante dy role.
414. S.S. deklaroi se njëra nga arsytet se pse M.S. kishte ardhur tek shtëpia e babait të B.S. ishte që ta bindte atë se ai po i ndihmonte në rastin e B. Kur u pyet se pse M.S. do ta bënte këtë *afërë të lirimit të B.*, ai deklaroi se ai nuk ishte i pranishëm, por që ai ishte përpjekur t’i bindte dëshmitarët t’i ndryshonin deklaratat e tyre dhe ta rikthente rastin në rigjykim.

415. M.S. deklaroi se ai supozonte se L. ishte miku i tij (i M.t) dhe kishte bërë premtime në emër të tij dhe a i besonte ai ende L.t? S.S. deklaroi se ai nuk i besonte. M.S. pyeti nëse ai mund ta shpjegonte se pse kishte shkuar ai dhe kërkoi ndihmë nga një person i cili e kishte kaluar tërë ditën në kazino duke luajtur bixhoz? S.S. u përgjigj se nuk ishte punë e tij të gjykonte se si L. e kalonte kohën e tij dhe se ai nuk e njohte atë më parë.
416. M.S. i ishte referuar marrëdhënies së dobët të S.S. me XH.B.n dhe pyeti se cilat ishin “*gjërat pa kuptim*” për të cilat ai gjoja kishte folur? S.S. u përgjigj se gabimi më i madh i XH.B. ishte se ai u besonte tepër shumë M.S. dhe B.SH.
417. M.S. pyeti nëse A.S. dhe XH.B. kishin frikë nga ai dhe B.SH. S.S. deklaroi se po. Megjithatë, M.S. i tha atij se B. dhe XH. kishin lidhje familjare që shkonin 20 vjet prapa në kohë që do të thoshte se kjo nuk kishte të ngjarë, por S.S. deklaroi se kjo lidhje nuk ishte punë e tij dhe se ai ishte i palëkundur në atë se XH.B. i kishte thënë atij se M.S. ishte “*person i rrezikshëm në Ferizaj*” dhe që të mos ngatërroheshin me të.
418. M.S. e përmbylli duke e pyetur dëshmitarin që të konfirmonte se ai nuk ishte takuar me të asnjëherë më parë dhe se të gjitha pretendimet e tij ishin thashetheme. S.S. konfirmoi se ai nuk e kishte takuar asnjëherë M.S. më parë, por se ai kishte dëgjuar supozime nga A.S. dhe anëtarë të tjerë të familjes S .
419. Dëshmitari i radhës për të dëshmuar para trupit gjykues në shqyrtim kryesor ishte **B.H.** Ai e kishte filluar dëshminë e tij më 19 maj 2015. Ai deklaroi se gruaja e xhaxhai të tij vinte nga e njëjta familje sikurse XH.B. dhe se vajza e hallës së tij ishte e martuar në atë familje.
420. Ai deklaroi se ai ishte i martuar dhe kishte fëmijë dhe se ai ishte biznesmen me shumë aktivitete afariste, e më kryesorja prej tyre ishte tregtimi i vajit të motorëve. Ai ishte pronar edhe i zinxhirit të pompave të derivateve “*Balkan Petrol*”.

421. B.H. deklaroi se ai i njihte vëllezërit e B.S., por që ai nuk mund t'i dallonte gjithnjë njërin nga tjetri. Ai deklaroi se ai e njihte B.S. që shtatë ose tetë vjet si klient. Ai deklaroi se ai e shihte atë çdo muaj herë pas here. Ai deklaroi se ai gjithmonë i kishte paguar faturat e veta edhe pse nganjëherë ai vonohej nga pak.
422. B. A. deklaroi se nga vitet 2008-2012 ai dinte për aktivitetet e “Lubotenit” dhe se ai nuk kishte përshtypje të mirë për këtë. B.H. deklaroi se ata shpesh kërkonin naftë pa qenë në gjendje të paguajnë dhe zakonisht nëpërmjet dikujt tjetër si XH.B. si garantues. Ai tha se ata as nuk paguanin gjithnjë me kohë. Megjithatë, ai u pajtua se kjo nuk ishte problem aq i madh dhe se nuk ishte ndalur së tregtuari me ta. B.H. u pajtua se ai kishte dëgjuar për arrestimin e B.S.. Ai po ashtu u pajtua se biznesi me këtë kompani ishte zvogëluar pas kësaj, por se ai nuk mund ta thoshte për sa.
423. B.H. deklaroi se përveç marrëdhënies së tyre familjare ai e njihte XH.B.n pasi që ai kishte punuar për një kohë të gjatë në kompani si person i mirëmbajtjes, por jo si i punësuar i rregullt. Ai deklaroi se XH.B. i kishte treguar atij për arrestimin e B. dhe se familja po përpiqej ta zbulonte arsyen për këtë. Ai tha se deri në atë kohë ata ishin në marrëdhënie të mira, por kjo më pastaj ishte përkeqësuar dhe ai e konsideronte XH.B. si “*mashtrues*”. Ai ia atribuonte këtë sëmundjes, të cilën ai e konsideronte të trilluar. Ai e pranoi se nuk kishte prova për këtë. Ai deklaroi se ai ishte punëtor i madh, por që tani nuk kishin asgjë të përbashkët.
424. B.H. deklaroi se tani ai ishte më afër B.SH. se sa XH.B. Ai deklaroi se kohëve të fundit ai e kishte vizituar B.SH.n pas lirimit të tij nga arresti shtëpiak. Megjithatë, ai e kishte vizituar atë si i afërm dhe për shkak se prindërit e tij ishin të sëmurë dhe ai nuk kishte aspak interes, e që pak a shumë ata e kishin diskutuar, për detajet e rastit kundër tij.
425. B.H. deklaronte se ai e dinte se kush ishte M.S. dhe se ai ishte zyrtar policor por se ai nuk e dinte gradën e tij. Ai deklaroi se ai nuk e dinte se ai jetonte afër M.S. B.H. deklaroi se ai e dinte se B.SH. ishte ngarkuar me katër ose pesë vepra, por ai nuk e dinte se cilat ishin ato. Ai u pajtua se i kishte dhënë deklaratë më parë, IPK-së. B.H. e deklaroi

B. e tij se ai nuk kishte asgjë të bënte me këtë rast dhe se përfshirja e tij ishte vetëm për shkak të XH.B.

426. B.H. deklaroi se ai më parë kishte punuar në “*Balkan Petrol*” për nja 4-5 vjet dhe kur ai ishte arrestuar, ai i kishte shkuar në vizitë. Megjithatë, ai pretendon se nuk kishin diskutuar për rastin pasi që mendonte se kjo mund ta vinte atë në siklet. Ai e përsëriti dëshminë e tij të mëhershme se ai nuk e kishte pyetur atë për rastin e tij kur e kishte vizituar atë pas lirimit të tij dhe se vetëm kishte shkuar të interesohej për shëndetin e prindërve të tij.

427. B.H. deklaroi se ai e njohte A.K. ose “L.”. Ai e njohte edhe R.I. Ai e dinte që H.B. ishte zyrtar policor, por që ai asnjëherë nuk kishte ndonjë kontakt me të. Ai deklaroi se ai njohte shumë zyrtarë policorë nga hyrje-daljet në pompat e tij për të marrë karburant.

428. B.H. deklaroi se ai e njohte M.S. si ekspert të gjeodezisë i cili kishte punuar për kompaninë e tij. Ai deklaroi se i njohte RR.V. dhe A.I. si juristë. Ai nuk ishte i sigurt për Raif Ibrahimin dhe ai e njohte A.D. vetëm për nga pamja . Ai e njohte M.D. si biznesmen lokal dhe B.D. si vëllain e tij.

429. B.H. deklaroi se ai i kishte parë M.S. n dhe B.SH.n së bashku me njerëz të tjerë në rrugë në Ferizaj në një veturë. Ai deklaroi se nganjëherë ata vinin në kafenenë e tij por se B.SH. vinte më shpesh se M.S. . B.H. deklaroi se ai nuk e njohte ndonjë individ me emrin R.A. ose “D.”. Ai nuk e njohte B.V. ose A.G.

430. B.H. deklaroi se për arrestimin e B.S. i kishte treguar XH.B.. Ai deklaroi se XH.B. nuk e kishte përmendur B.SH.n pas arrestimit të B. Ai deklaroi se ai nuk i kishte prezantuar ata, pasi që nuk kishte nevojë sepse ata e njihnin-njëri tjetrin që një kohë të gjatë, por se ai mund t’ia ketë dhënë XH.B. numrin e B.SH. Ai e deklaroi B. e tij se ata më pas ishin takuar dhe ai kishte menduar se i kishte parë ata së bashku. Megjithatë, ai deklaroi se ata ishin së bashku edhe në raste të tjera para arrestimit të B.

431. B.H. deklaroi se XH.B. kishte kërkuar nga ai ndihmë disa herë pas arrestimit të B.t, por që anëtarët e tjerë të familjes S. nuk e kishin bërë. Ai deklaroi se ai kishte kërkuar hua shuma të konsiderueshme për shembull, €3,000 dhe €5,000. Ai deklaroi se këto ishin për shpenzime mjekësore të bëra nga anëtarët e familjes së tij dhe shërbime për vetura. B.H. deklaroi se ai nuk e kishte refuzuar atë. B.H. deklaroi se ai nuk kishte folur me B.SH. lidhur me arrestimin e B.S., por ai deklaroi se ka mund të ketë qenë në restorantin e tij me disa nga familja S.
432. B.H. deklaroi se ishte vëllai i B.S., A., ai i cili e kishte informuar atë për arrestimin e B.t. Ai deklaroi se Ajet S.nuk e dinte arsyen e arrestimit por ai deklaroi se dikush në polici e kishte përmendur emrin e XH.B. Ai e kishte pyetur B.H. nëse ai dinte për këtë, sepse ai ishte në dijeni se e kishte parë XH. çdo ditë. B.H. deklaroi se ai i kishte telefonuar XH.B. menjëherë për të marrë disa informata. Ai deklaroi se më pas ai e kishte thirrur në restorant dhe e kishte takuar atë dhe Ajetin, por ai nuk kishte dhënë ndonjë përgjigje të kënaqshme.
433. B.H. deklaroi se ai nuk e konsideronte këtë “*përfshirje*” në rastin e B.SH.t ose të B.S.. Ai e përsëriti se e kishte pyetur XH.B. në prani të A.S. nëse ai kishte pasur ndonjë problem me B.SH., por ai vetëm kishte marrë pesë ose gjashtë versione të ndryshme të përgjigjeve brenda pesë minutave. Megjithatë, ai besonte se kishte probleme mes tyre. Ai deklaroi se ai qëndron prapa deklaratave të tij të mëparshme në këtë rast.
434. B. A. deklaroi se ishin dy ose tre raste më pastaj në fabrikën e tij kur XH.B. kishte ardhur për të blerë naftë dhe A. S.ishte i pranishëm atje gjithashtu. Megjithatë, ai ishte i palëkundur se ai nuk kishte aranzhuar asnjë takim me familjen S., M.S. n dhe B.SH.
435. Në përgjigje të pyetjeve nga pala e dëmtuar B.S., dëshmitari B.H. deklaroi se ai e kishte vizituar B.SH. gjersa ai ishte në qendrën e paraburgimit dhe kishte marrë leje nga EULEX-i pasi i kishte dhënë detajet e letërnjoftimit të tij.

436. Në përgjigje të pyetjeve nga mbrojtësi i të pandehurit M.S. , avokati A.R. B. A. deklaroi se ai kishte marrë pjesë në varrimin e nënës së XH.B., por që XH. nuk ka mundur të merrte pjesë sepse ishte në gjendje shumë të rëndë psikologjike. Ai deklaroi se vëllezërit e XH. kishin kërkuar nga ai që të ndihmojë, kështu që ai e kishte çuar XH.B. në një klinikë në Shkup ku ai ishte vlerësuar. Mjeku kishte deklaruar se ai nuk kishte asnjë sëmundje fizike, por se ishte i stërngarkuar dhe i stresuar dhe kishte nevojë të vizitohej te një psikolog në Prishtinë me të cilin ai do të mund të fliste në gjuhën e tij amtare.
437. Në përgjigje të pyetjeve nga i pandehuri M.S. , dëshmitari B.H. kishte deklaruar se ai nuk e njohte B.S. shumë mirë para arrestimit të tij. Ai deklaroi se në fund ai e kishte zbuluar arsyen e arrestimit të tij, por jo nga XH.B., të cilin nuk e njohte. Ai deklaroi se ai nuk e kishte mësuar arsyen e vërtetë deri një vit më vonë kur ai ishte intervistuar nga IPK-ja.
438. Dëshmitari i radhës për të dëshmuar para trupit gjykues të shqyrtimit kryesor ishte **R.I.** Ai e kishte filluar dëshminë e tij më 27 maj 2015. Ai deklaroi se ishte ekolog i papunë. Ai ishte i martuar dhe kishte dy fëmijë, si dhe jetonte me donacione nga familja e tij.
439. R.I. deklaroi se e njohte K.S. nga fshati Brod që prej fëmijërisë dhe se ata ishin fqinj. Ai nuk i kishte borxh atij asgjë dhe i kujtohej kontakti i rastit me të në vitin 2012 dhe 2013. Ai deklaroi se e njohte A.S. si vëllain e K. Ai e njohte edhe B.S.n si fqinj. Në përgjithësi, ai deklaroi se e njohte familjen dhe e njohte biznesin e tyre, ndonëse ai nuk kishte punuar asnjëherë për ta. Ai ishte në dijeni se kompania e tyre po shkonte shumë mirë, por pastaj pasuritë e saja ranë. Ai deklaroi se këtë e kishte mësuar nga fqinjët e B.S..
440. R.I. deklaroi se ai kishte dëgjuar për arrestimin e B.S.. Ai deklaroi se ai nuk e dinte se kush ishte XH.B. Ai e kishte marrë me mend se edhe A. e S.S. ishin vëllezër të B.S.

441. Ragip Imeri deklaroi se S.S. i kishte marrë hua €500 nga ai, por atij nuk i kujtohet nëse kjo ishte në muajin maj apo në qershor të vitit 2013 apo në vitin 2012. Ai tha se përveç kësaj nuk kishte probleme ose mëri mes tij dhe familjes S.dhe se nuk kishte pasur asnjëherë.
442. R.I. deklaroi se ai nuk i njihte H.B., M.S., ose M.S.. E as nuk e njihte A. S., D. D., RR.V., A.B., R.S., SH.S. ose Sh.B., por ai e njihte R.B. si zyrtar që punonte në Shtërpce. Ai deklaroi se ai nuk i njihte A.D., M.D., B.D. ose A.K. (të njohur si L.) nga Kaçaniku. Megjithatë, ai deklaroi se ai i njihte F. dhe F.H. si bashkëfshatarë por që nuk kishte shumë ndërveprim me ta. R.I. deklaroi se e njihte M.S. n por vetëm përmes mediave. Ai nuk kishte dëgjuar për të në vitet 2012-2013. Ngjashëm, në atë kohë ai nuk kishte asnjë njohuri për R.A. (të njohur si D.) ose V.T.
443. R.I. deklaroi se ai kishte dëgjuar për arrestimin e B.S. nga anëtarët e familjes së tij por që ata nuk kishin treguar se pse ishte arrestuar ai. Ai deklaroi se S.S. kishte kërkuar të merrte para hua nga ai, por se atij nuk i kujtohej nëse ishte muaji maj ose qershor ose nëse ishte viti 2012 ose 2013.
444. Megjithatë, ai u pajtua se ai i kishte dhënë deklaratë Inspektoratit Policor të Kosovës në nëntor të vitit 2013 duke përfshirë rrëfimin për huazimin e tij i cili ishte i vërtetë dhe pastaj ai kishte deklaruar se ai ishte pyetur për këto para në vitin 2012. Ai deklaroi se ai i kishte dhënë S.S.t €500. Ai tha se ai nuk kishte treguar se për çfarë ishin paratë dhe se ai nuk kishte pyetur, megjithatë ai kishte menduar se kjo ishte pas arrestimit të B.t. Ai deklaroi se ai nuk kishte kërkuar para nga ai ashtu si më përpara. Ai i kishte marrë paratë në shtëpinë e tij dhe i kishte ri-paguar ato pas dy ose tre muajsh. Askush nuk ka qenë dëshmitar i kësaj.
445. Në përgjigje ndaj pyetjeve nga avokati i të pandehurit M.S. , avokati A.R., R. I. deklaroi se ai nuk kishte qasje në të dhënat financiare të "*Kompanisë Luboteni*".

446. Dëshmitari **R.B.** po ashtu dëshmoi para trupit gjykues të shqyrtimit kryesor më 27 maj 2015.
447. Ai deklaroi se që nga lufta, ai ishte punësuar si Shef i Drejtorisë së Urbanizmit të Komunës së Shtërpçës. Në thelb, kjo do të thotë se ai ishte i përfshirë në mbikëqyrjen e zbatimit të projekteve ndërtimore dhe në veçanti në rregullativën ligjore të këtyre. R.B. deklaroi se në të kaluarën ai kishte pasur rast ta mbikëqyrte "*Kompaninë Luboteni*". Megjithatë, ai deklaroi se ai nuk ishte i përfshirë në dhënien e kontratave pasi që kjo ishte përgjegjësi e zyrës së prokurimit.
448. R.B. deklaroi se ai e njohte B.S.n dhe familjen e tij, por ai nuk kishte punuar drejtpërdrejt me "*Kompaninë Luboteni*" pasi ishte kontraktuar që të punojë nga Komuna e Shtërpçës. Megjithatë, ai deklaroi se ai kishte kontakte shoqërore me ta sepse ata ishin shokë që nga klasa e parë e shkollës fillore. Ai deklaroi se ai kishte dëgjuar për arrestimin e B.S. në ose rreth muajit maj të vitit 2012. Ai deklaroi se para arrestimit të tij, kompania ishte një nga kompanitë më të fuqishme në Komunën e Shtërpçës. R.B. deklaroi se "*Kompania Luboteni*" në përgjithësi kishte bërë punë të mirë dhe kishte një numër të madh të të punësuarve para arrestimit të B.S. në vitin 2012, por se kishte një "*rënie drastike pas arrestimit të B.t*".
449. R.B. deklaroi se ai e njohte XH.B. si mekanik dhe si kunat i B.S.. Ai tha se ai e kishte parë atë rregullisht që nga viti 2000 dhe nuk ishte as në marrëdhënie të mira, e as të këqija me të. Ai i njohte edhe Ali, Mergim dhe S.S.n, përkatësisht si vëlla të B.t, bir të tij dhe kushëri të afërt të tij. Ai tha se asnjëri prej tyre nuk u kishte atyre para borxh, as tani ose në vitet 2012-13 dhe se nuk kishin mëri mes tij dhe familjes së tyre atëherë ose që nga ajo kohë.
450. R.B. deklaroi se ai nuk e njohte H.B., por se ai e njohte M.S. si gjeometër që kishte punuar në kompaninë e B.t. R.B. deklaroi se ai e dinte se B. S. ishte babai i B. dhe se A. ishte e bija e tij.

451. R.B. deklaroi se me sa e dinte ai, D.D. ishte shofer kamioni por ai nuk kishte ndonjë marrëdhënie me të. Ai deklaroi se ai nuk i njohte RR.V., A.B. ose R.S. por ai e dinte se S. S. ishte gruaja e B. Ai deklaroi se nuk i njohte Sh.B., A.D., ose A. K. (të njohur si L.), por ai e njohte M.D. si pronar i një kompanie asfalti. Ai i njohte edhe F. dhe F.H. pasi që F. punonte në Kuvendin Komunal të Shtërpcës, ndërsa F. është anëtar i familjes së tij. Ai e njohte B.D. si pronar i kompanisë së asfaltit *“Burimi”*.
452. R.B. deklaroi se në vitin 2012, ai kishte pranuar një thirrje telefonike nga M.S. i cili donte të takohej me të në stacionin e policisë të Ferizajt. Ai kishte arritur atje në orën 1 dhe kishte shkuar në zyrën e M.S. Ai nuk e dinte gradën e tij ose nëse ajo ishte e lartë ose e ulët. Ai e njohte B.SH. por vetëm nga hera e parë kur ai e kishte marrë në pyetje atë. Ai e kuptoi se edhe ai ishte në policinë e Kosovës, por ai nuk ia dinte gradën as atij. Ai deklaroi se kjo ishte hera e vetme kur ai i kishte parë B.SH. dhe M.S. së bashku.
453. R.B. deklaroi se ai kishte dëgjuar për arrestimin e B.S. në stacionin e policisë. Ai deklaroi se të pranishëm ishin edhe zyrtarë të tjerë të policisë dhe M.S. u kishte kërkuar që ta përcillnin atë tek një zyrë tjetër. Ai deklaroi se të pranishëm ishin edhe N. dhe E.A. Ai e njohte E.A. nga lokaliteti. Ai deklaroi se M.S. jepte urdhër dhe se ai ishte përgjegjës për situatën. R.B. deklaroi se kur ai ishte çuar në zyrën tjetër nga zyrtarët e tjerë policorë ata kishin filluar t’i bënin presioni atij duke i thënë se nëse nuk thoshte çfarë donin ata që ai të thoshte edhe ai mund të arrestohej.
454. R.B. deklaroi se policia kishte filluar duke e pyetur atë për të dhëna biografike dhe pastaj nëse ai e njohte B.S. dhe ai tha se e njohte. Mirëpo, pastaj ata e pyetën nëse ai e dinte B.S. ishte i përfshirë në trafikimin e qenieve njerëzore dhe ai tha se nuk e dinte. Ai tha se M.S. nuk ishte i pranishëm në atë kohë. Ai tha se ata besonin se ai ishte dhe se ai duhet t’u tregonte krejt çka dinte për këtë. Ai deklaroi se ata i shtruan atij pyetje lidhur me dy femrat me emrin L.P. dhe N.H.. Ai deklaroi se pyetjet kishin vazhduar pandërprerë dhe se nuk kishin përfunduar me të atje deri në orën 5. Ai deklaroi se ai ishte shumë i hidhëruar dhe i mërzitur në atë kohë. Ai deklaroi se ai i kishte informuar zyrtarët policorë se ai i njohte L.P. dhe N.H. Ai deklaroi B. e tij se policia nuk i pranonte përgjigjet e tij në

pyetjet. Ai e kishte lexuar deklaratën e tij dhe e kishte nënshkruar atë, por ai deklaroi se ishte shumë i mërzitur dhe nuk e dinte se çfarë përmbajtje kishte deklarata. Ai deklaroi se shumicën e pyetjeve i bënte B.SH. Ai deklaroi se policia nuk e kishte kanosur familjen e tij, por se ata ia kishin ngritur zërin dhe se ai nuk kishte shkuar në tualet. Ai deklaroi se ai ishte ndjerë sikurse të mos ishte i lirë deri sa e kishte nënshkruar deklaratën. Megjithatë, ai deklaroi se ata i kishin dhënë atij ujë dhe se ai nuk kishte kërkuar pauzë. Ai deklaroi se pyetja e vetme që ia kishte shtruar M.S. ishte nëse ai i njihnte të dy femrat dhe këtë pyetje ia kishte në zyrën e tij. Atij nuk i kujtohej nëse M.S. ishte në zyrën e tij gjersa ai po merrej në pyetje në zyrën pranë.

455. R.B. deklaroi se M.S. i kishte thënë atij ta thërriste B.S. sepse ai nuk po përgjigjej në telefon, ai ashtu kishte bërë. Ai deklaroi se i kishte thënë B. se zyrtarët policorë donin të takoheshin me të dhe se ai kishte thënë se ishte i zënë dhe larg në Gjilan, por se do të vinte. Ai tha se në atë kohë ai ndjehej se nuk kishte zgjedhje tjetër përpos ta thërriste B.S.n. Ai tashmë e kishte dhënë deklaratën e tij. Ai deklaroi se ai nuk e kishte informuar B.n për dyshimet e policisë. Ai deklaroi se ai nuk kishte asnjë kontakt të mëtejme me policinë pas kësaj në maj të vitit 2012 sa i përket B.

456. R.B. deklaroi se pas intervistës së tij me policinë në Ferizaj, ai ishte në kontakt me familjen S.por vetëm pasi ishte liruar B. Ai deklaroi se ai kishte kontakte me A.S.n dhe XH.B. Ai deklaroi se edhe ata ishin takuar në oborrin e shtëpisë së tyre në Ferizaj. Ai deklaroi se ka pasur takime të rastit me K.S.. Ai deklaroi se ata kishin diskutuar për rastin e B.t dhe ai u kishte treguar atyre për intervistën e policisë dhe për marrjen në pyetje. Ai deklaroi se ai i kishte thënë A. dhe XH. se deklarata e tij nuk ishte e vërtetë dhe se ndaj tij ishte ushtruar presion. Ai tha se ata i kishin thënë atij ta thoshte të vërtetën kur të shkonte te prokurori. Ai deklaroi se që nga momenti kur ai e dha deklaratën e tij e deri në datën e dëshmisë së tij para gjykatës ai kishte *“shqetësime”*. R.B. deklaroi se në fund ai kishte dhënë deklaratë para prokurorit të EULEX-it dhe se ai ia kishte treguar *“situatën reale”*.

457. R.B. u pajtua me përmbajtjen e intervistës së tij dhënë IPK-së më 21 tetor 2013 në kuptimin se ai në ndërkohë kishte një takim me prokuroren e Kosovës, B.K. ku ai nuk e

kishte ndryshuar deklaratën e tij të mëhershme para policisë sepse ai ende ndjente presion nga ta. Ai deklaroi se më pastaj ai foli me A.S. dhe XH.B. dhe avokatin e tij, E.SH. Ai deklaroi se A.dhe XH. kishin thënë se ata kishin folur me M.S. n i cili kishte thënë se deklarata duhet të ndryshohet. Ai deklaroi se ai i kishte informuar ata se ai nuk do të *“hynte në këtë lojë”* dhe do të thoshte *“çdo gjë që është e vërtetë”*.

458. R.B., në një rast kishte thënë se ka indikacione nga XH.B. se B.SH., M.S. , E.A. ose zyrtari policor N., po përpiqeshin t'i ofronin ndihmë B. ose familjes S.në çfarëdo mënyre. Ai deklaroi se ai nuk kishte ide për ecurinë e rastit përveç se ai kishte marrë pjesë në seancën përfundimtare të gjykatës pa asnjë thirrje por askush nuk e kishte thirrur atë që të dëshmonte. Ai tha se familja nuk i kishte treguar atij se duhej të paguhej ndonjë ryshfet për t'i ndihmuar B. R.B. deklaroi se ai asnjëherë nuk kishte asnjë problem me policinë para këtij rasti dhe kjo ishte hera e parë për të në gjykatë.

459. Në përgjigje të pyetjeve nga avokati mbrojtës i të pandehurit M.S., avokati, A.R., R.B. deklaroi se ai personalisht nuk e dinte gjendjen financiare të familjes së B.S..

460. R.B. deklaroi se ai po ia jepte përgjigjet e tij policisë, ai iu ishte përgjigjur pyetjeve të tyre me sinqeritet por ata i ishin përgjigjur *“jo nuk është kështu, është ndryshe”* megjithatë, ai e pranon se e kishte nënshkruar procesverbalin. Ai po ashtu e pranoi se ai nuk kishte bërë ndonjë ankesë lidhur me presionin, që siç pretendon ai, i ishte nënshtruar, qoftë tutje më lart në zinxhirin komandues ose para prokurorit. Ai deklaroi se në asnjë moment i pandehuri M.S. nuk i kishte thënë atij që ta ndërronte deklaratën.

461. Në përgjigje të pyetjeve nga vetë i pandehuri M.S, R.B. u pajtua se B.S. ishte miku i tij më i mirë, por pa marrë parasysh këtë ai ende e ndjen presionin nga policia në intervistë. Ai nuk mund ta shpjegonte se pse ai nuk i kishte treguar M.S. në zyrën e tij se ai i njihte N.H. dhe L.P. Ai po ashtu deklaroi se nuk mund ta shpjegonte se pse B.S. e kishte pranuar fajësinë në seancën gjyqësore në të cilën ishte thirrur ai.

462. Në përgjigje të pyetjeve nga prokurori, R.B. tha se ai nuk kishte cekur asnjë vërejtje lidhur me trajtimin e tij në deklaratën e tij sepse ai ishte nën presion dhe nuk e dinte madje edhe se si e kishte nënshkruar atë. Ai deklaroi se zyrtarët e kishin ngritur zërin ndaj tij. Ai deklaroi se madje nuk e dinte se në çfarë cilësie ishte ftuar ai atje, ndonëse që në fillim i ishin lexuar të drejtat e tij.
463. Dëshmitari i radhës ishte **H.B.** dhe ai e kishte filluar dëshminë e tij më 22 qershor 2015. Ai deklaroi se kishte punuar si zyrtar policor për rreth nëntë vjet në Njësinë Mbështetëse (ROSU) në Ferizaj para se të transferohej në Njësinë e Hetimit në Kaçanik. Ai deklaroi se ishte koleg i M.S. dhe B.SH. dhe se i njihnte ata. Ai konfirmoi, nga perspektiva e punës policore, se Shtërpca binte nën autoritetin e Ferizajt. H.B. deklaroi se ai i kishte dhënë dy deklaratat, në IPK dhe në prokurorinë e EULEX-it, në lidhje me këtë rast dhe ai qëndronte prapa përmbytjes së të dyjave.
464. H.B. deklaroi se ai kishte dëgjuar emrin e B.S. por nuk dinte asgjë për të dhe se ai madje nuk e kishte parë atë më përpara. Ai deklaroi se ai nuk kishte dëgjuar asnjëherë për Kompaninë “*Luboteni*” përpara. Ai deklaroi se ai kishte dëgjuar “*shumë pak gjëra*” lidhur me rastin ku përfshihej B.S. por se ai nuk i dinte detajet. Ai vetëm kishte dëgjuar se ai ishte arrestuar pasi që rasti nuk po trajtohej nga njësitë e tij. Ai u pajtua se e dinte rastin ku ishin të përfshira N.H. dhe L.P. Ai deklaroi se ai nuk kishte asnjë lloj relacioni me B.S. dhe se nuk kishte para borxh nga asnjëra anë. Ai po ashtu nuk e njihnte asnjërin nga të afërmit e tij.
465. H.B. deklaroi se gjersa ai ishte i stacionuar në Ferizaj, M.S. mbante gradën e togerit dhe B.SH. ishte zyrtar policor i rëndomtë. Ai deklaroi se ai ishte në një njësit të ndarë nga M.S. dhe nuk ishte në pozitë që ta vlerësonte punën e tij. megjithatë, ai deklaroi se as M.S. , e as B.SH. ose dikush që ka vepruar në emër të tyre nuk i është afruar atij lidhur me deklaratën që ai pritej ta bënte. H.B. deklaroi se B.SH. ishte pjesëtar i njësitit dhe se ai kishte raporte normale me të. Megjithatë, ai nuk mund të thoshte se çfarë lloj raportesh kishte M.S. me B.SH.

466. H.B. u pajtua se një person e kishte thirrur XH. përmes B.SH. erdhi dhe u ul në të njëjtën tavolinë me të në një rast, por që ai nuk e njohte atë. Atij nuk i kujtohej se kur ishte kjo, por ndoshta në fund të vitit 2013. Ai e dinte se kjo ishte në restorant “Beni” afër fshatit të tij (Biqec) në rrugën nga Kaçaniku në Ferizaj. Ai dhe B.SH. ishin në rroba civile.
467. H.B. deklaroi se B.SH. e kishte ftuar atë dhe e kishin diskutuar rastin e B.S.. Ai deklaroi se ai i kishte thënë atij se ishte një rast ku përfshiheshin dy zonja dhe pasi që njëra nga vajzat vinin nga fshati i tij, dhe se a mund të ndikonte në to që t’i “zbusnin” deklaratat e tyre. Ai tha se ai nuk dinte asgjë në lidhje me B.S. Ai deklaroi se e dinte se N.H. ishte nga fshati i tij, por nuk e dinte se ajo kishte probleme, por kishte dëgjuar për këtë më vonë kur i kishte treguar B.SH.t por ai e kishte distancuar veten nga kjo. Ai deklaroi se madje ai nuk e dinte se kujt i ishin dhënë këto deklaratat. Ai e kishte kuptuar se B.S. kishte marrëdhënie familjare me B.SH.
468. H.B. deklaroi se ai e kishte pranuar propozimin e B.SH. dhe e kishte shpërfillur kërkesën. Ai deklaroi se pasi e kishin përfunduar bisedën e tyre, një person kishte ardhur edhe u ishte bashkuar atyre dhe e kishte prezantuar veten si XH. Atij nuk i kujtohet nëse B.SH. ishte duke e pritur atë.
469. H.B. deklaroi se ai nuk kishte njohuri se gjoja €400 ishin kërkuar në emër të tij nga familja e B.S. për të për të ndikuar në N.H. dhe L.P. Ai deklaroi se në atë kohë ai e kishte informuar B.SH.n se do të shihte nëse do të mund të ndihmonte, por ai e kishte thënë këtë vetëm sa për ta përfunduar bisedën dhe në fakt nuk kishte ndërmend ta ndihmonte atë. Ai deklaroi se në bisedë nuk ishte përmendur asnjëherë emri i M.S. t. Megjithatë, prokurori i tha atij se në deklaratën e tij para prokurorit të mëparshëm më 29 nëntor 2013, ai deklaroi se ai kishte refuzuar t’i ndihmonte B.SH.t dhe deklaroi *‘ata ishin ishin në kontakt me vajzat dhe i kishin marrë në pyetje ato dhe se ata mund t’i ftonin prapë ato që ta ndryshonin deklaratën’*. Prokurori e pyeti se çfarë nënkuptonte me *“ata?”* dhe H.B. deklaroi se mendonte se ai po iu referohej zyrtarëve policorë M.S. dhe B.SH. për shkak se ata ishin pjesë e njësitit përkatës.

470. H.B. deklaroi se ai e dinte se gjendja ekonomike e N.H. ishte mes gjendjes së mesme dhe të varfër. Ai deklaroi se ai nuk ka folur asnjëherë me të për këtë rast. Ai deklaroi se kur XH. u ishte bashkuar atij dhe B.SH. në restorantin “Beni”, ata kishin pasur një bisedë të përgjithshme dhe se atij nuk i kujtohej se për çfarë kishin folur. Ai deklaroi se XH. asnjëherë nuk i ishte afruar atij në lidhje me rastin e B.t.
471. H.B. deklaroi se ai nuk kishte biseduar për kërkesën e B.SH. me eprorë ose kolegë. Ai deklaroi se ai e konsideronte këtë një çështje relativisht të vogël dhe se B.SH. nuk kishte bërë përpjekje të ushtronte presion ndaj tij.
472. Në përgjigje të pyetjeve nga avokati mbrojtës i të pandehurit M.S. , avokati A.R., H.B. konfirmoi se personi për arrestimin dhe rastin e të cilit ai po fliste ishte B.S.. Ai deklaroi se ai nuk e dinte se kush i kishte intervistuar N.H. dhe L.P. Ai deklaroi se atij asnjëherë nuk i ishin ofruar para nga dikush që vepronte në emër të M.S.
473. Dëshmitari i radhës për të dëshmuar ishte **M.S.** Ai e kishte filluar dëshminë e tij më 29 qershor 2015. Ai deklaroi se merrej me gjeodezi pasi që kjo kishte të bënte me projektimin e ndërtimit të rrugës dhe se ai kishte kryer disa punë për B.S.n në kohën kur ai ishte e suksesshëm dhe që sipas pikëpamjes së tij po kryente punë të mira. M.S. deklaroi se atij i kujtohet kur ishte arrestuar B.S., por ai nuk e dinte se çfarë efekti, nëse kishte ndonjë, kishte kjo në kompaninë “Luboteni”. M.S.u pajtua se ai ishte marrë në pyetje nga policia më 21 tetor 2013 dhe ai qëndronte prapa përmbajtjes së asaj interviste.
474. M.S. deklaroi se ai e njihte XH.B. pasi që ai ishte fqinj dhe mekanik dhe i mirëmbante veturat e kësaj kompanie. Ai deklaroi se ai po ashtu i njihte A.S., Xh. S. dhe S.S. përmes profesionit të tij.
475. M.S. deklaroi se ai nuk ishte i njohur me z. M.S. . Ai deklaroi se ai e njihte B.SH dhe e kishte takuar atë një herë ose dy herë në “Balkan Petrol” dhe ai e dinte se ai ishte zyrtar policor. Ai deklaroi se XH.B. i kishte treguar në lidhje me arrestimin e B. kur ai e

kishte çuar veturën e tij në punëtorinë e tij. Ai deklaroi se ai nuk e dinte arsyen e arrestimit të tij.

476. Në përgjigje të pyetjeve nga avokati i të pandehurit M.S., avokatit, A.R., M.S. deklaroi se para arrestimit të tij ai kishte punuar me B.S. si dy biznesmenë dhe se ai nuk kishte bërë asnjë pyetje në lidhje me “*pastërtinë*” e karakterit të B.S.

477. Dëshmitari i radhës për të dëshmuar ishte **B.I.** Ai filloi dëshminë e tij më 29 qershor 2015. Ai është xhaxhai i B.

478. B.I. deklaroi se B.I., babai i B.S., e kishte informuar atë se B. ishte arrestuar. Ai deklaroi se kjo kishte shkaktuar befasi në familje. Ai deklaroi se në atë kohë nipat e tij i ishin afruar atij për €1,500 dhe fatmirësisht djali i tij ishte në Afganistan, përndryshe ai nuk do t’i kishte ato para. B.I. e konfirmoi se porsa u arrestua B., fitimet e kompanisë “*Luboteni*” kishin filluar të pësonin rënie.

479. B.S. nuk mund ta thoshte se sa gjatë pas arrestimit të B., nipat e tij i ishin afruar atij për para. Ai u pajtua se ishte çështje e procesverbalit, arrestimi i tij kishte ndodhur më 30 maj 2012. Atij i ishte treguar një deklaratë e Raiffeisen Bank e datës 18 tetor 2012 ku tregohet një tërheqje nga xhirollogaria bankare e djalit të tij. Ai deklaroi se kjo tërheqje ishte për familjen e B.S.. Ai tha se ishte A. S. ai i cili ia kishte kërkuar €1,500. Ai tha se ato ishin për t’i paguar të punësuarit. B.S. deklaroi se pas arrestimit, ai i kishte dhënë familjes S. para të tjera për arsye se ata ishin shumë keq financiarisht. Megjithatë, ai tha se këto nuk ishin shuma të mëdha të parave. B.S. tregoi se tërheqja e 2,000 USD nga Raiffeisen më 18 tetor 2012 ishte bërë me kërkesë të Ali Sylejmanit për pagesat e rrogave të punëtorëve. Ai kishte deklaruar se pas disa ditëve kompania do të merrte para pasi që ata ishin duke e asfaltuar një rrugë. B.S. deklaroi se familja S. po ashtu herë pas here i kërkonin shuma të vogla parash. Ai deklaroi se ata pjesën më të madhe e këtyre parave ia kishin kthyer, por ende i kishin mbetur borxh pak por jo më shumë se €2,000.

480. Në përgjigje të pyetjeve nga avokati i të pandehurit M.S. , avokatit A.R., fillimisht dëshmitari B.S.deklaroi se familja S. nuk i dinte arsyet e arrestimit të B.t por më vonë ata i kishin zbuluar.
481. Në përgjigje të pyetjeve nga M.S. , B.S. deklaroi se atë ditë ai kishte ardhur në seancë nga Ferizaji me B. në veturën e B. Ai e pranoi se ata kishin diskutuar për dëshminë e tij.
482. Dëshmitari i radhës që dha dëshmi ishte **B.S.** Ai e kishte filluar dëshminë e tij më 1 korrik 2015. Ai është babai i B.S. dhe një dajë i largët i M.S. B. S.deklaroi se ai ishte intervistuar nga IPK-ja në maj të vitit 2013 dhe se me atë rast i kishte dhënë informatat me vërtetësi. Ai konfirmoi se M.S. ishte një nip i largët por që asnjëherë nuk kishte pasur ndonjë ndërveprim me të.
483. B. S. deklaroi se deri sa ishte arrestuar B. çdo gjë ishte në rregull në kompaninë “Luboteni”. Megjithatë, ai deklaroi se pas arrestimit të tij, brenda dy javësh ajo me të madhe u rrënuar sepse nuk kishte para për t’i paguar punëtorët. Ai deklaroi se familja ishte detyruar të mbijetonte me pensionin e tij dhe të gruas së tij.
484. B. S. deklaroi se ai i njohte D.D. dhe A.B. vetëm nga pamja, por ai nuk e njohte RR.V. fare. Ai nuk e njohte R.B. si mik të B.t, por ai i njohte A.D. dhe M.D. vetëm nga pamja. Ai nuk e njohte A.L. (të njohur si L.) nga Kaçaniku ose F. dhe/ose F.H.
485. B. S.deklaroi se para arrestimit të B. në maj të vitit 2012, familja e tij asnjëherë nuk kishte pasur ndonjë problem me policinë në Ferizaj ose me ligjin në përgjithësi. Ai deklaroi se ai e kishte takuar M.S. n për herë të parë vetëm pas arrestimit të djalit të tij. Ai deklaroi se ai e dinte se familja e B.SH. ishte familja që kishte jetuar afër tij para se të zhvendosej në Ferizaj. Ai e dinte se i kishte thënë babait të tij “*tungjatjeta*”.

486. B. S. deklaroi se kishte kuptuar se M.S. , B.SH. dhe E.A. e kishin arrestuar B.n. Megjithatë, ai deklaroi se ai asnjëherë nuk i kishte parë M.S. dhe B.SH.n së bashku deri sa ata kishin ardhur në shtëpinë e tij pas arrestimit të B.
487. B. S. deklaroi se atij i ishte i njohur emri R.A. ose D. dhe ai e njohte atë nga pamja. Ai nuk mund të thoshte nëse M.S. ose B.SH. ishin në bashkëpunim me S.M. ose R.A. Ai nuk mund të thoshte nëse ai e njohte V.T.
488. B. S. deklaroi se ai nuk ishte i pranishëm kur ishte arrestuar djali i tij, por që më pas i kishin treguar atij për këtë. Ai deklaroi se njerëzit i kishin treguar se ishte B. dhe Enveri ata që e kishin arrestuar B. Ai deklaroi se A., K. dhe XH. menjëherë ishin angazhuar aktivisht për ta liruar B. Ai deklaroi se atij i kujtohet që i ishte shtruar një pyetje nga IPK-ja lidhur me atë se kur A.dhe XH. i kishin treguar atij për ndihmën në rastin e B. dhe ai ishte përgjegjës se ata e informuan atë se ishte e nevojshme të jepnin para dhe se nuk do të kishte problem që të sigurohej lirimi i B. Megjithatë, ai deklaroi se ai nuk e dinte nëse ata kishin dhënë para.
489. B. S. deklaroi se atij nuk i kujtohej data e saktë e lirimit të B. por se ai ishte në paraburgim për rreth shtatë muaj. Ai u pajtua me përmbajtjen e deklaratës së tij të mëhershme para IPK-së në kuptimin se K.S. e kishte informuar atë se para lirimit të B.t do të nevojiteshin €25,000 me qëllim që B. të lirohej nga burgu. Ai deklaroi se ai nuk i kishte ato para në dispozicion dhe se ai duhej të shkonte dhe t'i merrte ato tek të afërmit e tij, të njohurit, etj. Ai deklaroi se e tërë familja e dinte se nevojiteshin para. Ai deklaroi se K.S. ishte ai i cili i kishte mbledhur paratë (pasi që ai ishte i sëmurë në atë kohë) por që ai i kishte ruajtur ato në të sigurt.
490. B. S. deklaroi se kur ishte arrestuar B.S., përsëri policia nuk kishte ardhur që ta arrestonte atë por kishte ardhur një letër nga Shtërpa me urdhrin. B.S. i kujtohet se pas arrestimit dhe lirimit të parë të B.S., M.S. dhe B.SH. kishin ardhur në shtëpinë e tij një natë për darkë. Ata ishin në veshje civile. Ai tha se grupi kishin kaluar mirë. Ata thanë se B. ishte i pafajshëm dhe se kishte qenë i pafat. Ai tha se mënyra si e kuptonte ai këtë, ata

kishin ardhur që të kërkonin falje dhe për t'u pajtuar sa i përket arrestimit të B. Në vend të kësaj, ai deklaroi se B.SH. vazhdonte të thoshte se M.S. ishte *"njeri i madh"* dhe çfarëdo që thotë ai do të bëhet. Megjithatë, ata nuk thanë të mos brengoseshim dhe se rasti i B.t ishte rregulluar.

491. B. S.deklaroi se e dinte që para se të vinin M.S. dhe B.SH. se anëtarët e familjes S.ishin në kontakt me ta në lidhje me rastin e B. Ai deklaroi se ai besonte se diçka e mirë do të vinte prej kësaj. Ai e dinte se djali i tij nuk kishte bërë asgjë të gabuar.

492. Në përgjigje të pyetjeve nga avokati i të pandehurit M.S. , avokati A.R., B. S. deklaroi se babai i M.S. është U.S. nga Bitija dhe se ai nuk mund të thotë se ai ishte njeri i keq. B. S.deklaroi se as ai e as djali i tij nuk i kishin ftuar M.S. dhe B.SH. në shtëpinë e tij. Ai deklaroi se ata kishin ardhur me XH.B. Ai deklaroi se gruaja e B. e kishte përgatitur darkën dhe se nuk kishte asgjë të veçantë dhe se ata kishin ndenjur deri në 1 të mëngjesit.

493. B. S. deklaroi se M.S. asnjëherë nuk kishte kërkuar ose e kishte nxitur atë për të marrë para nga ai, e as nuk i kishte dhënë atij ndonjë gjë gjatë asaj nate ose ndonjëherë përpara. Në fakt ai deklaroi se paratë nuk ishin përmendur fare atë natë.

494. A.R. i tha B.S. se pse ai nuk i kishte pyetur ata se pse ishin atje, pasi që ai besonte se ata e kishin burgosur djalin e tij dhe tani kishin ardhur për vizitë. B. S.deklaroi se ndjente se nuk mund ta bënte këtë. Ai e deklaroi pikëpamjen e tij se ata ishin, *"në atë çështje dhe se kishin ardhur për një qëllim të mirë"*. Megjithatë, ai deklaroi se ata nuk i kishin kërkuar falje atij por thjesht i thanë se B. kishte qenë i *"pafat"*.

495. Pastaj i pandehuri M.S. e pyeti B. S.nëse ai kishte frikë ose ishte i trembur kur ai kishte ardhur në shtëpinë e tij dhe ai tha se ai kishte *"plot me stres"*, por ai u ndje se do të ishte në rregull për shkak të lidhjeve të tij të gjakut me M.S. n.

496. B. S.e deklaroi B. e tij se kur ishte arrestuar B. për herë të parë, ai ishte çuar në Gjilan dhe ata i kishin thënë atij se ai e kishte vrarë një njeri tjetër dhe ai kishte thënë se ai nuk e kishte bërë. Ai e deklaroi B. e tij se kjo ishte bërë vetëm për ta frikësuar atë. Ai deklaroi se B. ishte në burg për shtatë muaj, por ai nuk e dinte se për çfarë. Ai deklaroi se ai nuk e dinte as se pse ishte arrestuar ai për herë të dytë , por ai e dinte se M.S. e kishte pyetur atë përmes telefonit nëse ai do të vinte që t'ia vendoste fasadën shtëpisë së tij. Ai deklaroi se policia nuk kishin shkuar asnjëherë tek shtëpia e tij për ta kontrolluar.
497. Në përgjigje ndaj pyetjeve të prokurorit gjatë ri-marrjes në pyetje, B. S. deklaroi se ai ndjente se nuk mund të pyeste se pse M.S. dhe B.SH. kishin ardhur tek shtëpia e tij për arsye se në njëfarë mënyrë M.S. dhe B.SH. do të mund ta kontrollonin fatin e ardhshëm të asaj çfarë do t'i ndodhte B.S..
498. Dëshmitarja e radhës për të dëshmuar ishte **A.S.** Ajo është e bija e B.S.. Ajo e kishte filluar dëshminë se saj më 1 korrik 2015. Ajo deklaroi se gjatë periudhës kohore 2012-2013, ajo jetonte me xhaxhallarët e saj, por se tani jeton me prindërit e saj.
499. Ajo deklaroi se nuk e njohte B.SH. nga pamja, por ajo kishte dëgjuar për të. Ajo deklaroi se kompania e babait të saj ishte e suksesshme dhe ajo thotë se disa njerëz kishin zili për këtë. Ajo deklaroi se arrestimi i babait të saj e kishte shkatërruar plotësisht kompaninë. Ajo deklaroi se gjatë kohëzgjatjes sa ai ishte i burgosur, vëllezërit e tij kishin shumë probleme dhe ata kishin dhënë shumë para gjatë kohës kur ai ishte në burg.
500. Ajo deklaroi se ajo nuk i njohte D.D., RR.V., A.I. ose R.S.. Ajo e njohte R.B., por jo edhe A.D. ose A. (të njohur si L.) nga Kaçaniku. Ajo deklaroi se nuk kishte borxhe, mëri ose çështje të pazgjidhura mes asnjërit prej këtyre personave dhe familjes së saj.
501. A. S. deklaroi se ajo nuk e njohte asnjërin prej të pandehurve në këtë rast, e as nuk i kishte parë ata më parë ose që ajo të kishte lidhje me ta. Asaj nuk i kujtohej nëse kishte dëgjuar për M.S. n para ose pas arrestimit të babait të saj. Ajo deklaroi se ishte xhaxhai i saj K., ai që e kishte përmendur atë. Ajo ishte me anëtarë të tjerë të familjes në atë kohë.

Ajo deklaroi se më pas ajo kishte mësuar për M.S. dhe B.SH. duke i lexuar deklaratat në rastin e babait të saj.

502. Kur ajo e kishte vazhduar dëshminë e saj më 2 korrik 2015, ajo kishte deklaruar se e dinte se babai i saj ishte arrestuar më 30 maj 2012. Asaj nuk i kujtohet se kush saktësisht e kishte njoftuar atë për arrestimin e tij. Ajo deklaroi se fillimisht familja ishte përpjekur ta mbante këtë të fshehur nga fëmijët. Ajo deklaroi se xhaxhallarët e saj ishin ata që në të vërtetë i kishin dhënë forcë babait të saj dhe ishin përpjekur ta ndihmonin atë. Ata ishin K, A. dhe A.S.. Ajo deklaroi se edhe XH.B. kishte bërë ashtu. Ajo deklaroi se ata ishin përpjekur të gjenin ndonjë gjë për ta zbuluar të vërtetën dhe po ashtu ishin përpjekur të gjenin avokatë. Ajo nuk e dinte nëse ata kishin folur me gjyqtarë, prokurorë, policinë, e dëshmitarët përveç se kishin folur me avokatët. Antigona S.deklaroi se babai i saj ishte në paraburgim gjashtë deri në shtatë muaj. Ajo e dinte se ai kishte një numër avokatësh.

503. A. S. u pajtua me përmbajtjen e deklaratës së saj të mëhershme në kuptimin se dy zyrtarët policorë më pastaj e vizituan shtëpinë e familjes, por se asaj nuk i kujtohej se kush i kishte treguar për këtë. Asaj i kujtohet se kishte shkuar në dyqan në Kaçanik për të blerë për t'u shërbyer atyre diçka. Asaj nuk i kujtohej saktësisht se kur ishte kjo por ishte afërsisht një ose dy javë pas liritimit të babait të saj. Ajo nuk mund t'i përshkruante ata. Ajo besonte se babai i saj nuk ishte i pranishëm. Ajo nuk e dinte qëllimin e vizitës së tyre. Ajo nuk u kishte shërbyer atyre.

504. Në përgjigje ndaj pyetjeve nga i pandehuri M.S. , dëshmitarja A. S. deklaroi se ajo nuk e dinte se kush ishin palë të dëmtuara në rastin e babait të saj.

505. Dëshmitari i radhës për të dëshmuar ishte **RR.V.** Ai e kishte filluar dëshminë e tij më 2 korrik 2015. Ai e kishte kompaninë e vet të ndërtimit në Shtërpcë.

506. RR.V. deklaroi se ai e njihte B.S. që nga viti 2008 nëpërmje një miku, S.S. Ai deklaroi se ai kishte marrëdhënie normale me të dy, por ishte veçanërisht i afërt me S.n.

RR.V. i njihte Arben dhe K.S. dhe "Kompaninë Luboteni" pasi që ai kishte bashkëpunuar me të. Ai deklaroi se ai i kishte ndërtuar dy shtëpi për ta në vitet 2008-2009. Ai tha se nuk kishin para borxh mes vete. Ai e dinte se B.S. ishte pronar dhe menaxher i kompanisë. Ai e dinte se ajo ishte një kompani e madhe, e ngarkuar me punë . Ai kishte dëgjuar se B. ishte arrestuar, por ai nuk kishte dëgjuar për ndonjë efekt që kjo kishte në fatet e kompanisë.

507. RR.V. deklaroi se ai e njihte SH.S. por jo XH.B. Ai i njihte A. S., S.S. dhe M.S. Megjithatë, ai deklaroi se ai nuk do të gënjente për ta ose për askënd. Ai deklaroi se ai nuk e njihte D.D., A.B., R.S., SH.S., Sh.B. ose R.B.n. Ai deklaroi se ai i njihte A.D. dhe M.D. por vetëm nga pamja. Ai deklaroi se ai kishte dëgjuar për A. ose L. K. nga Kaçaniku, por asnjë herë nuk ishin takuar me të dhe e njëjta gjë vlente për F. ose F.H. Ai deklaroi se ai nuk i njihte asnjërin nga të pandehurit. Megjithatë, ai tani e dinte se M.S. ishte zyrtar policor. Ai e pranoi se e kishte takuar B.SH. një herë në Zvicër në vitin 1993.

508. RR.V. deklaroi se S.S. e kishte informuar atë për arrestimin e B.S., por nuk mund ta shpjegonte se pse ishte arrestuar ai. RR.V. deklaroi se S. dhe K.S. i kishin kërkuar atij €8,000. Ai deklaroi se ata kishin thënë se ato u duheshin urgjentisht, por nuk kishin thënë se për çfarë. Ai deklaroi se ai ia kishte dhënë atij një shumë të ngjashme më parë në Zvicër.

509. RR.V. konfirmoi se intervista e tij me policinë e Kosovës më 17 tetor 2013 ishte e vërtetë. Ai u pajtua se ai kishte dhënë para hua në vjeshtën e vitit 2013 dhe se ajo ishte pa kamatë. Ai deklaroi se S. kishte qenë i pranishëm kur ai e kishte paguar atë, por ai nuk ishte i sigurt nëse edhe K. ishte i pranishëm. Ai deklaroi se paratë ishin ri-paguar. Ai i kishte paratë në shtëpi. Atij nuk i ishte thënë se paratë ishin për t'i ndihmuar B. Ai kishte dëgjuar se ai ishte arrestuar pasi ai ia kishte dhënë paratë.

510. Në përgjigje të pyetjeve nga i pandehuri M.S. , RR.V. deklaroi se ai kishte pirë kafe me B.S. para seancës sepse ai nuk e dinte lokacionin e sallës së gjykatës.

511. Dëshmitari i radhës ishte **R.S.** Ai kishte filluar dëshminë e tij më 3 korrik 2015. Ai ishte zdrukthëtar që banonte në Ferizaj. Ai po ashtu ishte pronar i “M.” petrol që merrej me naftë. Ai deklaroi se ai nuk e njohte M.S. n, por që V.T. ishte një i afërm i largët nga ana e xhaxhait të tij. Ai nuk kishte lidhje me palën e supozuar si të dëmtuar. R.S. deklaroi se B.S. ishte njëri nga klientët më të mirë të “M.” petrol.
512. R.S. t i kujtohet të ketë folur me IKP-në në tetor të vitit 2013. Ai deklaroi se ai nuk dinte shumë për kompaninë “Luboteni”. Ai tha se ai gjithmonë kishte marrëdhënie të mira biznesore me B.S. Ai i njohte vëllezërit e tij. Ai deklaroi se kompania jo gjithmonë i paguante faturat e veta. Ajo kishte një borxh para arrestimit të B.S.. Ai e dinte se kompania ishte e suksesshme deri në arrestimin e B. gjë që ai besonte se ishte në vitin 2012.
513. R.S. u pajtua me përmbajtjen e deklaratës së tij të mëhershme para IKP-së se pas arrestimit të B. nga policia në vitin 2012, vëllezërit e tij kishin kaluar nëpër një krizë financiare dhe gjatë asaj periudhe kohore ata merrnin karburante me pagesa të vonuara. Atij nuk i kujtohej nëse familja e lidhte këtë problem me arrestimin e B. R.S. deklaroi se ai e njohte XH.B.n si klient në dyqanin e tij të mobileve por që nuk kishte folur me të për arrestimin ose telashin ligjor të B.
514. R.S. deklaroi se nuk e njohte D.D., por ai i njohte RR.V. A.B., R.B.n, por që ai nuk i njohte A.D., M.D. ose A.K. (të njohur si L.) nga Kaçaniku, por ai i njohte F. dhe F. H., pasi që ishin kushërinj të largët. Ai deklaroi se ai nuk kishte njohuri për M.S. n, por që ai e njohte V.T.n se ai ishte kushëri i largët dhe se ai punonte në ndërtim. Ai e njohte B.SH. por vetëm për nga pamja si dikë që ishte nga fshati Firajë, vendi i tij i lindjes. Ai nuk e njohte R.A. të njohur si D.
515. R.S. deklaroi se pas arrestimit të B.S., A. , K. dhe S. kishin shkuar tek ai për të kërkuar para që atyre u nevojiteshin për avokat. Ai nuk ishte i sigurt, por mendon se shuma ishte €15,000. B.S. ishte në burg në atë kohë. Ai u pajtua se ai i kishte thënë policisë në deklaratën e tij të mëhershme se ata mund ta zgjidhnin problemin e B.S. me

këtë shumë parash. Paratë duhet të ishin hua. Ai u pajtua se K. po i lutej atij dhe po qante. Atij i kujtohet të ketë dhënë €7,000-8,000 dhe pjesa tjetër ishte siguruar nga dikush tjetër. Ai u pajtua se kishte kontaktuar me një shofer kamioni/taksie të quajtur A. lidhur me bilancin e huasë. Ai nuk e dinte nëse A. dhe K. do ta garantonin huanë. Ai e dinte se më pastaj ata ishin takuar dhe se paratë ishin kthyer, ndërsa B.S. ishte ende në burg në atë kohë. R.S. deklaroi se K.S. e kishte informuar atë se dikush i kishte kërkuar këto para dhe se kjo kishte të bënte me rastin e B.S..

516. Në përgjigje të pyetjeve nga avokati i të pandehurit M.S. , avokati A.R., R.S. u pajtua me përmbajtjen e deklaratës së tij dhënë policisë më 17 tetor 2013 në kuptimin se K.S. i kishte kërkuar ato para me qëllim që t'i paguante avokatët. Megjithatë, ai deklaroi se atij nuk i kujtohej nëse ata e kishin informuar atë ndonjëherë për arsyen e arrestimit të B.S.. Ai deklaroi se nuk kishin hartuar kontratë në lidhje me huanë që ai ia kishte dhënë familjes S.

517. Në përgjigje të pyetjeve nga i pandehuri M.S. , dëshmitari R.S. deklaroi se ai nuk e dinte se pse ishte arrestuar B.S. ose pse ai në fund e kishte pranuar fajësinë. Ai nuk e dinte se ishte policia ajo që e kishte arrestuar atë.

518. Në përgjigje të pyetjeve nga pala e dëmtuar, B.S., R.S. deklaroi se ai ishte njëri nga klientët e tij më të mirë deri në arrestimin e tij, por që pas asaj kohe kishte pasur një reduktim prej 95%.

519. Dëshmitarja e radhës ishte **SH.S.** Ajo e kishte filluar dëshminë e saj në seancën e 9 shtatorit 2015. Ajo është bashkëshortja e B.S. dhe nëna e A., A. dhe M. S.. Ajo deklaroi se familja ishte mirë ekonomikisht prej vitit 2010 deri më 2012 kur B.S. ishte arrestuar, por pas kësaj situata u bë, “katastrofike”. Ajo deklaroi se ajo kishte kryer disa funksione administrative në kompaninë “Luboteni”.

520. Sh. S. deklaroi se D.D. ishte i njohur për të sepse ai kishte punuar me B. Megjithatë, ajo nuk i njohte RR.V., A.B. ose R.S.. Ajo nuk e njohte Sh.B., R.B.n dhe B.D.

nga kompania "Burimi". Ajo deklaroi se nuk i njihte M.D., A.K. (të njohur si "L."), F. ose F.H., Sh.O.ose N.S.. Ajo e deklaroi B.n e saj se me sa kishte ajo dijani, nuk kishte para borxh mes familjes S.dhe këtyre njerëzve.

521. SH.S.. deklaroi se ajo nuk e njihte asnjë zyrtar policor duke përfshirë M.S. n. Ajo deklaroi se kishte dëgjuar për emrat e M.S. dhe B.SH. për herë të parë pas arrestimit të bashkëshortit të saj. Ajo deklaroi se XH.B. dhe A.S. i kishin përmendur ata "*sepse atyre u duheshin para për ta liruar B.n*". Ajo deklaroi se shuma e përfshirë ishte €6,000-7,000. Ajo deklaroi se kjo ishte menjëherë pas arrestimit të B. Ajo deklaroi se ajo e dinte se ata kishin pasur takime për të diskutuar për rastin e B. me qëllim që ta lironin atë. Ajo deklaroi se me ta kryesisht janë marrë XH.B., A. Dhe K.S..

522. Sh. S. deklaroi se ajo e kishte dëgjuar se bashkëshorti i saj ishte arrestuar për trafikim të qenieve njerëzore, por ajo e dinte se kjo ishte gënjeshtër sepse ajo e dinte se bashkëshorti i saj ishte arrestuar për para. Ajo fillimisht deklaroi se askush nuk e dinte se pse ishte arrestuar ai, por pasi ai ishte sjellë në Prishtinë ata kishin marrë vesh për akuzat.

523. SH.S.. deklaroi se ka pasur diskutime brenda familjes në lidhje me kontaktimin e prokurorëve, gjyqtarëve, dëshmitarëve, të afërmëve dhe të policisë, në përpjekje për t'i ndihmuar B. Ajo e dinte se bashkëshorti i saj kishte caktuar tre ose katër avokatë dhe se nuk ishte e lehtë që ata të paguheshin. SH. S. deklaroi se bashkëshorti i saj ishte liruar më 27 nëntor 2012. Ajo deklaroi se ai kishte ardhur në shtëpi pas orës 6 të mbrëmjes dhe se kishte mbi 30 mysafirë, kryesisht të afërm të familjes përfshirë mbesa, xhaxhallarë, dhe halla për ta përshëndetur atë. Edhe XH.B. ishte atje. Ajo deklaroi se familja ishin shumë të lumtur.

524. SH. S.deklaroi se asaj i kujtohet që pas lirimit të B., M.S. dhe B.SH. kishin ardhur te shtëpia e saj. Ajo deklaroi se ajo nuk i kishte parë ata. Ajo e kishte përgatitur darkën por që nuk e kishte shërbyer atë. Në atë kohë, ajo nuk e dinte se kush ishin këta dy burra. Ajo tha se ata kishin kontaktuar me XH.B., i cili kishte kontaktuar me B.S.n për t'i ftuar ata. Ajo deklaroi se ata i kishin thënë babait të B.t se ata kishin ardhur për të kërkuar

ndjesë për arrestimin e tij. Ajo deklaroi se ata kishin mbërritur, ajo ishte në shtëpinë tjetër në kompleksin familjar ku babai i B., Bedriu, vetë B. dhe M.S.ishin të pranishëm me vizitorët në shtëpinë e B.S. Asaj nuk i kujtohet nëse XH. ishte atje. Ajo deklaroi se K. and A. S. kishin shkuar në Kaçanik për të blerë ushqim special.

525. SH.S. deklaroi se kur bashkëshorti i saj ishte arrestuar për herë të dytë, djali i tyre, M., ishte me të. Ajo deklaroi se atë e kishin thirrur dhe i kishin thënë se po e thërriste policia dhe kur B. ishte arrestuar, i pranishëm ishte edhe M.S. Ajo deklaroi se B. e kishte informuar atë për këtë gjë dhe për një bisedë që ai kishte pasur me M.S. n rreth punëve në ndërtim kur ai ishte arrestuar për herë të parë. Ajo deklaroi se B. ishte në Gjilan kur ai e kishte pranuar thirrjen dhe ata i kishin thënë atij se duhej në lidhje me punën, në të cilën B. ishte përgjigjur *“Jam në Gjilan dhe do të më marrë do kohë”* kështu që ata shkuan në Gjilan ku ishte ai dhe e çuan drejt e në burg.

526. Në përgjigje të pyetjes nga avokati i të pandehurit M.S., avokati A.R., SH.S..deklaroi se ajo nuk kishte përfunduar asnjë trajnim formal në çështjet komerciale ose financiare. SH.S..deklaroi se ajo e kishte një vëlla, G.A., i cili është duke e vuajtur dënimin. Ajo deklaroi se me sa dinte M.S. nuk e kishte arrestuar atë dhe se nuk kishte asnjë lidhje mes vëllait të saj dhe rastit të B.t.

527. A.R. i tha SH.S.t se nuk ishte normale ose tradicionale t’u shërbehet njerëzve ushqim special për tre orë kur ata kishin ardhur të kërkonin ndjesë për një gabim të rëndë që ata ia kishin bërë asaj familje. SH.S..u përgjigj se u mbetej M.S. dhe B.SH. që ta shpjegonin se pse ata kishin ndenjtur aq gjatë. SH.S..deklaroi se ajo nuk i kishte dhënë asnjë para personalisht M.S. dhe se as ai asnjëherë nuk kishte kërkuar ndonjë para nga ajo.

528. Në përgjigje të pyetjeve nga vetë M.S. , dëshmitarja SH.S..deklaroi se ai e kishte pranuar fajësinë (megjithëse ai ishte i pafajshëm) dhe kishte katër avokatë mbrojtës, *“që ta bënë të mundur që ai të dilte para drejtësisë”*. Ajo deklaroi se policia nuk e kishte

kontrolluar shtëpinë e saj pas arrestimit të B.t, por që "*Kompania Luboteni*" ishte kontrolluar por ajo nuk e di se nga kush.

529. SH.S. deklaroi se B. ishte thirrur nga policia dhe ishte arrestuar për herë të dytë më 4 janar 2013. Ajo deklaroi se ai i kishte vuajtur shtatë muaj në arrest shtëpiak dhe gjatë kohës së arrestit shtëpiak kishte marrë një thirrje telefonike nga M.S. që në thelb i kishte thënë atij se ai ishte me fat që është vetëm në arrest shtëpiak. Ajo e deklaroi B.n e saj se arrestimi i dytë ishte në lidhje me veprat e ngjashme sikurse të arrestimit të tij të parë dhe se policia po kërkonin një zonjë serbe, Sanella. Ajo deklaroi se arrestimi i parë kishte të bënte me dy zonja, por vetëm se qëllimi i vërtetë ishte të shkatërrohej B. dhe krejt çështja kishte të bënte me paratë.

530. Dëshmitari i radhës për të dëshmuar ishte **D.D.**. Edhe ai e kishte filluar dëshminë e tij para trupit gjykues në shqyrtim kryesor më 9 korrik 2015. Ai deklaroi se ai punonte si shofer i kamionit transportues që nga viti 1996. Ai deklaroi se ai kishte punuar për kompanitë "*Burimi*", "*Bageri*", "*Euro Trans*" dhe "*Luboteni*". Ai deklaroi se ai e njohte një person me emrin S. si menaxher transporti i disa prej kompanive të lartpërmendura. Ai deklaroi se ai asnjëherë nuk kishte pasur rast të dërgonte mall në stacionin e policisë në Ferizaj në emër të policisë.

531. D.D. deklaroi se ai e njohte K.S. nga puna e tij me "*Kompaninë Luboteni*". Ai i njohte edhe A.S. dhe B.S. që shumë vjet nëpërmjet punës së tij. ai e dinte që B. ishte drejtor i kompanisë dhe se kompania kishte mes 50 deri 70 të punësuar. Ai deklaroi se kompania kishte nam të mirë para arrestimit të B.t. Megjithatë, ai deklaroi se pas arrestimit të tij kishte shumë ndryshime dhe pagesat vonoheshin. Shumë punëtorë u bënë tepricë pasi që kishte më pak punë për të kryer.

532. D.D. deklaroi se ai i njohte XH.B. dhe A.S., vëllain e B.t. Ai i njohte edhe M.S. dhe S.S. Ai deklaroi se në periudhën prej 2010-2012 ai nuk u kishte borxh asgjë këtyre personave, e as ata nuk i kishin borxh atij, e as që kishte ai ndonjë lloj kontrate

ekskluzive me B.n ose kompaninë e tij. Ai deklaroi se nuk kishte ndonjë mëri ose çështje të pazgjidhur as mes tij, e as prej familjes S.

533. D.D. deklaroi se ai i njihete anëtarët e familjes së B.S. dhe se ishte shoqëruar në shtëpinë familjare shumë herë. Megjithatë, ai deklaroi se ai nuk kishte njohje me RR.V., A.B. e R.S., por se e njihete R.B., pasi që kishte punuar në komunën e Shtërpcës. Ai deklaroi se i njihete edhe A.D., M.D., por që ai nuk e njihete A.K. (të njohur si L.) nga Kaçaniku ose F. e F. H.. Ai deklaroi se ai kishte punuar me S. i lidhur me kompaninë "Bageri" nga viti 2007. D.D. deklaroi se ai nuk e kishte të njohur emrin e M.S. t. Ai deklaroi se ai e njihete njëfarë B. që punonte në "Kompaninë Luboteni".

534. D.D. deklaroi se ai kishte dëgjuar për arrestimin e B.S., por jo edhe për atë se cila forcë policore ishte e përfshirë. Ai deklaroi se ai ishte në kontakt me vëllezërit e tij dhe kishte dëgjuar se ai ishte arrestuar dhe vënë nën paraburgim. Ata nuk e kishin informuar atë për arsyen. Ai nuk ishte në dijeni se familja e tij kishte diskutuar se si mund t'i ndihmonin atij. Ai nuk e dinte se cili prej familjes së tij ishte përfshirë në ndihmë sa i përket rastit të B. Ai nuk e dinte nëse familja e tij kishte ndonjë kontakt në polici ose gjyqësor.

535. Kur ai e vazhdoi dëshminë e tij më 10 korrik 2015, ai deklaroi se ai ishte me njërin nga vëllezërit e B. kur ai ishte liruar në mbrëmjen e 27 nëntorit 2012.

536. Në përgjigje të pyetjeve nga avokati i të pandehurit M.S. , avokati A.R., D.D. deklaroi se nga data kur ishte arrestuar B.S. e deri në ditën e lirimit të tij nga paraburgimi, ai kishte kryer punë për "Kompaninë Luboteni". Ai deklaroi që B.S. e kishte kontaktuar atë për transportim të zhavorrit.

537. Dëshmitarja e radhës për të dhënë dëshminë ishte **znj. Sh.B.** Ajo e filloi dëshminë e saj më 10 korrik 2015. Ajo është e martuar me K.S. dhe si rrjedhojë është kumatë e B.S.. Ajo deklaroi se nuk ishte e afërme e H. S. dhe A.XH.

538. SH.B. deklaroi se në vitet 2011-2012, gjendja e saj ekonomike ishte e mirë për shkak se familjet e saj të ngushta dhe të gjera po punonin, por pas arrestimit të B. gjendja u përkeqësua. Ajo kishte familje e cila po mbijetonte vetëm me ndihmën nga pensioni i B.S. dhe "Kompania Luboteni" ishte detyruar të pezullojë shumë punëtorë nga puna.
539. SH.B. deklaroi se ajo i njihte D.D. dhe RR.V. për nga pamja, por jo edhe A.B., R.S., R.B.n, A.D., M.D., F. ose F.H. ose A.K., por ajo kishte dëgjuar për B.D.. Ajo nuk ishte në dijeni nëse ndonjëri prej tyre i kishte borxh para familjes S.dhe anasjelltas në periudhën kohore mes viteve 2010 dhe 2013.
540. SH.B. deklaroi se ajo nuk i kishte dëgjuar më parë emrat e M.S. ose V.T. Ajo nuk kishte dëgjuar për emrin e R.A. ose "D.t". Ajo deklaroi se ajo kishte dëgjuar se M.S. kishte punuar si zyrtar policor në vitet 2012-2013. Ajo kishte dëgjuar të përmendej emri i B.SH. dhe se ai kishte pasur diskutime me A. dhe K.S. dhe XH.B., por ajo nuk e dinte se për çfarë ishin ato.
541. SH.B. deklaroi se M.S. dhe B.SH. erdhën në shtëpinë e saj dhe kërkuan falje nga vjehri i saj. SH.B.deklaroi se XH.B. e informoi atë se M.S. dhe B.SH. kishin ardhur për të shprehur keqardhjen e tyre në lidhje me arrestimin e B.t. Ajo e dinte se ata ishin zyrtarë policorë dhe se kishin ardhur pas lirimit të B.t.
542. Në përgjigje të pyetjeve nga avokati i të pandehurit M.S., avokati A.R., dëshmitarja SH.B.deklaroi se M.S. dhe B.SH. të dy kishte ardhur vetëm dhe vullnetarisht në shtëpinë e saj. Ajo deklaroi se me sa kuptonte ata kishin ardhur për të kërkuar falje. Ajo deklaroi se atmosfera nuk ishte armiqësore ose ndonjë ambient kërcënues.
543. SH.B.deklaroi se e kishte kuptuar se arrestimi i parë i B.S. ishte në lidhje me disa gra, por me sa kishte dëgjuar ajo, "ata kishin marrë dëshmi të rreme".
544. Dëshmitari i radhës ishte **H.S.** Ai e filloi dëshminë e tij në seancë më 13 korrik 2015. Ai deklaroi se kishte punuar si mekanik, por që tani punonte në një restorant.

545. Ai deklaroi se kishte njëfarë përvoje ushtarake dhe ishte i trajnuar për përdorimin e armëve të zjarrit. Ai deklaroi se ai e kishte një bar të quajtur “*International*” në fshatin Prelez menjëherë në të dalë të magjistrales Ferizaj-Prishtinë, por që e kishte lënë atë në vitin 2014 dhe se tani ishte menaxher në “*Restaurant Burdushi*” në fshatin Gadime që një vit e gjysmë. F.B. ishte pronari.
546. H.S. deklaroi se në vitin 2013 ai ishte pronar i barit “*International*”. Atje kishte muzikë të gjallë me vallëzim dhe këndim. Valltaret ishin femra. Klientët ishin kryesisht meshkuj të moshës prej 20-50 vjeç, ndërsa valltaret ishin prej moshës 22 deri 30 vjeç. Biznesi nxirrte fitime modeste. Ai deklaroi se kishte sigurim, por që kjo i ishte imponuar atij. Një nga “*zyrtarët*” e sigurimit ishte R.A.. Ai deklaroi se R.A. nuk i kishte thënë asgjë drejtpërdrejt atij, por ai kishte ardhur në restorant dhe kishte filluar të thyente sende, grindej me mysafirët kështu që unë e mora atë në punë. Ai deklaroi se kur ishte esëll ai ishte në rregull, por kur ishte nën ndikimin e alkoolit ai ishte temperament.
547. H.S. deklaroi se ai e dinte se D. kishte miq të rëndësishëm, por ai nuk e dinte se kush ishin miqtë e tij. Ai deklaroi se kishte shkuar në atë bar dy ose tre herë me M.S. në cili kishte të veshura rroba civile, por ai e dinte se ai ishte zyrtar policor.
548. H.S. deklaroi se ai i kishte punësuar dy kamerierë meshkuj, një banakier dhe deri dhjetë këngëtare dhe valltare. H.S.deklaroi se disa nga mysafirët e tij nuk donin të ishin atje kur ishte i pranishëm M.S. , pasi që ai ishte zyrtar policor. Ai deklaroi se kishte kërkuar nga ai me mirësjellje që ai të mos vinte, por ai kishte refuzuar. Ai deklaroi se M.S. ishte përgjegjës për mbylljen e lokalit të tij disa herë.
549. H. S. deklaroi se ai nuk i njohte K. ose A.S., por se ai e njohte B.S. Ai e dinte se ai kishte një kompani dhe ata vinin nga i njëjti fshat. Ai deklaroi se ai nuk shoqërohej me të, por nganjëherë ai vinte në barin e tij “*për qejf*”. Ai nuk e dinte nëse ai ishte atje kur M.S. ishte atje dhe se D. asnjëherë nuk e kishte pyetur për atë. Ai nuk e njohte familjen e tij. Ai deklaroi se ai nuk i njohte B.H., R.Y.n, H.B., M.S. ose B.S.n.

550. H.S.e mbështeti përmbajtjen e deklaratës së tij para IPK-së të 11 shtatorit 2013. Ai deklaroi se M.S. nuk i kishte ndihmuar asnjëherë atij në asnjë çështje që kishte të bënte me restorantin. Ai tha se hera e vetme ishte kur ai e kishte thirrur që të vinte dhe ta merrte R.A. H.S. deklaroi se M.S. zakonisht i inspektonte lokalet një herë në muaj, por nganjëherë shumë më pak. Ai vinte me mes 15-20 kolegë. Nganjëherë i pranishëm ishte edhe B.SH.. Megjithatë, ai deklaroi se ata nuk shkonin në restorant së bashku kur ishin jashtë detyrës. H.S.deklaroi se ai nuk e njihte V.T.
551. H.S. deklaroi se ai kishte pirë kafë me M.S. në ditën kur R.A. “kishte shkaktuar probleme”. Ai po ashtu kishte pirë kafë me të te “*Euro-Miti*” dy ditë më pas. Ai deklaroi se të pranishme ishin edhe A.XH., Z.N. dhe motra e A. Ai deklaroi se ai i kishte parë M.S. n dhe R.A. të pinin kafë dy herë në vitin 2013, por atij nuk i kujtohej ndonjë rast më shumë se ky. H.S.deklaroi se A.XH.ishte punëtore e tij. Ajo ishte valltare. Ajo u bë punëtore në vitin 2012.
552. H.S. u pajtua se kishte pasur një incident me të shtëna ku ishte i përfshirë R.A. në restorantin e tij dhe A.XH. ishte duke punuar atje në atë kohë. Ajo vazhdoi të punonte pas kësaj. Atij i kujtohet që R.A. kishte ardhur në “*Restorant International*” më 29-30 maj 2012. Ai ishte nën ndikim të alkoolit dhe kishte pirë edhe në restorant dhe pastaj kishte filluar t’i thyente gotat, në atë moment H.S.e kishte kapur atë për ta nxjerrë jashtë dhe ai kishte dalë jashtë derës, prapa restorantit, dhe ai kishte shtënë në drejtim të veturës së A.XH.. Ai deklaroi se kjo ishte rreth orës 2 ose 3 në mëngjes. Ai deklaroi se deklarata e tij e mëhershme në kuptimin se ai kishte ardhur me A.XH. dhe Z.N. (me pseudonimin M.) nuk ishte e vërtetë, se ai kishte ardhur vetëm dhe se ato tashmë kishin qenë atje. Ai deklaroi se R.A. kishte një mosmarrëveshje me to dhe i kishte kërcënuar të dyja ato, kështu që ai e kapi D. dhe e qiti jashtë. Ai deklaroi se Z. ishte paksa e dehur, por A. nuk ishte. Ai deklaroi se R.A. e kishte nxjerrë armën e tij dhe kishte shtënë në veturën e A.XH., Peugeot 206. Ai deklaroi se i ishte afruar atij, ia kishte marrë armën e tij, i kishte thënë atij të shkonte në shtëpi dhe e kishte dërguar atë te vetura e tij. Pastaj ai i kishte thirrur disa të afërm të D., por asnjëri prej tyre nuk përgjigjej në telefon, kështu që ai në

fund e thirri M.S. Ai deklaroi se kishte kërkuar nga ai që të vinte dhe ta dërgonte D. në shtëpi për arsye se ai po shkaktonte telashe dhe ai tha se do të vinte. Pas më shumë se 20 minutash, ai nuk kishte ardhur kështu që ai e kishte thirrur përsëri dhe M.S. arriti dhe e la atë me D. në veturën e tij (M.).

553. H.S. deklaroi se rreth 40-45 minuta më vonë M.S. e kishte thirrur atë. Ai kishte deklaruar se e kishte thirrur atë më herët për arsye se e dinte se ai ishte zyrtar policor dhe se e kishte numrin e tij nga një kohë e mëhershme kur ai i kishte mbyllur lokalet e tij. H.S.deklaroi se ai nuk e kishte thirrur stacionin e policisë sepse nuk donte ta bënte të madhe këtë situatë. Ai deklaroi se ai nuk e dinte se M.S. ishte epror me gradë të lartë. Ai deklaroi se nuk kishte viktima. Ai deklaroi se punëtorët e tjerë, domethënë, V.T. dhe R.H. i kishin propozuar që ta thërriste M.S., H.S. deklaroi se në atë kohë e dashura e R.A. ishte një vajzë me emrin Z., por ai nuk e kishte numrin e saj.

554. H.S. deklaroi se fillimisht ai nuk i kishte treguar M.S., se R.A. e kishte shkrehur armën e zjarrit. Ai deklaroi se kur kishte mbërritur në restorant R.A. u ngrit në këmbë dhe shkoi në tualet, ai po qante, dhe pastaj M.S. pyeti se çfarë në të vërtetë kishte ndodhur se çfarë problemi kishte ai. Ai deklaroi se ai kishte ndenjur brenda restorantit por që stafi e kishte informuar atë se M.S. e kishte larguar R.A. tutje te restorant “D.” nga ku më vonë R.A. e kishte thirrur atë dhe ai po qante dhe ai kishte thënë se donte të kërkonte falje, kështu që H.S.kishte shkuar në “International” me A.Xh. , Z.N. dhe A.

555. H.S. e vazhdoi dëshminë e saj në seancë më 16 korrik 2015. Ai deklaroi se R.A. u kishte kërkuar falje zonjave në restorant D. dhe ato kishin këmbëngulur se ato nuk donin të inicionin hetim penal. Ai deklaroi se ata ishin larguar shumë shpejt pas kësaj, e edhe ai e kishte bërë të njëjtën gjë dhe kishin mbetur vetëm M.S. dhe R.A..

556. Ai u pajtua me përmbajtjen e deklaratës së tij të mëhershme në kuptimin që, *“vajzat erdhën dhe pinë kafe me ne, D. u kërkoj falje atyre duke thënë se ishte nën ndikimin e alkoolit dhe ne i pimë ato kafe dhe vajzat shkuan, e edhe unë shkova, e po ashtu edhe M.S. . Me sa më kujtohet pas dy ditësh, A., Z. dhe D. më tha se ato ishin*

thirrur nga M. ku i kishte pyetur nëse ato do të donin të ankoreshin kundër D.t dhe ato e vunë në dijeni se jo dhe çështja ishte mbyllur". Ai tha se ishte një vendim reciprok i përbashkët nga ana e vajzave dhe e atij që ta thërrisnin M.S. Ai pretendon se vajzat thanë që mos thirrej policia dhe ai nuk e kishte thirrur policinë për shkak të natyrës së biznesit të tij.

557. H.S. deklaroi se R.A. ishte vetëm 5-6 metra më tutje nga vetura e A. XH. kur ai kishte shtënë dy ose tre herë në të. Ai deklaroi se ishin një numër i madh i punëtorëve të tjerë të pranishëm, por që ai ishte më së afërmi.

558. Ai u pajtua që ai e njihte M.S. si "M." në kohën e incidentit, por e mohoi se ishin miq ose se ai ishte nën ndikimin e tij. Ai e mohoi deklaratën e tij të 13 shtatorit 2013 para prokurorit në të cilën ai gjoja kishte thënë se ai ishte, "si mik i imi". Ai tha se atij nuk i kujtohet se si ka ndodhë që ai ta ketë numrin e tij kur e kishte thirrur atë pas incidentit me të shtëna. Ai po ashtu e mohoi pjesën e deklaratës kur ai gjoja kishte thënë, "të dy ata, M.S. dhe R.A. janë nga Ferizaj. Ai e njeh R., ata kanë miqësi mes tyre dhe unë iu luta që të vinte dhe të merrej me këtë". Ai deklaroi se e dinte që M.S. do ta largonte R.A.n nga atje dhe do ta qetësonte atë dhe kjo është ajo çfarë në të vërtetë kishte ndodhur. Ai u pajtua se fillimisht M.S. kishte reaguuar, "Pse nuk po e thërret policinë?" Ai e pranoi se e kishte zmadhuar incidentin me qëllim që ta bindte M.S. n që të vinte. H.S.deklaroi se M.S. kishte bërë përpjekje për ta hetuar rastin. Ai deklaroi se ai kishte kontaktuar me vajzat dhe i kishte ftuar ato të shkonin në stacionin e policisë, por ato nuk kishin dashur të inicionin rast kundër R.A.t. Ai deklaroi se ai nuk e dinte nëse M.S. e kishte çuar R.A.n në stacionin e policisë për procedim.

559. H.S. deklaroi se vajzat shkuan me të në veturën e tij te restorant "D." dhe nga restoranti ato kishin shkuar në shtëpi me taksì dhe ai kishte shkuar në shtëpi për t'ia ndrequr veturën A. XH.. Në restorantin "D.", ai e përsëriti se D. po qante, ai kërkoi falje për veprimet e veta dhe kishte ofruar që t'ia ndreqte veturën. Në pjesën më të madhe të kohës M.S. ishte i heshtur. Megjithatë, ai i pyeti ato nëse ato do të donin që R.A. të ndiqej penalisht dhe ato thanë se nuk dëshironin. Ai tha se më vonë e kishte thirrur A.

XH. për ta parë nëse ajo ishte në rregull dhe brenga e saj kryesore ishte që vetura e saj ta ndreqej. Ai këmbënguli se ai ishte vetëm kur e kishte bërë këtë thirrje.

560. H.S. deklaroi se R.A. e kishte thirrur të nesërmen dhe e kishte ftuar në apartamentin e tij në Ferizaj për çaj dhe se ai kishte shkuar.

561. H.S. deklaroi se vetura e A. XH. ishte ndrequr në një garazh në Ferizaj rrugës për në Gjilan. Dritaret ishin blerë në Lipjan. Ai deklaroi se R.A. kishte paguar për dritaret dhe se ai kishte paguar për punën. Ai deklaroi se fatura e përgjithshme ishte €300 dhe në thelb ata e kishin paguar gjysmën sosh secili prej tyre. Ai tha se ai ndihej se duhej të paguante se ai i kishte dhënë atij alkoolin që e kishte dehur atë.

562. H.S. u pajtua se kur kishte dëgjuar se vajzat po planifikonin të largoheshin nga Kosova dhe të ktheheshin në Shqipëri, ai i dërgoi A. XH. një SMS për ta inkurajuar atë që të mos e bënte këtë dhe të ndërlidhej me M.S. nëse kishte ndonjë problem dhe ai do të mund t'u ndihmonte atyre.

563. H.S. deklaroi se R.A. nuk punonte më për të, e as vajzat, por ato u larguan pas R. por jo menjëherë. H.S.deklaroi se ishte edhe një incident tjetër ku përfshihej R.A. në restorantin e tij, “*Burdushi*” në vitin 2014. Kishte një grindje mes tij dhe disa mysafirëve të tjerë. Ata kishin filluar të gjuanin filxhanë dhe gota në njëri-tjetrin.

564. H.S. deklaroi se edhe R.A. i kishte dërguar një SMS që i ishte përcjellë atij nga punëtorët e tij në të cilin gjoja R.A. kishte thënë se “*ai do të vinte në restorant dhe do të na vriste të gjithëve me kallashnikov*”. Ai deklaroi se e kishte thirrur D. drejtpërdrejt dhe e kishte biseduar me të, ata kishin dalë dhe pirë kafe, dhe ai e kishte pyetur atë se çfarë ishte problemi pasi që ai nuk ka asnjë problem me të. Ai tha se nuk kishte problem.

565. Në përgjigje të pyetjeve nga avokati i të pandehurit M.S. , avokati A.R., H.S. deklaroi se ai nuk e dinte nëse M.S. ishte mik i R.A. ose jo, por ai i shihte ata së bashku nganjëherë. Ai e përsëriti se në fillim ai nuk i kishte treguar M.S. për dëmin e shkaktuar në veturë nga arma, pasi që nuk dëshironte ta bënte këtë gjë të madhe.

566. H.S. deklaroi se gjersa ai ishte i pranishëm ai nuk kishte dëgjuar që M.S. dhe R.A. të bënin ndonjë bisedë, e ai as nuk kishte dëgjuar që M.S. t'i premtonte R.A. se ai do të fshihte ndonjë gjë, se ai do të rregullonte ndonjë lloj dokumenti si pasaportë ose ndonjë gjë për udhëtim jashtë vendit. Ai nuk e kishte dëgjuar atë të thoshte as se ai do ta mbronte atë.
567. Në përgjigje të pyetjeve nga pandehuri M.S., dëshmitari H.S.konfirmoi se ishte një grup multi-disiplinar që e kishte inspektuar lokalin, por ishte i pandehuri M.S. përgjegjës për mbylljen e kësaj. Ai deklaroi se ai kishte paguar një gjobë prej €1,000 përkitazi me shkeljet e legjislacionit të punësimit. Ai u pajtua që edhe lokalet tjera ishin kontrolluar, por se ai nuk e dinte nëse edhe ata kishin paguar gjoba.
568. H.S. deklaroi se R.A. e kishte informuar atë se ai e kishte njohur M.S. nëpërmjet xhaxhait të tij. Ai konfirmoi se ishte vendim i përbashkët nga ai dhe vajzat që të shtënat mos t'i bënin gjë të madhe. Ai deklaroi se nuk ia kishte bërë me dije M.S. se ai u kishte dërguar një SMS vajzave në emër të tij. Ai u pajtua se ai fillimisht i kishte thënë atij se dritarja ishte thyer nga shishet dhe në restorant "D.", M.S. e kishte informuar atë madje nëse ishte kështu atëherë do të duhej ta raportonte këtë në polici. Ai u pajtua se M.S. e kishte këshilluar atë që edhe nëse ai nuk donte ta raportonte këtë tek ai, ai mund ta raportonte atë tek cilido zyrtar policor në Kosovë.
569. Në përgjigje të pyetjeve të mëtejme nga prokurori, H.S. u pajtua se veprimet e tij pas të shtënave, përfshirë thirrjen e M.S., kishin për synim që të mbulohej ajo që kishte ndodhur.
570. Dëshmitarja e radhës për të dëshmuar ishte **A. XH.** Ajo e filloi dëshminë e saj më 23 korrik 2016.
571. Ajo deklaroi se ishte valltare që punonte në një klub në Lipjan. Ajo deklaroi se në vitet 2012-13 punonte si valltare në kafenenë "International". Ajo u pajtua se prokurori e

kishte intervistuar atë më 11 shtator 2013 dhe se përgjigjet e saj atëherë ishin të vërteta. Ajo deklaroi se me sa i kujtohej asaj më së miri, ajo nuk kishte punuar atje pas muajit gusht 2013. Ajo deklaroi se ishte një lokal me muzikë të gjallë në pronësi të Heset S.t. Ajo deklaroi se shumica e klientëve ishin të mirë dhe se kishte më shumë meshkuj se sa femra. Ajo deklaroi se klientela nuk paguante për vallëzimet ose pijet për vajzat dhe se vajzave nuk u lejohej të uleshin në tavolinë me klientë. Ajo tha se klientela kishte ndryshuar shumë dhe ajo nuk kishte njohuri për shumë prej të rregulltëve.

572. A.XH .deklaroi se ajo e kishte të njohur emrin e M.S. Ajo e njohu atë në sallën e gjyqimit. Ajo nuk e dinte se ai ishte zyrtar policor, e as nuk njohte ndonjë zyrtar tjetër policor ose nëse ata e frekuentonin kafenenë *“International”*. Ajo deklaroi se ajo nuk e njohte M.S. n si dikë që kishte ardhur në kafenenë *“International”* gjersa ajo punonte atje.

573. A.XH. deklaroi se në mbrëmjen e të shtënave ajo ishte atje me motrën dhe një mikeshë. Ajo deklaroi se ajo nuk e njohte asnjë nga stafi i sigurimit në atë kohë. Ajo deklaroi se e njohte R.A., sepse e dashura e tij Z. ishte mikeshë e saj. Ata ishin shumë të afërt. Ajo i kishte parë Z. dhe R.A së bashku. Ajo e kishte parë atë në *“International”*, por nuk ishte e sigurt nëse ai ishte roje i sigurisë.

574. A.XH.deklaroi se ajo e dinte se V.S.ishte i biri i H. S. dhe që nganjëherë vinte në restorant dhe rrinte te banaku. Ajo deklaroi se D. XH. ishte motra e saj dhe njohet si A.. Ajo deklaroi se ajo e njohte edhe Z. N., e cila po ashtu njohet edhe si M. Ajo deklaroi se ajo vetë njohet edhe si J., shkurtim për A..

575. A.XH. deklaroi se ajo kishte dëgjuar për M.S. n si rezultat i rastit të tanishëm. Iu shtrua asaj këtu deklarata para prokurorit ku ajo kishte thënë, *“Jo, D. punon si sigurim në bar, dhe Meda e vizitonte barin nganjëherë”* prandaj ajo duhet ta ketë njohur atë para rastit të tanishëm. Ajo deklaroi se ajo tha *“ndoshta”* ai kishte ardhur në bar por ajo nuk i njohte të gjithë që vinin. Ajo e dinte se pseudonimi i tij ishte *“M.”* Ajo e mësoi këtë nga Heset S.. Kur ajo u takua me të në mëngjesin e incidentit, ai i kishte thënë asaj që ta

raportonte tatë tek policia por ajo kishte thënë jo. Ajo atëherë e kishte zbuluar se ai ishte zyrtar policor. Askush nuk i kishte thënë asaj se në cilin stacion ishte i caktuar ose se cila ishte grada e tij.

576. A.XH. kishte mohuar se ajo nuk kishte asnjë formë të marrëdhënieve intime me R.A.n. Ajo deklaroi se asaj nuk i kujtohej nëse ajo kishte të dashur në maj të vitit 2013. Ajo deklaroi se ajo ishte shoqëruar shumë herë me R.A. dhe Z. në atë kohë, por ajo nuk e kishte parë atë në shoqërinë e M.S. . A.XH. deklaroi se vetura e dëmtuar ishte e saj. Ishte një Peugeot 206 me numër regjistrimi AA 724 DG dhe ishte e regjistruar në Shqipëri.

577. A.XH. deklaroi se R.A. ishte në lokalin “*International*” natën kur ishte dëmtuar vetura. Ajo deklaroi se ai ishte i dehur. Ajo deklaroi se ai mund të kishte mbetur me miq, por që ajo nuk ishte e sigurt. Ajo deklaroi se kur ajo e kishte kryer ndërrimin e saj, ajo e kishte marrë rrogën e saj, kishte dalë jashtë dhe kishte parë se dritaret e pasme, dritaret në të dyja anët e veturës së saj ishin të thyera. Ajo deklaroi se R.A. ishte jashtë, i mërzhitur, duke qarë dhe i kërkonte falje asaj. Ajo deklaroi se kishte porositur një taksì dhe kishte shkuar në shtëpi me motrën dhe mikeshën e saj të ngushtë.

578. A.XH. deklaroi se R.A. e informoi atë se ai ia kishte dëmtuar dritaret pa qëllim dhe se ai kishte qenë nën ndikim të alkoolit, por ajo u pajtua se kur prokurori e kishte pyetur për këtë në shtator të vitit 2013, përgjigja e saj ishte “*Jo, në fakt nuk kishte asgjë ndërmjet tij dhe meje por mendoj se ishte për arsye se unë doja ta lija punën*”. Ajo kishte deklaruar se me sa duket H.S. ishte ai i cili i kishte treguar që ajo po e linte punën.

579. A.XH. deklaroi se H.S. i kishte bërë titull shumë R.A. t dhe dëshironte ta raportonte atë në polici, por ajo tha jo sepse ai nuk e kishte bërë këtë qëllimisht. A.XH. deklaroi se ajo nuk e dinte se pse R.A. e kishte dëmtuar veturën e saj por që ai nuk e kishte bërë këtë qëllimisht dhe se ai e kishte bërë këtë pa asnjë qëllim të keq ndaj saj. Ajo deklaroi se ajo ishte brenda kur kjo kishte ndodhur. Ajo deklaroi se ajo nuk e dinte se si e kishte dëmtuar ai veturën e saj. Ajo deklaroi se kur kishte shkuar në shtëpi, H.S. e kishte thirrur dhe kishte kërkuar nga ajo që të takoheshin dhe ta shpjegonin këtë çështje. Ajo shkoi në restorant “*D.*”. Ajo tha se atje R.A. e kishte pranuar se kishte bërë gabim kur i kishte thyer dritaret e veturës. Në fund, ajo e pranoi se kishte dëgjuar se ai e kishte shkaktuar dëmin përmes

duke shtënë në veturë me armë. A.XH. deklaroi se po ta kishte ditur ajo 100% se R.A. kishte përdorur armën, ajo do ta kishte raportuar atë sepse ai ka mundur t'i lëndonte njerëzit.

580. A.XH. deklaroi se R.A. e kishte ndrequr veturën e saj, por se ajo nuk e dinte se si dhe ku. Ajo deklaroi se ai kishte premtuar se do të paguante për këtë. Ajo u pajtua se H.S. ishte i pranishëm kur ajo ia dha çelësat e veturës, R.A. Ajo deklaroi se i kishte marrë çelësat prapë të nesërmen.

581. A.XH. ka deklaruar se H.S. i ka thënë asaj që ta raportojë rastin në Polici por ajo tha se nuk donte që ta raportonte. Ajo nuk e dinte se a ka ardhur më pas Policia sepse pas dhjetë minutash ajo kishte shkuar në shtëpi. Ajo e pranon se e kishte pranuar një SMS nga dashnorja e R.A., Z. e cila thoshte, *“Mos u shqetëso se do të paguhesh për atë”*. Ajo pohon se e ka pranuar një SMS edhe nga Z. e që thotë, *“Unë do t'i rregulloj xhamat e veturës. Për Zotin. Por unë jam më e më tepër e shqetësuar për A. e cila është e brengosur. Unë ju dua të treve. Gjumë të ëmbël!”*. Ajo tha se A. ishte me motrën e saj por ajo e ka mohuar të ketë patuar një zënkë atje brenda në restorant që rezultoi në nxjerrjen e R.A. dhe në të shtënit në veturë dhe A. u shqetësua pasi që e dinte se aty ishte përfshirë një armë. Ajo e ka mohuar që ajo ose motra e saj të kenë qenë më tepër se shokë me D.n.

582. A.Xh. ka deklaruar se kur ajo më pas shkoi në restorant “D.” me kërkesë të H. S. Ajo ka deklaruar se H.S. ishte i pranishëm me R.A. dhe M.S. iu bashkua më vonë. Ajo ka deklaruar ai i kishte thënë asaj: *“Mos të humbim as një minutë. Le të shkojnë për ta raportuar në polici.”* Ajo tha se H.S. i kishte thënë asaj se R.A. dëshironte t'i kërkoj falje asaj. A.XH. ishte pajtuar, ajo i dërgoi një SMS R.A. duke i thënë: *“ajo çka bëre ti nuk ishte e mirë”*. Ajo ka pranuar se ajo i kishte dërguar atij një SMS, pasi makina e saj ishte rregulluar.

583. A.XH. ka deklaruar se nuk i kujtohet se ka pranuar një SMS nga numri i H. S. 044 130362, më datë 05 qershor 2013, në orën 23:23 ku thuhet, *“M. po thotë merre numrin. Nëse ke diçka më lajmëro për gjithçka. Atë ditë ti ishte e drejtë. Në rregull, na thirr*

ndonjëherë, në rregull?” Po ashtu, asaj nuk i kujtohet se a e ka dërguar një SMS në numrin e M.S., më 7 qershor 2013 ku shkruhet, *“Përshëndetje i dashur, ky është numri i im. Me respekt, Jona”*. Megjithatë, ajo e pranoi se kur u pyet për këto SMS-e në shtator të vitit 2013, përgjigjet e saja ishin, *“M. ka qenë shok i D.t, dhe H. i ka thënë që ta thërrasë atë pasi që ai mund të ndihmojë në lidhje me incidentin. Nuk ka pas asgjë ndërmjet M. dhe mua.”* Ajo pohoi se M.S. dhe R.A. ishin shokë. Ajo tha se në Shqipëri është e zakonshme që ta përshëndesësh dike me fjalët, *“Përshëndetje i dashur”*.

584. A.XH. nuk i kujtohet të ketë pirë kafe me M.S. dy ditë pas incidentit. Ajo nuk e dinte se kush e ka thirrur atë, natën e 29 majit 2013. Kur u gjet nën presion ajo u pajtua me deklaratën e saj të mëparshme se ka mundur ta ketë thirrur M.S. n dhe se ajo ka pirë kafe me të dhe me motrën e saj dhe ai ju kishte thënë *“përkundër faktit se ai është një shok i imi, eja tani që ta raportoni atë (R.A.n)”*.

585. A.XH. pranoi deklarimin e saj të mëparshëm se R.A. e kishte ftuar atë njëqind herë që të shkonte në restorantin “D.” në mëngjes ditën kur kishte ndodhur incidenti. Ajo shkoi atje me shoqet e saja A. dhe M. dhe kanë qëndruar aty për 20 minuta. Ajo u pajtua me deklarimin e saj të mëparshëm se M.S. kishte thënë, *“Incidenti që kishte ndodhur, ai më ka pyetur se çka ke vendosur ti dhe madje ai më tha që ta raportoja atë në polici. Ai tha se edhe pse ai është shoku im ai duhet të dënohet dhe ta kuptoj gabimin e tij”*. Ajo e shprehu qëndrimin e saj se M.S. e ka thënë këtë sepse ai punonte për shtetin.

586. A.XH. vazhdoi dëshminë e saj më 24 korrik 2015. Ajo ka deklaruar se nuk e ka menduar si të çuditshme apo të pazakontë që dikush në polici do të merrte apo merr pjesë në një bisedë në orën 5 të mëngjesit, kur në të vërtet ai nuk ishte përfshirë në incident. Ajo deklaroi se ajo ishte atje për ta raportuar incidentin. Ajo tha se nuk është bërë raportimi sepse nuk ka dashur që këtë punë ta bëjë të madhe pasi që ajo e njihnte R.A.n.

587. A.XH. deklaroi se me sa e dinte ajo H.S. ishte brenda kur janë thyer xhamat dhe se aty ishte një zënkë ku ishin të përfshira M., D. dhe R.A. para kohës kur janë thyer xhamat.

588. A.XH. deklaroi se ajo kishte pirë kafe me A., M. dhe Z. para dhe pas incidentit. Asaj nuk i kujtohet se a ka shkuar për drekë me Z. atë ditë pas incidentit por e pranoi se

kishte shkuar. Ajo pohoi se ato kanë diskutuar për incidentin dhe ajo u pajtua me ato çfarë më parë i kishte thënë prokurorit se *“arsyeja ishte se unë do të heqja dorë dhe ai nuk ishte i kënaqur me këtë.”* Ajo pranoi se ajo i tërhiqte klientët dhe ishte shokë me Heset S.n dhe me Zanën.

589. Prokurori i tregoi A. XH. se ishte një SMS që ishte dërguar në telefonin e saj që ishte: *“044 121 611 M., vajza po thotë ky është numri, nëse ke ndonjë gjë vetëm më njofto për gjithçka pasi që atë ditë ti ishte e drejtë, thirre atë ndonjëherë, ai mund të jetë i dobishëm për neve, në rregull”* por ajo deklaroi se nuk i kujtohej kjo.

590. A.XH. deklaroi se vetëm kur ato kishin folur në restorantin *“D.”* për atë se cka ka ndodhur, atëherë M.S. e kuptoi se dritaret e veturës ishin thyer sepse kjo ka ndodhur aty dhe pastaj R.A. i tha asaj se ai i kishte thyer dritaret me grushtin e tij dhe me një shishe dhe ka kërkuar falje për këtë. Ajo e pranoi se nuk e kishte përmendur më parë dhe tha se tani sapo ju kujtua kjo gjë.

591. Në përgjigje të pyetjes së parashtruar nga A.R., avokati mbrojtës i M.S., A.XH. deklaroi se në deklaratën e saj të dhënë para prokurorit në shtator të vitit 2013, ajo ishte e vërteta. Ajo deklaroi se kur doli jashtë atë natë, ajo nuk e ka vërejtur madhësinë e copëzave të xhamit por ajo e kishte vërejtur R.A.n të ulur afërsisht 50 metra larg nga vetura. Ajo deklaroi se ai kishte qenë i shqetësuar dhe i ka kërkuar falje asaj. Ai ishte i dehur.

592. A.XH. ka deklaruar se në kafenenë *“D.”* M.S. i kishte thënë asaj, *“Ju duhet ta raportoni rastin për t’ua kompensuar dëmin, për ta marrë kompensimin”* por asaj nuk i kujtohet që ai i ka premtuar R.A. se ai do ta ndihmojë atë që të merr një pasaportë të re dhe letërnjoftim të ri, apo ndonjë dokument tjetër që ai të fshihej apo të largohej nga Ferizaji, apo ndonjë dokument tjetër mbështetës që ai të largohej nga vendi. Asaj nuk i kujtohet të ketë pasur ndonjë diskutim lidhur me armë apo ndonjë armë zjarri.

593. Në përgjigje të pyetjeve nga Kryetari i Trupit Gjykses, A.XH. e ka konfirmuar se M.S. i ka kërkuar apo e ka këshilluar që ta raportoj rastin në polici. Ajo deklaroi se ai e kishte thënë këtë në prani të R.A. dhe secili që ishte në tavolinë do ta kishte dëgjuar këtë pasi që kjo ishte thënë hapur. Ajo e konfirmoi se kishte thënë se nuk e kishte në plan ta

bënte këtë edhe pse M.S. tha se kjo gjë do të ishte në dobi të saj. Ajo ka deklaruar se edhe H.S.e kishte këshilluar që ta raportonte rastin në polici për ta marrë kompensimin. Ajo tha se edhe motra e saj dhe shoqet e kanë dëgjuar këtë këshillë. A.XH.pranoi se H.S.ishte shumë i shqetësuar me incidentin dhe se i vente keq për atë që i kishte ndodhur asaj.

594. Dëshmitarja tjetër ishte motra e A. XH. , **D. XH.** Ajo e kishte filluar dëshminë e saj në seancën e 24 korrikut 2015.

595. D. XH. ka deklaruar se në kohën kur kishte ndodhur incidenti, ajo ishte duke punuar me honorar si valltare në restorantin “*International*”. Ajo pohoi se para një prokurori të EULEX-it e kishte dhënë një deklaratë më datë 1 tetor 2013 dhe kishte dhënë përgjigjet dhe informacionet e vërteta me sa ajo ka njohuri.

596. D. XH. ka konfirmuar se ajo e ka njohur R.A.n në kafenenë “*International*” pasi që ai punonte aty në sigurim. Ajo ka deklaruar se pasi kishte ndodhur incidenti, ajo ka pirë kafe në restorantin “*D.*” me një njeri me emrin M. dhe ajo e identifikoi M.S. n të ishte ky njeriu. Ajo e dinte se ky kishte punuar në polici në Ferizaj. Ajo theksoi se ai e kishte këshilluar A. XH. që ta raportoj rastin në polici. Ajo ka deklaruar se vetëm në restorant “*D.*”, e kuptoi se M.S. dhe R.A. e njihnin njëri-tjetrin. Ajo ka deklaruar se A., M. dhe H.S. ishin të pranishëm në këtë takim. Ajo ka deklaruar ajo e dinte se Z. N. ishte e dashura e R.A. Ajo ka deklaruar se përpara incidentit ata ishin shoqëruar shumë, por jo aq shumë pas incidentit.

597. D. XH. tha se natën kur vetura e motrës së saj ishte dëmtuar, R.A. dhe shokët e tij ishin duke pirë alkool në kafenenë “*International*”. Ajo pohoi se në atë kohë ajo ishte duke punuar dhe pastaj ai doli jashtë, kur doli jashtë ai ishte i shqetësuar, dhe pas një kohe “*ne*” e kryem ndërrimin. Ajo deklaroi se kur “*ata*” dolën jashtë, ata panë xhama të thyera të veturës dhe R.A. po qante dhe ishte edhe i shqetësuar. Ajo tha se ai u kishte kërkuar falje atyre dhe pastaj ato hyrën brenda, e kanë thirrur taksinë dhe kanë shkuar në shtëpi. Ajo deklaroi se edhe ato ishin të shqetësuara. Ajo tha se kur mbërritën në shtëpi “*ata*” e thirrën A. dhe i kërkuan asaj që t’i takonte në restorantin “*D.*”. Ajo tha se ajo shkoi atje me A. dhe me Z. N. dhe R.A. u kërkoj falje edhe atyre. Ajo deklaroi se edhe

M.S. erdhi dhe ju bashkua atyre dhe kërkoi që rasti të raportoj në polici. Ajo deklaroi se A. tha se nuk dëshironte që ta raportonte sepse nuk donte ta bënte këtë punë të madhe pasi që R.A. i kishte kërkuar falje dhe i kishte ardhur keq. Ajo deklaroi se edhe ajo atë natë ishte nën ndikim të alkoolit.

598. D. XH. deklaroi se ajo nuk i kishte parë se dritaret ishin thyer pasi që ajo ishte brenda. Ajo tha se R.A. ishte i shqetësuar sepse “ne” donim të hiqim dorë. Ajo deklaroi se “ato” i thanë atij disa herë. Asaj nuk i kujtohet nëse vajzat kishin dalë jashtë para Hestet S.t dhe kishin parë veturën e dëmtuar. Ajo deklaroi se pak a shumë të gjithë dolën jashtë në të njëjtën kohë. Ajo pohoi se edhe ajo ishte e dehur dhe kujtesa e saj nuk ishte aq e qartë. Megjithatë, asaj i kujtohet se kishte parë gjak në grushtin e R.A.t dhe atyre ju ishte thënë se ai e kishte grushtuar xhamin. Asaj nuk i kujtohet se a kanë parë shishe apo gëzhoja plumbash pranë veturës. Ajo nuk e dinte se a ishte lajmëruar policia. Ajo deklaroi se një taksi kishte arritur pas 10 minutash. Ajo e pranoi se R.A. i kishte çelësat e veturës së motrës së saj dhe kishte ofruar që ta riparonte. Ajo tha se motra e saj ishte duke qarë. Megjithatë, ajo dhe motra e saj e kishin falë atë dhe i kishin lejuar atij që ta rregullonte veturën.

599. D. XH. ka deklaruar se ato kishin shkuar në shtëpi dhe pas pak minutash iu kishte telefonuar R.A.. Ai i ka ftuar ato që të takoheshin në restorantin “D.”, ato shkuan atje dhe e takuan atë, e diskutuan incidentin, ai ndjente keqardhje për atë çfarë kishte bërë, pas disa minutash erdhi M. dhe ju tha atyre që ta raportonin rastin në polici për të marrë kompensimin e dëmit por A. ju tha “Jo nuk dua ta raportojë”. Ajo tha se pas 20 apo 25 minutash ato ishin kthyer në shtëpi. Asaj nuk i kujtohet se a ka qenë M.S. në restorant kur ato mbërritën atje apo ai ka ardhur atje pas tyre. Ajo deklaroi se ai e ka prezantuar veten si shok i R.A.t dhe ajo kishte supozuar se ai ishte ashtu. Ai tha se ishte zyrtar policor dhe shtoi se “Nëse doni ju mund ta raportoni këtë në Polici.” Ajo deklaroi se ai kishte thënë, “Edhe pse ai është shoku im, prapëseprapë ju mund ta raportoni atë në polici.”

600. D. XH. deklaroi se asaj nuk i kujtohet të ketë dëgjuar se motra e saj pas incidentit ka pirë kafë me M.S. n dhe H. S. Asaj nuk i kujtohet që Z. N. i ka dërguar motrës së saj

një SMS lidhur me incidentin. Ajo gjithashtu nuk ishte në dijeni se motra e saj ka pranuar një SMS me numrin e M.S.

601. Në përgjigje të pyetjes të parashtruar nga avokati A.R., mbrojtësi i të pandehurit M.S., D. XH. deklaroi se ajo ishte nën ndikimin e alkoolit në kafenetë “*Intenrnational*” dhe “D.” dhe se kujtesa e saj ishte dobësuar nga kjo.
602. Dëshmitari tjetër për të dëshmuar ishte V. S. Ai ka dëshmuar në seancën e 29 shtatorit të vitit 2015. V. S. ka deklaruar se ka punuar me dhe për babanë e tij H. S.n në një restorant të quajtur “*Burdushi*”. Ai deklaroi se para tre vitesh, ata e kanë pas një restorant dhe një lokal me muzikë live të quajtur “*International*”. Ai deklaroi se ai ka punuar aty kohë pas kohe dhe se në atë kohë ai shkonte në shkollë. Ai tha se babai i tij e kishte marrë me qira nga një person i quajtur R. Ai deklaroi se babai ishte përgjegjës për punësimet dhe shkarkimet dhe se ata nuk e kanë punësuar një menaxher. V.S.ka deklaruar se atij i kujtohet se ka dhënë një deklaratë në IPK më 11 shtator 2013 dhe ai e mbështeti përmbajtjen e saj. V.S.ka deklaruar se ai nuk e njeh B.SH.n.
603. V.S. ka deklaruar se A.XH., motra e saj A., Z. N. ishin valltare në restorantin “*International*”. Ai e ka ditur se njëri prej punëtorëve të sigurimit ishte D. por nuk e dinte emrin dhe mbiemrin e tij. V.S.deklaroi se si ishte në dijeni të një vendi të ngjashëm në afërsi me muzikë live që quhej “*Montana*” dhe ndonjë herë po të njëjtat valltare kanë punuar në te dy lokalet. Ai nuk e njohte valltaren e quajtur Z. nga Tetova.
604. V.S. ka deklaruar se familja e tij nuk ka të bëjë asgjë me familjen S.e as nuk ishin shokë me ndonjë zyrtar policor. Ai e njohte M.S. n si “M.”, ai ishte një polic dhe se ai vinte në restorant shumë rrallë. Ai deklaroi se nuk ka pasur ndonjë marrëdhënie apo marrëdhënie të afërta dhe madje atij nuk i kujtohet të ketë folur me të. Ai e identifikoi atë në sallën e gjyqit. Ai theksoi se një kolegë në restorant i ka thënë atij se ai ishte zyrtar policor. Atij nuk i kujtohet ta ketë parë ndonjëherë duke e kryer detyrën si zyrtar policor. Atij i kujtohet se ai ka qëndruar në të njëjtën tavolinë me R.A.n.
605. V.S.u pajtua me përmbajtjen e deklaratës së tij të mëhershme të cilën e kishte dhënë në IPK deri në atë masë kur natën e incidentit, kur ai donte të shkoj në shtëpi, ai doli nga lokali dhe ka vërejtur se vetura e A. i kishte dritaret e thyera dhe babai i tij i

tregoi se “D.” kishte shtënë në të me një pistoletë. Ai tha se babi i tij i kishte thënë, “*shko në shtëpi me R.H.*”

606. Ai e pranoi se më parë kishte deklaruar se R.A. më 29 maj 2013 në orën 18:29.06 e kishte telefonuar atë nga numri 044 837388 dhe mes tjerash i kishte thënë, “*Mos u shqetëso. Vetura do të rregullohet. Mendoj se ka vetëm dy vrima. A të kujtohet kjo bisedë?*” dhe ai u përgjigj, “*Po më kujtohet kjo bisedë. Ai më ka thënë ashtu.*” Ai nuk ka mundur ta shpjegoj se përse R.A. e kishte thirre kur ata nuk kishin marrëdhënie të ngushta. Ai deklaroi se ai e ka qar veturën në shtëpi dhe kjo ka mundur të jetë arsyeja.

607. V.S.deklaroi se atij i kujtohet se atë natë kur ishte shtënë në veturë, R.A. kishte pirë alkool dhe ishte dehur goxha shumë. Prokurori ia parashtrroi se në deklaratën e tij të dhënë para prokurorit të EULEX-it, më 01 tetor 2013 ai ka deklaruar se e ka parë veturën në të cilën ishte gjuajtur. Ai ka deklaruar se ai në fakt i ka pa pasojat kur ka dalë jashtë në fund të ndërrimit me nipin e tij R. Ai deklaroi se ishte brenda dhe nuk ka dëgjuar ndonjë të shtënë, por ka dëgjuar për to nga babai i tij. Ai doli jashtë, por babai i tij i tha që të shkonte në shtëpi gjë që e kishte bërë, por i ati e thirri dhe i kërkoi që të kthehej dhe ta largojë makinën e A. XH., dhe kështu ai veproi. Ai deklaroi se nuk kishte marrëdhënie me R.A.n.

608. Ai e pranoi deklaratën e tij të dhënë në Tetor të vitit 2013 kur ai kishte deklaruar se më vonë atij i është thënë se “M.” M.S. kishte ardhur aty, ai nuk e ka parë atë por këtë ja kishte treguar babai i tij. Ai deklaroi se babai nuk i ka treguar se kur ka arritur dhe kur është larguar ai. Ai e dinte se babai i tij të nesërmen e kishte qar veturën për ta rregulluar por nuk e dinte se ku.

609. V.S.ka deklaruar se ai nuk e ka parë reagimin e A. XH. kur ajo e kishte parë veturën e saj. Ai nuk e din se çfarë lloj arme është përdorur kur është shtënë në veturë dhe se ai atë natë nuk e ka parë M.S. n. Ai e konfirmoi se ai nuk e ka parë R.A.n duke shtënë në veturë. Atij nuk i kujtohet se kush i ka treguar por ai i ka njohur disa njerëz nga aksidenti të cilët i ka takuar në restorantin “D.”.

610. Në përgjigje të pyetjeve të parashtruara nga A.R., mbrojtësi i të pandehurit M.S. , V.S.deklaroi se atë natë ai ka shkuar në punë në ora 8 pas dite dhe se ai fare nuk e ka parë M.S. atë natë apo të nesërmen.
611. Dëshmitari tjetër ishte Z. N.. Ajo ka dhënë dëshmi para trupit gjykues në seancën e 13 tetorit 2015. Ajo ka deklaruar se ajo ka punuar si këngëtare në restorantin “*International*” për afërsisht tre apo katër muaj, dy vjet më parë. Ajo tha se nofka e saj ishte Migena.
612. Z. N. ka deklaruar se shumica e klientëve në kafenenë “*International*” ishin meshkuj dhe se ajo nuk e njohte asnjë zyrtar policor. Megjithatë, ajo në gjykatore e identifikoi të pandehurin M.S. si klient dhe bëri shenjë nga ai. Ajo theksoi se atë e kishte parë vetëm një herë.
613. Z. N. ka theksuar se ajo e kishte mësuar se M.S. i kishte nofkën “M.” kur ajo e takoi atë për herë të parë me shoqen e saj A. XH. me nofkën “J.” dhe me motrën e saj, D., nofka “A.”. Kur ajo kishte punuar atje, edhe ato ishin këngëtare dhe valltare në “*International*”.
614. Z. N. ka deklaruar se “D.” ka punuar në sigurim por nuk e dinte emrin e tij të vërtet. Ajo gjithashtu e njohte një kolege të quajtur Z. pasi që kanë punuar nëpër vende të ngjashme me muzikë live. Ajo e dinte se ajo ishte e dashura e D. por nuk e dinte se a kanë qenë ata bashkë në vitin 2013. Ajo e dinte se ajo e kishte dhënë një deklaratë para Prokurorit të EULEX-it në vitin 2013 dhe e pranoi përmbajtjen e saj të jetë e vërtet dhe besnike dhe ajo e ka nënshkruar atë deklaratë.
615. Z. N. deklaroi se në vitin 2013 ajo ka jetuar me A. dhe D. XH. dhe se ato ishin shoqe të mira. Ajo tha se nuk e njohte B.SH., B.V. apo S.M. Ajo tha se A.XH.në vitin 2013, nuk ishte në lidhje romantike me askënd nga “*International*”.
616. Lidhur me ngjarjet e 29 Majit 2013, Z. N. kishte deklaruar se ajo vetë, A. dhe D. Xh. shoqëroheshin së bashku gjatë gjithë kohës. Ajo ka deklaruar se ajo kishte një pushim të gjatë nga puna pasi që i kishte vdekur ëmë. Ajo ka deklaruar se kishte punuar gjatë gjithë kohës me nënën e saj dhe nuk ishte e lehtë që ajo të punonte pa të dhe për

shkak se ajo pinte dhe shumicën e kohës ishte nën ndikimin e alkoolit. Ajo ka deklaruar se ishte e mërzhitur dhe donte ta ndryshonte restorantin në të cilin punonte. Ajo ka deklaruar se A. i ka treguar H. S. dhe që të tre kishin pirë së bashku. Ajo ka thënë se D. ishte aty me një grup të madh të cilët gjithashtu pinin. Ajo ka deklaruar se kishte pirë goxha shumë dhe ajo akoma nuk e kishte marrë pagën e saj. Ajo ka deklaruar se makinat e tyre ishin të parkuara në një pjesë parkingu të veçantë për klientë. Ajo ka deklaruar se A.XH.doli jashtë derisa ajo po e merrte pagën. Ajo ka deklaruar se një valltare apo një këngëtar/e tjetër mund të ketë qenë aty dhe ajo i dëgjoji ata duke thirrur *“vetura, vetura....vetura”*. Ajo e dëgjoji zërin e A. Ajo ka deklaruar se kur e kishte hapur derën, *“ka dëgjuar se dritarja e makinës ishte thyer”*. Ajo doli jashtë, D., e motra e J. dolën jashtë *“pronari e ka dëgjuar këtë, edhe ai doli jashtë”*. Ajo ka deklaruar se A.XH.ka dalë jashtë para saj dhe ajo tha se dritarja e makinës ishte thyer. Kur doli jashtë ajo, e kontrolloi veturën dhe e pa se vetëm dritarja ishte e thyer. Ajo ka deklaruar se ajo e pyeti se çfarë ka ndodhur dhe A.XH.tha: *“Nuk e di”*. Ajo tha se H.S.i ka bërë A. të njëjtën pyetje. Ajo deklaroi se e kanë parë D. të ulur në tokë dhe kokën e përkulur dhe me duar në fytyrë dhe dukej se ai po qante. Ajo deklaroi se Jona ju afrua dhe e pyeti se çfarë problemi kishte. Ajo tha se nuk i kujtohej se çfarë kishte ndodhur më pas dhe A.XH. kishte thënë, *“të shkojmë në shtëpi”* por ajo preferoi që ta linte veturën aty dhe të merrte një taksì. Ajo tha se D. i kishte kërkuar falje Jonës duke i thënë *“Të kërkojë falje dhe do ta sanoj dëmin, nuk e kam bërë më qëllim”*. Ajo deklaroi se ato e morën një taksì dhe shkuan në shtëpi. Ajo deklaroi se D. e ka telefonuar Jonën dhe ajo e ka dëgjuar bisedën dhe D. i kishte kërkuar falje ndërsa J. po qante. Ajo deklaroi se D. tha, *“të shkojmë për kafë te restorant ‘D.’”* dhe ajo tha, *“të lutem më fal”*. Ajo tha se A. nuk ka dashur që ta merr atë me vete por se ajo kishte insistuar që të shkonte. Ajo deklaroi se D. kishte mbetur pas dhe ato dhe H. S., e dashura e tij, M, D. dhe M. shkuan te restoranti *“D.”*.

617. Z. N. deklaroi se natën në fjalë ajo ishte e dehur por jo në një masë të madhe dhe se asaj i kujtohet se çfarë ka ndodhur. Ajo ka theksuar se as ajo e as A. e D. nuk kanë pasur ndonjë problem me D.n para kësaj ngjarje. Ajo deklaroi se ajo nuk e dinte se H.S.i ka treguar D. se ato po mendonin që të lënin punën, por kjo është e mundshme.

618. Z. N. ka deklaruar se pasi që i kishte parë dritaret e thyera, ajo ishte kthyer brenda në restorant. Ajo ka deklaruar se nuk e dinte se si ishte dëmtuar vetura. Ajo tha se as A. nuk e dinte këtë. Megjithatë, ajo ka deklaruar se kur ato shkuan në shtëpi A. filloi të qante dhe ajo tha *“D. i ka thyer ato padashur”* por nuk ka treguar si i ka thyer ato ndërsa Z. N. nuk e kishte pyetur për këtë. Ajo deklaroi se D. e kishte telefonuar A. XH. disa herë pas incidentit.
619. Z. N. pohoi se kur ajo kishte shkuar në restorant *“D.”* asaj nuk i kujtohet se a ka qenë M. aty apo ai ka mbërritur më vonë. Ajo theksoi se ajo nuk e ka ditur nëse M. dhe D. kishin marrëdhënie të afërta. Ajo e pranoi deklaratën e saj të mëhershme se D. ishte në restorant *“D.”* me *“shokun e tij M.”*. Ajo deklaroi se aty kanë qëndruar në restorantin *“D.”* për rreth 30 minuta. Ajo deklaroi se M. ishte larguar para saj. Ajo tha se derisa ai ishte atje, M. foli me A. por ajo nuk ka mundur të dëgjoj se çfarë është thënë aty.
620. Prokurori ja përkujtoi Z. N. se në deklaratën e saj dhënë në tetor të vitit 2013, ajo ishte pyetur se çfarë kishte thënë *“M.”* dhe u përgjigj pasi që D. shkoi në banjë, *“M.”* tha *“pa marrë parasysh faktin se ai është shoku im, unë e përkrahu më shumë të vërtetën, pra të lutem raportoje këtë në polici”* dhe ato thanë jo sepse ne e duam D.n dhe *“ne e dimë se ky nuk e ka bërë këtë me vetëdije të plotë”*, dhe ajo nuk e mohoi se nuk ishte e vërtetë. Ajo deklaroi se kurrë nuk ka arritur që ta kuptoj se çfarë metode ka përdorur D. për t’i thyer dritaret. Ajo ishte në dijeni se ai e kishte rregulluar veturën. Z. N. pohoi se nuk i kujtohet asaj të ketë pasur asnjë lloj diskutimi apo ngatërrese ndërmjet D. dhe A. apo dikujt nga grupi i tyre i vajzave para se D. të dilte jashtë lokalit.
621. Në përgjigje të pyetjeve të parashtruara nga avokati mbrojtës i M.S. , A.R., Z. N. pohoi se ajo kurrë më parë nuk e kishte parë M.S. para natës kur kishte ndodhur incidenti. Atë natë ajo nuk e kishte parë atë në restorantin *“International”*. Ajo tha se nuk kishte ndonjë njohuri specifike që D. dhe M. ishin shokë, ajo vetëm kishte supozuar ashtu. Ajo deklaroi se në atë kohë ajo nuk kishte dëgjuar se si ishin thyer dritaret e veturës.
622. Dëshmitari tjetër ishte N.S. Ai e filloi dëshminë e tij para trupit gjykues në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 13 tetor 2015. N.S. deklaroi se ai ishte punonjës në Policinë e Kosovës ku kishte diplomuar në vitin 2000. Që nga kjo kohë, ai

gjithmonë ka qenë i lidhur me Njësinë Rajonale të Trafikut në Ferizaj. Ai deklaroi se kjo ka përfshirë kontrollet e shpejtësisë, pika kontrolli dhe pjesëmarrja në aksidente. Ai theksoi se ata kanë bashkëpunuar edhe me zyrtarët e Administratës Tatimore të Kosovës lidhur me kontrabandimin e mallrave dhe të gjitha veprimet lidhur me tatimet përfshirë taksat doganore të pagueshme të importit dhe eksportit të automjeteve. N.S. ka deklaruar se ai ka ndjekur një trajnim specifik për oficerët e trafikut si dhe trajnimin për të qenë trajner brenda asaj njësie. Ai gjithashtu ka pasur trajnim për sjelljet etike dhe profesionale dhe kjo ka përfshirë trajnimin kundër korrupsion.

623. Lidhur me funksionet specifike, Oficeri N.S. ka deklaruar se para fillimit të secilit ndërrim, ai i ka raportuar mbikëqyrësit të tij i cili ishte Rreshter apo zyrtar policor pa grada por që e kryente punën e një rreshteri. Rreshteri apo Ushtruesi i detyrës së Rreshterit pastaj do ta njoftonte atë dhe do ta informonte atë për detyrat e mundshme të cilat atij do ti duhej t'i kryente gjatë ndërrimit. Ai deklaroi se në rast se ndodhë ndonjë gjë gjatë ndërrimit, ai menjëherë e informonte Ushtruesin e Detyrës të Rreshterit përmes telefonit apo radios. Ai deklaroi se mbi Rreshterit është Togeri dhe pastaj mbi Togerin është Kapiteni dhe në Njësinë Rajonale të Trafikut, kapiteni është grada më e lartë dhe se ai është Komandant i Njësisë Rajonale të Trafikut. Ai tha se ka qenë detyra e tij që tu bindet urdhrave. Ai deklaroi se nuk do ta respektonte një urdhër të jashtëligjshëm edhe në qoftë se ai vjen nga një epror i lartë.

624. N.S. deklaroi se ai e ka njohur M.S. n si kolegë dhe si epror i lartë. Ai e identifikoi atë në gjykatore. Ai e njohte V.T.n por vetëm si person të cilin e kishte ndaluar një herë gjersa po voziste. Atij nuk i kujtohet fytyra e tij. Megjithatë, ai ishte në gjendje të ta identifikojë atë në gjykatore. N.S. ka deklaruar se ai e njohte B.SH. pasi që kishin punuar në të njëjtin stacion policor.

625. N.S. ka pohuar se ai e njohte E.L. i cili ishte në atë kohë udhëheqës i ndërrimit në stacion. Ai deklaroi se ai e njeh edhe Sh.O. si koleg i cili ka punuar në të njëjtin njësi dhe ka jetuar në të njëjtin fshat. Ai pohoi se ata kanë punuar së bashku për katër apo pesë vite por jo gjithmonë në të njëjtin ndërrim. Ai deklaroi se nëse kanë punuar së bashku në të njëjtin ndërrim, ai ka qenë udhëheqës i patrullës pasi që ai kishte më shumë përvojë megjithëse ai nuk ka pasur gradë të lartë. N.S. ka deklaruar se ka pasur raste kur ai është

konsultuar me persona jashtë njësimit të trafikut për detyrat e trafikut kur ai nuk ka pasur njohuri për çështje specifike.

626. N.S. e ka konfirmuar se ia ka dhënë deklaratë para Prokurorit të EULEX-it dhe IPK-së. Ai e konfirmoi se përgjigjet e tij janë të sakta. Ai deklaroi se i ka mbajtur po të njëjtit numra telefonik (zyrtar dhe privat) që nga viti 2013.

627. N.S. deklaroi se në vitin 2013, me sa din ai, M.S. ishte caktuar në Njësinë Kundër Drogave në policinë e Ferizajt. Ai theksoi se në akademinë policore, ata kanë qenë në të njëjtën klasë pasi që numri i policëve në vitin 2000 ishte shumë i vogël; ata kanë pasur kontakte të shpeshta kur kanë filluar punën. Ai deklaroi se në baza shoqërore ai kurrë nuk ka pirë kafe për vite, por ka mundur të ketë pirë dy apo tre herë në punë. Ai deklaroi se M.S. ishte një mbikëqyrës por kurrë nuk ka qenë mbikëqyrës i tij. Ai nuk e kishte numrin e tij të telefonit dhe, me sa din ati, edhe M.S. nuk e kishte numrin e tij. N.S. deklaroi se mendimi i tij ishte se M.S. ishte një kolegë i mirë dhe një zyrtar i mirë policor. Ai pohoi se ai ishte në dijeni se tani ai ishte i ngarkuar me vepra penale.

628. Oficeri N.S. e vazhdoi dëshminë e tij më 19 tetor 2015. Ai pohoi se e dinte se nofka e M.S. t ishte “M.”. Ai theksoi se në vitin 2013, ai beson se ai ishte caktuar në njësimit kundër drogës me gradën e Togërit. Ai theksoi se në kohën kur ishte arrestuar, ai ishte në Zvicër dhe kur u kthye ai u mor në pyetje nga IPK-ja. Ai theksoi se në këtë kohë kishte kuptuar për arrestimin e S. Ai deklaroi, ai më pas kishte dëgjuar për këtë nga kolegët policë por vetëm detaje sipërfaqësore. Ai e pranoi se ai është përpjekur që të kuptoj më tepër por theksoi se sa herë që EULEX-i ishte i përfshirë, kolegët ishin më të rezervuar për nxjerrjen e informacioneve. N.S. theksoi se ai kishte diskutuar ndalimin në trafik në fjalë, në këtë rast, me kolegët e tij SH.O.por jo pasi ai ishte intervistuar nga IPK-ja. N.S. pohoi se nuk ishte në dijeni që M.S. dhe B.SH. kanë pasur ndonjë herë kontakte apo se a kanë punuar ata në të njëjtin njësit policor. Ai pohoi se kishte dëgjuar se edhe B.SH. ishte i përfshirë në procedurë penale por jo më tepër se aq.

629. N.S. u pajtua se ai ka qenë në detyrë në trafik me SH.O., më 28 maj 2013. Ai theksoi se ata ishin mbikëqyrur nga një rreshter por nuk i kujtohet se cili ka qenë. Ai deklaroi se ishte udhëheqës i patrullës për shkak të përvojës më të madhe në shërbim.

Megjithatë, ai theksoi se vendimet janë marrë si punë e ekipit dhe se nuk ka pasur superioritet apo inferioritet. Megjithatë, ai deklaroi se në rast se ka pasur ndonjë konflikt apo ndonjë dyshim, udhëheqësi do të bisedonte me mbikëqyrësin dhe/apo do të raportonte për gjithçka lidhur me turnin.

630. Lidhur me incidentin specifik, më 28 maj 2013, N.S. ka deklaruar se atij i kujtohej më shumë atëherë se sa që i janë kujtuar në intervistën me IKP-në. Ai theksoi se ishte duke e bërë një pikë kontrolli me SH.O.në fshatin Koshare nga ora 15:00 deri në ora 23:00. Ai theksoi se në një moment të caktuar ai ishte në veturë duke kryer një detyrë administrative derisa oficeri Obrazhda po e maste shpejtësinë e veturës me radar. Ai deklaroi se një veturë Renault “Clio” kaloi pakëz shpejt por çështja më e rëndësishme ishte se nuk i kishte dritat e ndezura. Ai pohoi se kolegu i tij e ndaloi veturën dhe foli me shoferin. Ai tha se nuk e din se për çka ishte biseda. Ai ia mori dokumentet, ju afrua dhe i tha: *“Kolegë, ky zotëria nuk është fare në rregull. Këto janë dokumentet.”* Oficeri N.S. deklaroi se ai doli nga vetura dhe u përgjigj *“Kolegë, kjo është ajo me çka ne merremi. Kjo është arsyeja përse ne jemi këtu.”*

631. Ai deklaroi se ata vërejtën se vetura nuk i kishte të paguara taksat doganore dhe nuk ishte i regjistruar. Shoferi doli nga vetura. Atij i kujtohet emri i tij ishte V.T. Ai pohoi se ishte e qartë se ai e ka ditur se në çfarë situatë ishte ai. Ai deklaroi se ai i kishte thënë *“A jeni në dijeni se në këtë situatë ne duhet ta thërrasim shërbimin e doganës dhe të konfiskojmë veturën tuaj. Gjoha është e madhe; ajo është 5000 – 5500 euro. Vetura konfiskohet automatikisht”*. Ai deklaroi se ai ka dashur vetëm që ta frikësoj atë me këtë informacion. Ai theksoi se ai e ka njoftuar atë me të gjitha problemet tjera (d.m.th. tejkalimin e shpejtësisë, pa drita). Ai tha se V.T. u përgjigj, *“I nderuari polic, e di se çfarëdo që të thuash është e drejtë”*. Ai deklaroi se ai u soll mirë dhe tha, *“Unë e kam huazuar këtë veturë dhe unë po e qojë këtë në një vend të sigurt dhe nuk do ta vozisë prapë por do të përgatitëm që t’i kryej pagesat e taksave doganore.”* Oficeri N.S. deklaroi se fillimisht ai nuk i besoj atij por ai ju premtoi atyre, neve, nëse e lirojmë këtë herë dhe nëse e shohin herën tjetër me këtë veturë në këtë situatë, atëherë ata mund t’i zbatojnë të gjitha procedurat ligjore dhe të shqiptojnë një dënim më të ashpër. Oficeri N.S. deklaroi se ai nuk i ka besuar atij, pra ai hyri në veturën e policisë dhe filloi që ta ia

lëshoj një gjobë. Oficeri N.S. në këtë pikë deklaroi se ai i bëri me shenjë kolegut të tij Sh.O. që të largohej nga rrezja e dëgjimit të V.T. Ai tha se ata diskutuan rrëfimin e tij, se ai e kishte makinën vetëm të huazuar dhe se ai do ta parkojë atë diku në vend të sigurt dhe nuk do të dalë me të jashtë dhe ata ranë dakord që të mos e gjobisin atë por vetëm t'ia marrin të dhënat më shumë si një paralajmërim dhe jo si dënim.

632. Oficeri N.S. theksoi se në këtë pikë ai kishte vërejtur se shoferi e kishte një telefon në dorë dhe se ai komunikonte nëpërmjet tij. Ai deklaroi se ai ishte afruar veturës së policisë dhe e ka pyetur atë, *“Z. Polic, a është e mundshme të flisni me një kolegë të caktuar?”* Oficeri N.S. deklaroi se ai, *“e ka mohuar absolutisht atë kërkesë”* dhe i tha atij *“Nëse dëshiron që t'i telefonon dikujt, unë e kam telefonin tim.”* Ai deklaroi se shoferi u largua nga vetura sepse ai i tha të bëjë ashtu. Ai pohoi se ai i kërkoi të flas me telefon dy herë dhe ai e refuzoi te dy herët. Ai theksoi se ai pastaj ju afrua për të tretën herë dhe e pyeti, *“A mundësh të flasësh me Togerin “M.?”* Oficeri N.S. deklaroi se në fillim ai refuzoi të flasë me dikë por kur ai e përmendi në mënyrë specifike atë, dhe ai e njihte se kush ishte ai, nga respekti ai e mori telefonin dhe foli me togerin “M.”. Ai deklaroi se përderisa shoferi u përpoq të fliste në telefon pranë veturës së tij, ai dhe kolegu i tij SH. u morën vesh që të ja japin atij një gjobë për vozitje pa drita. Ai deklaroi se ngasësi në fjalë kishte përshtypjen se ai e kishte mbajtur qëndrimin e tij profesional sepse ai filloi të shkruante gjobën e trafikut dhe ai ishte i bindur se ata po e gjobisnin atë me dënimin më të madh, edhe pse në fakt ata veçse kishin vendosur që ta gjobisnin vetëm për mos ndezjen e dritave dhe për mungesë të autorizimit për të ngarë atë veturë.

633. Oficeri N.S. deklaroi se ai e mori telefonin e shoferit dhe u prezantua duke thënë *“Përshëndetje, këtu N.S., kush është atje?”* Ai deklaroi se ju përgjigj zëri, *“Përshëndetje shoku im i luftës. Po flet me Togerin M.S. n.”* Ai ka deklaruar se ai ishte përgjigjur, *“Kujdesu për këtë person, ai është i afërm i imi, a mund të ja lëshon një gjobë më të lehtë?”* Oficeri N.S. deklaroi se ai ishte përpjekur që të sqaroj çështjen duke thënë, *“Po, ne e kemi ndalur sepse ai po ngiste shpejt, ai nuk është i regjistruar, vetura nuk është në emrin e tij.”*

634. Oficeri N.S. ka deklaruar se Togeri “M.” i është përgjigjur, *“Po, ai e ka huazuar veturën dhe se nuk do ta ngasë më.”* Oficeri N.S. deklaroi se ai në fund tha, *“Në rregull,*

kësaj here të jetë ashtu. Ne do ta gjobisim vetëm mos ndezjen e dritave të veturës por mos të ndodhë prapë përndryshe do të ndërmarim masa të tjera ligjore.” Ai tha se Togerit M. e falënderoi atë dhe ai tha *“tung”* dhe kjo ishte tëra. Ai deklaroi se e plotësoi tiketën të cilën e kishte filluar ta plotësojë, e shkoqi fletën dhe para se të ja jepte fletën shoferit ai i tha, *“Merre këtë gjobë por duke e marrë parasysht situatën tënde aktuale, kjo fare nuk është gjobë. Merre këtë si vërejtje dhe nëse të hasim edhe një herë, ne i kemi të dhënat tua.”* Ai pohoi se fjalët e fundit të ngasësit ishin *“Nuk ka shanse se do ta shihni më këtë veturë të pa regjistruar.”* Ai deklaroi, se ai e falënderoi dhe i ja shtrëngoi dorën. Ai pohoi se ngasësi vazhdoi rrugës së tij dhe ai dhe kolegu i tij vazhduan me detyrat e tyre të rëndomta.

635. Oficeri N.S. deklaroi se thirrja telefonike nuk ka zgjatur më shumë se një minutë apo më shumë. Ai ishte i bindur se nuk ka pasur ndonjë ndikim mbi vendimin që ata kishin e kishim marrë më parë.

636. N.S. ka deklaruar se në karrierën e tij ai kishte lëshuar mijëra tiketa për kundërvajtje në trafik. Ai ka deklaruar se shumica e të ardhurave të grumbulluara i kanë shkuar Komunës por disa i kanë shkuar edhe Ministrisë së Punëve të Brendshme.

637. N.S. pranoi në këtë rast, ka pasur *“disa lëshime profesionale brenda shërbimit”* dhe ai dhe kolegët e tij është dashur që ta njoftonin Shërbimin e Doganave që të vinin apo që ta kishin konfiskuar veturën. Megjithatë, ai deklaroi se kanë konsideruar dhe besuar në premtimin e shoferit se ai do ta regjistronte veturën dhe të paguaj tarifën e papaguara. Ai deklaroi se ky ka qenë rasti i parë ku kishte hasur në veturë për të cilin nuk ishin paguar tarifën doganore.

638. N.S. u pajtua kur shoferi ju referua “M.”, ai e kuptoi këtë si referencë për M.S. n. Ai u pajtua që ka qenë e pazakontë që atij t’i kërkohet favore përmes telefonit në atë mënyrë. Ai i qëndroi pas pohimit se atij i kujtohet incidenti më mirë tani dhe është përmirësuar nga dy intervista e tij të mëparshme pasi që tani ai është përqendruar më shumë në të.

639. N.S. deklaroi se në fillim nuk i besoi V.T.t. Megjithatë, ai pohoi se kur e mori parasysht sqarimin se ai e kishte marrë veturën si kompensim për punë dhe ai e mori

parasysh rastin se kurrë nuk do ta shohë më. Ai theksoi se besonte se tarifata doganore mund të jetë objekt i një dënimi prej deri në 5500 euro por gjoha maksimale që policia mund të shqiptonte ishte e limituar në 40 euro. Ai pohoi se ngasësi e pranoi se vetura nuk ishte e regjistruar në emrin e tij por ai e kishte marrë atë si kompensim për disa punë që i kishte kryer ai dhe ai kishte filluar përgatitjen e dokumenteve për ta regjistruar atë dhe që t'i paguaj tarifata doganore. Ai u pajtua se të gjithë shoferët në atë kohë kishin dokumentin e regjistrimit të veturës dhe një patentë shoferi. Ai nuk kishte të drejtë ta ngiste atë.

640. Prokurori ja parashtrori oficerit N.S., ai tha në fillim se ai nuk i ka besuar V.T. por pastaj ai dhe kolegu i tij vendosën që t'i japin atij kohë dhe t'i lëshojnë vetëm një gjobë për mos ndezje të dritave dhe kishte filluar që ta shkruante tiketën por pastaj ai tha se do t'i thoshte "M." se po mendonte se ai po gënjente. Në përgjigje Oficeri N.S. deklaroi se ngasësi i kishte bindur ata me tregimin dhe qëndrimin e tij. Ai e pranoi se e kishte informuar M.S. n se ai mendonte se ngasësi po gënjente por ai tha se nuk ka menduar po aq fort.

641. Në përgjigje të një pyetje nga Kryetari i Trupit Gjyqësor, oficeri N.S. ka deklaruar se ai nuk e ka raportuar incidentin tek eprorët e tij. Ai e pranoi se kjo ishte një shkelje disiplinore. Në përgjigje të pyetjeve të parashtruara nga prokurori, ai u përgjigj se nuk e kishte kontrolluar veturën.

642. Në përgjigje të një pyetje nga Kryetari i Trupit Gjyqësor, ai u pajtua se vendimi për ta lëshuar V.T. ishte marrë para se të flisnin në telefon me M.S. n. Ai e përsëriti se kishte folur me M.S. nga respekti dhe sepse ai do të ishte ndier keq që t'i thoshte "Jo, nuk dua ta flasë me ty" Megjithatë, ai e pranoi se M.S. i kishte kërkuar atij që ta dënonte shokun e tij sa më lehtë që ishte e mundshme. Ai u pajtua që kjo që i kishte kërkuar M.S. nuk ishte e duhur dhe ai tha se do të kishte qenë më mirë për të po të mos e kishte thirrë atë fare në telefon. Ai e përsëriti vlerësimin e tij të mëparshëm se telefonata nuk kishte ndikuar në vendim. Megjithatë, ai u pajtua që nuk e kishte zbatuar ligjin dhe ka shkelur Kodi e Mirësjelljes të Policisë me pranimin e telefonatës dhe mos raportimin e telefonatës.

643. N.S. u pajtua që ai i kishte deklaruar prokurorit se arsyeja përse e ka pranuar telefonatën është se i ka ardhur keq për ngasësin. Ai pohoi se ka ndjerë respekt dhe keqardhje. Ai tha se ai e ka bërë këtë nga respekti dhe do të ishte ndier keq po ta kishte mbyllur telefonatën. Ai tha se përshëndetja “Përshëndetje shok i luftës” ishte e çuditshme për të sepse M.S. duhet ta kishte ditur se ai nuk ka marrë pjesë në luftë.

644. N.S. u pajtua me deklaratën e tij të mëhershme të dhënë para Prokurorit të EULEX-it ku ai kishte thënë. *“ai po fliste si kolegë dhe më tha të kujdesem për të si për një të afërm, nëse mund ta gjobisni më lehtë, dhe unë thashë në rregull M. pasi që edhe ju thirrret unë do ta gjobisë atë vetëm për vozitje me drita të fikura”*.

645. N.S. deklaroi se ai nuk i ka bërë ndonjë telefonatë askujt për ta pasur qasje në bazën e të dhënave të policisë lidhur me informacion për veturën që po e ngiste V.T.. Ai deklaroi se të vetmit policë të përfshirë në incident ishin vetë ai, Sh.O. dhe M.S. .

646. Pastaj prokurori parashtrroi telefonatën e përgjuar, si më poshtë, nga V.T. për M.S.
n:

M.: Përshëndetje shoku im Vahid

V.: Përshëndetje “Mendë”, kah je?

M.: Këtej pari kam qenë

V: Si po ja kalon?

M. thotë: Mirë po kaloj.

V i thotë: Unë po shkoja diku me veturën e paregjistruar dhe disa kolegë tuaj më kanë ndaluar.

M.: Kush ishin ata?

V: Nuk po i njoh ata.

M.: A je atje me ta?

V: Po.

M.: Thuaju atyre se “M.” është daja yt.

V: U thashë atyre se “M.” është daja im, por ata nuk.

M.: Kush janë ata?

V: Nuk po i njoh ata.

M.: Pyeti ata a mund të flasim me mua.

V ju drejtua zyrtarit policor, a mund të flasësh për një moment me “M.”?

647. N.S. ka deklaruar, aq sa di ai, nuk ka patur rëndësi për “Mendën” që ai të jetë daja/xhaxhai i tij apo ndonjë i afërt. Ai ka deklaruar se nuk e ka dëgjuar këtë bisedë sepse ai ishte ulur në veturë duke shkruar dënimin.

648. Oficeri N.S. vazhdoi dëshminë e tij në seancën e 27 tetorit 2015. Ai theksoi se V.T. në asnjë moment nuk i është paraqitur që ai është i afërm i M.S. Ai përsëriti, ai vetëm tregoi se kush është në anën tjetër të linjës dhe ai ju afrua atij për herë të tretë. Ai u pajtua që ai menjëherë e bëri ndërlidhjen mes “M.” dhe M.S.

649. Oficeri N.S. pohoi se V.T. ja dorëzoi telefonin drejtpërdrejt atij. Ai e pranoi se e kishte njohur zërin e M.S. Ai pohoi se ka pasuar një bisedë ku ai kishte thënë: *“Hej unë e kam këtë personin këtu. Nëse i them atij se po gënjen ai do të nervozohet por ai pastaj e përmendi emrin tënd pasi unë i plotësova të gjitha dhe ai as nuk e ka paguar doganën e asgjë tjetër dhe mua më duhet që ta ja lëshoj një tiketë të ulët por mos vendosjen e rripit të sigurisë apo diçka të tillë”*

650. Oficeri N.S. pohoi se M.S. nuk i kishte dhënë shpjegime lidhur me atë se si e njihnte ai shoferin, për pronësinë e veturës apo se kush ishte pronari i vërtet. Ngjashëm, nuk kishte sqarime lidhur me tarifat doganore që nuk ishin paguar apo për regjistrimin e veturës.

651. Në përgjigje të një pyetje nga Kryetari i Trupit Gjykses, N.S. deklaroi se kur ai tha se mendonte se ngasësi po gënjente, ai ka menduar që ta pyeste “Mendën” se a ishte e vërtet ajo çka po thoshte ai apo ngasësi po e gënjente atë. Ai deklaroi se ideja e tij ishte që ta konfirmonte se a është e vërtet ajo çka ka thënë Z. T. Megjithatë, ai e pranoi se mendimi i tij ishte relevant për hetimin pasi që ai dhe kolegu i tij tashmë kishin vendosur. Ai deklaroi se kur tha se ngasësi do të nervozohej po ta kishte akuzuar për gënjim, ai ka

menduar më shumë në kuptimin se ai do të ishte poshtëruar dhe kjo nuk ishte mirë nga perspektiva etike pasi që ai duhej ta respektonte atë.

652. Kur ju prezantua biseda e mëvonshme, N.S. u pajtua, ai tha ai ka mundur që ta lëshoj vetëm një tiketë simbolike dhe kjo ishte në kundërshtim me deklaratën e tij të mëhershme kur tha se ai edhe ashtu tashmë kishte vendosur të veproj kështu. Ai pohoi, se e ka thënë kështu vetëm për ta mbyllur bisedën dhe ta largoj M.

653. Prokurori gjithashtu i ka parashtruar atij se M. kishte thënë, *“hej shoku im, ai do ta shqiptoj një gjobë të vogël sepse ai më tha mua se ju i keni thënë atij për mua vetëm pasi ai i ka plotësuar letrat”* dhe kjo nënkuptonte se “M.” ishte gjithashtu nën përshtypjen se oficeri N.S. veç kishte filluar të plotësoj dokumentet të cilat do të jenë shumë më të kushtueshme për z T. , por oficeri N.S. nuk u pajtua me këtë.

654. Ai deklaroi se kur i ishte ofruar telefoni, dhe foli me M., ai ishte gati për ta përfunduar tiketën për dritat, dhe ai vetëm duhej ta plotësonte pjesën kur bëhet përshkrimi i kundërvajtjes por ai ishte ndërprerë dhe fillimisht ai nuk i kishte treguar atij për dritat, por ata do ta shqiptonin një gjobë për rrip të sigurimit. Ai e përsëriti se biseda me M.S. n nuk ka ndikuar që ai të ndërroj mendje nga ajo çfarë ai kishte vendosur të bënte. Ai u pajtua se të kërkohet që ta ndryshon tiketën *“nuk ishte aspak profesionale”*. Ai e theksoi se besonte se personi i cili kishte kërkuar gjithashtu po bënte diçka të jashtëligjshme.

655. Oficeri N.S. deklaroi se ai nuk kishte dëgjuar asgjë çka i ka thënë V.T. M. pasi që ai e kishte kthyer telefonin. Ai e konfirmoi kur u pyet nga hetuesit e IPK-së, ai kishte deklaruar se i urrente thirrjet telefonike të tilla apo në të vërtet çfarëdo thirrje telefonike. Ai deklaroi se në fillim ka besuar se gjoba për këtë kundërvajtje ishte ndërmjet 5,000 e 5500 € por pastaj e kishte mësuar se maksimumi i saj ishte 500€. Ai e përsëriti, ai e kishte cekur shumë e lartë fillestare për ta frikësuar ngasësin. Ai e konfirmoi se ai i kishte thënë M. se në atë rast ai nuk do ta shqiptojë gjobën e duhur por se ngasësi nuk mund të

vazhdojë të ngasë ashtu. Ai pohoi se nuk kishte asnjë rast tjetër që të bisedonte në telefon me M.S. në vitin 2013.

656. Në përgjigje të pyetjes nga avokati, A.R., mbrojtësi i të pandehurit M.S. , oficeri N.S. deklaroi se ai nuk e ka ditur saktësisht se si autoritetet e Doganës së Kosovës e kalkulojnë gjrobat për sa i përket pagesave të vonuara të tarifave për importim. Ai deklaroi se nuk e ka mësuar se a e ka regjistruar V.T. veturën. Ai deklaroi se ai ishte në dijeni se ekzistojnë një sistem i lejitimit ku autoritetet e Doganave të Kosovës i lejojnë ngasësit për një muaj që ta regjistrojnë një veturë dhe të paguajnë taksat doganore, Ai nuk e dinte nëse periudha e përkohshme ndërmjet hyrjes në vend dhe regjistrimit nuk gjobitej nëse automjeti ishte certifikuar si “jashtë rrugës” por ai ka menduar se ekzistonte një politikë/praktikë e tillë.

657. Në përgjigje të pyetjes nga i pandehuri M.S. , oficeri N.S. deklaroi se ai kishte autorizime ligjore që të jep një vërejtje (praktikisht “të përdorë diskrecionin e tij) sesa menjëherë të vazhdojë e të lëshoj një gjobë.

658. Në përgjigje të pyetjes nga avokati Z. A.S., mbrojtës i të pandehurit V.T., N.S. u pajtua se ai nuk ishte kompetent të përcaktoj vlerën e një veture të cilën e kishte ndaluar, shuma e gjobës që mund të ishte për atë veturë apo veprimet që duhet të ndërmerren nga institucionet tjera lidhur me të. Ai deklaroi se kolegët e tij e kishin ndaluar veturën sepse ishte me shpejtësi dhe dritat nuk i kishte të ndezura por ai deklaroi se ata mund ta ndalonin një veturë edhe pa ndonjë qëllim vetëm për ta kontrolluar atë. Megjithatë, ai deklaroi se detyra e tij e parë ishte që t’ia sqarojë personit të cilin e kishte ndaluar se përse kishte vepruar ashtu.

659. Oficeri N.S. u pajtua se si zyrtar i policisë, ai nuk ishte i autorizuar që të përcaktojë vlerën e mallrave të gjetur në veturë. Ai theksoi se ai i kishte ndaluar vetura me tabela regjistrimi të cilat nuk ishin të Kosovës dhe fare pa tabela regjistrimi por këto ishin më shumë rastet ku pronari i kishte paguar taksat që detyrohej dhe thjeshtë ishte në pritje që paratë të kalonin nëpër sitëm dhe të lëshohej vërtetimi.

660. Avokati mbrojtës A.S. pastaj i tregoi oficerit N.S. një dokument unik doganor i quajtur në shqip “DUD”. Ai deklaroi se ai nuk kishte parë një të tillë më përpara por ai e dinte se ai ishte një dokument i rëndësishëm.
661. Oficeri N.S. pohoi se si rezultat i veprimeve të tij në këtë rast, ai ishte pezulluar për dy muaj me gjysmë pagesë. Ai deklaroi se në atë ka pasur në dispozicion ngritje në pozita dhe se ai ishte përgatitur për këto por për shkak të suspendimit të tij ai nuk ka mundur që të konkurroj për to. Ai deklaroi se pastaj ishte kthyer në punë dhe u ndje keq për këtë. Ai e pranoi se në rastet e tilla si ky, detyra e tij ishte që ta lajmëroj Shërbimin Doganor të Kosovës që të vijjë dhe ta marrin veturën dhe ta procedojnë rastin.
662. Dëshmitari tjetër i thirrur për të dhënë dëshmi është oficeri i Policisë së Kosovës Sh.O. Ai e filloi dëshminë e tij në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 27 tetor 2015. Ai deklaroi se ka qenë oficer policie prej 1977 deri në 1990. Oficeri SH.O. deklaroi se ka qenë pjesë e njësisë patrulluese në stacionin policor të Ferizajt por ka punuar në njësinë e trafikut nga vitit 2005 deri më 2014. Oficeri SH.O. deklaroi se ai ka marrë trajnim të përgjithshëm për kundër-korrupsion por ky ka qenë vetëm themelor.
663. Oficeri Sh.O. deklaroi se në vitin 2013, mbikëqyrësi i tij ka qenë Rreshteri I.SH., mbi të ka qenë Kapiteni B.S. dhe mbi të ka qenë një Drejtor. Ai deklaroi se e dinte se në atë kohë M.S. ishte toger por theksoi se nuk ka qenë në zinxhirin e tij komandues. Ai pohoi se e njeh atë si kolegë dhe si epror që nga vitit 2013. Ai e tregoi (identifikoi) atë në gjykatore. Ai e dinte se nofka e tij ishte M. Ai gjithashtu e njohte B.SH.n si kolegë. Ai besonte se M.S. ishte i caktuar me detyrë në Njësinë Kundër Drogës por nuk kishte njohuri për B.SH. Ai theksoi se në vitin 2013, ai nuk ishte në posedim të numrave të telefonit të asnjërit prej tyre e as që është tani.
664. Oficeri Sh.O. deklaroi se e njohte Oficerin N.S.. Ai theksoi se ata ishin nga i njëjti fshat dhe kanë punuar së bashku në njësinë e trafikut por vetëm për pak kohë, në të njëjtin ndërrim. Ai deklaroi se nuk kanë lidhje me njëri tjetrin e as që kanë qenë veçanërisht shok të mirë. Ai pohoi se kur kanë punuar së bashku, puna e oficerit S. ishte

udhëheqës i ndërrimit pasi që ai kishte shërbyer më gjatë edhe pse ata te dy kanë patur të njëjtën gradë. Ai i konfirmoi numrat e tij telefonik në vitin 2012 dhe 2013. Ai pohoi se në vitin 2013, ai dhe Oficeri S. e kishin numrin e telefonit të njëri-tjetrit.

665. Oficeri SH.O. e konfirmoi se më datë 17 shtator 2013, ai kishte dhënë një deklaratë në IPK lidhur me incidentin në fjalë dhe se përmbajtja e saj ishte e saktë. Ai deklaroi se atij i kujtohet emri V.T. vetëm pasi e ka parë atë dhe pasi IPK-ja i tregon tiketën. Ai pohoi se asnjëherë më parë nuk ka qenë në gjykatë për të dëshmuar për një gjobë (tiketë) trafiku.

666. Oficeri Sh.O. deklaroi se V.T.t kishte bërë një ndalje të rregullt për tejkalim shpejtësie dhe për vozitje pa drita të ndezura. Oficeri SH.O. deklaroi se me sa ishte ai në dijeni kishte mbetur vetëm dënimi për ta shënuar në tiketë kur oficeri N.S. e mori një telefonatë. Ai tha se ai e kishte informuar se kishte folur me M. Ai e pranoi se ky ka qenë M.S. të cilin e identifikoi pak më herët. Oficeri Sh.O. deklaroi se M.S. asnjëherë nuk e kishte telefonuar në këtë mënyrë.

667. Oficeri Sh.O. theksoi se Oficeri N.S. ka refuzuar disa herë dhe vetëm kur ai e kreu atëherë u përgjigj në telefon. Ai pohoi se Oficer S. e njihte M. në të njëjtën mënyrë si e njihte ai. Ai theksoi se ai kurrë nuk i kishte parë së bashku.

668. Oficeri Sh.O. deklaroi se atij i kujtohet 28 maji i vitit 2013 pasi kishte dhënë deklaratën e tij në IPK. Ai pohoi se e kishte ndaluar veturën për tejkalim shpejtësie dhe për mos ndezjen e asnjë drite dhe pastaj ju afrua kolegut të tij, i cili ishte në veturë, për t'i treguar se edhe dokumentet e shoferit nuk ishin në rregull. Ai deklaroi se ishte kthyer në shtëpi deh pas një kohe kolegu ti tij e thirri prapë dhe e pyeti se çfarë duhet të bënin? Ai deklaroi se u konsultuan me njëri tjetrin dhe u morën vesh që t'i japin shoferit një gjobë më të ulët dhe ta lënë të shkonte, sepse ai premtoi se nuk do të del më në rrugë më këtë veturë pasi që e kishte huazuar atë. Ai deklaroi se shoferi ishte i respektueshëm dhe njeri jo i pasur.

669. Oficeri SH.O. ishte i vendosur se kolegu i tij veç e kishte shkruar gjobën dhe ishte gati për të lëshuar atë dhe e shqeu atë dhe vetëm pastaj ai foli me “M.”. Ai deklaroi se kolegu i tij foli me M.S. dhe ai vetëm pastaj foli me “M.”. Ai pohoi se kolegu i tij kishte folur me M.S. dhe se ai nuk e kishte dëgjuar bisedën.
670. Oficeri SH.O. e vazhdoi dëshminë me tij më 28 tetor 2015. Ai deklaroi se kur V.T. ishte ndaluar ai e tregoi patentë shoferin dhe ai kishte e dhe disa dokumente të tjera por zyrtarët policor nuk i kuptonin ato pasi që ishin në gjuhë të huaj. Ai deklaroi se V.T. ju tha që të qëndrojnë në veturë e tij por ai doli dhe i kërkoi zyrtarëve policor që t’ia lëshojnë një gjobë për kundërvajtje më të lehtë. Ai tha se e tërë kjo ka ndhëdur brenda 10 minutave. Ai e përsëriti se oficeri N.S. kishte refuzuar dy herë që të fliste me telefon derisa ai po e shkruante gjobën dhe vetëm pasi e përfundoi të shkruarit e gjobës, ai u përgjigj në telefon.
671. Oficeri SH.O. pohoi se besonte se kundërvajtja e tanishme kishte ndodhur 3-4 minuta para se të shkruhej koha në tiketë, d.m.th. në 17:35. Ai pohoi se e tërë ngjarja kishte zgajtur 10 deri në 15 minuta. Ai pohoi se nuk ishte i saktë për kohën por ai ishte i sigurt se “M.: kishte thirrë pasi që ishte lëshuar gjoba. Oficeri SH.O. deklaroi se N.S. nuk tha se çfarë i kishte thënë M. në telefon dhe, në fakt, ai nuk tha asgjë. Ai deklaroi se po të kishte thënë ai që ta lironin atë me një gjobë më të ulët ai do të kishte thënë kështu. Oficeri SH.O. e konfirmoi se Oficeri N.S. ishte suspenduar lidhur me këtë por vetë ai nuk ishte suspenduar.
672. Në përgjigje të pyetjeve të parashtruara nga A.S., avokat mbrojtës i të pandehurit V.T., oficeri SH.O. deklaroi se vetura të cilin e kishin ndaluar ishte një Renault “Clio” me ngjyrë të bardhë.
673. Dëshmitari tjetër ishte **A.I.** Ai ka dhënë dëshminë e tij në seancën e mbajtur më 16 nëntor 2015. Ai ishte i thirrur nga gjykata por i kërkuar nga M.S. dhe avokati i tij mbrojtës, A.R..

674. Në përgjigje të pyetjeve të parashtruara nga A.R., A.I. në seancën e mëparshme kishte deklaruar se ishte pretenduar që më 26 nëntor 2012, K.S. dhe A.B. e kishin hartuar një kontratë në zyrën e tij ligjore. Ai e ka konfirmuar se këto pretendime çuan në atë që ai të përjashtohet dhe zëvendëson si avokat mbrojtës i të pandehurit M.S. . Megjithatë, ai pohoi se K.S. madje as që nuk e ka ditur se ku gjendej zyra. Ai deklaroi se kontrata ishte hartuar në një zyre krejt tjetër dhe se ai nuk ishte i pranishëm. Ai deklaroi se kontrata e pretenduar nuk mbanë vulën e hartuesit ose as edhe të palëve nënshkruese (d.m.th as huadhënësit e as huamarrësit).
675. Në përgjigje të pyetjeve të parashtruara nga i pandehuri M.S. , A.I. se në datën kur pretendohet se është hartuar kontrata, ai ka qenë në Prishtinë duke përfaqësuar një klient.
676. Në përgjigje të pyetjeve të parashtruara nga Prokurori, A.I. deklaroi se ai ka përfaqësuar të pandehurin M.S. që nga arresti i tij në Shtator 2013 deri kur ai ishte përjashtuar në tetor 2014. Ai deklaroi se ai nuk kishte kërkuar asnjë lloj pagese sepse ai e dinte se familja S. kishte vështirësi financiare.
677. A.I. deklaroi se ai nuk e njihte K.S. apo ndonjë anëtarë të familjes S.para kohës së arrestimit të M.S.Ngjashëm, ai deklaroi se ai nuk e ka njohur A.B., B. apo R.S.. Ai deklaroi se nuk i ka borxh asnjërit prej këtyre njerëzve apo ndonjërit prej anëtarëve të familjeve të tyre ndonjë favor apo ndonjë borxh e as që ka pasur ndonjë ndenje të keqe ndërmjet tij dhe atyre.
678. A.I. deklaroi se ai e kishte parë kontratën e pretenduar dhe në të nuk ka pasur asgjë që tregonte se ai ishte i përfshirë. Ai deklaroi se formati, përmbajtja dhe terminologjia nuk ishin të llojit që ai i përdorë në kontratën e tij standarde. Megjithatë, ai u pajtua se duket se ajo i përmban të gjitha elementet e një kontrate ligjore dhe me shumë gjasa një avokat është përfshirë në përpilimin e saj.
679. A.I. deklaroi se besonte se kontrata në fakt është hartuar nga avokati S. J. zyrat e të cilit ishin 150 metra nga ai. Në përgjigje të pyetjes nga Kryetari i Trupit Gjykses,

dëshmitari A.I. deklaroi se pala e dëmtuar K.S. dhe dëshmitari A.I. e kishin gabim dhe po gënjenin kur ata e identifikuan atë si personi i cili e kishte kontratën.

680. Dëshmitari tjetër për të dëshmuar ishte avokati **S.T.**. Ai e filloi dëshminë e tij në sanëzën e shqyrtimit gjyqësor, më 16 nëntor 2015. Ai ishte thirrur nga mbrojtja e M.S.

681. S.T. deklaroi se ai është avokat dhe avokat mbrojtës i viktimës brenda kuadrit të Ministrisë së Drejtësisë. Ai deklaroi se e njihnte M.S. dhe B.SH. se kanë punuar së bashku në divizionin e trafikimit të qenie njerëzore në Policinë e Kosovës. Ai deklaroi se e ka njohur emrin B.S. kur rasti i tij është gjykuar në Gjykatën e Qarkut dhe kur kundër tij ishte shpallur një Aktgjykim dënues.

682. S.T. deklaroi se i kujtohet 29 qershori 2012 kur në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë, ai shërbeu në cilësinë e avokatit të viktimës një zonje të quajtur N.H.. Ai pohoi se dhe pala e dëmtuar N.H. ishte e pranishme, avokatja mbrojtëse L. XH. e caktuar sipas detyrës zyrtare dhe avokati mbrojtës i të pandehurit B.S., avokati E.SH..

683. S.T. deklaroi, gjatë dhënies së dëshmisë së dëshmitares N.H., nuk ka pasur ndonjë presion të ushtruar në të dhe ajo ka dhënë dëshminë e saj me vullnet të lirë. Ai pohoi se e kishte nënshkruar procesverbalin.

684. Në përgjigje të pyetjeve të parashtruara nga M.S. , S.T. deklaroi se ai ka marrë pjesë gjatë intervistimit apo marrjes në pyetje të viktimave qysh se ka filluar punën e tij në vitin 2011. Ai deklaroi se policia ishte e obliguar që ta thërras apo ftoj atë. Ai deklaroi se asnjëherë nuk ka parë dëshmi të ndonjë trysnie apo ndonjë lloj dhune në drejtim në viktimave të trafikimit , të ushtruar nga autoritetet policore.

685. S.T. deklaroi se nuk i kujtohet, në lidhje me rastin specifik të N.H., ai ka vërejtur për ndonjë ndryshim apo ndonjë alternim në dëshmitë e viktimave të pretenduara të trafikimit duke filluar nga hetimet deri te në prokurori dhe në fund në gjykatë.

686. Në përgjigje në pyetjet e prokurorit, S.T. deklaroi se ai fillimisht u takua me N.H. në stacionin policor në Ferizaj. Ai nuk e dinte se sa kohë ajo ka qenë atje. Ai deklaroi se ka biseduar me të për 5 deri në 10 minuta para se të merrej deklarata e saj.
687. S.T. deklaroi se rasti i N.H.t në nuk kishte *“asgjë të posaçme”*, nuk dallohej prej rasteve të tjerave me të cilat ishte marrë ai. Ai deklaroi se asnjëherë më parë nuk e kishte takuar atë apo dikë nga familja e saj.
688. S.T. pohoi se ai vinte nga fshati Greme por ai deklaroi se si është një fshat goxha i madhe me 1,100 shtëpi dhe me më shumë se 5,000 banorë andaj ai nuk i njihte B.V., S.M. apo A.M.. Ngjashëm me këtë, ai deklaroi se nuk e njihte familjen S. dhe biznesin *“Luboteni”*. Ai deklaroi se kur ishte thirrur që të merr pjesë në rastin e N.H. ai nuk kishte njohuri se ka pasur akuza penale kundër ndonjë pale. S.T. deklaroi se ai ishte në dijeni se në këtë rast ishte e përfshirë edhe një vajzë tjetër pasi ai shkoi në stacionin policor me një koleg. S.T. deklaroi se ai nuk ka asnjë përshtypje për besueshmërinë e N.H.
689. Në përgjigje të pyetjeve nga pala e dëmtuar, B.S., S.T. deklaroi se ai nuk mund të thotë se si u bë që N.H. erdhi në stacionin policor. Ai pohoi se në përgjithësi nëse viktimat e pretenduar ka ndonjë ankesë zyrtare lidhur me trajtimin e tyre përfshirë metodën e ekzaminimit të zyrtarëve policor, këto duhet të raportohen te prokurori apo drejtpërdrejtë në departamentin e tij.
690. Dëshmitari tjetër për të dëshmuar ishte **A.K.** Ai ka dhënë dëshminë në seancën e shqyrtimit gjyqësor më 20 nëntor 2015. Edha ai ishte propozuar nga mbrojtja e M.S.
691. Ai punonte në Policinë e Kosovës. Ai deklaroi se e njihte M.S. dhe B.SH.n për shkak të punës që e bënte. Ai deklaroi se e njihte B.S. si dikë që ishte i dyshuar për trafikim me qenie njerëzore dhe për këtë ai ishte arrestuar. Ai deklaroi se ai e njihte një person të quajtur *“S.”* si viktimë e trafikimit me qenie njerëzore.
692. Në përgjigje të pyetjeve nga A.R., A.K. deklaroi se nga Janari i vitit 2013 ai ishte hetuesi kryesor në sektorin qendror, në drejtorinë e trafikimit me qenie njerëzore në

Policinë e Kosovës. Ai theksoi se mbi të ishte një drejtor dhe njësitë rajonale të cilat kanë raportuar drejtpërdrejt te ai.

693. Oficeri A.K. theksoi se ai e ka prangosur B.S.n në stacionin policor në Ferizaj. A.K. deklaroi se ai ka kontaktuar B.S. përmes telefonit dhe i ka kërkuar atij që të paraqitet në stacionin policor. Ai tha se do të vonohej pasi q; ai ishte larg, andaj ai i tha atij *“nuk është problem”*. Megjithatë, ai ka deklaruar se kur ka ardhur koha që ai të paraqitet, ai nuk u paraqit andaj ai e thirri edhe një herë por ai nuk u përgjigj. Ai deklaroi, pas pak, shefi i hetimeve në stacionin policor në Ferizaj, Togeri M.S. i telefoni atij dhe e pyeti atë dhe ka pyetur se a ka kërkuar praninë e B. Ai deklaroi se ai i tha atij: *“po, neve na duhen disa sqarime lidhur me një rast”*.
694. Oficeri A.K. ka deklaruar se një qytetar nga Prishtina e kishte raportuar këtë rast. Ai pohoi se në fillim stacioni policor jug në Prishtinë është marrë me këtë dhe pastaj ishte vazhduar nga njësia qendrore e drejtorisë së trafikimit të qenieve njerëzore dhe njësia në Ferizaj nuk kishte njohuri për këtë deri në momentin e arrestimit të B.S.. Ai deklaroi se rasti ishte udhëhequr tërësisht nga njësia qendrore në Prishtinë.
695. Në përgjigje të pyetjeve nga prokurori, Oficeri A.K. deklaroi se ai nuk e ka njohur dhe as që kishte lidhje me palët e dëmtuara të rastit ku përfshihet B.S. apo në rastin e tanishëm.
696. Oficeri A.K. ka deklaruar se ai e takonte M.S. n afërsisht një herë në muaj përmes detyrës së tyre por se ai nuk ishte shoqëruar me të jashtë punës. Megjithatë, ai e shprehu B.n e tij se ai tani akuzohet në gjykatë për keqpërdorim të detyrës zyrtare.
697. Oficeri A.K. deklaroi se ai asnjëherë nuk ka zhvilluar një hetim të përbashkët me M.S. n. Megjithatë, ai deklaroi se nga viti 2010 deri në vitin 2013, ai i ka caktuar detyrës të gjithë njësive dhe se ai i ka caktuar edhe detyra specifike M.S. dhe jo vetëm për këtë rast. Ai deklaroi se M.S. ishte hetuesi udhëheqës për rastet që janë caktuar atij. Oficeri A.K. theksoi se ai nuk ka punuar në raste me B.SH.

698. Oficeri A.K. deklaroi se falë meritave të pozitës së tij ai kishte njohuri të përgjithshme për veprimtaritë e prostitucionit dhe të trafikimit në Kosovë. Ai e mohoi të ketë dëgjuar se në kafenetë “*Montana*” dhe “*International*” ishin vendet ku supozohej se trafikoheshin dhe prostituonin vajza nga Maqedonia dhe Shqipëria. Ai deklaroi se nuk ishte në dijeni se së voni në vitin 2015, kafeneja “*International*” ishte mbyllur pas një kontrolli nga Policia në të cilën pronari ishte arrestuar dhe ku policia e migracionit kishte bërë arrestime në lidhje me këtë kafene.
699. Dëshmitari tjetër për të dëshmuar ishte zyrtari policor i Policisë së Kosovës **E.A.**. Ai gjithashtu filloi dëshminë e tij në seancën e 20 nëntorit 2015. Ai ishte thirrur nga mbrojtja e M.S. t.
700. Në përgjigje të pyetjeve nga avokati A.R., mbrojtësi i të pandehurit M.S. , ai deklaroi se ai që nga viti 2002 deri në shtator 2002 ai ishte polic hetues; ai punonte në hetimin e rasteve të trafikimit me qenie njerëzore. Ai deklaroi se përparësia e tij ishte mbrojtja e viktimave dhe pastaj të merrej me të dyshuarit e rastit.
701. Oficeri E.A. deklaroi se atij i kujtohet një rast me palët e dëmtuara L.P. dhe N.H. Ai pohoi se ato fillimisht ishin marrë në pyetje si dëshmitare. Megjithatë, ai thekoi se pas hetimit dhe pas konsultimit me prokurorin, policia konstatoi se ato ishin viktime të mundshme dhe më pas ato ishin marrë në pyetje dhe një herë. Ai deklaroi se ato ishin intervistuar në prani të avokatit mbrojtës dhe ato ishin pranuar se ishin viktime. Ai deklaroi se mbrojtës ishte z. I.T. Ai deklaroi se ai e njihnte edhe S.T. Ai deklaroi se te dy zonjat, në cilësinë e viktimave, kanë sqaruar në mënyrë konkrete dhe precize mënyrën me të cilën ato supozojnë se janë viktimizuar. Ai deklaroi se askush nuk ka ndikuar apo ka ushtruar presion mbi to në praninë e tij apo në prani të zyrtarëve policor derisa ato po intervistoheshin dhe se kishte një procedurë për ta raportuar atë po të kishin ato presion. Ai deklaroi se M.S. nuk ka ndërhyrë në hetim as me fjalë e as më kërcënime.

702. Oficeri E.A. deklaroi se e njithe R.N. Ai deklaroi se i kujtohej se “*të gjithë zyrtarët policor ishin të pranishëm*” kur ai ishte marrë në pyetje, por atij nuk i kujtohet saktësisht se kush e ka marrë në pyetje atë.
703. Oficeri E.A. deklaroi se kur është marrë në pyetje B.S., i pranishëm ka qenë edhe avokati mbrojtës. Ai theksoi se nuk kishte njohuri për ndonjë trysni apo ndikim qoftë fizik apo psikologjik të ushtruar gjatë hetimet në drejtim të B.S. e aq më pak nga të pandehurit M.S. t.
704. Oficeri E.A. deklaroi se hetimet në Policinë e Kosovës kryhen në mënyrë të pavarur. Ai deklaroi se në rastin e B.S., rasti fillimisht kishte ardhur nga drejtoria e Prishtinës dhe pastaj shefi ja kishte dorëzuar rastin atij. Megjithatë, ai theksoi se pasi kishte filluar me hetimet, dhe pasi që B.S. vinte nga i njëjti fashat, ka qenë një marrëveshje me zyrtarin policor të quajtur N.O.
705. Në përgjigje të pyetjeve nga prokurori, oficeri E.A. deklaroi se për herë të parë e kishte njohur M.S. n në korrik të vitit 2005. Ai pohoi se M.S. ishte një toger dhe shef i njësitit të tij. Ai theksoi se B.SH. mbante të njëjtën gradë si ai.
706. Oficeri E.A. deklaroi se ai nuk kishte marrë udhëzime apo urdhra specifike nga M.S. . Megjithatë, ai deklaroi se ai ja kishte shqyrtuar punën dhe rastet që ishin caktuar atij. Ai deklaroi se ishte shqetësuar kur ishte arrestuar dhe një hije e zezë kishte rënë mbi njësinë.
707. Oficeri E.A. deklaroi se ai e njithe B.S.n që nga fëmijëria. Ai deklaroi se e dinte se ai e udhëhiqte Ndërmarrjen “*Luboteni*”. Ai nuk e dinte se a ishte ndërmarrja e suksesshme apo jo. Ai deklaroi se dinte dhe për Ndërmarrjen “*Sallahu*”. Ai theksoi se kushëriri i tij, djali i hallës së tij, ishte pronari i asaj ndërmarrje dhe ata kanë shtruar asfalt. Ai nuk e dinte se a ka pasur ndonjë konkurrencë ndërmjet dy ndërmarrjeve.

708. Oficer E.A. deklaroi se ai kurrë nuk ka pasur rast të takohet me B.S. jashtë stacionit të policisë e as që e kishte transportuar atë ndonjëherë jashtë stacionit policor. Ai pohoi se ai e kishte intervistuar atë së bashku me B.SH. Atij nuk i kujtohet se a ka qenë i pranishëm M.S. Ai deklaroi se, pas ndalimit të B.S. për dy netë në Ferizaj, ai kishte vetë së bashku me B.SH. në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Ai deklaroi se ai vetë dhe N.O. kishin sjellë B.S.n në Prokurorinë e Qarkut. Ai theksoi se M.S. ishte me ta prej stacionit policor deri te kafeneja “Lamborghini” por, me sa ka ai njohuri, as M. e as B.SH. nuk kishin ardhur me ta në Prishtinë.
709. Oficeri E.A. deklaroi se ka mundur të dikush të ketë thënë (fjalë për efektin e), *“ndihmoi atij sepse ai është njëri prej tanëve”* por nuk i kujtohet se a ka qenë M.S. ai që e ka thënë këtë. Ai tha se këtë e mori si një nxitje për të ndihmuar atij si një shok si njeri.
710. Oficeri E.A. deklaroi se hetimi i rastit ku përfshinë B.S. ishte në zhvillim e sipër për më shumë se një vit. Ai deklaroi se rasti i ishte caktuar Oficerit N.O. Ai e mohoi se oficerët së pari kanë marrë deklaratat nga të dyshuarit e pastaj deklaratat nga viktimat.
711. Oficeri E.A. deklaroi se B.S. fillimisht ishte arrestuar por më tepër ata i kishin kërkuar atij që të shkonte me ta për një intervistim dhe se ai nuk kishte kundërshtuar. Megjithatë, ai u pajtua se ai nuk është i lirë që të shkonte. Ai deklaroi se i ka siguruar atij një avokat. Ai deklaroi se marrja e tij në pyetje zgjati prej një deri një orë e gjysmë. Ai nuk ishte i sigurt se a ishte M.S. aty afër derisa ai po e merret në pyetje B.S.n. Megjithatë, ai deklaroi se ishte i sigurt që ai ishte i pranishëm kur janë marrë deklaratat e N.H. dhe L.P.
712. Oficeri E.A. deklaroi se atij i kujtohet të ketë pasur një bisedë në praninë e B.S. për R.B. Ai deklaroi se ai e ka përmendur emrin e tij jo si dëshmitarë por si të dyshuar.
713. Oficeri E.A. deklaroi se ditën kur ai e dërgoi B.n në gjykatë, anëtarët e familjes së tij nuk po përcillnin atë në veturën e policisë dhe se ai nuk i ka parë anëtarët e tij të familjes në gjykatë apo menjëherë pas gjykatës. Ai deklaroi se ai kurrë nuk ka pasur

ndonjë ndërlidhje me ndonjërin prej tyre. Oficeri E.A. deklaroi se ai ka qenë i pranishëm kur B.S. i ishin shqiptuar 30 ditë paraburgim.

714. Oficeri E.A. e ka vazhduar dëshminë e tij më 23 nëntor 2015. Në përgjigje të pyetjeve nga Prokurori, ai deklaroi se mbase kanë kaluar gjashtë deri shtatë muaj para se ai të kërkonte që të lirohet nga detyra e hetuesit kryesor. Ai deklaroi se, pasi ata i kishin sqaruar arsyet e tyre, M.S. është pajtuar më këtë porse ai asnjëherë nuk kishte parë ndonjë dokument lidhur me këtë. Oficeri E.A. u pajtua që pavarësisht kësaj ai mbeti që të punonte në rastin deri në nëntor të vitit 2012. Megjithatë, ai ka deklaruar se gjatë kësaj kohe ai nuk ishte i interesuar për këtë rast dhe kryesisht ka punuar në raste të tjera.

715. Oficeri E.A. deklaroi se ai e njohte një person me emrin B.G. dhe ai ishte rreshter por e ka plotësuar rolin e togerit dhe të mbikëqyrësit.

716. Dëshmitari tjetër ishte oficeri i Policisë së Kosovës **B.G.** Ai e ka filluar dëshminë e tij në seancën e shqyrtimit gjyqësor më 23 nëntor 2015.

717. Duke u përgjigjur pyetjes së avokatit A.R., mbrojtësit të të pandehurit M.S. , oficeri B.G.deklaroi se ai ka punuar në Policinë e Kosovës prej vitit 2004. Ai pohoi se nga vitit 2007 deri në vitin 2013 ai ka mbajtur gradën e rreshterit dhe në vitin 2013 ai ishte ngritur në gradën e togerit.

718. Oficeri B.G. deklaroi se e njohte M.S. n që nga viti 2004 kur ai kishte filluar të punonte në Policinë e Kosovës. Ai deklaroi se atë kohë ata kanë punuar në njësitin e patrullës. Ai pohoi se e njohte edhe B.SH. pasi që ai ka punuar bashkë më të për 5 – 6 vite në njësinë speciale. Ai deklaroi se ai e njohte edhe E.A. i cili kishte punuar si hetues në Njësinë Qendrore të Hetuesisë dhe kur ai ka punuar në njësinë kundër trafikimit me qenie njerëzore, ai ka punuar me të edhe me B.SH.

719. Oficeri B.G. deklaroi se ai nuk e ka njohur B.S. Ai pohoi se i kujtohen emrat L.P. dhe N.H.. Ai pohoi se kjo ka qenë nga një rast ku përfshihej edhe B.S.në Njësinë kundër

Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Ai deklaroi se në kohën kur ai ishte udhëheqës i hetimeve ai nuk kishte pasur “dorë” por ai ka mbikëqyrë situatën dhe i ka lejuar hetuesit e specializuar që të merren me çështje specifike.

720. Oficeri B.G. deklaroi se “një apo dy herë” ai ka qenë në lokale me muzikë “live” së bashku me M.S. , jashtë orarit të punës. Ai pohoi se e njihte një person me emrin “D.” por atij nuk i kujtohet se a ka qenë ai i pranishëm në këto raste. Ai deklaroi se M.S. dhe D. kanë pasur “një farë lidhje” por nuk e din se a kanë qenë ata shokë.

721. Oficeri B.G. deklaroi se zyrtarisht e din se kur M.S. dhe B.SH. janë arrestuar dhe se ai nuk është interesuar lidhur me këtë pasi që ai nuk ishte shumë i interesuar për thashetheme.

722. Oficeri B.G. deklaroi se nga Janari deri në Qershor të vitit 2012 ai ka punuar në njësinë që është mbikëqyrë nga M.S. dhe ai ka punuar nën urdhrat, këshillat dhe udhëzimet e tij.

723. Oficeri B.G. deklaroi se në lidhjet me hetimet ndaj B.S., ai kishte intervistuar dy femra të mitura të nacionalitetit serb dhe intervista është zhvilluar në prani të një punëtori social në Shtërpce. Ai deklaroi se dy të miturat ishin intervistuar në cilësinë e dëshmitarëve. Ai deklaroi se rasti ishte udhëhequr nga N.O. përderisa E.A. ka vepruar si ndihmës. Ai deklaroi se përveç intervistimit të të dy të miturave, ai nuk ka marrë në ndonjë pjesë tjetër. Megjithatë, ai e pranoi se ai ka nënshkruar gjatë hetimit dy dokumente në periudhën nga Janarit dhe Qershorit 2012. Ai deklaroi se M.S. ishte eprori i tij dhe se ai nuk e dinte se çka ka bërë ati në hetime dhe ai nuk e ka përcjellë atë. Oficeri B.G.deklaroi se ai nuk e ka ditur se kur kishte ardhur në zyrën e tij rasti i B.S. por e dinte se N.O. në fillim ishte hetuesi kryesor.

724. Oficeri B.G.deklaroi se ai ishte i brengosur jo vetëm me arrestimin e M.S. por sa herë që një zyrtar policor arrestohet por theksoi se secili prej këtyre zyrtarëve policor gëzonte prezumimin e pafajësisë. Ai deklaroi se ai i besonte M.S. derisa ai ka punuar me

të dhe ai nuk e konsideron se puna e tij është njollosur ndonjëherë. Ai tha se ai kishte besim edhe në B.SH.

725. Dëshmitari i radhës ishte A. "L." K. Ai e filloi dëshminë e tij në seancën e shqyrtimit gjyqësor më 24 nëntor 2015. Ai ishte thirrur nga mbrojtja e M.S. A. K. theksoi se me profesion ishte piktor dhe kishte shkollim të mesëm.

726. A.K. deklaroi se e njohte M.S. që nga viti 2007 apo 2008 kur kishte ndodhur një vrasje në fshatin e tij dhe M.S. dhe ekipi i tij e kishin hetuar atë vrasje. Ai deklaroi se ai e njeh si zyrtar policor edhe B.SH. Ai deklaroi se e njeh A.D. si shofer kamioni. A. K. deklaroi se po ta shohë mund ta njeh edhe A.S. por nuk e njeh XH.B., S.S. dhe më herët ai nuk e ka njohur B.S. por tani e njeh atë. Ai pohoi se e njeh R.A.n.

727. A.K. deklaroi se atij nuk i kujtohet data apo viti por e din se ai ishte në Ferizaj me shokun e tij A.D., kur XH.B. i telefonoi A.D. Ai deklaroi se XH.B., vëllai i B., dhe një person tjetër erdhi në Ferizaj. Ai deklaroi se ata ishin takuar në një kafene dhe ata e pyetën A.D. se a e njohte B.S. A. B. deklaroi se edhe XH.B. e pyeti atë se a e njohte zyrtarin policor M. Ai pohoi se A.D. e pyeti atë "pse" dhe ai u përgjigj "dhëndëri im është arrestuar dhe ne duam të dimë se përse ai është arrestuar." Ai deklaroi se me sa i kujtohet atij dhe me sa i ka treguar XH. ka qenë në lidhje me disa femra dhe disa tenderë. Ai deklaroi se e njohte M. por ai nuk kishte ndonjë marrëdhënie shoqërore me të. Ai deklaroi XH.B. kishte thënë se M. e kishte një shok që quhej D. dhe A.K.deklaroi se ai e njeh atë dhe vendin ku ka punuar ai. Ata ishin pajtuar të shkonin atje atë natë.

728. A.K. deklaroi kur arritën pijet e tyre dhe D. ishte atje dhe ata e ftuan atë në tavolinën e tyre dhe i thanë atij se donin të bisedonin të flisnin me M. Ai deklaroi se D. tha "ai ishte këtu po sapo shkoi". Ai deklaroi se ata i kërkuan atij që t'i telefononte atij por ka ora ishte ndërmjet 23:00 dhe 01:00 dhe M. nuk u përgjigj në telefon. Ai deklaroi se D. kishte thënë, "eja dhe më merr në shtëpinë time dhe do të shkojmë e do ta gjejmë M.". Megjithatë, ai deklaroi se të nesërmen D. nuk ishte në shtëpi e a që përgjigjej në telefon.

729. A.K. deklaroi se ata kanë vendosur që vetë ta thërrasin M. Ai deklaroi se ata ishin takuar në pompën e karburanteve “*Lamborghini*” në Ferizaj. Megjithatë, ai pohoi se M. refuzoi që të ulej me të tjerët sepse ai nuk i njihte ata. Ai pohoi se e kishte pyetur M. se çfarë po kërkonte familja S., d.m.th. përse ishte arrestuar B.? A ka qenë në lidhje me vajzat apo me tenderë? Megjithatë, ai deklaroi se M. nuk deshi të përgjigjej por i tha atij që të shkonte në Prokurori në Prishtinë . Ai deklaroi se ata shkuan dhe folën me një avokat i cili ju tha atyre se Gjyqtari i kishte caktuar një muaj paraburgim. Ai deklaroi se ai u kthye në Ferizaj me anëtarët e familjes së B.S.. Ai pohoi se ata kishin zhvilluar një bisedë të përgjithshme dhe ai nuk ju kishte sugjeruar ndonjë veprim specifik.
730. Duke qenë nën pyetje të tërthorta të parashtruara nga Prokurori, A.K.deklaroi se ai sot nuk ka biseduar me avokatin e të pandehurit M.S. , avokatin A.R.. A.K.deklaroi se ai vetë kurrë nuk ka qenë nën hetime e as që është arrestuar ndonjë herë.
731. A.K. deklaroi se tri herë nga shtëpia e tij janë vjedhë sende dhe ai i ka kërkuar ndihmë M.S. t si dhe policëve të tjerë. Ai deklaroi se ai e kishte numrin e M.S. t në stacion policor pasi një vrasje të ndodhur në fshatin e tij në vitin 2007 apo 2008.
732. A.K.u pranoi se e njihte R.A. Ai pohoi se ai shkonte në vendet si “*International*” dhe “*Montana*”. Ai deklaroi se ai e kishte parë R.A. duke punuar në këto vende. Atij nuk i kujtohej se a e ka parë M.S. në këto vende/lokale.
733. A.K. pohoi se ka mirë kafe me M.S. n në kafenenë “*Lamborghini*” por atij nuk i kujtohet ndonjë rast tjetër. Ai deklaroi se nuk e dinte se a janë shokë R.A. dhe M.S. . Ai deklaroi se ai ka mundësi t’i ketë parë një herë së bashku në kafenenë “*International*” por nuk i kujtohet kur.
734. A.K. deklaroi se takimin e parë në Ferizaj të cilin e përshkroi më sipër ishte në një restorant apo kafene por atij nuk i kujtohet emri. Ai deklaroi se A.D. e njihte M.S. apo “M.”. Ai e përsëriti se XH.B. kishte arritur me njërin prej vëllezërve të B.S. dhe me një

njeri tjetër. Ai pohoi se besonte se XH.B. nuk e ka ditur se ai ka kontakte ne polici. Ngjashëm, ai pohoi se besonte se A.D. nuk i ka njohur vajzat që ishin në qendër të rastit të B.t. Ai e pranoi se ka thënë që e njeh R.A. apo D. e njithe M.S. dhe se mund t'i vejë në kontakt anëtarët e familjes S.me të. Ai nuk arriti të jep sqarime se përse ai thjesht nuk ua kishte dhënë atyre numrin e M.S.

735. A.K. deklaroi se lidhur me rastin e B.S., ai nuk i kishte dëgjuar emrat e L.P.dhe N.H.t.

736. A.K. deklaroi se në takimin në kafenenë “*Lamborghini*” ai kishte pirë kafe me M.S. për afërsisht për vetëm dhjetë apo pesëmbëdhjetë minuta. Ai deklaroi se ai nuk ishte shok me M.S. por ai nuk arriti të jep sqarime se përse ai e kishte ndërprerë atë çfarë ishte duke bërë dhe erdhi për ta takuar atë. Ai e përsëriti se M.S. nuk zbuloi ndonjë informacion dhe se ata duhej të shkonin në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Ai deklaroi se nuk i kujtohej t’i ketë thënë XH.B. dhe dy njerëzve të tjerë, diçka e tillë si “*do të bëhet mirë me rastin*”. Ai deklaroi se nuk i kujtohet tu ketë thënë atyre se duhet të mendonin t’i jepnin “M.” një farë shpërblimi apo një bakshish; ai deklaroi se ata nuk kanë folur për këtë temë. Ai pohoi se emri i B.SH. nuk ishte përmendur fare. Ai deklaroi se arsyeja kryesore se përse ai ishte përfshirë në rastin e XH.B. ishte shoku i tij.

737. A.K.deklaroi se ai e njithe B.H. si pronar të “*Ballkan Petrol*” –it dhe motra e tij ishte e martuar për vëllain e tij (B.it). Ai deklaroi se ai nuk kishte bërë asgjë tjetër për t’i ndihmuar familjes S.dhe se ai nuk e dinte rezultatin përfundimtar të rastit të B.S..

738. Dëshmitari tjetër ishte **B.K.** Ai ishte një zyrtar i Doganave të Kosovës. Ai e filloi dëshminë e tij në seancën e shqyrtimit gjyqësor më 7 dhjetor 2015. Ai ishte thirrur nga mbrojtja e V.T.

739. Mbrojtja e të pandehurit V.T., avokati A.S. ja paraqiti dëshmitarit një dokument.¹² B.K. deklaroi se ai ishte një dokument unik doganor, që në gjuhën shqipe mban shkurtesën DUD. Ai pohoi se ishte një deklaratë doganore, fillimisht e paraqitur nga njësia përkatëse doganore ku deklarohet vendi i caktuar i origjinës dhe vlera e veturës dhe shuma për pagesë e taksave doganore, TVSH-së dhe akcizës, etj. Ai deklaroi se autoritetet e doganave në Ferizaj kanë pranuar vlerësimin e kësaj veture të caktuar në 2,050 Euro. Ai deklaroi se duke marrë parasysh dokumentin *prima facie*, të gjitha taksat janë paguar për sa i përket veturës. Megjithatë, ai nuk mund të thoshte nëse vlerësimi i veturës ishte në rregull.
740. B.K. deklaroi se Doganat e Kosovës ishin autoriteti i vetëm që mund të bënte vlerësimin e vlerës së veturës për qëllime të taksimit dhe se ato gjithashtu kanë pasur kompetenca që të vlerësonin këtë brenda tre vitesh. Ai deklaroi se Doganat e Kosovës dhe ndërmjetësuesit doganor dhe agjencitë tjera shpeditive ishin të vetmet organe të cilët mund të lëshojnë një dokument “DUD”.
741. Kur mbrojtësi ja tregoi një dokument tjetër¹³, B.K. deklaroi se kjo nuk vërtetonte ndonjë pagesë por më tepër vërtetonte se vetura në fjalë mund të vozitet. Ai deklaroi se ishte e detyrueshme që të paraqitet një dokument i tillë para se vetura të mund të taksohej.
742. B.K. u pajtua që shumë vetura ishin ngarë në Kosovë por ishin të regjistruara diku tjetër dhe varej nga autoritet të cilat e vlerësonin se a ishte automjeti një importim i përkohshëm apo vetëm kalonte transit nëpër vend. Ai deklaroi se ekziston një legjislacion për të rregulluar se sa gjatë automjetet e tilla mund të voziten në Kosovë me këto tabela. Në përgjithësi, ai deklaroi se ekziston një procedurë kur policia e ndalon një automjet për shkak të mos pagesës së taksave, ata mund t’i japin pronarit një “periudhë e faljes” për ta paguar. Ai deklaroi se gjatë kësaj kohe, policia ja ka dorëzuar rastin Doganave të

¹² Regjistratori i provave të Gjykatës, Vëllimi I në Tab. 22

¹³ Regjistratori i provave të Gjykatës, Vëllimi I në Tab. 22

Kosovës për tu siguruar se është bërë pagesa. Ai deklaroi se pasi të kalojë afati për pagesë, atëherë është një procedurë tjetër.

743. Avokati mbrojtës e pyeti dëshmitarin se a kishte njohuri me opinionin ligjor të Gjykatës Supreme në lidhje me Nenin 276 të Kodit të Doganave dhe të Akcizës si dhe Nenin e mëparshëm 319. Dëshmitari deklaroi se që nga hyrja në fuqi e Kodit të ri Penal, Neni 439 parashtrohet me një fjali e që thotë se çdo shkelje sipas atij Neni do të konsiderohet vepër penale. Ai deklaroi se kjo ka krijuar problem në Doganat e Kosovës sepse ata ishin përdorur për ti trajtuar disa vepra sipas këtij seksioni si shkelje administrative (e jo vepra penale). Ai shprehu B. e tij se ekziston një mendim ligjor i Gjykatës Supreme të Kosovës dhe i EULEX-it se të vetmet vepra të supozuara ishin ato për shmangie nga tatimi në shumën që e tejkalon 5,000 Euro dhe këto ishin vepra penale. Ai deklaroi se kjo është ajo se si Doganat e Kosovës e kanë zbatuar ligjin.

744. Në përgjigje të pyetjeve nga avokati A.R., mbrojtësi i të pandehurit M.S. , B.K. deklaroi se Doganat e Kosovës i përdor gjashtë (6) kritere kur bëjnë vlerësimin e një automjeti.

745. Në përgjigje të pyetjeve nga Prokurori, B.K. deklaroi se Gjykata Supreme e Kosovës, kishte nxjerrë një opinion ligjor për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të Kosovës për këtë çështje si dhe kishte edhe një opinion nga EULEX-i. Ai deklaroi se e ka lexuar opinionin e Gjykatës Supreme dhe me sa i kujtohet atij, aty thuhej se ai është nxjerrë *“në bashkëpunim me gjyqtarët e EULEX-it”*.

746. B.K. deklaroi se nuk ka qenë i përfshirë në vlerësimin e automjetit në këtë rast dhe as që ishte në dijeni për ndalimin në trafik dhe për rrethanat lidhur me këtë deri tani para gjykatës. Ai deklaroi se nuk e njohte M.S., B.SH., SH.O. apo N.S..

747. Dëshmitari tjetër ishte **L.P.** Ajo e filloi dëshminë e saj në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 7 dhjetor 2015. Ajo ishte thirrur nga mbrojtja e M.S.

748. Në përgjigje të pyetjeve nga A.R., mbrojtësi i të pandehurit M.S. , ajo deklaroi se ajo nuk e ka kryer shkollën e mesme. Ajo pohoi se në vitin 2012, ajo ishte e përfshirë si palë e dëmtuar në një rast tjetër ku përfshihej B.S. dhe ajo pohoi se besonte se rasti akoma nuk ka përfunduar. Ajo e pranoi se kishte dhënë dy deklarata për atë rast, një në polici dhe një para prokurorit. Kur u pyet se a i pranon këto deklarata si të sajat, ajo tha se ka kaluar shumë kohë.
749. L.P. nuk i kujtohet se a e njeh një person me emrin B.SH.. Lidhur me deklaratat, ajo deklaroi se nuk kishte shkuar në stacionin policor por policia kishte ardhur tek ajo pa ndonjë paralajmërim. Ajo deklaroi, “ne” jemi thirre, dhe “neve” na është thënë se “ne” duhet të japim deklarata lidhur me B.S. dhe “neve” gjithashtu na është thënë se, “ai është person shumë i keq” ndërsa ajo personalisht e kishte njohur vetëm si shokë. Ajo deklaroi se ka gjasë që këtë e ka thënë një person me emrin B., i cili e kishte intervistuar atë në stacionin policor por nuk është e sigurt sepse ka kaluar shumë kohë. Ajo deklaroi se aty ishin edhe dy persona të tjerë por të cilët nuk ishin prezantuar.
750. L.P. deklaroi se ajo nuk e njeh I.T.. Ajo deklaroi se dy personat tjerë që ishin të pranishëm gjatë intervistimit kishin thënë se e dinin që “ne” e njohim B.S. dhe “ne” ishim të befasuara nga kjo sepse ne nuk e dinim se si ata e dinë këtë gjë. Ajo deklaroi se asaj i ishin bërë pyetje se si e njeh ajo atë dhe ajo pohoi se ishte përgjigjur se ajo e njeh atë dhe se ai ishte shok i saj. Ajo pohoi se e njeh R.B. dhe ajo e ka takuar atë kur ajo po pinte kafe me B. Ajo deklaroi se ai ishte ish i dashuri i saj.
751. L.P. deklaroi se ajo nuk e njeh M.S. n dhe as që e ka njohur më parë e as që mundet ta njeh atë. Ajo pohoi se N.H. ishte shoqe e saj. Ajo deklaroi se e njeh atë që shtatë apo tetë vite por jo më gjatë. Ajo pohoi se në vitin 2011 apo 2012 ajo ka jetuar me familjen e saj dhe se ajo ishte e vetmja e punësuar. Ajo deklaroi se ka punuar në një internet kafe. Ajo pohoi se B.S. vinte aty si myshteri dhe paguante me para në dorë dhe i jepte asaj bakshish. Ajo deklaroi se ajo e ka prezantuar N.H.n me B.S.n. Ajo deklaroi se kishte shkuar së bashku me ta nëpër qytete të tjera në Kosovë. Ajo deklaroi se ka shkuar me ta shumë herë në Hotelin “Europa 92”. Ajo deklaroi se ajo ka qenë së bashku me ta

edhe në Sarandë, Shqipëri por nuk i kujtohej sa kishin qëndruar atje. Ajo pohoi se ata ishin kthyer në Durrës nga ku B.S. ishte kthyer në Kosovë dhe ajo kishte qëndruar në Durrës me shoqen e saj.

752. Avokati mbrojtës A.R. i tregoi dëshmitares deklaratën e saj PP, nr. 390-1/12, të datës 29 qershor 2012, e hartuar në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë në të cilën ajo pretendohet të ketë deklaruar, *“Më kujtohet se ne i kemi kërkuara para B. sepse donin të shkonin në Shqipëri për pushime.....”*¹⁴ ndaj të cilës ai ishte përgjigjur, *“po nëse dilni me mua dhe nëse ne të gjithë së bashku bëjmë seks”,* dhe ajo më tej tha, *“ne nuk folëm për çmim dhe ne i pranuan kushtet e tij, dhe pas kryem marrëdhënie, ai la në tavolinë nga 100 Euro për secilën, dhe unë dua që ta theksoj se unë kam pasur marrëdhënie të tilla me B. shumë herë, dhe çdo herë ai na paguante, por kurrë nuk e keni caktuar ndonjë çmim për këtë. Më kujtohet se para 3 vitesh ne shkuam në Sarandë me B.n dhe me shoqen time N., ku qëndruam për dy ditë, dhe B. kërkoi nga ne që të bëjmë një orgji, por unë refuzova dhe si pasojë ai na neve në rrugë, por pastaj u kthye prapë dhe na qoi në Durrës, ku edhe na la neve”.* Ajo deklaroi se nuk i kujtohet ta ketë thënë këtë.

753. Avokati mbrojtës A.R. i tha dëshmitares se ajo kishte thënë edhe se, *“B. kishte premtuar se ai do të ma jepte një vend pune në ndërmarrjen e tij, duke thënë se ai do ta hapte një qendër tregtare të ngjashme me Ben-af, unë i besova a tij pasi që nuk e kishte një punë dhe me duhej të gjeja punë dhe mendova se do të kisha të ardhura të mira, pasi që të hyrat e mija nuk ishin të mjaftueshme për familjen. Unë isha në lidhje me B.n deri para një viti, dhe gjatë kësaj lidhje unë kam pasur marrëdhënie seksuale me të, dhe pas çdo marrëdhënie seksuale ai më ka paguar një shumë prej 100 apo 50 Euro”*¹⁵. Ajo deklaroi se asaj nuk i kujtohet ta ketë dhënë këtë. L.P. deklaroi se ajo mund të jetë në gjendje ta njoh B.SH.n nga pamja.

754. Dëshmitarja L.P. e vazhdoi dëshminë e saj ditën e nesërme, më 8 dhjetor 2015.

¹⁴ Në faqen 3, paragrafi 4

¹⁵ Në faqen 2, paragrafi i fundit.

755. Në përgjigje të pyetjeve të parashtruara nga prokurori lidhur me deklaratën e saj të datës 5 prill 2012, ajo deklaroi se nuk i kujtohet të ketë përdorur fjalën “*saktësisht*” dhe ajo deklaroi se ajo nuk e ka përdorur fjalët “*gjendja ime ekonomike*” apo shprehjen “*na është afruar neve*”? Asaj nuk i kujtohet të ketë përdorur shprehjen “*të vini me rastin e festimeve*”. Ajo pohoi se ajo zakonisht thotë, “*Shterpce*” krahasuar me “*Komuna e Shtërpcës*”. Ajo gjithashtu deklaroi se nuk i kujtohet koha kur ajo ishte e zemëruar me B.S.n për shkak të mos mbajtjes së premtimit. Ajo e pranoi se për një kohë ajo kishte shoqëri me atë.
756. L.P. deklaroi se B.S. kurrë nuk e kishte skllavëruar, robëruar apo lidhur me zinxhir. Ajo ka deklaruar se ai nuk e kishte mbyllur atë në një birucë apo dhomë tjetër. Ajo ka deklaruar se ai kurrë nuk e përdorur forcën apo forma të tjera të detyrimit për të shtyrë atë që të bëjë diçka që ajo nuk ka dashur ta bëjë. Ajo ka deklaruar se ai kurrë nuk e ka rrëmbyer atë. Ajo ka deklaruar se ai kurrë nuk e bërë ndonjë mashtrim apo hile ndaj ose ta detyrojë atë në pornografi. Ajo ka deklaruar se nuk ndihet në mënyrë të pakëndshme në prani të tij ose anëtarëve të familjes së tij.
757. L.P. deklaroi sa ajo nuk e ka njohur apo njeh M.S. Ajo shikoi dhe deklaroi se nuk e njeh askënd në këtë gjykatore që ka lidhje me policinë. L.P. deklaroi se nga viti 2012 deri në vitin 2015 ajo ka punuar në një internet kafe dhe me N.H. në një ëmbëltore. Ajo deklaroi se ajo asnjëherë nuk ka punuar në lokalet me muzikë live. L.P. deklaroi se ajo asnjëherë nuk ishte intervistuar nga policia para se ajo tu jepte atyre te tri deklaratat lidhur me këtë rast. Ajo deklaroi se ata kishin ardhur në shtëpinë e saj gjatë ditës por prapë ajo ishte e befasuar. Ajo deklaroi se ata i thanë, “*Jeni e obliguar të vini*” por ata nuk e kishin prangosur. Ajo deklaroi se aty ishin tre zyrtarë policor. Ajo deklaroi se ajo e dinte se ata kishin folur me N.H. por ajo tha, “*Nuk munden të ju tregoj më shumë detaje*”. L.P. deklaroi se te tre zyrtarët policor i thanë asaj që të shkonte me ta por se nuk i kishin treguar përse dhe kjo e bëri atë të ndjehet, “*shumë keq*”.
758. L.P. deklaroi se kur arritën në stacion policor për herë të parë, zyrtarët policor i thanë asaj “*ju duhet patjetër të flisni për B.S. sepse ju jeni shoqja e tij dhe ju komunikoni*

me të dhe ne e dimë sepse i kemi SMS-të”, edhe kjo e kishte bërë të ndjehet, *“shumë keq”*. Ajo deklaroi se ishte ndjerë sikur nuk kishte zgjidhje por të flas me zyrtarët policor dhe ajo nuk kishte kërkuar një avokat. Ajo pohoi se kishte qenë *“shumë e shqetësuar”*.

759. L.P. deklaroi se nuk i kujtohet se sa kohë ka qëndruar atje por ka qenë përafërsisht për një orë. Ajo deklaroi se ajo është pyetur nga të tre oficerët dhe njëri ishte me uniformë dhe dy të tjerët ishin në rroba të zakonshme. Ajo deklaroi se ata nuk kishin folur me zë të ngritur por thanë se, *“ne i dimë sendet”* dhe *“përse po mundohesh me gënjye”*? Ajo e pranoi se ajo nuk e kishte lexuar asnjërën prej deklaratave por veç i ka nënshkruar ato sepse ka dashur të largohet nga aty. Ajo pohoi se kishte shkuar vetë në shtëpi.

760. L.P. kishte ardhur që të jep deklaratën e saj të dytë përmes një thirrjeje. Ajo deklaroi se kur kishte shkuar për herë të parë asaj i ishte thënë se do ta merrte një thirrje por jo përse. Megjithatë, ajo pohoi se e dinte se për çfarë ishte ajo. Ajo pohoi se ishte ndjerë keq dhe e shqetësuar ashtu si herën e parë. Ajo pohoi se ajo e dha deklaratën e saj të dytë në një zyre ku ishin të pranishëm njerëzit e njëjtë. Ajo deklaroi se ajo kishte qëndruar aty përafërsisht aq kohë sa kishte qëndruar herën e parë. Ajo deklaroi sjellja e policisë ishte e njëjtë si herën e parë. Ajo ka deklaruar se njëri prej tyre tha: *“Ju nuk keni zgjidhje, përndryshe do të shkonit në burg”*. Ajo ka deklaruar se ata e kanë thënë këtë edhe herën e parë. Ajo deklaroi se në një rast ajo ishte intervistuar me N.H.n dhe në një rast tjetër ka qenë veç e veç, por asaj nuk i kujtohet kur.

761. L.P. deklaroi se zyrtarët policor i thanë se ajo do të ndiqet penalisht, *“Për shkak se keni biseduar në telefon me B, ju keni qenë në një ndejë”*. Ajo ka deklaruar kjo e ka bërë të ndihej *“shumë keq”*. Ajo ka deklaruar se nuk kishte zgjidhje tjetër, por veç ti thoshte policisë atë çka ata donin të dëgjonin. L.P. deklaroi asaj nuk i kujtohet se a ka qenë në një rast i pranishëm mbrojtësi i vikamave z. Terstena, por ajo ka deklaruar se ai nuk ka qenë aty që nga fillimi. Ajo deklaroi se ajo e ka pasur mundësinë që të biseduar me z. Tërstena para intervistës. Kur ajo foli me atë, asaj nuk i kujtohet se çfarë i tha ai. Asaj nuk i kujtohet se a ka qenë ai i pranishëm aty herën e parë, të dytë ose të tretë.

762. L.P. ka deklaruar se asaj nuk i kujtohet se a ka pasur ndonjë thirrje për intervistën e tretë. Ajo ka deklaruar se policia i kishte thënë asaj se ajo nuk mund të ndryshonte këto deklaratave dhe madje ju as që guxoni t'i ndryshoni ato dhe ju duhet t'i përmbaheni këtyre deklaratave gjatë gjithë kohës deri në fund përndryshe ju do të shkoni në burg. Ajo deklaroi se ishte policia ajo që kishte shkuar më parë atje.
763. Në përgjigje të pyetjeve nga mbrojtësi i palëve të dëmtuara, B. S., dëshmitarja L.P. deklaroi se ajo nuk mundej të ishte e sigurt se a ka marrë telefonata nga Policia pas intervistimit të tretë. Ajo deklaroi se dy zyrtarë policor e kishin dërguar atë nga Ferizaj në Prishtinë, në Gjykatën e Qarkut. Ajo pohoi se ata i thanë asaj, *“ti nuk mund t'i ndryshon gjërat që i ke thënë më parë dhe ato duhet të mbesin ashtu”*.
764. L.P. e përfundoi dëshminë e saj duke thënë se ajo nuk beson se pala e dëmtuar B.S. i ka bërë ndonjë të keqe asaj. Ajo e konfirmoi se ajo i kishte nënshkruar të gjitha deklaratat e saja por se nuk i ka lexuar ato. Ajo gjithashtu e konfirmoi se ajo e ka nënshkruar edhe deklaratën e dhënë në Policinë e EULEX-it më datë 28 tetor 2013. Lidhur me deklaratën e dhënë në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë, ajo e përsëriti të njëjtat në intervistën e saj të parë, të dytë dhe të tretë pasi që policia i kishte thënë se ajo nuk mund t'i ndryshoj.
765. Dëshmitari tjetër ishte **I.T.**. Ai e filloi dëshminë e tij në seancën e 8 dhjetorit 2015. Ai ishte thirrur nga mbrojtja e M.S.
766. Në përgjigje të pyetjeve të parashtruara nga A.R., dëshmitari deklaroi se më 29 maj të vitit 2012 ai kishte marrë pjesë në intervistë në cilësinë e avokatit të viktimës me L.P. dhe Policinë e Kosovës në stacionin policor në Ferizaj. Ai deklaroi se E.A., M.S. dhe N.O. ishin të gjithë të pranishëm. Ai nuk ishte i sigurt por besonte se oficeri E.A. e kishte thirrur atë për të marrë pjesë. Ai deklaroi se ishte në dijeni se ky ishte rast i trafikimit të supozuar me qenie njerëzore (“TQNJ”) dhe ai e këshilloi viktimën e

pretenduar për të drejtat e saja dhe e këshilloi atë që ta thotë të vërtetën në një zyre të ndarë. Ai deklaroi se edhe policia duhet ta njoftoj viktimën për të drejtat e saja.

767. I.T. deklaroi se gjatë intervistimit të L.P.t, ai nuk kishte vërejtur asgjë që do të ishte në kundërshtim me KPP. Ai theksoi se, po ta kishte bërë këtë do të kishte. Ai pohoi se kishte marrë pjesë në intervistim e kësaj dëshmitareje në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë, më 29 qershor 2012 dhe, sikur edhe me deklaratën e saj të dhënë në polici, ai deklaroi se besonte se deklarata e viktimës ishte dhënë vullnetarisht dhe në përputhje me ligjin.

768. I.T. deklaroi mendimin e tij se L.P. ka dhënë tre deklarata – një në Polici, një në Prokurori dhe një në shqyrtimin gjyqësor në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Ai deklaroi se ai nuk ishte në dijeni se ekziston edhe një deklaratë tjetër, kur ajo ka qenë vetëm dëshmitare. Ai pohoi se nuk është në dijeni të asaj që policia ka mund t'i ketë apo mund të mos i ketë thënë asaj para se ai të përfshihej në rast.

769. I.T. deklaroi se nuk kishte folur me L.P. lidhur me atë se si e kishte marrë Policia atë nga shtëpia e saj për ta intervistuar. Ai pohoi se ajo nuk e ka njoftuar atë se policia i kishte thënë asaj sa ajo mund të ndiqej penalisht dhe se ajo duhet të bashkëpunonte. Ai pohoi se ka folur me të për rreth pesëmbëdhjetë minuta para se ajo të intervistohet dhe i ka shpjeguar asaj të drejtat e saja. Ai deklaroi se ajo ka nënshkruar një formular që tregon se ajo i ka kuptuar ato të drejta.

770. I.T. deklaroi se zyrtarët policor e kishin njoftuar lidhur me pretendimet kryesore të rastit para se ai të fliste me L.P. Ai pohoi se E.A. dhe N.O. e kishin njoftuar përderisa hetuesi kryesor, Toger M.S. ishte në një zyre tjetër të ndarë. Atij nuk i kujtohet sa a ka hyrë ndonjëherë ai në dhomën kur po zhvillohej intervista. Ai e identifikoi në gjykatore M.S. I.T. deklaroi se ai kishte një mendim shumë të mirë për M.S. n. Ai deklaroi se Rajoni i Ferizajt ishte rajoni udhëheqës në rastet e THNJ sepse ata kanë punuar ditë e natë. Ai deklaroi se E.A. dhe N.O. e kanë zhvilluar intervistën me B.SH. ka ardhur më vonë. Në përgjithësi, ai deklaroi se nuk ka pasur asgjë të pazakontë për këtë rast.

771. I.T. deklaroi se ai ishte i pranishëm rreth kohës që ishte marrë intervista e viktimës dhe për afro tri orë në total. Ai deklaroi se ai e ka dëgjuar viktimën t'i përdorë fjalët dhe frazat sic janë, “gjendja ekonomike”, “është afruar”, “me rastin e festimeve” por nuk i kujtohet që ajo ka përdorur fjalën “saktësisht”. Ai pohoi se i kujtohet shumë mirë se ky ka qenë rast shumë i veçantë dhe ajo tha se kryetari i komunës së Shtërpcës i ka kërkuar asaj që të vallëzoj me të. Ai pohoi se ai ja ka lexuar asaj deklaratën dhe ajo e ka nënshkruar këtë.
772. I.T. deklaroi se L.P. e ka dhen deklaratën e saj në Prokurori pas përafërsisht një muaj pasi ajo e kishte dhënë deklaratën e saj në Policinë e Ferizajt. Ai deklaroi se deri në atë moment, ajo ishte trajtuar si viktimë e TQNJ. Ai e shprehu B. e tij se pas një ankese të bërë nga avokati mbrojtës, rasti ishte kthyer nga Gjykata e Apelit në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe se shqyrtimi fillestar ishte mbajtur javën e kaluar.
773. I.T. theksoi se e ka ditur që N.H. ka deklaruar se atë e kishin transportuar, mbajtur nën kontroll dhe e kanë lënë në rrugë. Ai theksoi që ajo ka deklaruar për vuajtjet e saj nga ana e të pandehurit dhe se e tërë procedura penale ishte e bazuar në këtë. Ai theksoi se të gjitha viktimat e rastit THB i kanë ndryshuar deklaratat e tyre. Sidoqoftë, ai nuk e ka ditur se çfarë provash kishte mbledhur policia që kanë qar në ardhjen e L.P. në stacionin e policisë para ardhjes së tij.
774. Në përgjigje të pyetjeve nga avokati i viktimës, B. S. avokat i familjes S., I.T. deklaroi që atij në stacionin e policisë iu dha një formular për ta plotësuar.
775. I.T. deklaroi që deklarata e L.P. ishte dy faqe e gjysmë apo tre faqe dhe nuk ishte e pazakontë që një deklaratë e tillë të zgjaste aq shumë.
776. Dëshmitarja tjetër ishte **N.H.** Ajo filloi deklaratën e saj në gjykimin kryesor më 17 dhjetor 2015.

777. Në përgjigje të pyetjeve nga avokati A.R., avokat për të pandehurin M.S. ajo theksoi se më 2011-2012 ajo dhe babai i saj ishin të vetmit persona që punonin dhe mbanin familjen prej shtatë anëtarëve. Ajo tha se ka punuar se kameriere në një ëmbëltore.
778. N.H. u pajtua që deklaratën e parë në stacionin e policisë e kishte dhënë me 29 maj 2012 në stacionin policor në Ferizaj dhe ajo ishte deklaruar si viktimë e trafikimit. Megjithatë, ajo kërkoi që ti lexohet sërish pasi që, *“janë disa fjalë të cilat nuk i kam thënë”*. Ajo tha se nuk e ka njohur M.S. por e ka njohur B.SH.n.
779. Në lidhje me intervistën e saj të parë në Prokurorinë Publike të Qarkut në Prishtinë në rastin PP.nr. 390-1/2012, më 29 qershor 2012 avokati A.R. tha se N.H. kishte thënë¹⁶, *“B. i ka thënë L. që të më thotë mua të kryej marrëdhënie seksuale me atë dhe për këtë ai do të më ndihmojë materialisht dhe unë kam pranuar dhe kam pasur marrëdhënies me atë 5 – 6 herë dhe me L. që ishte me ne dhe kemi pasur marrëdhënie seksuale në grup”*. Ajo tha se kjo nuk është e vërtetë, nuk kanë pasur marrëdhënie seksuale në grup por vetëm janë *“dëfryer”* si shokë. Ajo ka deklaruar se e ka njohur R.B. vetëm si *“Raif”* dhe se ai ishte shok i shoqes së saj L.P. Ajo ka thënë se nuk ka pasur marrëdhënie me të.
780. A.R. tha se dëshmitarja ka thënë¹⁷, *“B. na propozoi të bëjmë marrëdhënie seksuale me shokun e vet, ne pranuan të shkojmë me shokun e tij dhe se ai person ishte nga komuna e Shtërpçës, ai ka qenë i punësuar në vendin ku bëhen tenderët. Ai quhej “R.” dhe B.S. e kishte bërë këtë për interesa të veta personale”* dhe *“B.S. i ka thënë nuk duhet ti tregosh R. asgjë sepse do të të paguaj”*. N.H. tha se nuk i kujtohet që e ka thënë këtë dhe se ajo nuk kishte marrë kurrfarë pagese nga R. apo dikush tjetër. Ngjashëm, asaj nuk i kujtohet të ketë thënë, *“na kanë paguar nga 100€ ndarazi (për të bërë seks me R.B.)”*.

¹⁶ Faqe 2 paragrafi 4

¹⁷ Faqe 2, paragrafi 3.

781. N.H. deklaroi se ka qenë në Sarandë, Shqipëri me B.S. dhe L.P. për katër ditë. Megjithatë, ajo theksoi se B. është zënë më L.P. dhe ai i kishte lënë në Durrës kurse ato më pas kishin marrë një autobus për tu kthyer në Kosovë.
782. Avokati mbrojtës A.R. tha se dëshmitarja gjithashtu ka thënë¹⁸, “*që unë dhe L. pranuan të bëjmë marrëdhënie seksuale me “R.” dhe më pas së bashku me L., dy herë L. ka pasur marrëdhënie seksuale me R. po ashtu. Unë nuk kam pasur asnjë dëshirë që të kem marrëdhënie me R. por B. më propozoi dhe më premtoi të më punësojë dhe gjithashtu me ka premtuar të ma blinte një makinë kur ta marr lejen*”. N.H. tha se nuk ka pasur marrëdhënie me R. por që B.S. i kishte premtuar L.P. ta punësonte në një qendër të madhe tregtare nëse e bën atë.
783. N.H. shpjegoi dallimin ndërmjet deklaratës së parë dhe deklaratës para trupit gjykues se kur e ka dhënë atë deklaratë ka qenë e re dhe se nuk e ka ditur që është dashur të tregonte atë që ka ndodhur saktësisht dhe jo atë që është dashur ta thoshte. Në përgjigje të pyetjeve nga prokurori N.H. tha se ajo ka punuar një muaj në lokalin me muzikë live “*Macedonia*”.
784. N.H. ka deklaruar në deklaratën e saj më 29 qershor 2012 se i kishte takuar B.S. në një “*ëmbëltorë*” (dhe jo në një shitore tekstili). Gjithashtu ka mohuar se ka përdorur fjalët “*respektivisht*” dhe “*Komuna e Shtërpcës*”. Ajo deklaroi se nuk është ankuar te avokati i viktimës së saj në lidhje me ndjesinë e presionit gjatë dhënies së deklaratës kur “*ne*” kemi dhënë deklaratë në Ferizaj ai erdhi vonë. Ajo po ashtu deklaroi se kishte frikë sepse “*neve*” policia na ka thënë se “*duhet të qëndrojmë pranë deklaratave tona*”. Ajo theksoi se kanë prova të tjera kundër B.S. dhe se nuk ka pasur zgjidhje tjetër por të jap deklaratë.
785. Në lidhje me deklaratën e saj të datës 29 maj 2012, ajo theksoi se ajo nuk i ka përdorur fjalët “*gjendje ekonomike*” “*zyra e prokurimit*” ose “*akomoduar*”. N.H. theksoi se kishte shkuar në Sarandë me vetë dëshirë. Ajo tha se kur policia kishte shkuar në shtëpinë e saj B.S.H. e kishte lënë një numër dhe kur ajo e kishte marrë atë numër i kishin

¹⁸ Faqe 3, paragrafi 1.

thënë “*duhet të vish këtu*” dhe “*Pa tjetër duhet të vish këtu*”. Ajo tha se nuk e dinte për çka është puna por se ishte shumë e shqetësuar. Ajo tha se kishte shkuar në stacionin policor me L.P. herën e parë kurse herën e dytë i kishte marrë B. dhe dikush tjetër por nuk ishin në uniforma. Ajo tha se herën e tretë ishin dërguar në prokurori në Prishtinë.

786. Për sa i takon deklaratës së saj të parë, N.H. theksoi se ajo kishte shkuar me L.P. në stacionin e policisë ku ishin takuar me B.SH. dhe i cili i kishte dërguar në një zyre që ndahej me xham nga një zyre tjetër. Asaj nuk i kujtohet ta ketë parë dikë në atë zyrën tjetër. Ajo tha se ishte edhe një polic në zyrën ku ishte ajo. Ajo the se nuk i kujtoheshin emrat N.O. ose E.A. Ajo tha se tha se kishin folur të dy.

787. N.H. theksoi, “*ata të dy na thanë*” se kanë ardhur aty për B.S. dhe thanë “*Ne e dimë se ai ka bërë edhe gjëra tjera, dhe duhet ta japësh një deklaratë, pa tjetër duhet ta japësh një deklaratë, sepse ne i kemi të gjithë SMS-të që i ke shkëmbyer me atë*”. Ajo tha se nuk ia ka treguar ato mesazhe. Ajo tha se ishte ndjerë “*shumë keq*” dhe “*e frikësuar*”. Ajo tha se policia nuk e kishte njoftuar me të drejtat e saj para se të fillonte të fliste. Ajo tha se policët po shtypnin derisa po bisedonin por nuk i kujtohet se kush po shtypte (regjistronte). Ajo tha se herën e parë kanë qenë atje për rreth tri orë. Ajo tha se nuk e kishte lexuar me kujdes deklaratën para se ta nënshkruante. Ajo tha se kishte ndjerë presion për ta nënshkruar. Ajo tha se avokati i viktimës kishte ardhur pasi “*ne*” i kishim dhënë deklaratat.

788. Në lidhje me herën e dytë kur ishte njoftuar për të ardhur në stacionin e policisë atë e kishin marrë në një automjet pa shenja B.SH. dhe një njeri tjetër. Ajo tha se ata nuk ishin paraqitur kush ishin por vetëm kishin ardhur. Megjithatë, ajo tha se ishte ndier keq që të kthehet prapa. Ajo tha se me atë rast vetëm kishin nënshkruar. Ajo tha se ata nuk i kishin lexuar deklaratat e tyre. Ajo tha se kishte ndier presion për ta nënshkruar atë dhe se do të kishte probleme po qe se nuk e nënshkruan.

789. Përkitazi me intervistën e tretë në prokurori, N.H. theksoi se e kishte marrë B.SH. dhe një polic tjetër. Ajo tha se gjatë rrugës ata i kishin thënë. “*duhet të qëndrosh prapa*

deklaratës që ke dhënë më herët”. Ajo tha se ata i kishin thënë se nëse nuk vepron ashtu mund të burgoset. Asaj nuk i kujtohet nëse avokati i viktimës ka qenë i pranishëm kur ajo e ka dhënë deklaratën e parë para prokurorit. Ajo tha se ai quhej I.T. Ajo nuk mund ta shpjegonte se pse nuk e ka kontaktuar atë për ta informuar në lidhje me presionin e mëhershëm të cilës iu referua ajo. Sidoqoftë, ajo tha se nuk ka vërejtur ndonjë afërsi apo ndonjë ndjenjë ndërmjet policisë, prokurorit dhe avokatit të viktimës. Ajo theksoi se nuk kishte paraqitur asnjë lloj kërkesë për kompensim të viktimës. Ajo tha se së voni kishte dëshmuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj përkitazi me këtë rast.

790. Në përgjigje të pyetjeve nga M.S. , dëshmitarja theksoi se prokuroria, me sa i kujtohet asaj, ata vetëm e kanë pyetur, *“Nëse qëndrojnë prapa fjalëve që kamë thënë”*, dhe ajo tha “po”. Ajo tha se policia ia kishte thënë këtë. Ajo theksoi se askush nuk i kishte bërë presion pas një viti kur e kishte dhënë deklaratën e saj para Inspektoratit Policor të Kosovës, mirëpo se kishte qëndruar prapa fjalëve të saja të para pasi që tha se kështu i kishin thënë. Ajo theksoi se policia i kishte thirrur dhe thënë, *“B. është me të vërtetë një njeri i keq”* dhe ishin të frikësuar.

791. N.H. tha se deklarata e saj në polici përmbanin shumë fjalë që *“ne”* nuk i kthemi thënë por që deklarimi se ajo kishte shkuar në Sarandë dhe më vonë në Durrës me L.P.n ishte i vërtetë. Ajo tha se kishte qenë e detyruar ta thoshte këtë dhe se policia veç kishte njohuri për këtë përmes SMS-ve. Ajo tha se polici i kishte thënë se ata e dinin se ajo kishte qenë në një aheng në Shtërpce.

792. I pandehuri M.S. i tha N.H.t që ajo kishte dhënë të njëjtën deklaratë në dy intervista në polici dhe në një intervistë në prokurori kurse tani po e ndryshon atë dhe e pyeti se pse po ndodh kjo? N.H. tha se gjithçka kishte bërë me vetë dëshirë dhe askush nuk e kishte detyruar të bënte ndonjë gjë dhe se askush nuk e kishte paguar por tani nuk i kujtohet dhe ishte e hutuar. Ajo tha se atëbotë kishte qenë më e re dhe kishte folur nga frika kurse policia i kishte thënë se do ta dërgonin në strehimore. Ajo tha se nuk kishte dëgjuar që ndonjë polic ishte hetuar në lidhje me incidentin dhe kështu kjo nuk do kishte ndikuar deklaratën e dhënë në Inspektoratin Policor të Kosovës. Ajo po ashtu tha se ajo kishte dëgjuar *“ata”* kishin përgatitur *“skenarë”* kundër B. Kur u pyet nga Kryetari i

trupit gjykues se ç ‘nënkuptonte me këtë, N.H. theksoi se shoqja e saj L.P. i kishte thënë ata kishin përgatitur skenar kundër B.S. sepse ai kishte një kompani dhe me qëllim që ta bankrotonin “ata” kishin përgatitur një “skenar”. Ajo tha se ishte informuar se ata ishin Policia. N.H. e kishte kompletuar dëshminë e saj duke thënë se nuk e kishte ndier të njëjtin presion kur kishte dëshmuar para gjykatës siç e kishte ndier kur kishte dhënë deklaratë në polici.

793. Në përgjigje të pyetjeve nga avokati i viktimave B. S., N.H. theksoi që ajo asnjëherë nuk ishte ftuar formalisht në stacionin e policisë për të dhënë deklaratë. Ajo përsëriti deklaratën e saj të mëhershme se ka pasur raporte shoqërore me B.S. dhe se ai asnjëherë nuk e kishte mbajtur paligjshëm apo ta kishte detyruar të bënte diçka. Ajo e konfirmoi se ka dhënë deklaratë në rastin kundër B.S. dhe e ka konfirmuar përmbajtjen e deklaratave të mëhershme.

794. Dëshmitarja tjetër ishte **SH.L.** Ajo filloi deklaratën e saj në seancën e 17 dhjetor 2015.

795. Ajo theksoi se ka qenë valltare dhe kishte punuar në “*Montana*” dhe tani në “*International*” në mes tjerash. Ajo theksoi se IIZ.n e kishte shoqe. Ajo e dinte se ajo kishte qenë në marrëdhënie me një person me emrin D. apo D. emri i të cilit ishte R. Ajo tha se e ka ditur që M.S. ka qenë polic në Ferizaj por asnjëherë nuk ka pasur të bënte asgjë me të. Ajo tha se e kishte parë atë në “*Montana*” dhe “*International*” herë pas here por kurrë në shoqëri me D. Megjithatë, ajo pajtohet se mund të kenë qenë shokë.

796. Dëshmitarja tjetër ishte **IIZ.** Ajo filloi dëshminë e saj me datë 17 dhjetor 2015. I. theksoi që ajo ishte këngëtare dhe valltare e cila kishte kënduar dhe vallëzuar nëpër lokale me muzikë të gjallë në Zvicër dhe Kosovë, përfshirë këtu edhe në “*Montana*” dhe “*International*”.

797. I. theksoi që e kishte njohur SH.L. si “*shoqe të mirë*”. Ajo tha se R.A. e kishte të dashur. Ajo tha se ai kurrë nuk kishte punuar si roje sigurie në restorant “*Montana*”. Asaj

nuk i kujtohet ta ketë thënë të kundërtën në deklaratën e saj të datës 31 mars 2014. Ajo u pajtua që deklarata e saj ishte e saktë dhe R.A. i kishte thënë të mos thoshte asgjë në polici në lidhje me një incident të armatosur.

798. I. tha se nuk e kishte njohur M.S. personalisht por përmes D. Ajo e dinte se ai ishte polic. Ajo u pajtua se në deklaratën e saj të datës 31 mars 2014 kishte thënë se Kreshin Sefedini e kishte thirrur R.A.n pas të shtënave në “Montana” sepse ai kishte shokë brenda policisë në Ferizaj. Sidoqoftë, ajo tha se R.A. nuk e kishte thirrur M.S. n.

799. Në përgjigje të pyetjeve nga avokati mbrojtës A.R. për të pandehurin M. S, dëshmitarja tha se ajo ka punuar në “Montana” një vit dhe se gjatë asaj kohe ajo e kishte parë M.S. vetëm dy apo tri herë.

800. Dëshmitari tjetër ishte **R.K.**. Ai ishte ftuar nga prokuroria. Ai ka dëshmuar para trupit gjykues me datë 15 shkurt 2016.

801. R.K. tha se ai ishte polic për 26 vite. Ai tha se kishte punuar si hetues për rreth 14 vite para se të kalonte në policinë e trafikut në vitin 2014. Ai theksoi se që nga konflikti i armatosur në Kosovë kishte punuar në Ferizaj.

802. Ai tha se e kishte njohur R.A. i cili kishte punuar në sigurim në kafene të ndryshme e po ashtu e kishte njohur edhe M.S. për shumë vite. Ai kishte deklaruar se nuk e dinte nëse M.S. e R.A. e kanë njohur njëri tjetrin edhe pse ka thënë se i ka parë të dy duke pirë kafe një ose dy herë.

803. Dëshmitari i radhës ishte **B.D.**. Ai ishte ftuar nga prokuroria. Ai ka dëshmuar para trupit gjykues në seancën e datës 17 mars 2016.

804. B.D. ka thënë se ka qenë pronar i kompanisë me emrin “*Burimi*” që nga viti 1998. Ai ka thënë se kompania ka operuar në fushën e ndërtimit të rrugëve kurse kompania ishte e tij dhe pesë vëllezërve. Saktësisht, ata ishin nën-kontraktorë të cilët kanë prodhuar

dhe shitur beton për kompanitë tjera të ndërtimit. Kompania kishte kontrata publike dhe private. Ai tha se biznesi i tij ishte fitim prurës dhe kishte punuar me kompaninë Luboteni që nga viti 2008.

805. B.D. theksoi se kishte dëgjuar për arrestimin e B.S. në vitin 2012, një ose dy ditë pas ngjarjes. Ai tha se puna që kishin së bashku me të ra menjëherë pas kësaj.

806. B.D. kishte thënë se fillimisht nuk e ka ditur se kush ka qenë i përfshirë në arrestimin e B.S. por pas një kohe ai kishte dëgjuar se kishte qenë M.S. dhe B.SH.. Ai tha se M.S. n nuk e kishte njohur fare kurse B.SH.n e kishte njohur pasi që kishte punuar në pompën e benzinës “Balkan Petrol”. B.D. tha se M.D. është vëllai i tij. Ai tha se e njihte vëllain e B. dhe XH.B.n sepse kishin punuar bashkërisht.

807. B.D. tha se një apo dy ditë pas arrestimit të B.S. ai ishte takuar me XH.B dhe njërin nga vëllezërit e B. Ai tha se M.D. dhe A.D. po ashtu ishin aty. Ata kishin biseduar për rastin e B. por nuk e dinin se çfarë kishte ndodhur me të. Ai tha se e njihte L. ose A.K. nga Kaçanikun por se nuk kanë pasur asnjë kontakt me atë ose në lidhje me B.S.

808. B.D. ka thënë se para arrestimit të B.S. në janar 2012 ata kanë shkuar në Gjermani. Ai tha se në Gjermani, B. kishte blerë dy kamionë si dhe një rezervuar për beton. Gjithashtu tha se kishte blerë një automjet të vogël kurse B. kishte blerë një xhip. Ai tha se të dy automjetet ishin Mercedes Benz. Makina e vogël kishte qenë një model C klas kurse xhipi një ML. Ai tha se C - klasën e kishte mbajtur 1 vit para se t`ia jepte nipit të tij H.D. kurse më vonë e kishte ndërruar me M.S. për një Audi A4. Para këtij ndërrimi, ai tha se M. e kishte njohur vetëm si klient potencial për beton. Ai tha se kur ishin takuar në lidhje me këtë para një jave, M.S. i kishte kërkuar t`i ndërronin makinat. Ai tha se edhe B.SH. kishte qenë i involvuar. Me M.S. ishin marrë vesh që Audi kishte vlerë 12,000 euro kurse Mercedesi rreth 17,000 Euro kështu që M. është dashur t`ia jepte edhe 5,000 Euro kesh.

809. B.D. u pajtua me deklaratën e tij të mëhershme që disa ditë pas arrestimit të B.S. ai ishte kontaktuar nga një person me emrin B.SH.. Ata ishin pajtuar të takoheshin në restorant “*Veranda*”. Ai theksoi se i kishte takuar atje dhe kishte kuptuar se ata ishin personat që e kishin arrestuar B.S.n dhe kishte pak frikë. Ai tha se ata i kishin thënë se kishin nevojë për beton dhe pas kësaj kishte ndodhur edhe shkëmbimi i makinave.
810. B.D. tha se kishte frikë nga ajo që kishte ndodhur me B.S.n. Ai frikësohej se e njëjta mund ti ndodhte edhe atij. Tha se kishte menduar se nuk kishte zgjidhje tjetër përpos të takohej me ata. Ai po ashtu u pajtua me deklaratën e mëhershme se kishte ndier presion që ti furnizonte me beton M.S. dhe vëllain e tij A.
811. B.D. theksoi se nuk kishte biseduar për shkëmbimin e Mercedesit deri në momentin kur ishte takuar me M.S. dhe B.SH. herën e dytë në lokalin që quhet “*Lamborghini*”. Ai u pajtua me deklaratën e tij se M.S. kishte insistuar në shkëmbim edhe në takimin e parë. Ai tha se kurrë nuk e kishte marrë diferencën prej 5,000 Euro në kesh. Tha se e kishte ndier obligimin ta bënte transferin edhe pse nuk kishte dashur vetë. Ai u pajtua se kishte pasur frikë. Ai tha se M.S. poashtu ia kishte borgj 6,000 Euro për betonin me të cilin e kishte furnizuar. Ai tha se do ta padiste nëse nuk e paguan.
812. B.D. theksoi që nuk kishte biseduar për rastin e B.S. me M.S. Sidoqoftë, ai u pajtua me deklaratën e dhënë në vitin 2014 se kishte vepruar asi soji duke thënë se B.S. ka qenë në krizë fizike dhe financiare por M.S. tha se nuk i kishte besuar.
813. Në këtë pikë, dëshmitari B.D. ka thënë se gjatë një pushimi kur ishte në tualet me B.S. kur A.S., vëllai i M.S. n i kishte thënë “*të mos na dëmtojë neve*” dhe se ai do ti kthejë borgjet. Ai tha se nuk e kishte takuar më parë.
814. Në përgjigje të pyetjeve nga avokati i të pandehurit M.S. , avokati A.R., dëshmitari B.D. theksoi që M.S. nuk e kishte kërcënuar apo frikësuar drejtpërdrejt atë me fjalë apo gjeste përpos kur ishin takuar për herë të parë. Në përgjigje të nga i pandehuri M.S. , drejtuar B.D., ky i fundit tha që edhe pse Mercedesi ishte i nipit të tij, transferimi te M.S. u bë me pajtimin e tij. Ai u pajtua që kur ishte njoftuar me M.S. n, ai nuk kishte

frikë nga ai por vetëm kishte shqetësim që të paguhej. Sidoqoftë, ai u pajtua me prokurorin që Mercedesi kishte vlerë 20,000 Euro dhe se kishte pasur presion për tu ndarë me të.

815. I pandehuri **M.S.** zgjodhi që të deklarohej në mbrojtjen e tij. Ai e filloi këtë në seancën e datës 18 mars 2016.

816. Në përgjigje të pyetjeve nga avokati i tij mbrojtës A.R., i pandehuri M.S. tha se asnjë nga rrethanat e tij personale nuk kishin ndryshuar dhe se i kishte kuptuar akuzat ndaj tij.

817. M.S. theksoi se ishte bërë polic në vitin 2000. Ai theksoi se në vitin 2004 ai ishte graduar me shkallën e rreshterit kurse në vitin 2005 në gradën e togerit. Ai tha se pak më pas ishte caktuar si Shef i Hetimeve Speciale në tri rajonet e Ferizajt dhe ishte në krye të Njësisë për Persona të Zhdukur, Njësisë Anti-Narkotik dhe Njësisë Anti-Trafikim të qenieve njerëzore (ATQNj). Ai theksoi se pas ndryshimeve të strukturës organizative që ka ndodhur në vitin 2010, ai ishte fokusuar në Njësinë (“ATQNj)

818. M.S. fillimisht tha se Njësia ATQNj që nga viti 2010 ishte e centralizuar brenda kurse Shtabi kryesor ishte në Prishtinë. Ishte një drejtorat. Në këtë njësi ishin pesë zyrtarë. Ai tha se kjo njësi mbikëqyrej shumë më tepër nga ndërkombëtarët se sa njësitë tjera dhe se ka pasur trajnime të rregullta. Ai tha se kjo njësi ka pasur nivele të mira të bashkëpunimit me prokurorë dhe agjenci tjera.

819. M.S. theksoi se në këtë njësi përpos tij ishin edhe policët E.A., N.O., V. H., B.SH. dhe toger B.G. Ai theksoi që në lidhje me rastin e B.S., informacioni i parë kishte ardhur nga drejtoria, konkretisht Shtabi Qendror në Prishtinë. Ai tha se e kishte caktuar E.A. për ta hetuar këtë sepse ai kishte jetuar në të njëjtin rajon me B.S. Ai tha se ishte hartuar një plan hetimor në bashkëpunim me prokurorin.

820. M.S. fillimisht tha se rasti i B.S. ishte raportuar si rasti i trafikimit me femra nga Shqipëria që ishin martuar në territorin e Shtërpcës. Ai tha se hetuesit kishin punuar në

bashkëpunim me qendrat sociale në komunën e Shtërpçës por se viktimat e pretenduara nuk donin të bashkëpunonin e nuk donte as qendra për mirëqenie sociale. Ai tha se telekomunikimi i B.S. ishte përgjuar. Ai tha se u pa qartë se ishin edhe dy viktimat të tjera të cilat njësia nuk i dinte. Ai tha se viktimat e pretenduara ishin intervistuar nga hetuesit E.A., N.O., V. H. dhe B.SH.. Ai tha se R.B. kishte dhënë deklaratën në mënyrë vullnetare.

821. M.S. ka thënë në rastin e B.S., prokurori publik ishte i informuar kurse B. ishte sjellë në stacionin e policisë, deklarata e tij ishte marrë kurse prokurori ishte i azhurnuar dhe në bazë të urdhërit të tij ai ishte mbajtur 48 orë. Ai tha se rasti i tij ishte kompletuar, ishte dërguar në gjykatë dhe asnjë veprim tjetër hetimor nuk ishte ndërmarrë më pas nga policia.

822. M.S. theksoi se ai e kishte njohur B.SH. nga Policia e Kosovës por se para kësaj nuk e kishte njohur. M. tha se e njohte B.H.. E dinte se ai ishte pronar i pompës “*Balkan Petrol*” dhe se kishte lidhje me B.SH. por asgjë më shumë.

823. M.S. theksoi se ai e ka njohur Z. B.S. pasi që njësia e tij e kishte arrestuar dhe e njëjta vlen edhe për XH.B. Ai tha se e kishte takuar atë për herë të parë në pompën e benzinës “*Balkan Petrol*”. Ai theksoi që B.SH. ishte në automjetin zyrtar, ishin në Bibaj duke udhëtuar në drejtim të Gjilanit kur B.SH. kishte pranuar një thirrje telefonike. Ai foli me dikë dhe më pas tha nëse mund të shkojmë në “*Balkan Petrol*” sepse “*B.i*” me të cilin kishte lidhje farefisnore donte të bisedonte diçka.

824. Ai tha se ishin ulur në tavolinë jashtë restorantit kurse erdhën edhe B.H. dhe XH.B.. Ai nuk e ka ditur se kush është XH.B. por se ai u paraqit dhe e kuptoi se ishte i afërm i B.SH. Ai tha se kanë pasur një bisedë të shkurtër ku XH.B. donte ta dinte se pse ishte arrestuar B.S. Ai tha se asnjë informacion nuk i ka dhënë atij dhe se menjëherë i kishte thënë B.SH. se duheshin larguar. Ai tha se nëse me të vërtetë donte ta dinte se pse ishte arrestuar B., ai duhet të vinte në stacion. Ai tha se ai erdhi pas një ose dy ditësh në stacion së bashku me vëllain e B. A. me ç`rast shkuan në zyrën e B.SH. Ai tha se B.SH. i kishte sjellë në zyrën e tij dhe ua kishte shpjeguar se pse ishte arrestuar B. dhe kishte

zbuluar se familjet e tyre ishin të lidhura po më pas i kishte informuar XH.n dhe A. se nuk mund të bënte asgjë për t`ju ndihmuar.

825. M.S. tha se ditët në vazhdim ai kishte shkuar me B.SH. në restorant “*Bifurkacioni*” por personalisht ai nuk e ka ditur se XH.B. dhe A.S. do ishin aty. Ai tha se e kishin arrestuar B.S. dhe se nuk donte të bisedonte me të. Ai tha se të dy ata ishin larguar por se XH. u kthye. Ai tha se e kishte informuar se nuk kishte intervenime dhe se kjo ishte çështje e policisë.

826. M.S. theksoi se i kujtohet edhe një takim pasues. Ai tha se nuk i kujtohet data por se ai zyrtarisht ishte në një seminar në një restorant organizuar nga qendra për mirëqenie sociale dhe organizata zvicerane “*Terre des homes*” kur u paraqit B.SH. së bashku me XH.B. dhe A.S. Ai tha se i kishte parë nga një distancë dhe ishte çuar, kishte shkuar te ata dhe u kishte bërtitur duke ju thënë se pse keni ardhur këtu? Ai tha se B.SH. tha se ata donin të shpjegonin diçka por ky nuk i kishte lejuar dhe u kishte thënë të largoheshin.

827. M.S. tha se me B.SH. nuk ishin shokë por vetëm kishin kontakte profesionale. Vetëm një ose dy herë kishte qenë në shtëpinë e tij. Atij ju kujtua të ketë qenë atje kur ai i kishte bërë djemtë synet. Ai theksoi se kishte shkuar atje por nuk kishte hyrë brenda shtëpisë por kishin ndenjtur në oborr ku po ashtu e kishte parë edhe XH.B. Ai tha se nuk ishte ndier mirë dhe nuk kishte folur me atë. Më vonë ai e kishte pyetur B.SH. se pse XH. ishte aty dhe pse e kishte ftuar atë (M.) duke e ditur se do të ishte atje por ai tha se kishte ardhur për urime.

828. M.S. po ashtu theksoi se një ditë tjetër B.SH. i propozoi atij të shkonin në restorant “*Euromiti*” në periferi të Ferizajt për të pirë kafe. Ai theksoi se pas pesë minutash XH.B. u paraqit aty duke qeshur, i përshëndeti dhe përqafoi B.SH. Ai tha se nuk kishte kundërshtuar kur ai iu bashkua atyre. Ai tha se biseda u drejtua nga B.S. me ç`rast XH.B. tha se R.B. e kishte futur në grackë B. Ai tha se e kishte këshilluar të mos brengosej pasi që e vërteta do të del në shesh nga gjykata dhe prokuroria. Ai tha se XH.B. e kishte informuar se ai donte të blinte parfum. Ai tha se kjo ishte e çuditshme dhe u ngrit, e goditi tavolinën me grusht dhe i tha atij, “*a do ta blesh apo të më korruptosh*”

mua?”. Ai tha se B.SH. u ngrit dhe e përkrahi atë dhe i tha XH. “*dajë, nuk duhet të veprosh kështu*”. Ai tha se menjëherë ishin larguar.

829. M.S. tha se nuk i ka njohur dëshmitaret L.P. dhe N.H. e aq më pak ti ketë kontaktuar ato apo t’ju thotë ti ndërronin deklaratat e tyre. Ai tha se i kishte parë në gjykatë kur ishte udhëzuar ti sillte aty.

830. M.S. theksoi se B.SH. ndihej në pamundësi ti thoshte XH.B. që ta linte të qetë pasi që kishin afërsi familjare. Ai tha se kurrë nuk e kishte parë të merrte dhurata apo as të bisedonte për këtë nga XH.B. Ai tha se i kishte zbuluar këto akuza pas arrestimit të tij në dosjen e lëndës. Ai tha se B.SH. ishte një person i cili “*luajti një rol për keqardhje dhe të dhimbshme*” por në praninë e tij ai ka qenë një person shumë i mirë dhe po ashtu ishte i mirë në prani të XH.B. Ai tha se askush nga familja S. nuk i kishte dhënë para apo dhurata për ta ndihmuar B.S. e as që ka pasur biseda të tilla.

831. M.S. thotë se tani beson që B.SH. e kishte keqpërdorur atë por atëherë nuk e ka ditur. Ai tha bindjen e tij se ai kishte keqpërdorur policinë si edhe gjykatën. Ai tha se B.SH. nuk ia kishte rregulluar makinën e as që i kishte dhënë para për këtë.

832. M.S. tha se e kishte vizituar shtëpinë e S. nga mesi i dhjetorit 2012 dhe kjo me urdhër të B.SH.t. Ai theksoi se kishin shkuar me makinën e XH.B. Ai tha se i kishin pritur shumë mirë, ai kishte ndenjur me B., kishin pirë kurse B. kryesisht kishte ndenjur me babain e B. dhe familjarët tjerë të cilit i kishte njoftuar njëri pas tjetrit. Ai tha se ata ishin të lumtur që e kishin takuar dhe nuk e lejonin të largohej. Tha se në mesnatë ishin ngritur për tu larguar por B. kishte insistuar të shkonin në “*Europa*” për kafe.

833. M.S. theksoi B. e tij se atë e kishin ftuar në familjen S. për kafe sepse B.S. e ka ditur se arrestimi i tij i dytë ishte i pashmangshëm dhe donte ti bënte një favor atij paraprakisht. Ai tha se pas dy javësh erdhi informacioni nga Prishtina dhe ai i kishte ndihmuar njësisë dhe vetë B.t të dorëzohej në polici. Ai shprehu B.n e tij që pasi që B. u

largua me hetuesit e Prishtinës në drejtim të Prishtinës, ai e kishte kuptuar që M.S. e kishte tradhtuar.

834. M.S. theksoi që arrestimi i dyte i B.S. ka ndodhur në fillim të vitit 2013 dhe kishte të bënte me një rast tjetër të trafikimit me qenie njerëzore që ishte hetuar nga njësia qendrore në Prishtinë, në bashkëpunim me njësinë rajonale të Gjilanit. Viktimë kishte qenë një femër nga Serbia, apo një serbe nga Kosova, nuk ishte i sigurt. Ai tha se natën e arrestimit, para orës 20,00 XH.B., K.S. dhe B.SH. kishin ardhur në një kafene kur ai ishte në afërsi të stacionit policor. B. u largua. XH. i tha B. se nuk i besonte policisë së Prishtinës dhe do ti dorëzohej vetëm M.S.

835. Ai tha se e bëri këtë në stacionin policor atë natë dhe i pyeti hetuesit nga Prishtina se pse po arrestohej. Ai tha se ishte informuar dhe ishte dërguar në Prishtinë kurse në ndërkohë M.S. tha se kishte kontaktuar avokatin e tij. M.S. shprehi B. e tij se ata e kishin keqpërdorur B.SH. dhe familja e B.S. Ai tha se ata menduan se ky i kishte tradhtuar ata e që ishte përzier me faktin se ai i afërm më vëllain e gruas së B.S..

836. Përkritazi me pikat e mbetura të aktakuzës në seancën e gjykimit të datës 21 mars 2016, M.S. theksoi se nuk ka kryer shmangie të tarifave doganore (Akuza 4) e as që i ka dhënë ndihmë kryesit pas kryerjes së veprës penale (Akuza 5). Ai e ka pranuar se ka biseduar në telefon me V.T. i cili ia ka kaluar në telefon një polic por polici menjëherë i ka thënë se ia kishte plotësuar tiketën por kishte vendosur t'ia lëshonte një dënim më lehtë. Ai tha se sipas ligjit nuk është e domosdoshme që taksapaguesi ti paguajë obligimet doganore menjëherë dhe se nuk ka mundur të ndikonte te ndonjë polic pasi që ai kishte vendosur tashmë edhe para se të bisedonte me të.

837. Në lidhje me Akuzat 6 dhe 7, M.S. theksoi se R.A. nuk e kishte shok por axhën e tij E.A. Në lidhje me mos raportimin e një vepre penale ai është pajtuar se ai kishte marrë një thirrje telefonike të cilës i ishte përgjigjur dhe se kishte shkuar te vendi ku pretendohet se ishte kryer vepra por nuk kishte parë asgjë përpos R.A. i cili ishte i ulur në tokë dhe po qante. Ai tha se nuk ka pasur automjete atje, nuk kishte dëshmitarë apo persona tjerë të cilët do të mund ti tregonin se çka kishte ndodhur. Ai tha se personi i cili e kishte thirrur gjendej atje por kishte thënë se e vetmja arsye pse kishte deklaruar se

kishte pasur të shtëna ishte ta sillte atë te vendi. Ai tha se pronari i automjetit dhe personat tjerë të pranishëm nuk kishin thënë se R.A. kishte përdorur armë. Ai tha se e kishin fshehur të vërtetën nga i duke thënë se xhami i automjetit ishte i thyer me një shishe xhami dhe një gur. Ai tha se kishte bërë përpjekje të merrte më shumë informacion por çdo herë merrte të njëjtën përgjigje, që nuk ka pasur revole. Ai tha se e kishte këshilluar pronarin e automjetit që ta raportonte në polici përkundër asaj që xhami ishte thyer me anë të një shisheje por pronari theksoi se nuk donte ta bënte këtë punë të madhe. Ai tha se në këto rrethana nuk ia vlen të kontaktohet patrulla e Policisë së Kosovës. Ai theksoi që R.A. e dërgoi në një kafene për ta kthjellur dhe më pas në banesën e tij.

838. Përkitazi me veprat në Pikën 8 në Aktakuzë, dmth, mbajtja në posedim dhe kontroll i paautorizuar i armëve, ai ka pranuar se arma ishte gjetur në shtëpinë e tij së bashku me një numër plumbash, dmth 40 plumba dhe 50 plumba gazi. Sidoqoftë, ai fillimisht tha se ato nuk ishin plumba gazi, ata ishin plumba piroteknikë që vetëm kanë prodhuar zhurmë dhe nuk kishin asnjë gaz. Ai u pajtua që numri ishte përtej sasisë që i lejohet të posedojë me rregulla dhe procedura të policisë (vetëm 30 plumba) por bilanci kishte mbetur nga të shtënat në një poligon qitjeje ku ai ishte trajnuar dhe qitur me armë një ndërkombëtarë.

839. Në përgjigje të pyetjeve nga prokurori, M.S. u pajtua se kishte dhënë deklaratë në tetor dhe dhjetor 2013 dhe të njëjtat ishin të sakta dhe të vërteta.

840. M.S. theksoi para suspendimit të tij se ai e kishte gradën e togerit që nga viti 2005 dhe se kishte ndjekur disa kurse trajnimi për lidshp se si të bëhet menagjer dhe mbikëqyrës. Ai refuzoi të përgjigjet në pyetje tjera lidhur me familjen e tij, raportet me V.T.n dhe çfarë kishte mësuar në akademinë policore.

841. M.S. theksoi se në kohën e arrestimit të tij dhe suspendimit ai kishte mbikëqyrë disa zyrtarë. Ai theksoi se kryesisht kishin punuar në mënyrë autonome por herë pas here ai iu kishte dhënë urdhra dhe udhëzime të cilat ata i kishin respektuar dhe quar në vend. Ai tha se kurrë nuk e kishte disiplinuar ndonjërin nga vartësit e tij në 13 vite shërbim.

842. M.S. tha se nuk i kujtohet nëse B.SH. ndonjëherë kishte shkelur ndonjërin nga urdhrat e tij. Ai tha se kishte mbikëqyrur në baza ditore policët nga njësia e tij (B.SH., E.A., N.O. dhe V. H.). Ai gjithashtu tha kishte pasur mbikëqyrje nga ndërkombëtarët por kjo ka pushuar në vitin 2012 dhe se që atëherë nuk ka pasur kontakte në lidhje me rastin e B.t.
843. M.S. u pajtua që ka pasur disa kontakte me/nga dhe/ose nga XH.B. dhe/ose familja S.gjatë periudhës kohore të rastit të B.t por nuk i kujtoheshin datat. Ai theksoi se ishte takuar me A.S.n dhe XH.B.n vetëm një ose dy herë kurse familjen S. me rastin kur e kishte vizituar këtë familje. Ai tha se nuk kishte bërë shënime mbi këto takime e as që i kishte raportuar tek eprorët e tij.
844. M.S. theksoi që B.SH. po përpiquej ta rregullte takimin e tij me A.S. dhe XH.B. por u kishte rezistuar shumë kontakteve të tilla sepse kishte ndier se ishte gabim pasi që A.dhe XH. donin informacion dhe se ai ishte hetues dhe nuk donte ta ndante një informacion të tillë.
845. M.S. tha se në njësinë e tij dhe në përgjithësi në policinë e Kosovës, nuk ka polic i cili ka vepra penale dhe nëse ata kanë kryer ata janë larguar. Ai tha se personalisht i ka vlerësuar zyrtarët policor në njësinë e tij por një gjë e tillë ishte kërkuar nga drejtori. Në fakt, ai thotë se të gjitha veprimet që kryhen nga njësia aprovohen nga ana e drejtorit dhe/ose prokurorit.
846. M.S. ka thënë se ai kurrë nuk ka pasur rastin t`u jap vartësve nga njësia e tij vlerësim negativ. M.S. tha se ai dhe njësia e tij rregullisht kanë kontakte me qendrat e mirëqenies dhe avokatët për të drejtat e viktimave. Ai tha se kurrë nuk ka qenë i përfshirë në shpërblim. Njësia e tij nuk ka mundur të ndërhynte se si ata i kryenin punët e tyre dhe kanë pasur të drejtë të ishin të pranishëm kur policia i merrte në pyetje viktimat e pretenduara. Ai theksoi se nuk ka qenë i pranishëm kur viktimat e pretenduara në rastin e B.S. ishin intervistuar.

847. Prokurori ka vazhduar me pyetjet kryqëzore për të pandehurin M.S. në seancën e datës 24 mars 2016.
848. M.S. ka thënë para pezullimit të tij nga detyra se ka qenë plotësisht në dijeni të hetimit të parë në lidhje me B.S. por ka pasur fare pak njohuri për të dytin ku ai vetëm ka asistuar. Ai ka thënë se vetë B.S. dhe shoku i tij R.B. ishin të dyshuar në hetimin e parë. Ai tha se nuk i njihte ata më parë. Roli i tij ishte të mbikëqyrte hetimin dhe nuk e kishte intervistuar e as arrestuar B.S. ose R.B.
849. M.S. tha se i kishte lexuar deklaratat e viktimave në rastin e B. dhe në konsultim me prokurorin publik, njësia kishte vërejtur se kishte elemente të veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore. Ai tha se në këtë rast baza faktike për akuzat ishin deklaratat e viktimave. Në veçanti, ai theksoi se në përmbajtjen e deklaratave të tyre kishte shpjegime se si B.S. pretendohet se i kishte shfrytëzuar, u kishte premtuar dhe i kishte mbajtur nën kontroll. Ai tha se i kishte shfrytëzuar seksualisht duke i paguar rregullisht në këmbim të shërbimeve seksuale. Ai tha se kishte kryer vepra të Prostitucionit dhe Trafikimit të Qenieve Njerëzore. M.S. tha se viktimat në deklaratat e tyre kishin thënë se B.S. i kishte shfrytëzuar seksualisht ato dhe për më tepër, ua kishte ofruar personave të tjerë si dhe u kishte premtuar punësim. Ai tha se kjo përbënte trafikim sepse ato është dashur të bënin atë që B.S. u kishte thënë me shpresë për një jetë më të mirë. Ai tha se nuk është e domosdoshme të ketë dhunë apo kanosje me dhunë për të pasur vepra të trafikimit, dhënia e premtimeve të rreme mjaftonte.
850. M.S. theksoi që togër B.G. ishte udhëheqës i hetimit në rastin e B.S. por fillimisht hetues kryesor ishte E.A.. Ai tha se informacioni fillestar që kishte ardhur nga drejtoria ishte për një person me emrin B, në rajonin e Shtërpcës dhe i cili sillte femra nga Shqipëria dhe i martonte ato me persona nga komuna e Shtërpcës dhe i shiste për para.
851. M.S. ka thënë se një plan hetimor ishte përgatitur dhe ai ishte informuar gojarisht nga hetuesit kohë pas kohe në lidhje me punën e tyre. Ai tha se ishin identifikuar disa

femra nga Shqipëria por që nuk kishin bashkëpunuar e as nuk kishte bashkëpunuar Qendra për Mirëqenie Sociale në komunën e Shterpës. Ai tha se informacion më të thuktë në lidhje me rastin e B.S. kishte siguruar pas arrestimit të tij herën e parë. Ai nuk kishte qenë i përfshirë në asnjë masë të fshehtë ndaj tij. Bazat kryesore për arrestimin e tij kishin qenë deklaratat e N.H.t, L.P. dhe R.B.

852. Prokurori vazhdoi pyetje kryqëzore për të pandehurin M.S. në seancën gjyqësore të datës 22 prill 2016.

853. M.S. tha se para arrestimit të B.S. ai i kishte parë deklaratat e viktimave të pretenduara dhe të dëshmitarit R.B. së bashku me SMS-të nga telefoni i B. Ai tha se ishte e qartë që B. ishte i përzier me viktimat e trafikimit me qenie njerëzore dhe po aranzhonte pagesa. Ai tha se ai ishte arrestuar dhe mbajtur në konsultim dhe koordinim me prokurorin. Policia e Ferizajt kishte marrë B.S. dhe dosjen e lëndës në prokurori në Prishtinë dhe nga ai moment policia asnjëherë nuk ndërmoi ndonjë aksion në dëm të B.t apo rastit. Ai theksoi që me sa dinte ai, ky kishte qenë fundi i përfshirjes së tij në rast. Ai tha se hetuesit e dërguan dosjen e lëndës dhe ai e kishte parë atë por nuk e kishte lexuar. Tha se në shumë raste shumë dokumente kalojnë nëpër tavolinën e tij por jo secili dokument i secilit rast. Ai tha se kallëzimi penal ishte i nënshkruar nga ai apo dikush tjetër në emrin e tij nëse ai nuk kishte qenë në detyrë.

854. M.S. tha se kur i kishte lexuar deklaratat e palëve të dëmtuara të pretenduara ai nuk kishte qenë i interesuar në veprimet e pretenduara të B.S. dhe jo në atë personalisht. Ai u pajtua se e dinte që pala e dëmtuar N.H. ka thënë se ka qenë në marrëdhënie me B.S. për tre apo katër muaj.

855. Prokurori ka vazhduar pyetjet kryqëzore për të pandehurin M.S. në seancën e gjyqimit kryesor më 25 prill 2016.

856. M.S. theksoi se raporti fillestar hetimor në rastin kundër B.S. theksonte që akuzat kanë ardhur nga një burim i besueshëm “A B”. Ai nuk e dinte se kush ishte ky dhe nuk kishte qenë i interesuar nëse burimi i ka njohur B.S. apo jo.
857. M.S. u pajtua që raportet e rastit në rastin e B. filluan të paraqiteshin nga fundi i vitit 2011 dhe kishin vazhduar deri në arrestimin e tij në maj 2012. Sidoqoftë, ai nuk ishte në gjendje të tregonte se sa raporte i kishte pranuar. Ai tha se nuk e kishte dëgjuar e as parë intervistën e parë me N.H. dhe L.P. Ai tha se shkurtimisht i kishte parë në stacionin e policisë në kohën kur i kishin dhënë intervistat e dyta. Ai tha se nuk i kishte njohur edhe kur ishin paraqitur në gjykatë. Megjithatë, ai tha se në kohën hetuesit e kishin informuar në lidhje me veprimet e tyre. Ai e dinte se SMS-të e tyre po përgjoheshin dhe i kishte lexuar.
858. M.S. ka thënë se njësia e tij i kishte trajtuar N.H. dhe L.P. si persona të besueshëm dhe nuk i kishin marrë parasysh nivelin e tyre të shkollimit apo historitë e tyre të involvimit me sistemin penal të drejtësisë.
859. M.S. pajtohet që E.A. fillimisht ishte hetues dhe kishte punuar në rast për afërsisht nga fundi i vitit 2011 deri në maj 2012. Ai tha se nuk ishte në dijeni që E.A. e kishte një të afërm në biznes rival me B.S. Ai tha se zëvendësi i tij ishte rreshter B.G. kurse B.SH. nuk e kishte gradën e rreshterit.
860. M.S. tha se nuk e ka ditur që N.H. dhe L.P. ishin valltare me para dhe nuk e ka ditur që ato një herë kishin vallëzuar në përvjetorin e dhjetë të kompanisë së B.S.. Ai tha bindjen e tij se B.S. kishte qenë i përfshirë në trafikimin e tyre dhe nuk ka pasur romancë me asnjërën nga ato.
861. M.S. pajtohet që ai i kishte informuar disa pjesëtarë të familjes S.dhe XH.B. që rastin e kishte prokuroria. Ai tha se ata kishin vazhduar ta kontaktonin në lidhje me rastin por e kishin bërë përmes B.SH. dhe nuk e kishin thirrur personalisht. Ai tha se pasi e kishte lexuar Kallëzimin Penal ndaj tij ai e kishte kuptuar se ata vazhdimisht e kishin

thirrur B.SH. M.S. theksoi që B.SH. asnjëherë nuk ia kishte thënë atij këtë dhe se takimet që kishin ndodhur me familjarët e B.t ishin aksidentale për sa i takon atij. Ai tha se me B.S. kishte folur kur B.SH. e kishte prezantuar si të afërm, por që ka qenë i pranishëm në shoqëri të A.S. dhe pjesëtarëve tjerë të familjes në disa raste. Ai tha se nuk i kishte raportuar këto takime pasi që nuk kishte çfarë të raportojë pasi që vetëm një familje po interesohej në atë që po ndodhte me familjarin e tyre në një rast kriminal. Ai tha se nuk e ka ditur nëse ata janë përpjekur ta kontaktonin ndonjërin nga policët tjerë të njësisë përkitazi me rastin e B.

862. M.S. theksoi se nuk i kujtohet akuza që N.H. dhe L.P. nuk donin të deklaronin se ishin viktime të trafikimit ose që prokuroria kishte dëgjuar për këtë.

863. M.S. përsëriti që rreshter B.G. ishte udhëheqës i hetimit që ishte zhvilluar brenda njësisë dhe dokumentet i kishin nënshkruar nga të dy. Ai tha se i kishte besuar atij dhe madje ishin shoqëruar në disa raste por nuk i kujtohet nëse kishin shkuar në lokal me muzikë live. Ai tha se atje kishte shkuar vetëm në rastet e bastisjes.

864. M.S. pajtohet se ka pasur rastin të shkonte në lokale me muzikë live “*International*” pas orarit të punës, por jo shpesh. Ai u pajtua se në vitin 2013 e ka njohur Y. H. dhe Z. por jo SH. L.

865. M.S. theksoi se e ka ditur që R.A. rri te “*Montana*” dhe “*International*” por nuk e ka ditur se ai kryente edhe punë të sigurimit aty. E ka ditur që pronari i “*International*” ishte H.S.kurse pronari i “*Montana*” ishte R.B.

866. M.S. tha se kartela e tij e identitetit e Policisë së Kosovës i ishte marrë ditën kur ishte arrestuar dhe që atëbotë nuk kishte marrë as edhe një cent pagë. Ai u pajtua që ishte në pronësi të Mercedes Benz të cilin dëshmitari B.D. e kishte përshkruar në gjykatë.

867. M.S. tha se e ka njohur B.SH. para policisë sepse ata ishin nga e njëjta lagje por kurrë nuk kishin diskutuar me atë para se ti bashkohej policisë. Ai tha se nuk e ka ditur se

ai kishte tri makina. Ai tha se ai kishte punuar me të në njësinë anti-trafiking që nga gjysma e dytë e vitit 2012. Ai tha se zyrën e kishte ngjitur me të tijën.

868. M.S. tha se kur N.H. dhe L.P. ishin intervistuar për herë të dytë e tërë njësia ishte e pranishme. Ai tha se B.SH. kishte gënjyer kur ka thënë se mbante gradën e rreshterit. Me atë kishin shkuar në shumë udhëtime zyrtare por në asnjë udhëtim jo-zyrtar. Ai e mohoi se ishin shokë por e pranoi se kishte shkuar në shtëpinë e tij një herë. Ai e mohoi se kjo ishte për të luajtur shah. Megjithatë, ai e pranoi se kishte qenë prezent me rastin e synetisë së djemve të tij.

869. M.S. theksoi se kur kishin shkuar në “Ballkan” dhe “Euro Mit” ata kishin qenë në detyrë gjatë orarit të punës. Ai e pranoi se kishte biseduar me XH.B. dhe B.H.. M. theksoi se fillimisht nuk e ka ditur se pse ai dhe B. ishin arrestuar dhe tha se B. i kishte treguar kur po transportoheshin në një automjet. Ai tha se kishte pyetur se pse XH.B. e kishte paraqitur një ankesë ndaj tij?

870. M.S. tha se një kohë pasi ishte arrestuar kishte dëgjuar që B.SH. e kishte përdorur emrin e tij vazhdimisht në biseda të ndryshme me XH.B., Arbenin dhe K.S. M.S. tha se B.SH. e kishte prezantuar atë si person që mund t`ju ndihmonte por kështu nuk kishte ndodhur. Ai përsëriti se asnjëherë nuk kishte ndikuar në rastin ndaj B.S. – as që ishte përpjekur e as që ka pasur mundësi. Ai tha se nuk ka pasur arsye dhe as që kishte menduar për një gjë të tillë.

871. M.S. tha se e kishte njohur R.A. si “D.” dhe tha se kishte punuar si sigurim në “Montana” dhe “International” dhe vende tjera por nuk e ka ditur këtë. Ai pranoi se kishte pirë kafe me atë në disa vende.

872. M.S. refuzoi të përgjigjet nëse H.S.e kishte ftuar dy herë për ta marrë R.A. në orët e hershme të mëngjesit pas incidentit me të shtëna na lokalin “International”. Ai thjeshtë tha se R.A. nuk e kishte shok. Ai e mohoi se ishin shokë dhe prandaj kishte arsye që ta merrte, të gënjente në lidhje me hetimin apo të mos e hetonte rastin, ta rregullonte

rastin me atë dhe ta bindte A. XH. që të mos ngrinte padi. Ai e mohoi në tërësi se ka pasur të shtëna na lokal. Ai tha se nuk kishte parë as të shtëna e as dëme. Ai tha se kishte shkuar atje vetë për ta vërtetuar se çka kishte ndodhur e jo që potencialisht t'ua humte kohën. Ai tha se ai kishte qenë i dehur, pas makinë dhe pa ndonjë person kështu që nuk kishte çfarë të raportonte. Ai tha që as H.S.nuk e kishte pranuar se ka pasur të shtëna. Megjithatë, ai e ka pranuar se ishte zgjuar herët në mëngjes për të prezantuar në vendin e ngjarjes. Tha se e kishte takuar R.A. i cili kishte qenë i dehur kështu që e kishte dërguar në një restorant tjetër për kafe. Ai tha se kur ai kishte arritur atje nuk e kishte thirrur Hestet S.n i cili, ai insistonte, kishte ardhur vetë.

873. Prokurori ka vazhduar pyetjet kryqëzore për të pandehurin M.S. në seancën e gjyqimit kryesor më 26 prill 2016.

874. M.S. deklaroi se nuk kishte shkuar në vendin e incidentit në "*International*" si shok i R.A. por sepse pronari e kishte telefonuar atë dhe e kishte ndier këtë si obligim. Tha se nuk kishte shkuar në cilësi zyrtare. Tha se nuk kishte pasur automjete atje dhe se nuk i kujtohet asnjë automjet merimangë apo shërbim emergjent. Ai deklaroi se nuk kishte bërë asnjë ekzaminim forenzik për të përcaktuar nëse kishte pasur shkrepte nga arma e zjarrit.

875. M.S. nuk donte të përgjigjej se pse kishte folur me telefonin e R.A. me të dashurën e tij Z. dhe e kishte siguruar Z. se ishin duke pirë kafe bashkë dhe do ta sillte në shtëpi. Ai e mohoi ta ketë këshilluar ndonjëherë A. XH. që ta raportonte incidentin në polici edhe pse ai e kishte shok R.A. Ai e mohoi të ketë zhvilluar raporte shoqërore me disa nga vajzat që punonin në disa nga lokalet me muzikë të gjallë në zonën e Ferizajt.

876. M.S. më pas refuzoi të përgjigjet në pyetjet përkitazi me raportin e tij me V.T. Megjithatë, ai tha se kur V.T. i kishte thirrur për ti ndihmuar për të mos e paguar një tiketë për vepër të kundërvajtjes në komunikacion ai nuk e kishte ndihmuar. Ai e mohoi madje edhe t'ia kishte njohur zërin në telefon. Ai refuzoi të përgjigjet në pyetjet në lidhje me bisedën që ka pasur më policin N.S..

877. Prokurori vazhdoi pyetjet kryqëzore për të pandehurin M.S. në seancën e gjyqimit kryesor më 21 korrik 2016.
878. M.S. tha se nuk mund të thoshte se ka pasur një konspiracion ndaj tij nga ana e B.SH., XH.B. dhe familjes S., por tha se edhe nuk mund ta mohonte një gjë të tillë. Ai nuk mundi të thotë nëse ka pasur një konspiracion të tillë në rastin e H. S. dhe R.A. e as për V.T.
879. M.S. tha se kur XH.B. dhe A.S. kishin shprehur interesin në rastin e B.S. në praninë e tij, ai ishte ngritur dhe u kishte thënë *“për këtë rast mund ti drejtoheni vetëm gjykatës dhe prokurorisë, stacioni i policisë nuk është vend për këtë”*. Ai tha se kishte nënkuptuar që ata duhet të largoheshin nga zyra e tij.
880. M.S. tha se takimi pasues në Euromiti nuk ka qenë i organizuar. Ai mohoi ta ketë parë një shishe parfumi dhe në tërësi mohoi të ketë parë para nga XH.B. kur kishte qenë i pranishëm edhe B.SH.. Ai tha se XH.B. e kishte informuar atë se kishte blerë një send dhe donte t`ia jepte atij me ç`rast tha se kishte reaguar menjëherë, kishte goditur tavolinën dhe u kishte thënë të largoheshin menjëherë. Ai tha se ishte ai moment kur B.SH. i kishte thënë XH.B., *“dajë, nuk veprohet në këtë mënyrë”*. Ai tha se jashtë pompës së benzinës i kishte thënë B.SH.t se nuk kishte nevojë ta arrestonin XH.B. dhe se thjeshtë duhet të largoheshin.
881. M.S. nuk e mohoi se kishte diskutuar në lidhje me rastin me XH.B. dhe A.S. por tha se i kishte informuar ata se policia nuk kishte më të bënte me rastin dhe se rasti tani gjendej në prokurori dhe gjykatë. Ai tha se i kishte informuar vetëm arsyen pse ishte arrestuar B.S. Ai shprehu bindjen e tij se ata tashmë kishin qenë të informuar për rastin. Familja kishte ditur më shumë për rastin se sa vetë ai por ai e pranoi se ai e kishte konfirmuar atë që ata tashmë e dinin.

882. M.S. refuzoi të përgjigjet se pse nuk e kishte raportuar ofertën e pretenduar korruptive të ofrimit të një shisheje parfum nga XH.B. apo përpjekjes së tij për të zbuluar informacion në lidhje me rastin ndaj B.S. Ai theksoi se nuk e kishte konsideruar ofertën e parfumit si veprim i tentimit për korruptim, por si një gjest naiv.
883. M.S. tha se nuk i kishte bërtitur B.SH. në parkingun te restoranti “*Mulliri i Vjetër*” por e kishte bërë këtë në një restorant në Prishtinë. Atij i kujtohet se i pranishëm ka qenë XH.B. por nuk i kujtohet nëse ishin të pranishëm A.ose vëllezërit e tij. M.S. theksoi se askush nuk e kishte detyruar atë ta vizitonte familjen S.edhe pse ata vazhdimisht e lutnin për tu takuar.
884. Prokurori vazhdoi pyetjet kryqëzore për të pandehurin M.S. në seancën e gjyqimit kryesor më 2 gusht 2016.
885. M.S. theksoi se nuk e ka informuar e as i konfirmuar XH.B. SMS-të ose përgjimet telefonike në rastin e B.t e as që kishte diskutuar për provat, deklaratat e shkruara apo dënimin potencial me të cilin ballafaqohej.
886. M.S. theksoi që nuk e ka njohur B. para këtij rasti. Megjithatë, ai e pranoi të ketë pyetur atë për ta angazhuar që të punojë në fasadën e ndërtesës, pasi ishte deklaruar fajtor. Ai pajtohet se asnjëherë më parë nuk kishte përdorur shërbimet e tija.
887. M.S. pranoi se pak municion ishte gjetur gjatë bastisjes së shtëpisë së tij. Ai tha se ishte e kalibrit të revoles zyrtare që mbante. Ai tha se ishte lënë nga të shtënat në poligon ku kishte ushtruar me policë ndërkombëtarë. Ai e ka pranuar se posedonte më tepër se sa sasia e lejuar.
888. Në lidhje me incidentin ku përfshihej V.T., M.S. theksoi se ai ishte përgjigjur në telefon dhe i kishte thënë V.T. ti thoshte policëve që në telefon ishte “M.” dhe se M. e kishte dajë.

889. Edhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 27 korrik 2016 i pandehuri V.T. e as avokati i tij mbrojtës , A.S., nuk deklaruan se kanë ndonjë pyetje për t'ia parashtruar M.S.
890. Edhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 27 korrik 2016, pala e dëmtuar B.S. ka deklaruar se nuk ka asnjë pyetje për të pandehurin, M.S. .
891. Në përgjigje të pyetjeve të avokatit mbrojtës për palët e dëmtuara, avokatit B. S., M.S. deklaroi se kontakti i tij i parë me B.n Sylejmanin ishte me telefon kur ai ishte në mbajtje në polici para se të arrestohej në të njëjtën ditë. Ai përsëriti se ai kurrë nuk kishte parë, e aq më pak të pranojë, ndonjë parfum apo kolonjë.
892. M.S. deklaroi se kur ai e kishte takuar për herë të parë B.S. në stacionin policor ai nuk i kishte treguar atij që ai ishte daja i tij por gjatë intervistës ai e zbuloi se ai ka mund të jetë. Ai tha se takimet dhe intervista ishin kryer në mënyrë miqësore.
893. Edhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 27 korrik 2016 i pandehuri V.T. tha se nuk donte të bënte një deklaratë përmbyllëse.
894. Prokurori paraqiti deklaratën përfundimtare në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 9 shtator 2016 dhe e njëjta i bashkëngjitet procesverbalit në dosjen e rastit.
895. Avokati mbrojtës, A.R., dhe pala e dëmtuar, B.S., paraqitën deklaratat e tyre përfundimtare në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 26 shtator 2016 dhe të njëjtat i bashkëngjiten procesverbalit në dosjen e rastit.
896. Avokati mbrojtës A.S. për të pandehurin V.T. dhe i pandehuri M.S. paraqitën fjalët përfundimtare në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 30 shtator 2016 dhe të njëjtat i bashkëngjiten procesverbalit në dosjen e rastit.

897. Prokurori paraqiti kundërshtimin e tij ndaj fjalimit të të dy të pandehurve në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 4 tetor 2016.

D. PROVAT E DOKUMENTUARA

898. Palët janë pajtuar mbi inventarin e provave të dokumentuara të gjykatës në seancën e datës 5 shtator 2016 dhe të njëjtat paraqiten në Shtojcën 1 të këtij Aktgjykimi

E. ANALIZA E PROVAVE DHE KONSTATIMET FAKTIKE

M.S.

899. Ky ishte një hetim i gjatë dhe kompleks kurse në gjykim janë ngritur shumë çështje dhe pretendime ndaj shumë të pandehurve. Aktakuza përshkruante pesë skenarë të veçantë të skenarit faktik. Këto ishin së pari, “rasti” i parë i B.S. (Akuzat 1, 2 dhe 3 kundër M.S. t dhe B.SH.), së dyti incidenti ku përfshihej R.A. në restorantin “*International*” më 29 maj 2013 (Akuzat 6 dhe 7 kundër M.S. t), së treti posedimi i pretenduar i paligjshëm i një arme pa leje kur ai ishte arrestuar më 11 shtator 2013 (Akuza 8 kundër M.S. t), së katërti, incidenti ku përfshihet i pandehuri V.T. më 28 maj 2013 (Akuza 4 dhe 5 kundër të pandehurit M.S.) dhe së fundi incidenti i cili pretendohet se ka ndodhur në shtëpinë e S. pas lirimimit të tij më 27 nëntor 2012 dhe në janar dhe mars 2013. Të pandehurit A.M., S.M. dhe B.V. janë akuzuar në raport me incidentin e fundit në pikat 14, 15 dhe 16 të Akuzës.

900. Në aktakuzë ngarkoheshin shtatë (7) të pandehur. I pandehuri A.M. mbetet në arrati pasi ka ikur para dëgjimit fillestar. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, të pandehurit R.A. dhe B.SH. kishin bërë marrëveshje për pranimin e fajësisë me PSRK-në me ç`rast trupi gjykues i ndau rastet e tyre nga gjykimit kryesor. Të pandehurit B.V. dhe S.M. pranuan fajësinë para trupit gjykues. I pandehuri B.V. u arratis dhe nuk u dënua deri më 4 gusht 2016. I pandehuri S.M. mbetet në arrati kurse Kryetari i trupit gjykues ka lëshuar urdhër arreste vendore dhe ndërkombëtare. Kryetari i trupit gjykues po ashtu ka veçuar rastet e tyre nga shqyrtimi gjyqësor.

901. Prokurori dëgjoi deklarinimin (pranimin) e të pandehurit B.SH. në lidhje me akuzat ku ai paraqitet si i bashkë-akuzuar së bashku me të pandehurin tjetër M.S. n (Akuzat 1, 2 dhe 3). Sidoqoftë, trupi gjykues vendosi se deklarimi (pranimi) i tij, i bërë derisa gjykimi ishte në vazhdim e sipër e ka ngritur të pandehurin B.SH. në statusin e dëshmitarit bashkëpunues dhe kjo ishte jashtë nivelit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë në këtë fazë të procedurës, prandaj deklarimi (pranimi) nuk mund të konsiderohet si dëshmi.
902. Trupi gjykues nuk e ka konsideruar faktin që të pandehurit B.SH. dhe R.A. janë deklaruar fajtor si fakte dëshmuese të asnjë pretendimi kundër të pandehurit M.S. . Ngjashëm, trupi gjykues nuk e ka konsideruar faktin që të pandehurit B.V. dhe S.M. janë deklaruar fajtorë për Akuzat 14, 15 dhe 16 si dëshmi të asnjë pretendimi kundër të pandehurit M.S. Disa dëshmitarë e kanë shprehur qëndrimin e tyre se ka ekzistuar një lidhje faktike ndërmjet të pandehurit M.S. dhe të pandehurve dhe akuzave në pikat 14, 15 dhe 16 të aktakuzës mirëpo trupi gjykues nuk gjeti asnjë provë të besueshme për ta dëshmuar këtë.
903. Pika qendrore e akuzave në Pikat 1, 2 dhe 3 të aktakuzës ishte çështja e besueshmërisë së familjarëve të ngushtë dhe të largët të familjes S., në veçanti B.S., A.S.t dhe XH.B. të vënë përballë deklaratave dhe provave të pandehurit M.S. . Trupi gjykues konsideroi se në veçanti mbrojtja u përpoq të përmendte prova nga dëshmitarët tjerë në lidhje me disa çështje që ishin krejtësisht të huaja dhe tërësisht të parëndësishme. Përpos kësaj, trupi gjykues konsideroi përmbajtjen e përgjimeve telefonike të mbledhura nga prokuroria si ndihmesë e madhe për t'i mundësuar që të vendos se kush po fliste të vërtetën në lidhje me secilën pikë të aktakuzës.
904. Trupi gjykues në mënyrë përmbajtësore i ka shqyrtuar deklaratat dhe dëshmitë e anëtarëve të familjes S.dhe njëzëri është pajtuar se ato ishin dëshmuese përtej dyshimit të arsyeshëm për të gjitha pretendimet e përfshira në to në lidhje me Pikat 1, 2 dhe 3. Jo vetëm që deklaratat e tyre individualisht ishin kohezive, bindëse dhe të besueshme por në përgjithësi ishin reciprokisht vërtetuese në një mënyrë e cila ishte aq e detajuar dhe kjo ka

mund të jetë kështu vetëm për shkak se ajo që ata ishin duke e thënë ishte e vërtetë dhe nuk ishte shpikur apo sajuar. Trupi gjykues kishte mundësinë që të vëzhgojë çdo anëtar të familjes së ngushtë dhe të gjerë S.kur ata dëshmuuan në seancat e shqyrtimit gjyqësor. Trupi gjykues nuk ka qenë i impresionuar vetëm me saktësinë e mbajtjes së tyre në mend por edhe me sjelljen e tyre të qetë gjatë marrjes së gjatë dhe shpesh të parëndësishme të tërthortë në pyetje.

905. Trupi gjykues ishte veçanërisht i impresionuar se si anëtarët e familjes së ngushtë dhe të gjerë S. mbanin në mend të mënyrë të saktë takimet e tyre të shumta me të pandehurin, M.S. , ku dhe kur ato kishin ndodhur, kush ishte i pranishëm, si dhe çfarë kishte ndodhur, çfarë ishte thënë dhe nga kush. Për të marrë një shembull, dëshmia e bindi trupin gjykues përtej dyshimit kur M.S. iu kishin dorëzuar para në një kuti të parfumit dhe ai kishte thënë "*a po mundoheni të më korruptoni?*" Trupi gjykues e gjen të provuar përtej dyshimit se i pandehuri, M.S. , në bashkëpunim me të pandehurin, B.SH., e kishin kërkuar këtë dhe pagesa (të tjera) për përfitimin e tyre. Ata e bënë këtë me vetëdije dhe qëllimisht duke ua dhënë anëtarëve të familjes së ngushtë dhe të gjerë S.përshtypjen se ata, në kundërshtim, ishin duke punuar shumë për të fituar një rezultat të favorshëm për rastin e B.S. Trupi gjykues e konsideroi këtë si një abuzim të madh të pozitive të tyre përkatëse.

906. Ka pasur shumë shembuj të tjerë të aftësisë së saktë të familjes S.për të treguar me hollësi takimet e rëndësishme dhe bisedat që kanë ndodhur mes tyre dhe të pandehurit, M.S. Kryesisht, trupi gjykues konsideroi se mbajtjet në mend nga pala e dëmtuar, B.S. ishin shumë të sakta posaçërisht kur ato shqyrtohen në dritën e hidhur traumatike që ai u detyrua ta durojë. Pala e dëmtuar, B.S. ishte në gjendje të mbaj mend në hollësi të madhe ngjarjet në secilën ditë prej arrestimit të tij, ajo që kishte ndodhur në stacionin e policisë dhe kur ai ishte dërguar në Gjykatë.

907. Trupi gjykues i konsideron provat e vërtetuara përtej dyshimit të bazuar që “rasti” kundër palës së dëmtuar B.S. për pretendim të trafikimit të qenieve njerëzore përkitazi me N.H. dhe L.P. ishte krejtësisht false (i rremë). Si N.H. ashtu edhe L.P. kanë dhënë prova të cilat ishin krejtësisht në përputhje me përgjimet. Është e vërtetë se kanë dhënë

dëshmi se kanë pasur raporte intime me palën e dëmtuar B.S. dhe që kanë marrë para nga ai. Megjithatë, provat e tyre nuk ishin që (a) paratë ishin përdorur kryekëput dhe ekskluzivisht në këmbim të favorit seksual dhe (b) nuk ka pasur prova që B.S. i ka trafikuar ato për qëllime të shfrytëzimit seksual. Ka qenë e kundërta, duket se ato kanë qenë pjesëmarrëse me vetë dëshirë.

908. Trupi gjykues e konsideron me rëndësi të thuhet që edhe pse ka pasur prova të besueshme për ta vërtetuar që “rasti” ndaj B.S. ka qenë i vërtetë dhe jo i sajuar, sjellja e M.S. dhe B.SH. në kërkimin e ryshfetit për të ushtruar ndikimin përbën keqpërdorim të detyrave të tyre zyrtare dhe kjo ka përbërë veprat me të cilat janë Akuzuar në Pikat 1, 2 dhe 3 të akuzës. Trupi gjykues është i sigurt që “rasti” kundër B.S. ishte sajuar nga policia me qëllim që atij ti bëjnë presion dhe ta shfrytëzojnë atë, familjen dhe kompaninë e tij. Në fakt, ka qenë pikërisht kjo akuzë e bërë nga anëtarët e familjes S. disa nga të cilët mendojnë se kjo ishte bërë saktësisht për ta pasuruar financiarisht të pandehurin M. dhe B. Fakti që ‘rasti’ ishte krejtësisht jo-meritor përfundimisht gjeti mbështetje edhe në vendimin PRK. nr. 73/2014 të Gjykatës Komunale në Ferizaj, datë 9 shkurt 2016 në bazë të të cilit pala e dëmtuar B.S. ishte shpallur i pafajshëm për veprën penale Trafikim i Qenieve Njerëzore¹⁹.

909. Trupi gjykues refuzon në tërësi pretendimin e të pandehurit M.S. se ai nuk ishte në dijeni të asaj se çfarë po ndodhte në këtë apo secilin rast të njësisë së tij. Trupi gjykues është i sigurt se si Shef i Njesisë Kundër Trafikimit në Ferizaj, i pandehuri M.S. e ka ditur (ose është dashur ta dinte) për këtë rast dhe kush ka qenë i pandehur. Është kundër logjikës që një biznesmen lokal i një rajoni të vogël të një shteti të vogël mund të arrestohet për krime të rënda kurse shefi i njesisë përkatëse policore të ketë vetëm njohuri të përgjithshme mbi rastin. Trupi gjykues është i sigurt që M.S. ka qenë në dijeni që pala e dëmtuar B.S. ka qenë një person i pasur dhe e kishte parë një mundësi që të fitonte para për veten e tij duke pranuar ryshfet për ta shpërdorur detyrën e tij zyrtare dhe për të ushtruar ndikim. Në të vërtetë, ai i kishte thënë B.S. kur e kishte bërë punën që ai të sillej për herë të parë në stacionin policor në Ferizaj që ai, “do të të ndihmoj sa të mundem”.

¹⁹ Dosja e rastit është krijuar nga Gjykata në lidhje me “Rastin” P. Nr. 594/12, ndarja 20.

910. Thjeshtë, trupi gjykues nuk e ka pranuar pretendimin e të pandehurit M.S. si vetë ai ishte shfrytëzuar nga B.SH. i cili kishte qenë iniciatori kryesor i veprave e nuk e pranon atë që familja S.në vazhdimësi e kishte kontaktuar atë por që ai ishte munduar të distancohej nga ata. Në fakt, trupi gjykues konsideron se familjarët S.ishin inkurajuar në veçanti nga B.SH. që të besonin se vetë ai dhe M.S. ishin duke punuar shumë për ti ndihmuar B.S. për të siguruar një rezultat sa më të mirë për atë. Trupi gjykues vëren se ka qenë B.SH. ai i cili kishte filluar kontaktet me A.S. dhe XH.B., mirëpo trupi gjykues është i sigurt se ai ka vepruar kështu në bazë të udhëzimeve nga eprori i tij M.S. si pjesë e planit që ata kishin bërë së bashku për të nxjerrë ryshfet nga një njeri të cilin ata e dinin se ishte i pasur.

911. Trupi gjykues po ashtu e pranon në tërësi provën e palës së dëmtuar B.S. që pas lirimit të tij, ai ishte takuar me M.S. dhe B.SH. dhe që të dy ata e kishin informuar se sa me fat kishte qenë me të gjitha përpjekjet që ata i kishin bërë për ta zgjidhur ‘rastin’. Trupi gjykues po ashtu në tërësi i refuzon dëshminë e M.S. se ai me hezitim kishte shkuar në shtëpinë e familjes S.pas lirimit të B. dhe se B.S. i kishte ftuar ata për t’iu nxjerrë favore pasi e dinte se arrestimi i tij i dytë ishte i pashmangshëm. Ka ndodhur e kundërta, trupi gjykues është i mendimit që më shumë ka të ngjarë që M.S. kishte shkuar atje në përpjekje egoiste për të nxjerrë favore nga familja Syljemani me shpresë që ata nuk do ta raportnin për veprimet e tij kriminale.

912. Trupi gjykues e ka gjetur si të dëshmuar përtej dyshimit se më 30 maj 2012, B.S. kishte pranuar një thirrje telefonike nga M.S. i cili i kishte thënë të vinte në polici. Në fakt, B. e kishin takuar në një pompë benzine policët E.A., B.SH. dhe një polic tjetër. M.S. nuk ishte aty por ata e morën me vete B.S. në një automjet policor për ta dërguar në stacionin e policisë në Ferizaj. Atje ishte takuar me M.S. i cili e kishte pyetur nëse ai e kishte “*vrarë dikë*” dhe nëse ai “*e kishte martuar ndonjë Serb me një femër nga Shqipëria*”. B.S. e mohoi këtë por M.S. i ia tregoi një fotografi dhe i tha “*vepra penale e trafikimit është më e rëndë se sa vrasja*”. M. më pas e pyeti nëse e njihte “*L. apo X.,?*” kurse B. u përgjigj se i njihte. B.S. më pas u intervistua nga E.A. dhe B.SH. kurse më pas u dërgua në zyrën e M.S. ti cili i tha, “*do të të ndihmoj sa të mundem*”. Trupi gjykues e

gjen si të dëshmuar përtej dyshimit se i pandehuri M.S. i ka thënë këto fjalë dhe ka bërë të qartë planin e tij për të nxjerrë ryshfet të paligjshëm nga pala e dëmtuar B.S. duke kryer shpërdorim të detyrës zyrtare dhe duke ushtruar ndikim për ta bindur B.S.n se ai i kishte ndihmuar për ta arritur një rezultat të favorshëm në një rast penal krejtësisht të rremë ku përfshiheshin pretendime për trafikimin e L.P. dhe N.H., ai ka qenë personi kyç që ka sajuar ndaj B.S..

913. Trupi gjykues gjithashtu e ka gjetur si të dëshmuar përtej dyshimit që B.S. më pas ishte mbajtur dy ditë në stacionin e policisë në Ferizaj kurse më pas ishte transportuar nga E.A. dhe B.SH. në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Trupi gjykues pranon dëshminë e B.S. që M.S. i kishte shoqëruar për një pjesë të rrugës dhe kishte dalë nga kafe Lamborghini në Ferizaj por jo para se ti thotë E.A. dhe B.SH. *“ndihmoi sepse është i yni”*. Dokumentet gjyqësore tregojnë që B.S. ishte vendosur në paraburgim për nja muaj por dy ose tri ditë pas dëgjimit, derisa ishte në paraburgim, B. ishte takuar me vëllezërit e tij A. dhe S.S. të cilët i kishin thënë *“e kemi rregulluar punën ; po shkon mirë dhe jemi në kontakt vazhdimisht me M.n [S.] dhe B.n [SH.]*.

914. Trupi gjykues e ka gjetur si të dëshmuar përtej dyshimit se më 27 nëntor 2012 B.S. ishte liruar nga paraburgimi në këmbim të 25,000 Eurove. B. ishte deklaruar fajtor dhe ishte dënuar me dy vite e tre muaj burg, ku ishte llogaritur koha e kaluar. Ai më pas ishte liruar më 27 nëntor 2012 dhe ishte kthyer pranë familjes së tij. Deklarata e B.S. në lidhje me këtë vërtetohet nga kronologjia e procedurave gjyqësore ndaj tij dhe mund të gjendet në dosjen e lëndës P.Nr 594/12²⁰.

915. Në vazhdim, ka pasur një sekuençë ngjarjesh që kanë të bëjnë me të pandehurit B.V., S.M. dhe A.M. dhe që pasqyrohen në Pikat 14, 15 dhe 16 të Aktakuzës. Trupi gjykues nuk i referohet asnjë dëshmie përkitazi me këto ngjarje në këtë aktgjykim. Kryesisht, kjo sepse i pandehuri A.M. ende nuk është deklaruar në lidhje me ato akuza kurse trupi gjykues nuk dëshiron të paragjykojë atë në asnjë mënyrë. Përpos kësaj, i

²⁰ Dokumentet e këtij “rasti” ishin të përfshira në dosjen e lëndës të paraqitura nga Prokurori por edhe Gjykata e ka krijuar një dosje të veten që përmbante të gjitha vendimet dhe urdhërat e këtij “rasti”.

pandehuri S.M. ka pranuar fajësinë por më pas është arratisur. Ai ende nuk është arrestuar për ta konfirmuar deklarin e tij dhe potencialisht të dënohet.

916. Sigurisht, trupi gjykues e ka të qartë që i pandehuri B.V. ka pranuar fajësinë dhe është dënuar përkitazi me këto akuza. Por, trupi gjykues konsideron se është shumë me rëndësi të theksojë se këtë nuk e ka marrë aspak parasysh kur i ka shqyrtuar pretendimet faktike në pikat e akuzës ndaj të pandehurit M.S. . Trupi gjykues nuk ka gjetur prova që ta lidh të pandehurin M.S. n me pretendimet nga Pikat 14, 15 dhe 16 të aktakuzës. Trupi gjykues e pranon se B.S. sërish ishte dërguar në paraburgim nga fillimi i janarit 2013.

917. Trupi gjykues po ashtu gjen se është dëshmuar përtej dyshimit që dosja e “rastit” të B.S. tregon se M.S. ka qenë i përfshirë në këtë rast sepse emri dhe nënshkrimi i tij gjenden në formularët e arrestimit. Trupi gjykues nuk e pranon dëshminë e tij se ai i kishte nënshkruar siç i nënshkruan shumë dokumente që prodhohen nga njësia e tij, sepse ai ka qenë në krye të njësisë dhe si formalitet por jo domosdoshmërisht duke ditur përmbajtjen e saktë të secilës prej tyre. Trupi gjykues konstaton se i pandehuri M.S. ka qenë thellë i përfshirë në këtë “rast” ndaj palës së dëmtuar B.S. deri në pikën që e ka sajuar së bashku me B.SH.n për të nxjerrë ryshfet duke shpërdoruar pozitën e tij zyrtare dhe duke ushtruar ndikim.

918. Trupi gjykues gjen se është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se kjo sjellje kriminale ka vazhduar në janar 2013 kur B.S. ishte arrestuar sërish më 4 janar 2013 dhe ishte vendosur në arrest shtëpiak më 5 janar 2015. Trupi gjykues në tërësi e pranon dëshminë e palës së dëmtuar B.S. që rreth orës 13;00 të datës 4 janar 2013, derisa ai ishte duke drekuar në Brezovicë me djalin e tij, ai kishte marrë një thirrje telefonike nga M.S. i cili i kishte thënë: “B., kam dëgjuar që merresh me punimin e fasadave të shtëpisë”. M. më pas i kërkoi të shkonte në shtëpinë e M.t për të parë se çka i duhet për atë punë dhe u pajtuan të takoheshin atë pasdite. Më vonë atë ditë, B. mori një thirrje telefonike nga një numër i panjohur me ç`rast thirrësi u prezantua si Polic nga Krimet e Rënda në Prishtinë. Thirrësi i kërkoi B.t të takoheshin në Ferizaj. Trupi gjykues në tërësi e pranon dëshminë e B.S. i cili thotë se ishte shokuar nga kjo thirrje dhe menjëherë e kishte telefonuar M.S.

për ta pyetur nëse e njihte policin i cili e kishte kontaktuar. Trupi gjykues poashtu e pranon dëshminë e tij kur M.S. iu përgjigj: *“B., nëse nuk e ndien veten fajtor, shko dhe takohu me atë pasi që e njoh shumë mirë dhe e kam kolegë”*. Trupi gjykues konstaton si të dëshmuar që më pas B.S. foli me vëllain e tij K.S. i cili bisedoi me M.S. dhe e informoi B. se ishte e sigurt të shkonte në stacionin policor në Ferizaj pasi që vetëm duhet ta jepte një deklaratë atje.

919. Sidoqoftë, kur B. dhe K.S. arritën në stacionin policor në Ferizaj, M.S. e pyeti B.S. nëse e njihte një femër me emrin S. dhe kur ai u përgjigj që se e njihte, M. tha, *“Situata nuk është e mirë pasi që rasti është serioz”*. Trupi gjykues e pranon që M.S. më pas e identifikoi B.S. për dy policët nga Prishtina dhe ju tha *“atë e kam kushëri”*. B. shkoi dhe u paraqit para gjykatës në Prishtinë më 5 janar 2013 ku u lirua në arrest shtëpiak.

920. Trupi gjykues në tërësi e pranon si të dëshmuar përtej dyshimi, kryesisht nga deklaratat e sakta dhe të detajuara të A.S. dhe XH.B., se familja e gjerë S.kishin bërë pagesa në total prej 4,750 eurove të pandehurve M.S. dhe B.SH..

921. Së pari, e gjen si të dëshmuar se fillimisht pesë ose gjashtë ditë pas dëgjimit mbi paraburgim të B.S., B.SH. e kishte thirrur XH.B.n dhe i kishte kërkuar të takoheshin te *“Viva”* e vjetër në Ferizaj. A.S. dëshmoi dhe trupi gjykues e pranoi këtë që, ky takim ka ndodhur dy ose tre ditë pasi ai e kishte takuar M.S. n dhe B.SH. në stacionin policor. XH.B. dhe A.S. shkuan te Viva e vjetër në Ferizaj. Me të arritur, ata u takuan me B.SH.n i cili iu kishte thënë se sapo e kishte dëmtuar automjetin e M., Audin dhe ua kërkoi 1,000 Euro për ta riparuar pasi që M. ishte duke ju ndihmuar në rastin e B., dhe t'ia jepnin 50 Euro për dreke për M.S. n. Trupi gjykues pranon dëshminë e A.S.i cili kishte tërhequr 300 Euro nga llogaria e tij në Pro Credit bank (nga ATM) së bashku me para të tjera (100 Euro) të cilat i kishte tërhequr një ditë më parë dhe i kishte në shtëpi. Trupi gjykues po ashtu pranon dëshminë e XH.B.t i cili kujton që edhe A.S. kishte kontribuar me 400 Euro dhe se është dashur të shkonte në shtëpi për të mbledhur pjesën e mbetur prej 650 Euro. A.S. kishte siguruar 500 Euro përmes S.S.t i cili i kishte siguruar nga R.I.

922. Trupi gjykues pranon dëshmitë e A.S. dhe XH.B. që i kanë dhënë këto 1,050 Euro B.SH. në ulëset e pasme të makinës së tyre në Viva Market dhe B.SH. u ka thënë se rasti do të zgjidhet. Trupi gjykues është i sigurt se edhe pse B.SH. i kishte pranuar paratë ai ishte duke vepruar në marrëveshje me M.S. n për përfitim të tyre dhe ky ishte një ryshfet, një shpërdorim nga të dy ata të pozitës zyrtare duke ushtruar ndikim në bashkë-kryerje.
923. Gjithashtu, trupi gjykues e pranon dëshminë e A.S. dhe XH.B. që rreth datës 6 qershor 2012 ata kanë shkuar në Prokurori në Prishtinë, më pas në një kafene dhe më pas në Universitetin AAB ku B.SH. ia kërkoi XH. dhe A. t ia jepnin 300 Euro për ta paguar tarifën. Trupi gjykues e pranon dëshminë e A.S. që ia kishte dhënë B.SH.t paratë të cilat ai i shfrytëzoi për ta paguar tarifën e fakultetit.
924. Trupi gjykues gjithashtu e pranon provën e A.S. dhe XH.B. e që mbështeten nga regjistrimi telefonik dhe gjen se është dëshmuar përtej dyshimit që pak pas incidentit në Universitetin AAB, B.SH. e kishte thirr XH. dhe i kishte kërkuar të takoheshin sërish te Viva e vjetër në Ferizaj. Trupi gjykues e pranon se në takim kishin shkuar të dy dhe me të arritur, B.SH. ua kërkoi atyre 1,400 Euro, duke ju thënë se 500 Euro ishin për të kurse 500 Euro për M.S. n, kurse 400 Euro për një polic tjetër i cili nuk kishte dalë para gjykatës. Trupi gjykues e pranon dëshminë e XH.B. se ai nuk i kishte paratë në atë moment dhe është dashur të largohet dhe ti kërkonte nga të afërmit. Ai dhe A.S. theksuan (dhe trupi gjykues e pranon) se pas rreth një ore pasi i kishin siguruar paratë, ata ishin takuar me B.SH. sërish në parkingun e Vivës. B. hyri në makinë para XH.B. dhe A.S. dhe më pas ia paguan 1,400 Euro.
925. Trupi gjykues po ashtu pranon dëshminë e A.S. dhe XH.B. që gjejnë mbështetje nga të dhënat e regjistrimit telefonik dhe gjen të dëshmuar përtej dyshimit se disa ditë pasi i kishin paguar 1,400 Euro B.SH.t, ky i fundit e kishte thirrur XH.B.n dhe ishin takuar te restoranti “Mullini i Vjetër” me A.S.n. Me të arritur, XH. u takua me M.S. n i cili refuzoi të takohet me A.S.n. Sidoqoftë, XH.B. u takua me M.S. dhe B.SH., kurse A.S. u kthye në Ferizaj vetëm. Trupi gjykues e pranon dëshminë e XH.B. që gjatë

takimit, B.SH. i kishte thënë, “Duhet ti gjesh 500 Euro për shpenzimet që jemi duke i bërë”. XH.B. më pas ia pagoi B.SH. 500 Euro në kesh në prani të M.S.

926. Trupi gjykues gjithashtu e pranon dëshminë e A.S. dhe XH.B. që gjen mbështetje edhe në të dhënat e regjistrimit telefonik dhe gjen të dëshmuar përtej dyshimi se disa ditë pasi ia kishte paguar 500 Euro B.SH.t, ai kishte shkuar në Prokurori në Prishtinë në lidhje me rastin e B. Pasi ishte informuar se palët e dëmtuara nuk ishin përgjigjur në ftesë, XH. kthehet në Ferizaj dhe kontakton B.SH.n. XH. dhe A. më pas u takuan me B.SH. dhe M.S. në një restorant përgjatë rrugës së Nerodimes në Ferizaj dhe u tregoi atyre me këtë zhvillim.

927. Sipas XH.B., dhe trupi gjykues e pranon, B.SH. e kishte thirrur të nesërmen dhe e lanë të takoheshin në shtëpinë e tij në Ferizaj, po ashtu i pranishëm ishte edhe M.S. , A.S. nuk ishte i pranishëm në takim por gjatë takimit, B.SH. i tha XH.B. “*puna është afër përfundimit*” dhe M.S. i tha XH. se duheshin edhe 1,500 Euro tjera ti paguheshin atij në momentin përkatës. Me tu larguar nga shtëpia e B.SH., XH.B. ia përcolli përmbajtjen e bisedës A.S.t dhe ata më pas u përpoqën ti siguronin paratë nga të afërm të ndryshëm. Në fund, XH. thirri B.H. dhe i siguroi paratë nga ai.

928. Gjithashtu, trupi gjykues pranon dëshminë e A.S. dhe XH.B. që gjejnë mbështetje në të dhënat e regjistrimeve telefonike dhe gjen si të mbështetur përtej dyshimit se B.SH. e ka thirrur XH.B. sërish dhe së bashku kishin shkuar të takoheshin me M.S. te “*Euro Miti*”. A.S. nuk ishte i pranishëm sepse nuk ndihej mirë. Gjatë rrugës dhe sipas kërkesës së B.SH.t, ata ndaluan ku XH.B. bleu një kuti parfumi në një super market. B.SH. i kishte thënë se 1,500 Euro duhet të vendoseshin në një kuti parfumi dhe duhet t`ia jepte pakon M.S. kur ai thotë se ishte momenti i duhur për t`ia dhënë. Në restorant, B.SH. më pas i thotë XH.t t`ia jepte kutinë e parfumit M.S. gjë të cilën XH. e bëri. M.S. e mori kutinë, e hapi, i pa paratë brenda, qeshi dhe tha “*ju doni edhe të më korruptoni mua*”. Trupi gjykues e konsideroi të saktë atë që tha XH.B. për ngjarjen si një provë të qartë të sjelljes kriminale të M.S. dhe B.SH. dhe një provë të pastër se ata kishin vepruar së bashku si pjesë e një plani të përgatitur paraprakisht.

929. Në lidhje me Pikën 1 të aktakuzës, trupi gjykues është plotësisht i kënaqur se i pandehuri M.S. ka qenë një person zyrtar, konkretisht një toger në Policinë e Kosovës dhe Shef i Njësisë Kundër Trafikimit në Ferizaj dhe së bashku me të pandehurin B.SH., gjithashtu një person zyrtar, në bashkë kryerje dhe me qëllim që ti sjellin vetes përfitim të paligjshëm material, (konkretisht 4750 €) e kanë shpërdorur detyrën e tyre zyrtare. Në veçanti, ata kanë marrë para nga XH.B. dhe A.S. dhe rrjedhimisht edhe nga familjarët e B.S., duke ju shkaktuar kështu dëmtim financiar këtyre individëve, në këmbim të premtimit që ta siguronin lirin e B.S. nga paraburgimi apo duke iu premtuar se ai nuk do të shpallej fajtor dhe/ose duke iu premtuar se ai nuk do ta vuante dënimin. Këto veprime të pandehurve, në mes tjerash, paraqitja para familjes S.se të pandehurit do ti kontaktonin dëshmitarët me qëllim që ata ti ndryshonin deklaratat kundër B., dhënia e dhuratave prokurorëve të caktuar në rastin e B. dhe do të fshihnin disa prova që gjendeshin në dosjen e B.t nga dosja që do ti dorëzohej prokurorisë.

930. Duke kryer kështu veprën Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar në kundërshtim me nenin 422 të KPK të vitit 2013, e dënueshme me një dënim me burg nga gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vite.

931. Në lidhje me Pikën 2 të aktakuzës, trupi gjykues është plotësisht i kënaqur se në qershor të vitit 2012, në Ferizaj, Kosovë dhe/ose gjetiu në Kosovë, i pandehuri M.S. , si një person zyrtar, konkretisht një toger në Policinë e Kosovës dhe Shef i Njësisë Kundër Trafikimit në Ferizaj dhe së bashku me të pandehurin B.SH., gjithashtu një person zyrtar, në bashkë kryerje kanë kërkuar dhe pranuar një dhuratë ose përfitime tjera për veten e tyre (konkretisht, pagesa në para në vlerë totale përafërsisht 4750 €) për të kryer brenda fushëveprimit të autoritetit një veprim zyrtar apo tjetër të cilin ai ose ajo nuk duhet ta kryejnë ose nuk e kanë kryer një vepër të cilën është dashur ta kryenin, që ose ta siguronin lirin e B.S. nga paraburgimi ose të sigurohen se ai nuk do të shpallet fajtor dhe/ose të sigurohen se nuk do ta vuante dënimin. Veprimet e të pandehurve përfshinin, në mes tjerash, paraqitjen para familjes S.se të pandehurit do të kontaktonin me

dëshmitarë që ata ti ndryshonin deklaratat e tyre, dhënia e dhuratave prokurorit të caktuar në rastin e B. dhe fshejja e disa provave nga dosja e lëndës që do të dërgohej prokurorit.

932. Duke kryer kështu veprën Marrje e ryshfetit, në kundërshtim me nenin 428 të KPK të vitit 2013, e dënueshme me një dënim me burg nga gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vite.

933. Në lidhje me Pikën 3 të Aktakuzës, trupi gjykues gjithashtu është i kënaqur përtej dyshimit të arsyeshëm se në qershor të vitit 2012, në Ferizaj, Kosovë dhe/ose gjetiu në Kosovë, të pandehurit M.S. dhe B.SH., në bashkë-kryerje, kanë kërkuar dhe pranuar një ofertë (konkretisht, pagesa monetare në shumë përafërsisht 4750 €) të një dobie të paligjshme për veten e tyre në këmbim të ushtrimit të ndikimit nga kryesi mbi vendim marrjen e një personi zyrtar që ose ta lirojë B.S.n nga paraburgimi ose të sigurohet se ai nuk do të dënohet dhe/ose të sigurohet se ai nuk do ta vuajë dënimin, pavarësisht nëse ndikimi ishte ushtruar ose nëse ndikimi i pretenduar qon në rezultatin e synuar.

934. Duke kryer kështu veprën Ushtrim i ndikimit, në kundërshtim me nenin 431 paragrafi 1 të KPK të vitit 2013, e dënueshme me gjobë ose me burg deri në tetë (8) vite.

935. Në lidhje me Pikat 4 dhe 5, trupi gjykues nuk ishte veçanërisht i impresionuar me dëshminë e dëshmitarit, policit N.S. apo provave të ofruara nga i pandehuri M.S. në mbrojtjen e tij. Sido që të jetë, trupi gjykues nuk ka mundur ti injoronte pohimet e vazhdueshme të policëve S. dhe O. që polici S. e kishte vendosur se çfarë lloji të dënimit (tiketës) t'ia shkruante para se kishte biseduar me të pandehurin M.S. dhe në respektim të parimit *in dubio reo*, ishte i obliguar t'ia falte B. të pandehurit M.S. . Trupi gjykues gjithashtu mori në konsideratë se i pandehuri V.T. ishte shpallur i pafajshëm për veprën Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore (për arsyet e përmendura infra) kështu që i pandehuri M.S. nuk duhet të dënohet si bashkë-konspirator.

V.T.

936. Në lidhje me Pikën 4 të aktakuzës, trupi gjykues e ka shpallur të pafajshëm të pandehurin V.T. sepse trupi konsideroi që formulimi i veprës në gjuhën angleze ishte dy kuptimesh deri në pikën ku në fakt nuk krijonte asnjë vepër. Neni 318, paragrafi 1 thekson:

937. *“Kushdo që me qëllim që vetes apo personit tjetër t’i mundësojë shmangien nga pagesa e tarifave tatimore doganore apo tarifave tjera ose detyrimeve doganore që paguhen me rastin e importimit apo eksportimit të mallrave, ose nëse doganës i paraqet dokument të rrejshëm lidhur me prejardhjen, vlerën, sasinë, cilësinë, llojin apo karakteristikat tjera të mallit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.”*

938. Në gjuhën angleze, ky formulim nuk krijon një vepër pasi që nuk ia del ta përshkruajë në mënyrë adekuate një sjellje të caktuar. Trupi gjykues gjithashtu konsideroi se kishte një dyshim sepse policët e Kosovës N.S. dhe SH. O. kanë dëshmuar se tashmë ata kishin vendosur se çfarë tikete t’ia shqiptonin për një kundërvajtje para intervenimit të M.S. dhe ta pranojë shpjegimin e të pandehurit V.T. se ai e kishte pranuar makinën si pagesë për punën dhe do ti formalizonte dokumentet sa më parë të jetë e mundur. Trupi gjykues e ka pranuar se versioni i tyre i ngjarjeve ishte i mundshëm dhe kjo ka ngritur dyshime tek ata dhe duke qenë kështu, ata ia falën B. të pandehurit V.T.

939. Prandaj, trupi gjykues ka vendosur ta shpallë të pafajshëm të pandehurin M.S. për akuzën Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore dhe Dhënia e ndihmës kryesit pas kryerjes së veprës penale sepse nuk ishte dëshmuar se ai ka kryer veprat për të cilat ishte ngarkuar dhe se faktet me të cilat i njëjti ishte akuzuar nuk përbëjnë vepër penale.

940. Në lidhje me Pikat 6 dhe 7, trupi gjykues e konsideroi se krejtësisht të papërshtatshëm që i pandehuri M.S. u paraqit në vendin e ngjarjes të incidentit. Dëshmia e tij ishte se ai kishte shkuar atje në cilësi jo-zyrtare por si një zyrtar i rangut të tij dhe me përvojë ai nuk është dashur ta bënte këtë. Në vend të kësaj, ai është dashur ta informonte

Heset S.n ta kontaktonte policinë lokale në Ferizaj të cilët duhet ta hetonin incidentin në mënyrë të zakonshme. Së dyti, është e qartë për trupin gjykues se kur i pandehuri M.S. arriti në vendin e ngjarjes ai tashmë ishte informuar se ishte shkrepur një armë zjarri dhe kush ishte i dyshuar. Ai megjithatë nuk ndërmori asnjë veprim tjetër hetimor, aq ma pak që ta arrestonte të pandehurin R.A. Trupi gjykues konstaton se kjo ka ndodhur pasi që i pandehuri M.S. ishte shok me të pandehurin R.A.. Në fakt, ai këtë ia kishte pranuar A. XH. kur ai kishte arritur në kafe “D.” në orët e hershme të mëngjesit. Trupi gjykues e konsideron deklaratën e M.S. t bërë asaj, se ajo duhet ta raportonte rastin në polici si jo të vërtetë dhe ai e ka ditur sigurt se ajo nuk do ta pranonte sepse ajo ishte në praninë e saj dhe se nuk donte ta involvonte veten e saj dhe/ose R.A. me organet e rendit. Trupi gjykues e konsideron si të dëshmuar se, kur M.S. arriti në vendin e krimit, shqetësimi i tij parësor nuk ishte hetimi por fshehja e veprave të cilat i pandehuri R.A. i kishte kryer dhe po përpiquej ti pajtonte palët. Për ta bërë këtë, ai mori të pandehurin R.A. dhe e qoi në kafe “D.” ku u mundua ta pajtonte atë me palën e dëmtuar A. Xh. Ndërmarrja e këtyre hapave ishin krejtësisht jo të duhur për një zyrtar të lart policor në secilën forcë policore. Në fakt, ishin vepra penale.

941. Në lidhje me Pikën 6 të aktakuzës, trupi gjykues është plotësisht i kënaqur që më 29 maj 2013, në Ferizaj, Kosovë dhe gjetiu në Kosovë, i pandehuri M.S. ishte informuar nga H.S.që shoku i tij R.A. kishte shtënë në drejtim të një automjeti afër një restoranti të quajtur “International”. I pandehuri M.S. nuk e kishte raportuar këtë incident dhe kishte intervenuar aktivisht për ta bindur viktimën (at) që formalisht të mos e raportonin incidentin në polici. Duke vepruar kësi soji, M.S. e kishte ndihmuar R.A. si kryes i veprës (konkretisht, Neni 365 (1) Shkaktim i Rrezikut të Përgjithshëm) neni 375 (2) Përdorimi i Armës apo i Mjetit të Rrezikshëm të KPK të vitit 2013, që janë vepra penale sipas Kapitullit XXX – Veprat me Armë të KPK të vitit 2013) për të shmangur zbulimin ose arrestimin dhe ka ndërmarrë veprime për të penguar arrestimin, ekzekutimin ose dënimin e R.A.t duke u siguruar që R.A. nuk do të raportohej për një vepër penale të cilën e kishte kryer.

942. Duke vepruar kështu, ka kryer veprën panel Dhënia Ndhimë Kryesit pas Kryerjes së Veprës Penale, në kundërshtim me nenin 388, paragrafët 1 dhe 2 të KPK të vitit 2013.

943. Në lidhje me Pikën 7 të aktakuzës, trupi gjykues është plotësisht i kënaqur se më 29 maj 2013, në Ferizaj, Kosovë dhe gjetiu në Kosovë, i pandehuri M.S. ishte informuar se shoku i tij R.A. kishte shtënë në drejtim të një automjeti afër një restoranti të quajtur “*International*”. M.S. nuk e kishte raportuar këtë incident, që përbën një veprë penale (konkretisht, Neni 365 (1) Shkaktim i Rrezikut të Përgjithshëm) neni 375 (2) Përdorimi i Armës apo i Mjetit të Rrezikshëm të KPK të vitit 2013, që janë vepra penale sipas Kapitullit XXX – Veprat me Armë të KPK të vitit 2013). Gjithashtu, trupi gjykues është i kënaqur që ky dënim nuk përbën një dënim të dytë përkitazi me të njëjtat fakte si në Pikën 6 më lart. Elementi kryesor fajësues në Pikën 6 është që M.S. i ka dhënë ndihmë një shoku kurse sipas Pikës 7, është se ai ka neglizhuar detyrën e tij si polic.

944. Duke vepruar kështu, ka kryer veprën panel Mos Raportim i Veprave Penale ose Kryesit pas Kryerjes së Veprave Penale në kundërshtim me nenin 386, paragrafin 1, nën-paragrafin 1.9 të KPK të vitit 2013.

945. Në lidhje me Pikën 8 të aktakuzës, trupi gjykues vëren se i pandehuri ka pasur më shumë municion se sa i lejohet një polici. M.S. e ka pranuar këtë dhe ka thënë se municioni ishte një mbetje e plumbave që i kishin mbetur pas ushtrimeve në poligon që ishin kryer në shoqëri të kolegëve ndërkombëtarë. Trupi gjykues konsideron se kjo veprë mbulohet me Ligjin mbi Amnistinë nr 04/L-209. Trupi gjykues po ashtu konsideron se është me rëndësi të thuhet se nuk ka pasur akuza ose prova të dhunës ose kanosjes që përfshin përdorimin e armëve ose ndryshe nga i pandehuri M.S. në asnjërën nga akuzat e paraqitura nga prokurori në aktakuzë.

946. Prandaj, trupi gjykues ka vendosur ta shpallë të pafajshëm M.S. n për akuzën Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të armëve, në kundërshtim me

nenin 374 paragrafin 1 sepse ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale.

G. PËRCAKTIMI I DËNIMIT

947. Si rrethana rënduese trupi gjykues i ka marrë në konsideratë faktet të cilat në kohën e veprave, i pandehuri M.S. ka qenë toger në Policinë e Kosovës që është një gradë e lartë që kërkon nivel të lartë të profesionalizmit dhe B. të cilat i pandehuri i ka keqpërdorur. Trupi gjykues gjithashtu ka vërejtur se i pandehuri ka vazhduar me keqpërdorimin e pozitës së tij zyrtare për më shumë se një vit. Një faktor veçanërisht rëndues është efekti gati katastrofik i sjelljes kriminale të të pandehurit në rastin e B.S., si personalisht ashtu edhe profesionalisht, dmth, mbi fatin e kompanisë familjare “Luboteni”.

948. Si rrethanë lehtësuese trupi gjykues ka marrë parasysh atë se trupi gjykues M.S. nuk ka qenë i dënuar më parë, ai ka një dosje të fortë të punës dhe gjithashtu një familje mbi të cilën sjellja e tij kriminale do të ketë ndikim negativ.

M.S. (dhe B.SH.):

AKUZA 1: KEQPËRDORIMI I DETYRËS ZYRTARE në bashkë kryerje, në kundërshtim me Nenin 339, paragrafin 2, në lidhje me paragrafin 1, në lidhje me Nenin 23 të KPK të vjetër, momentalisht e dënueshme me nenin 422 në lidhje me nenin 31 të KPK të vitit 2013.

Trupi gjykues i dënon me tre vite burg.

AKUZA: MARRJA E RYSHFETIT në bashkë kryerje, në kundërshtim me nenin 343, paragrafin 1, në lidhje me nenin 23 të KPK të vjetër.

Trupi gjykues i dënon me pesë vite burg.

AKUZA 3: USHTRIMI I NDIKIMIT në bashkë kryerje, në kundërshtim me Nenin 345, paragrafin 1, në lidhje me Nenin 23 të KPK të vjetër, momentalisht e dënueshme me Nenin 431, paragrafin 1, në lidhje me Nenin 31 të KPK të vitit 2013

Trupi gjykues i dënon me dy vite burg.

AKUZA 6: DHËNIA E NDIHMËS KRYESVE PAS KRYERJES SË VEPRËS PENALE, në kundërshtim me nenin 388, paragrafin 1 dhe 2 të KPK të vitit 2013.

Trupi gjykues i dënon me një vit burg.

AKUZA 7: MOS RAPORTIM I VEPRËS PENALE OSE KRYESVE, në kundërshtim me nenin 386, paragrafin 1, nën-paragrafin 1.9 të KPK të vitit 2013

949. Trupi gjykues i dënon më një vit burg.

Në pajtim me nenin 80.1 të KPRK-së, Gjykata i dënon me dënim unik prej shtatë (7) vitesh burg.

950. Sidoqoftë, sipas menit 83.1 të KPK-së, i pandehurit i llogarit koha e kaluar tashmë në paraburgim e cila llogaritet me sa vijon:

951. I pandehuri është arrestuar më 11 shtator 2013 dhe ishte privuar nga liria. Më 12 shtator 2013 i pandehuri ishte vendosur në paraburgim. Më 28 prill 2015 i pandehuri ishte liruar në arrest shtëpiak. Kryetari i trupit gjykues nuk e ka ndryshuar këtë masë kështu që deri më 6 tetor 2016, i pandehuri ka kaluar 1,121 ditë në paraburgim ose arrest shtëpiak. Më 6 tetor 2016, Kryetari i trupit gjykues ka lëshuar një vendim që urdhëron paraburgimin deri në momentin kur aktgjykimi merr formën e prerë.

952. Në bazë të neneve 42 paragrafit 1 dhe 65 paragrafit 1, i pandehuri M.S. përjashtohet nga mbajtja e çfarëdo pozite zyrtare për një periudhë pesë vjeçare.
953. Në bazë të neneve 41.1.3, 62.2.2, 64.1 të KPRK-së, trupi gjykues urdhër të pandehurin M.S. t'ia kompensojë familjes S.shumën prej 4,750 € të cilën ua kishte marrë në mënyrë të paligjshme duke marrë në konsideratë atë se të pandehurit M.S. dhe B.SH. kishin ndikuar në procedurën penale ndaj B.S. i pandehuri M.S. , bashkërisht dhe individualisht është përgjegjës me bashkë pandehurin tjetër B.SH. i cili gjithashtu ka pranuar fajësinë, për kthimin e shumës. Shumë e plotë duhet të kthehet deri më 31 dhjetor 2020. Nëse jo, prokurori mund ta rikthejë rastin para trupi gjykues apo çdo anëtar të tij për ta shqyrtuar një dënim alternativ.
954. I pandehuri M.S. poashtu *mund* të jetë përgjegjës ndaj familjes S.për dëmin ekonomik dhe personal të shkaktuar ndaj tyre si rezultat i veprimeve të tij. Familja S.kanë paraqitur padi në gjykatë në lidhje me këtë. Sidoqoftë, këto padi duhet të jenë subjekt i një procedure civile të ndarë ku dëmi i pretenduar duhet të saktësohet në detaje.
955. Në bazë të nenit 450 të KPK kostoja e procedurës do të kompensohet nga i pandehuri. Kostoja vlerësohet në shumën prej 500€.
956. Çdo padi pronësore duhet të ndiqet përmes gjykatave civile.

H. KONFISKIMI

957. Gjykata urdhëron konfiskimin e përhershëm të municionit të konfiskuar në vendbanimin e të pandehurit.

I. SHPENZIMET E PROCEDURËS

958. Në bazë të Nenit 450 të KPP shpenzimet e procedurës do të kompensohen nga i pandehuri e të cilat llogariten në shumën prej 500 Euro.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr. 250/13

Datë: 6 tetor 2016

Piotr Bojarczuk

Kryetar i trupit gjykues

Marie Tuma

Anëtare e trupit

Musa Konxheli

Anëtar i trupit

Hysni Recica

Procesmbajtës

KËSHILLË LIGJORE: Në bazë të Nenit 380 të KPP, personat e autorizuar mund të paraqesin ankesa kundër aktgjykimit pesëmbëdhjetë (15) ditë pas pranimin të aktgjykimit.

SHTOJCA 1: Provat dokumentuese

(1) E gjithë përmbajtja e Dosjes së Prokurorisë të paraqitur me Aktakuzën PPS. 05/2012 dhe përmbajtja e të cilës përshkruhet në Pikën V të Aktakuzën dhe që etiketohen me sa vijon:

1, 2A, 2B, 2 B, 3A, 3B, 3C, 4A, 4B, 5, 6A, 6B, 6C, 6D, 7 & 8.

(2) E gjithë përmbajtja e dosjes paraprake të gjykatës PP nr. 51/13 të etiketuar si vijon:
Volumet 1 – 7

(3) E gjithë përmbajtja e dosjes së gjykatës së gjykimit kryesor P.nr. 250/13 të etiketuar si vijon:

Volumet 1 – 27

(4) Dokumentet e kërkuara nga Gjykata dhe të paraqitura nga palët përkitazi me rastet në shkallën e parë dhe të dytë në lidhje me palën e dëmtuar B.S. dhe akuzat për Trafikimin e Qenieve Njerëzore. Këto mbahen në një dosje të ndarë P. Nr. 594/12.

(5) Dokumentet e paraqitura në gjykimin kryesor dhe që përfshihen në dosjen e gjykatës të shënuar si “Provat” dhe që përfshijnë por nuk kufizohen në:

- Kërkesa për kompensim dhe dokumentet mbështetëse të paraqitura nga pala e dëmtuar, B.S. në gjykimin kryesor më 19 shtator 2014;
- Dokumentet nga Dogana e Kosovës dhe Mendimi nga Gjykata Supreme e Kosovës i riparaqitur nga avokati për të pandehurin V.T. dhe avokati A.S. në mbështetje të kërkesës së tij datë 25 maj 2015;
- Dokumenti mjekësor i paraqitur nga avokati B.S., datë 17 mars 2016;
- Marrëveshje mbi hipotekën ndërmjet Bankës Komerciale JSC dhe “Luboteni” SHPK, A.S. dhe “BURIMI” SHPK.
- Dënimet e mëparshme të A.K. (“L.”) nga Gjykata Komunale në Prishtinë, datë 8 korrik 2009;
- Kërkesa për Lirimin e Pronës të paraqitur nga B.S. përmes avokatit të tij, B. S. në Gjykatën Themelore në Ferizaj, më 15 mars 2016;
- Dokumentet e nxjerra gjatë hetimit disiplinor kundër policit N.S. nga Policia e Kosovës.
- Kërkesa për kompensim për dëmtim material dhe jo material paraqitur nga pala e dëmtuar B.S. gjatë gjykimit kryesor, në seancën e 28 gushtit 2014;
- Vendimi i Gjykatës së Apelit, datë 13 mars 2014 me të cilin anulohet vendimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, datë 27 nëntor 2012;
- Deklarata e aseteve të kompanisë “Luboteni” në 2012;
- Dokumentet e paraqitura nga avokati B. S. gjatë gjykimit kryesor në seancën e datës 21 korrik 2016 në lidhje me shpenzimet e familjes S.